



RAPORTI VJETOR

I BANKËS SË SHQIPËRISË



*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
E-mail: public@bankofalbania.org*

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje

P Ë R M B A J T J A

FJALA E GUVERNATORIT	11
----------------------	----

KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	15
1.1 Ekonomia botërore	15
1.2 Politikat monetare të bankave qendrore kryesore dhe zhvillimet në tregjet financiare	20
1.3 Çmimi i lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare	22

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	27
2.1 Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë	27
2.2 Zhvillimet kryesore makroekonomike	35
2.3 Bilanci i pagesave	51
2.4 Politika fiskale dhe treguesit kryesorë fiskalë	56

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	67
3.1 Zhvillimet monetare	67
3.2 Zhvillimet në tregjet financiare	81

KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	93
4.1 Instrumentet e politikës monetare	93
4.2 Administrimi i rezervës valutore	100

KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	107
5.1 Ecuria e sistemit bankar	107
5.2 Licencimi dhe kuadri rregullativ	112
5.3 Mbikëqyrja në vend	117
5.4 Regjistri i kredive	123

KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	129
6.1 Zhvillimet në Sistemin e Pagesave	129
6.2 Emisioni i Parasë	136
6.3 Marrëdhëniet me Publikun	138
6.4 Integrimi Evropian dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar	141
6.5 Ndryshime në legjislacionin bankar gjatë vitit 2008	148

KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	155
Raporti i audituesve të pavarur	155

	Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë	157
	Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha balancat janë në milionë lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)	162
1.	Informacione të përgjithshme	162
2.	Bazat e përgatitjes	162
3.	Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	163
4.	Përdorimi i vlerësimit dhe gjykimeve	172
5.	Ari dhe metale të çmuara	174
6.	Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	174
7.	Depozita në bankat e huaja	175
8.	Investime në letra me vlerë në monedhë të huaj	175
9.	Aktive të tjera në monedhë të huaj	177
10.	Kredi për palët e treta	177
11.	Investime të vlefshme për shitje (në monedhë vendase)	178
12.	Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare për në rezervë	178
13.	Aktive të tjera (në monedhë vendase)	178
14.	Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	181
15.	Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	182
16.	Para në qarkullim	182
17.	Detyrime ndaj bankave vendase	183
18.	Detyrime ndaj qeverisë	183
19.	Detyrime të tjera (në monedhë vendase)	184
20.	Fondi i themelimit	185
21.	Rezerva ligjore	185
22.	Rezerva e rivlerësimit	186
23.	Rezerva të tjera	186
24.	Të ardhura nga interesat dhe komisionet (jo rezidentët)	187
25.	Shpenzime për interesa dhe komisione (jo rezidentët)	187
26.	Të ardhura nga interesa dhe komisione (rezidentët)	187
27.	Shpenzime për interesa dhe komisione (rezidentët)	187
28.	Të ardhura të tjera operative, neto	187
29.	Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto	188
30.	Shpenzime të personelit	188
31.	Paraja dhe ekuivalentët e saj	188
32.	Shtypshkronja	188
33.	Angazhime dhe garanci	189
34.	Aktive të administruara	190
35.	Palët e lidhura	190
36.	Administrimi i rrezikut	191

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA

Tabelë 1.	Disa tregues kryesorë makroekonomikë.	15
Tabelë 2.	Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.	17
Tabelë 3.	Tregues ekonomikë për vendet e rajonit për vitin 2008.	19

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

Tabelë 1.	Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).	29
Tabelë 2.	Normat vjetore të ndryshimit të disa përbërësve të IÇP-së dhe të IÇK-së të kategorisë "Ushqime të përpunuara" (në përqindje).	33
Tabelë 3.	Disa tregues të ekonomisë në vite.	38
Tabelë 4.	Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim (mesatarja e ndryshimeve vjetore të tremujorëve, në përqindje).	42
Tabelë 5.	Bilanci i sistemit elektroenergjitik shqiptar (në GWh).	42
Tabelë 6.	Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim sipas degëve të sektorit të shërbimeve ndër vite (mesatarja e ndryshimeve vjetore të tremujorëve, në përqindje).	46
Tabelë 7.	Tregues të aktivitetit të hoteleve (ndryshimi vjetor, në përqindje).	46
Tabelë 8.	Ecuria e treguesve të papunësisë dhe të të punësuarve (në mijë persona).	48
Tabelë 9.	Tregu i punës.	51
Tabelë 10.	Norma e papunësisë në Shqipëri dhe në rajon.	51
Tabelë 11.	Tregues të bilancit të pagesave në vite.	52
Tabelë 12.	Struktura e tregtisë së jashtme.	53
Tabelë 13.	Tregtia e jashtme sipas partnerëve tregtarë.	53
Tabelë 14.	Treguesit fiskalë në raport ndaj PBB-së (në përqindje), 2005-2008.	56
Tabelë 15.	Plani dhe fakti për treguesit buxhetorë për vitin 2008.	57
Tabelë 16.	Realizimi i të ardhurave buxhetore të ndara sipas zërave kryesorë.	58
Tabelë 17.	Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas zërave kryesorë.	60

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

Tabelë 1.	Rezerva valutore dhe tregues të mjaftueshmërisë (vendet e Evropës Qendrore e Lindore).	74
Tabelë 2.	Ecuria e treguesve të ndërmjetësimit në vendet e EQJL.	80

KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE

Tabelë 1.	Rezultati neto në miliardë lekë.	107
Tabelë 2.	Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative).	108
Tabelë 3.	Tregues kryesorë të rentabilitetit në përqindje(kumulative).	108
Tabelë 4.	Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.	109
Tabelë 5.	Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.	109
Tabelë 6.	Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2008.	109
Tabelë 7.	Ecuria e treguesit kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (në përqindje).	111
Tabelë 8.	Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave.	111
Tabelë 9.	Ecuria e treguesit kredi ndaj depozitave në përqindje.	112
Tabelë 10.	Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2007.	114
Tabelë 11.	Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2008.	114
Tabelë 12.	Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2000 deri në fund të vitit 2008.	116

KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Tabelë 1.	Ecuria e transaksioneve në AIPS për periudhën 2006-2008.	129
Tabelë 2.	Shpërndarja e transaksioneve në AIPS sipas tremujorëve të vitit 2008.	129
Tabelë 3.	Llojet e transaksioneve në AIPS.	130
Tabelë 4.	Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS.	130
Tabelë 5.	Numri dhe vlera e kredive brenda ditës për pjesëmarrësit në sistemin AIPS.	131
Tabelë 6.	Ecuria e pagesave në AECH për periudhën 2006-2008.	131
Tabelë 7.	Shpërndarja e pagesave në AECH sipas tremujorëve të vitit 2008.	131
Tabelë 8.	Shpërndarja e pagesave në AECH sipas seksioneve të klerimit gjatë vitit 2008.	132
Tabelë 9.	Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH.	132
Tabelë 10.	Numri total i llogarive bankare të klientëve në 31 dhjetor 2008.	133

Tabelë 11.	Numri total i ATM dhe POS në 31 dhjetor 2008.	133
Tabelë 12.	Numri total i kartave bankare në qarkullim në 31 dhjetor 2008.	133
Tabelë 13.	Numri total i transaksioneve të realizuara me karta bankare gjatë vitit 2008.	134
Tabelë 14.	Numri total i transaksioneve "home banking" gjatë vitit 2008.	134

KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008

Tabelë 1.	Bilanci më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)	157
Tabelë 2.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)	158
Tabelë 3.	Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe rezervave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)	159
Tabelë 5.	Pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe).	160
Tabelë 6.	Pasqyra e flukseve të parave (vazhdim) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)	161

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA

Grafik 1.	Ecuria e normave bazë të interesit në ekonomitë e mëdha.	20
Grafik 2.	Ecuria e yield-eve të disa letrave me vlerë në tregun amerikan (2007-2008).	21
Grafik 3.	Ecuria ditore e raportit euro/usd në tregjet ndërkombëtare.	22
Grafik 4.	Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para.	22
Grafik 5.	Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd.	22

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

Grafik 1.	Inflacioni vjetor sipas tremujorëve (në përqindje).	27
Grafik 2.	Norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë.	28
Grafik 3.	Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).	28
Grafik 4.	Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje).	30
Grafik 5.	Ecuria e inflacionit vjetor bazë dhe e normës bazë të interesit (në përqindje).	31
Grafik 6.	Ecuria e inflacionit vjetor sipas sektorëve të çmimeve të shportës së IÇK (në përqindje).	32
Grafik 7.	Ndryshime vjetore të çmimeve të konsumit (boshti djathtas) dhe të çmimeve të prodhimit dhe të importit (boshti majtas).	33
Grafik 8.	Ndryshimet vjetore të çmimeve të huaja dhe të çmimeve në vend (grafiku majtas) dhe të çmimeve të huaja dhe në vend të mallrave ushqimorë (grafiku djathtas) dhe kursi i këmbimit.	34
Grafik 9.	Ndryshimet vjetore të indeksit të vlerës njësi për importet e mallrave të konsumit dhe të çmimeve të konsumit (në përqindje).	35
Grafik 10.	Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend e jashtë dhe i kursit të këmbimit lekë/usd.	35
Grafik 11.	Shifra e afarizmit në vëllim sipas sektorëve të ekonomisë (mesatarja e ndryshimeve vjetore të tre tremujorëve të parë të secilit vit, në përqindje).	39
Grafik 12.	Treguesi i Tendencës Ekonomike (majtas) dhe Treguesi i Besimit të Biznesit dhe Konsumatorit (djathtas).	39
Grafik 13.	Treguesi i tendencës ekonomike dhe indeksi i shitjeve dhe i shifrës së afarizmit për ekonominë në total (ndryshime vjetore).	40
Grafik 14.	Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim dhe e kontributeve për aktivitetin ndërtues dhe atë industrial ndër vite (ndryshime vjetore, në përqindje).	41
Grafik 15.	Importet (në GWh) dhe përdorimi i energjisë elektrike (në përqindje ndaj burimeve).	43
Grafik 16.	Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimit të banesave (në terma nominalë dhe realë, majtas) dhe ndryshimi vjetor i indeksit të qirasë (në terma nominalë dhe realë, djathtas).	44
Grafik 17.	Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimit të banesave dhe indeksit të kushtimit në ndërtim (majtas) dhe indeksi i çmimit të banesave, indeksi i qirasë dhe mesatarja lëvizëse (djathtas).	45
Grafik 18.	Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim dhe kontributet sipas degëve përkatëse të sektorit të shërbimeve (ndryshime vjetore, në përqindje).	45
Grafik 19.	Numri i vizitorëve të huaj gjatë periudhës 2006-2008.	47
Grafik 20.	Raporti i vizitorëve të huaj për vitin 2008, sipas mënyrës së udhëtimit (majtas) dhe raporti i vizitorëve të huaj për vitin 2008, sipas qëllimit të udhëtimit (djathtas).	47
Grafik 21.	Ecuria e numrit të të punësuarve me pagesë në sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve (ndryshime vjetore, në përqindje).	48
Grafik 22.	Paga mesatare në sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve (grafiku majtas) dhe niveli i pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror (grafiku djathtas) - ndryshime vjetore, në përqindje.	49
Grafik 23.	Ecuria e pagës mesatare në sektorin e prodhimit (grafiku majtas) dhe në sektorin e shërbimeve (grafiku djathtas) - ndryshime vjetore, në përqindje.	49
Grafik 24.	Raporti i numrit të të papunëve të regjistruar sipas grupmoshës ndaj numrit të të papunëve të regjistruar (majtas) dhe raporti i numrit të të papunëve sipas nivelit arsimor ndaj numrit të të papunëve të regjistruar (djathtas) (në përqindje).	50
Grafik 25.	Bilanci tregtar (majtas) dhe llogaria korente (djathtas), në përqindje të PBB-së sipas zërave.	52
Grafik 26.	Llogaria kapitale dhe financiare në përqindje të PBB-së, sipas zërave.	55
Grafik 27.	Realizimi i treguesve kryesorë fiskalë përgjatë tremujorëve, T1 1999-T4 2008.	57
Grafik 28.	Ndryshimi nominal vjetor i të ardhurave, sipas kontributeve të grupeve	

	kryesore, 2000 – 2008.	58
Grafik 29.	Të ardhurat sipas grupeve kryesore në raport ndaj PBB-së, 2000-2008.	59
Grafik 30.	Ndryshimi nominal vjetor i shpenzimeve, sipas kontributeve të grupeve kryesore, 2000–2008.	60
Grafik 31.	Shpenzimet sipas grupeve kryesore në raport ndaj PBB-së, 2000-2008.	61
Grafik 32.	Ndryshimi vjetor i deficitit buxhetor, financimit të huaj e të brendshëm, 2000-2008.	61
Grafik 33.	Stoku i borxhit publik në përqindje ndaj PBB-së, 2000-2008.	61
Grafik 34.	Përbërja e stokut të borxhit të jashtëm (2008) dhe të brendshëm (2000-2008), sipas monedhave dhe instrumenteve.	62

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

Grafik 1.	Ndarja sektoriale e parasë në ekonomi dhe norma bazë e interesit.	67
Grafik 2.	Rritja vjetore e agregatëve monetarë dhe kontributi i përbërësve të ofertës monetare.	68
Grafik 3.	Ecuria e depozitave në total ndaj M3 dhe rritja vjetore sipas strukturës kohore.	70
Grafik 4.	Pesha e parasë në qarkullim ndaj PBB-së dhe pesha e depozitave në lekë ndaj M2.	71
Grafik 5.	Ecuria vjetore e depozitave në lekë dhe pesha e tyre ndaj totalit të depozitave.	72
Grafik 6.	Ecuria vjetore e depozitave në valutë dhe pesha e tyre ndaj parasë së gjerë.	72
Grafik 7.	Zhvillimet në portofolin e kredisë dhe treguesit e ndërmjetësimit.	75
Grafik 8.	Ecuria vjetore e rritjes së kredisë sipas monedhave (në përqindje dhe në miliardë lekë).	76
Grafik 9.	Zhvillimet e portofolit të kredisë për biznese.	77
Grafik 10.	Ecuria e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë.	77
Grafik 11.	Zhvillimet në portofolin e kredisë për individë.	78
Grafik 12.	Shpërndarja e depozitave dhe e kredisë sipas rretheve kryesore të vendit.	79
Grafik 13.	Ecuria e normave të interesit (majtas) dhe e vëllimit të huadhënies në tregun ndërbankar (djathtas).	82
Grafik 14.	Diferenca midis maturiteteve të yield-eve.	83
Grafik 15.	Ecuria e yield-it të letrave me vlerë të qeverisë.	83
Grafik 16.	Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER).	84
Grafik 17.	Ecuria ditore e kursit të këmbimit euro/lekë dhe usd/lek.	84
Grafik 18.	Ecuria e euros në raport me monedhat e vendeve të Evropës Lindore (indeks tetor'08 = 100).	85
Grafik 19.	Ecuria mesatare e raportit euro-monedhë vendase për shtetet e Evropës Lindore.	85
Grafik 20.	Luhatshmëria e lekut kundrejt monedhave kryesore (mesatare vjetore).	85
Grafik 21.	Ecuria e interesave të depozitave në lekë dhe në euro.	86
Grafik 22.	Ecuria e interesave të depozitave në lek dhe në euro.	86
Grafik 23.	Ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kredinë në lekë dhe atë në euro.	87
Grafik 24.	Spread-i i normës së interesave (norma e ndërmjetësimit) kredi-depozita për lekë dhe euro.	87

KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Grafik 1.	Operacionet e tregut të hapur dhe përdorimi i lehtësive të përhershme.	93
Grafik 2.	Operacioni kryesor i tregut sipas datave të ankandeve (në miliardë lekë).	94
Grafik 3.	Operacionet rregulluese të tregut sipas datave të ankandeve (në miliardë lekë).	95
Grafik 4.	Operacionet strukturore të tregut sipas datave të ankandeve (në miliardë lekë).	95
Grafik 5.	Rezerva e detyruar (në miliardë lekë).	99
Grafik 6.	Normat e remunerimit të rezervës së detyruar.	100

KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE

Grafik 1.	Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.	108
-----------	---	-----

KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Grafik 1.	Monedha në qarkullim.	136
Grafik 2.	Struktura e kartëmonedhës.	136
Grafik 3.	Struktura e monedhës metalike.	137
Grafik 4.	Raporti i monedhës metalike kundrejt kartëmonedhës.	137



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani.



Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në rreshtin e parë, nga e majta në të djathtë:

KSENOFON KRISAFI	Anëtar
ARDIAN FULLANI	Kryetar
TEFTA ÇUÇI	Anëtare
FATOS IBRAHIMI	Zëvendëskryetar

Në rreshtin e dytë, nga e majta në të djathtë:

LIMOS MALAJ	Anëtar
ARJAN KADAREJA	Anëtar
ADRIAN CIVICI	Anëtar
HALIT XHAFA	Anëtar
BENET BECI	Anëtar

FJALA E GUVERNATORIT

I dashur lexues!

Është kënaqësi e veçantë të takohem përsëri me ju, në këtë prezantim të përvitshëm të ecurisë së ekonomisë shqiptare dhe të punës së Bankës së Shqipërisë, jo vetëm për përmbushjen e mandatit të saj ligjor por edhe për zhvillimin e angazhimeve të saj institucionale.

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë është një pasqyrë besnike e opinionit të institucionit që unë drejtoj në lidhje me zhvillimet ekonomike gjatë vitit, problemeve, sfidave dhe masave të marra për ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë e financiarë, për përmirësimin e infrastrukturës së zhvillimit ekonomik, për zhvillimin e tregjeve të parasë dhe nxitjen e ndërmjetësimit financiar si dhe për një komunikim më të gjerë e transparent me publikun.

Ekonomia shqiptare u karakterizua përgjithësisht nga zhvillime pozitive gjatë vitit 2008. Rritja ekonomike ishte në linjë me parashikimet ndërkohë që ekuilibrat makroekonomikë kanë mbetur të fortë. Në veçanti, Banka e Shqipërisë e ka përmbushur objektivin e saj kryesor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke kontribuar në mbajtjen e një norme mesatare inflacioni prej 3.4 për qind përgjatë vitit 2008.


Megjithatë, në aspektin kronologjik, zhvillimi i ekonomisë së vendit ka kaluar dy faza qartësisht të dallueshme gjatë vitit. Nëntëmuji i parë i vitit u zhvillua në kontekstin e një klime globale mjaft më pozitive, sidomos në vendet tona partnere. Në përgjigje të ritmeve të larta të kreditimit, kjo periudhë u shoqërua jo vetëm me një kërkesë të lartë të brendshme dhe rritje të fortë ekonomike, por edhe me presione të dukshme inflacioniste dhe rritje të deficitit tregtar dhe të bilancit të llogarisë korente. Konsumi dhe investimi në ekonominë shqiptare kanë qenë të lartë gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, tremujori i fundit i vitit u karakterizua nga një ndikim në rritje i krizës financiare dhe ekonomike botërore në ekonominë e vendit. Kriza botërore u reflektua në lëkundjen e besimit të agjentëve ekonomikë në vend ndaj sistemit bankar dhe në lindjen e problemeve të likuiditetit në të. Gjithashtu, ato u shoqëruan me një ngadalësim të ritmit të rritjes së aktivitetit ekonomik dhe të ndërmjetësimit financiar në vend. Zhvillimet e mësipërme nxorën në pah rëndësinë që ka ruajtja e stabilitetit të sistemit financiar dhe ekuilibrave makroekonomikë në këndvështrimin e krijimit të premisave të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë. Këto probleme do të përbëjnë kryefjalën e politikave ekonomike gjatë vitit 2009 dhe në vijim.

Në aspektin institucional, viti 2008 është karakterizuar nga rritja e përpjekjeve tona për krijimin e infrastrukturës dhe të bazës rregullative të nevojshme për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Arritje të dukshme janë

shënuar në drejtim të forcimit të kapaciteteve analitike dhe vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë, të rishikimit dhe forcimit të rregulloreve të mbikëqyrjes, të plotësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ të zhvillimit të sistemit bankar, të zhvillimit të tregut ndërbankar dhe të perfeksionimit të instrumenteve tona të ndërhyrjes në të, zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të pagesave, të përmirësimit sasior e cilësor të komunikimit të Bankës së Shqipërisë me publikun etj.. Të gjitha këto zhvillime, do t'i gjeni të pasqyruara me transparencë në faqet e këtij Raporti Vjetor.

Duke falenderuar stafin e përkushtuar të Bankës së Shqipërisë për arritjet e tij dhe me bindjen se edhe viti 2009 do të shënojë hapa të mëtejshëm në forcimin institucional dhe të kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë, ju falenderoj për vëmendjen dhe interesin ndaj aktivitetit të këtij institucioni. Në vijim, ju ftoj të njiheni me analizat e zhvillimeve kryesore ekonomike dhe institucionale për vitin 2008.

ARDIAN FULLANI



Guvernator

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155

KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA

1.1 EKONOMIA BOTËRORE

Ekonomia botërore në vitin 2008 është karakterizuar nga një ngadalësim i ritmeve të rritjes, duke shënuar 3.4 për qind, pas një periudhe katërvjeçare me një rritje prej mesatarisht 5 për qind. Ky ngadalësim erdhi kryesisht si pasojë e krizës financiare që nisi në ShBA në vitin 2007 dhe mori përmasa më të gjera në mesin e vitit 2008, duke rritur shtrirjen gjeografike në vendet e zhvilluara evropiane dhe më pas në vendet e Evropës Qendrore e Lindore.

Kolapsi i tregut të kredive hipotekore solli zhvlerësimin e vazhdueshëm në bursë të aksioneve të institucioneve financiare, duke bërë që kriza të përcillej në segmente të ekonomisë. Këto kushte detyruan institucionet vendimmarrëse të zbatojnë politika monetare lehtësuese për t'i dhënë frymëmarrje tregut, si edhe paketa fiskale për të rritur besimin e publikut në sistemin financiar dhe për të ndihmuar bankat dhe industrinë e tjera të mëdha në vështirësi falimentimi, në disa raste duke shtetëzuar një pjesë të tyre.

Presionet inflacioniste kanë qenë të larta në gjysmën e parë të vitit, për t'u qetësuar më pas në pjesën në vazhdim. Inflacioni mesatar në nivel global shënoi vlerën 3.5 për qind për vitin 2008, nga 2.1 për qind që ishte në vitin 2007. Ky zhvillim është pasojë e rritjes së shpejtë të çmimit të energjisë dhe të ushqimeve, shkaktuar nga rënia e ofertës gjatë gjysmës së parë të vitit dhe e kërkesës relativisht të lartë. Me thellimin e krizës financiare në gjysmën e dytë të vitit 2008, çmimet kryesisht kanë ndjekur një prirje rënëse, e cila gjykohej të vijojë edhe gjatë vitit 2009.

Vendet	Rritja e PBB-së		Norma vjetore e papunësisë		Norma vjetore e inflacionit	
	2007	2008	2007	2008	2007	2008
ShBA	2.0	1.1	4.6	5.8	2.9	3.8
Eurozonë	2.7	0.9	7.5	7.5	2.1	3.3
Gjermani	2.5	1.3	8.4	7.3	2.3	2.8
Greqi	4.0	2.9	8.3	8.3 ¹	3.0	4.2
Itali	2.9	-0.6 ¹	6.1	6.7 ¹	2.0	3.5
Japoni	1.9	-0.6	3.9	4.0	0.0	1.4

Burimi: Komisioni Evropian, Eurostat, Institutet statistikore përkatëse.

¹ Vlerësime.

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë.

1.1.1. EKONOMIA E EUROZONËS

Ekonomia e Eurozonës ka njohur ritme të ngadalësuara të rritjes në vitin 2008 duke shënuar rreth 0.9 për qind, krahasuar me 2.7 për qind në vitin 2007. Viti 2008 është karakterizuar nga një ngadalësim i kërkesës së brendshme

dhe investimeve private, tkurrje e aktivitetit kreditues, rritje e papunësisë dhe tendencë rënëse e indekseve të besimit të biznesit dhe të konsumatorit.

Rritjen më të lartë ekonomike, Eurozona e shënoi në tremujorin e parë kur kriza financiare nuk ishte thelluar ende. Ajo u ndihmua nga rritja e shpenzimeve për konsum dhe nga zhvillimet pozitive në sektorin e ndërtimit. Në tre tremujorët vijues, ekonomia e Eurozonës ka shënuar tkurrje, duke hyrë kështu në recesion teknik. Ky ngadalësim ekonomik është pasojë e krizës financiare dhe e përçimit të saj në ekonomi. Kjo ka shkaktuar luhatje të tregut të banesave dhe falimentimin e disa prej institucioneve financiare të mëdha. Megjithë masat ndihmëse të marra nga BQE, ritmi i rritjes së kërkesës së brendshme dhe investimeve private është ngadalësuar ndjeshëm.

Inflacioni vjetor në Eurozonë shënoi vlerën 3.3 për qind për vitin 2008, duke qenë më lart se kufiri i sipërm prej 2 për qind i synuar nga BQE. Kontributin kryesor në këtë zhvillim e ka dhënë çmimi i energjisë dhe i ushqimeve të përpunuara¹. Norma e inflacionit ka patur një prirje rritëse deri në muajin gusht, kur arriti vlerën vjetore prej 3.8 për qind, për të pësuar një rënie në pjesën e mbetur të vitit.

1.1.2. EKONOMIA E SHBA

Pas një periudhe disavjeçare rritjeje të kënaqshme të PBB-së, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë karakterizuar nga një dobësim i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2008. Zhvlerësimi i pandërprerë i mjeteve financiare në bursa, përkeqësimi i bilancit të firmave kryesore financiare dhe rënia e përshpejtuar e çmimeve të banesave ndikuan në mënyrë direkte në ecurinë e ekonomisë reale. Shtrëngimi i kushteve të nevojshme për dhënie të kredive të reja dhe efekti i zhvlerësimit nominal të mjeteve të individëve dhe kompanive përshpejtuan rënien e indekseve të besimit të konsumatorëve e bizneseve dhe njëkohësisht, të investimeve agregate.

Gjatë gjysmës së parë të vitit, Qeveria Federale ndërmori disa masa në formën e lehtësimeve fiskale me synim ruajtjen e rritjes së shpenzimeve për konsum. Shoqëruar edhe me përmirësimin e kërkesës së jashtme për shkak të zhvlerësimit të dollarit amerikan kundrejt disa monedhave kryesore ndërkombëtare, këto masa administrative ndihmuan në rritjen e PBB-së me ritme relativisht të larta². Rritja e përshpejtuar e numrit të kredive të humbura gjatë gjysmës së dytë të vitit, dha efekt negativ në bilancin e shumë prej institucioneve financiare dhe kulmoi në falimentimin e disave prej tyre. Për pasojë, tregu ndërbankar u përball me mungesë të likuiditetit dhe bankat u detyruan të shtrëngojnë më tej kushtet e miratimit të kredive të reja. Investimet agregate dhe shpenzimet për konsum, dy ndër përbërësit kryesorë në përlllogaritjen e PBB-së, pësuan rënie me ritme të përshpejtuara në terma vjetorë. Dy treguesit e mësipërm kombinuar me rënien e eksporteve agregate për shkak të forcimit të dollarit amerikan dhe rënies së kërkesës në botë, shkaktuan kontraktimin e ekonomisë amerikane gjatë dy tremujorëve të fundit të vitit.

Të dhënat jo të favorshme të aktivitetit në industrinë prodhuese ndikuan në përkeqësimin e treguesve të punësimit në ekonomi. Numri mesatar i të papunëve u rrit me rreth 25 për qind në vitin 2008 kundrejt mesatares së vitit 2007, kryesisht si rezultat i rritjes së papunësisë në industrinë përpunuese, atë të ndërtimit dhe në sektorin financiar.

Rritja e vazhdueshme e çmimit të naftës, energjisë dhe lëndëve të para gjatë gjysmës së parë të vitit ushqeu rritjen e përsheptuar të normës së inflacionit gjatë muajve janar-gusht. Ndërkohë, ndryshimi i kahut të ecurisë së çmimeve të këtyre produkteve ndikoi në rënien e indeksit të çmimit të konsumit në muajt e fundit të vitit³.

1.1.3. EKONOMITË E BRIK⁴

Efekti i ngadalësimit ekonomik në vendet e industrializuara preku edhe vendet BRIK, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit. Integrimi gjithnjë e më i madh financiar dhe ekonomik midis rajoneve të ndryshme të botës bëri të mundur që turbullirat financiare, rritja dhe më pas rënia e çmimit të lëndëve të para e të naftës dhe humbja e besimit të investitorëve dhe bizneseve, të kushtëzojnë ecurinë ekonomike të vendeve BRIK.

Vendet	2007	2008	2007	2008
	Inflacioni		Rritja reale ekonomike	
Brazil	6.4	5.7	5.4	6.3 ²
Kinë	2.4	6.5 ¹	11.9	9.0
Indi	10.5	8.2	9.3	8.1 ²
Rusi	13.8	14.1	8.1	7.7 ²

Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.

Burimi: FMN, OECD, Institutet statistikore përkatëse.

¹Vlera mesatare e 11 muajve të parë të vitit 2008.

²Vlera mesatare e tre tremujorëve të parë të vitit 2008.

Megjithëse rënia e çmimit të lëndëve të para dobësoi disi treguesit e prodhimit industrial dhe ngadalësoi ritmet e rritjes së eksporteve gjatë gjysmës së dytë të vitit, në Brazil, ekonomia u rrit me ritme krahasimisht të larta në vitin 2008. Investimet agregate dhe shpenzimet për konsum vijuan të rriten me ritme të përsheptuara, por krijuan gjithashtu edhe presione inflacioniste të vazhdueshme e të tejzgjatura gjatë vitit 2008.

Rusia, u përball me zhvlerësimin e përsheptuar të bursës dhe me rënien e lirë të çmimit të monedhës vendase kundrejt monedhave kryesore ndërkombëtare. Pas një periudhe ku ekonomia përfitoi nga çmimet e larta të naftës dhe të energjisë, duke marrë parasysh pozicionin e Rusisë si vend eksportues i këtyre mallrave, rënia e përsheptuar e çmimeve gjatë gjysmës së dytë të vitit ndikoi në dobësimin e kërkesës së brendshme dhe përkeqësimin e llogarisë tregtare. Norma e inflacionit shfaqti prirje rënëse gjatë muajve të fundit të vitit, por megjithatë mbeti në nivele të larta.

Në Indi, ngadalësimi i ritmit të rritjes së kërkesës së brendshme në kushtet e një prirjeje rritëse të normës së inflacionit dhe reduktimi i kapacitetit prodhues të kompanive vendase ndikuan në ngadalësimin e rritjes së PBB-së.

Gjatë vitit 2008, ekonomia e Kinës u përball me dobësimin e ritmeve të rritjes së kërkesës së jashtme ndonëse ajo shënoi një rritje dyshifrore prej 17.2 për qind⁵. Kjo erdhi si pasojë e dobësimit të kërkesës në vendet e zhvilluara dhe dha një kontribut thelbësor në moderimin e ritmeve të rritjes ekonomike këtë vit. Në mënyrë që të ruante ecurinë pozitive të shpenzimeve për konsum, Qeveria Kineze ndërmori disa politika të ndryshme fiskale në formën e investimeve publike dhe të uljes së taksave për individët.

1.1.4. Ekonomitë e vendeve të rajonit

- *ITALI*

Gjatë vitit 2008, ecuria e ekonomisë italiane u kushtëzua nga turbullirat financiare e ekonomike në tregjet ndërkombëtare. PBB-ja u kontraktua me mesatarisht 0.6 për qind në terma vjetorë krahasuar me vitin 2007. Kjo erdhi si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme dhe të investimeve. Nënçmimi i shpejtë i vlerës së mjeteve financiare, rënia e të ardhurave reale të disponueshme të individëve e të familjarëve dhe frika për përkeqësimin e treguesve të punësimit ndikoi në stepjen e shpenzimeve për konsum⁶. Zhvlerësimi i monedhës së përbashkët evropiane nuk ishte i mjaftueshëm për të shuar efektin e rënies së kërkesës për eksportet italiane në tregjet brenda dhe jashtë Bashkimit Evropian. Megjithatë, rënia me ritme më të përshpejtuara e importeve agregate ndihmoi në krijimin e një kontributi pozitiv të eksporteve neto në përllogaritjen e PBB-së.

Çmimet e larta të lëndëve bazë dhe kërkesa e dobët për mallra e shërbime italiane kushtëzuan aktivitetin ekonomik në industrinë prodhuese. Gjatë vitit 2008, prodhimi industrial ra me afërsisht 4 për qind krahasuar me një vit më parë. Të dhënat për industrinë e ndërtimit flasin për ulje të kapacitetit prodhues në total, ndërkohë që çmimi mesatar i banesave nuk ka ndjekur prirjen rënëse që karakterizoi vendet e Eurozonës këtë vit. Norma mesatare e inflacionit për vitin 2008 ishte 3.5 për qind ku vlerat më të larta të saj u përqendruan në gjysmën e parë të vitit.

- *GREQI*

Ekonomia e Greqisë rezultoi më e mbrojtur nga efektet e krizës ekonomike që përfshiu vendet e industrializuara. Rritja mesatare e PBB-së në terma vjetorë për vitin 2008 ishte më e lartë se mesatarja e vendeve të Eurozonës dhe shënoi vlerën 2.9 për qind. Kjo i atribuohet rritjes së qëndrueshme të shpenzimeve për konsum dhe rritjes me ritme të moderuara të eksporteve të mallrave e shërbimeve, pavarësisht rënies së investimeve agregate⁷.

Kreditë konsumatore, kryesisht për blerjen e banesave të reja dhe ato për biznesin kanë rënë gjatë vitit 2008, fakt që përforcohet edhe nga rënia e indekseve të besimit të biznesit dhe konsumatorëve për këtë vit. Kështu,

prodhimi industrial ra me 3.7 për qind në terma vjetorë si rezultat i dobësimit të aktivitetit në industrinë përpunuese dhe në sektorin energjitik. Industria e ndërtimit, në të kundërt, vijoi të rritet në bazë vjetore edhe këtë vit, ndonëse me ritme më të moderuara se një vit më parë. Norma e inflacionit shfaqti prirje rritëse deri në muajin shtator, periudhë kur filloi shuarja e presioneve mbi këtë tregues⁸.

Vendet	Rritja vjetore e PBB-së	Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë	Llogaria korente ³	Deficiti buxhetor ³
Itali	-0.6 ¹	3.5	6.7 ¹	-2.2	-2.8
Greqi	2.9	4.2	8.3 ¹	-13.4	-3.4
Maqedoni	5.8 ²	8.3	33.9 ²	-12.9 ⁴	3.0 ⁴
Serbi	6.1	13.6	14.2 ²	-20.7 ⁵	-0.3 ⁴
Kroaci	3.1 ²	6.1	13.3	-10.9 ⁴	-2.1 ¹
Turqi	3.2 ²	10.4	15.2 ²	-6.0 ⁴	-1.4 ¹

Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit për vitin 2008.

Burimi: Institutet statistikore përkatëse, Eurostat, Komisioni Evropian.

¹ Vlerësime 2008.

² Vlera mesatare për tre tremujorët e parë të vitit 2008.

³ Raporti në përqindje ndaj PBB-së.

⁴ Vlera në tremujorin e tretë të vitit 2008.

⁵ Vlera në tremujorin e dytë të vitit 2008.

• REPUBLIKA ISH-JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

Rritja ekonomike në RIJM për nëntëmuajorin e parë të vitit 2008 ishte mesatarisht 5.7 për qind, lehtësisht më lart se rritja e nëntëmuajorit të parë të vitit 2007 në vlerën 5.5 për qind. Sektorët e prodhimit dhe të ndërtimit ishin kontribuesit kryesorë në formimin e këtij treguesi, ndërkohë që rritja e prodhimit bujqësor ishte më e ulët se norma e rritjes ekonomike.

Presionet inflacioniste kanë qenë të larta për vitin 2008. Inflacioni për këtë periudhë shënoi vlerën 8.3 për qind krahasuar me 2.3 për qind në vitin 2007. Nxitësi kryesor i kësaj rritjeje ishte rritja e shpejtë e çmimit të energjisë dhe të ushqimeve, si pasojë e kushteve jo të favorshme klimaterike.

• TURQI

Ekonomia në Turqi shënoi një ngadalësim të normave rritëse gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2008, kur arriti vlerën mesatare prej 3.2 për qind krahasuar me rreth 5 për qind gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2007. Ky ngadalësim erdhi si pasojë e rënies së ritmeve të rritjes së investimeve private dhe të shpenzimeve për konsum. Parashikimet tregojnë për vlera më të ulëta të rritjes në tremujorin e katërt të vitit, gjë që pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2009.

Inflacioni vjetor në Turqi shënoi vlerën 10.4 për qind gjatë vitit 2008, nga 8.3 për qind në vitin paraardhës. Rritje të konsiderueshme ka pësuar çmimi i energjisë dhe ai i ushqimeve të përpunuara. Presionet inflacioniste u ulën gjatë muajve të fundit, ku muaji dhjetor shënoi vlera negative vjetore si pasojë e rënies së çmimit të veshjeve dhe qirave për shtëpi.

1.2 POLITIKAT MONETARE TË BANKAVE QENDRORE KRYESORE DHE ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE


Përgjatë vitit 2008, tregjet financiare u përballën me luhatje të pazakonta, të mëdha dhe të befta si pasojë e ristrukturimit të bilanceve të institucioneve financiare dhe reagimeve të agjentëve, pas pasigurisë që solli tronditja financiare e nisur në vitin 2007. Kjo ndjesi ka prekur pothuajse të gjitha segmentet e tregut financiar. Goditja më e madhe erdhi në tremujorin e tretë, kur në muajin shtator u lajmërua falimentimi i Lehman Brothers gjë që bëri që indekset në bursë të pësonin rënie dhe luhatshmëri në vlera historike.

Me qëllim zbehjen dhe normalizimin e këtyre tensioneve në tregjet financiare botërore, autoritetet monetare morën masa të koordinuara dhe të menjëhershme⁹. Disa prej tyre, kanë ulur normat e interesit në vlerat më të ulëta historike. Ecuria pozitive e çmimeve për lëndë të para, gjatë periudhës në fjalë, ka mundësuar këto autoritete që të ndryshojnë fokusin e tyre nga politikat anti-inflacioniste në ato lehtësuese, me qëllim zbutjen e kostos së parësë për institucionet financiare.

Banka Qendrore Evropiane ka ndryshuar katër herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2008. Nga këto vetëm një herë (në muajin korrik 2008) norma e interesit u rrit me 0.25 pikë përqindjeje, me qëllim kontrollin e presioneve inflacioniste të sinjalizuar nga zhvillimet në gjysmën e parë të vitit. Në tremujorin e fundit, politika monetare ndryshoi në kahun lehtësues dhe norma bazë e interesit u ul dy herë me nga 0.50 pikë përqindjeje, dhe një herë me 0.75 pikë përqindjeje. Në muajin janar 2008, norma bazë e interesit ishte 4.0 për qind, ndërsa në muajin dhjetor ajo shënonte 2.5 për qind.

Rezerva Federale uli shtatë herë normën e interesit gjatë vitit 2008 duke e çuar atë në 0-0.25 për qind, nga 4.25 për qind në fillim të vitit. Këto ulje të normës në vlera minimale historike janë ndërmarrë, për të nxitur aktivitetin kreditues në rënie pas problemeve financiare në SHBA.

Grafik 1. Ecuria e normave bazë të interesit në ekonomitë e mëdha.



Burimi: Bankat qendrore përkatëse.


Banka e Anglisë, gjithashtu ka ndërmarrë një politikë monetare lehtësuese, duke e ulur pesë herë normën e interesit në vlerën 3.0 për qind, nga 5.5 për qind që ishte në fillim të vitit. Këto vendime u morën në kuadrin e masave për të frenuar ngadalësimin ekonomik dhe rrjedhojat negative të zhvillimeve në tregjet financiare.

Pavarësisht hapësirës së kufizuar, Banka e Japonisë ka ulur normën e interesit, me dy lëvizje të njëpasnjëshme me nga 0.2 pikë përqindjeje, duke e çuar normën në 0.1 për qind në muajin dhjetor. Kjo lëvizje u bë pas parashikimeve për një ngadalësim të mëtejshëm të aktivitetit ekonomik në Japoni gjatë vitit 2009.

Stimuli monetar dhe fiskal ka bërë që në fund të vitit 2008, normat e interesit në tregjet financiare ndërkombëtare të ulen. Kështu, gjatë muajve të fundit të vitit, normat e interesit në tregjet ndërbankare pësuan një rënie të ndjeshme, duke reflektuar uljen e normave bazë të bankave qendrore përkatëse. Pavarësisht rënies së normave të interesit në këto tregje, tensionet dhe perceptimi i rrezikut nga pjesëmarrësit duket se janë ende në nivele të larta. Kjo reflektohet nga vëllimet e larta të likuiditetit të pashfrytëzuar në formën e depozitave njëditore, si dhe nga dinamika e lartë e normave të interesit të aplikuara në këto tregje për shkëmbimin e fondeve të pasiguruara. Kështu, diferenca midis normës së interesit të bonove qeveritare amerikane dhe normës së LIBOR-it në kohë të volitshme ekonomike vlerësohet të luhatet me 25 deri në 50 pikë bazë. Pas evidentimit të shenjave të para të krizës financiare, gjatë verës së vitit 2007, kjo diferencë u luhat me rreth 100 pikë bazë deri në kulmin e saj, në shtator të vitit 2008, kur u regjistrua një ndryshim prej 487 pikësh bazë.

Në linjë me uljen e normës bazë të interesit prej Rezervës Federale në vlerën 0.00 - 0.25 për qind, normat e interesit të bonove të Qeverisë Amerikane pësuan rënie të mëtejshme. Në muajt e fundit të vitit arritën në disa raste dhe normë interesi negative. Tregu i obligacioneve të korporatave dëshmoi për një korrektim të preferencave të investitorëve duke i paraprirë rishikimit të renditjes së rrezikut të kredisë. Kërkesa e rritur për obligacione të klasifikuara deri në atë kohë si më të sigurta prej agjencive të kreditimit u pasqyrua në *yield*-e mesatarisht më të larta për vitin 2008. Ky fakt dëshmon edhe për humbjen e besimit të investitorëve në kushtet e përkeqësimit të deklaratave financiare të kompanive më të mëdha amerikane dhe humbjes së vazhdueshme të vlerës së mjeteve të tyre.

Grafik 2. Ecuria e *yield*-eve të disa letrave me vlerë në tregun amerikan (2007-2008).



Burimi: Moody's.

Një tjetër zhvillim për t'u përmendur është ndikimi që ka pasur dobësimi i ekonomive reale në disa vende të zhvilluara të Evropës Lindore në tregjet financiare. Vende si Hungaria, Çekia, Polonia apo Rumania janë përballur me një rritje të vazhdueshme të deficitit buxhetor, zhvlerësim të monedhës vendase dhe reduktim të investimeve direkte hyrëse gjatë vitit 2008. Gjithashtu, problemet financiare që këto vende përjetuan, kombinuar me aplikimin për miratimin e borxheve prej disa institucioneve kryesore ndërkombëtare financiare, kanë ndikuar në rishikimin e klasifikimit të bonove të tyre qeveritare. Kështu, agjencitë e kreditimit ulën nivelin e klasifikimit të bonove qeveritare hungareze në muajin nëntor të këtij viti, ndërsa bonot qeveritare të Polonisë dhe të Çekisë ishin disi më të qëndrueshme.


Në tregjet valutore ndërkombëtare, gjatë vitit 2007 dhe në fillim të vitit 2008 pozicionimi në shitje i monedhës amerikane dukej si zgjidhja më e përshtatshme, duke u mbështetur në faktin se kjo ishte nënçmuar gjatë kësaj periudhe kundrejt euros me 13 për qind dhe kundrejt jenit japonez dhe paundit anglez me 10 dhe 8.5 për qind. Ecuria pozitive e raportit euro/usd në

Grafik 3. Ecuria ditore e raportit euro/USD në tregjet ndërkombëtare.




Burimi: BQE.

Grafik 4. Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para.



Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Grafik 5. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/USD.



Burimi: Eurostat, Administrata për Informacionin Energjetik.

gjashtëmujorin e parë të vitit duket të ketë rrjedhur nga ecuria pozitive e treguesve makroekonomikë në Eurozonë dhe nga politikat shtrënguese (rritje e normës bazë) të autoritetit monetar evropian, në kundërshti me atë amerikan (ulje e normës bazë), duke bërë që ky raport të tregtohet deri në vlera maksimale 1.579.

Që nga muaji gusht vihet re një vlerësim i monedhës amerikane duke u mbiçmuar me 2.9 për qind kundrejt monedhave të tjera kryesore dhe me 4.2 për qind, kundrejt monedhës evropiane deri në fund të vitit. Kërkesa e lartë për dollarin amerikan nga shumë institucione financiare, ecuria jopozitive e ekonomisë së Eurozonës si dhe të dhënat e fundit të disa treguesve makroekonomikë poshtë pritjeve të agjentëve të tregut, kanë ndikuar këto zhvillime.

1.3 ÇMIMI I LËNDËVE TË PARA NË TREGJET NDËRKOMBËTARE

Indeksi i Çmimit të Mallrave kryesorë pësoi një rritje mesatare prej 27.6 për qind gjatë vitit 2008, ndërsa në vitin 2007 pati shënuar një rritje prej 11.8 për qind. Rritje të përshpejtuar kanë regjistruar Indeksi i Çmimit të Ushqimeve dhe ai i Çmimit të Karburantit, me përkatësisht 23.4 dhe 40.3 për qind për vitin 2008. Të tre indekset kanë ndjekur një prirje rritëse gjatë pjesës së parë të vitit, si pasojë e pakësimit të ofertës në kushtet e një kërkesë relativisht të lartë. Ato kanë njohur rënie gjatë gjithë gjysmës së dytë të 2008-ës si pasojë e tkurrjes së kërkesës dhe e ngadalësimit të ekonomisë botërore.

• ÇMIMI I NAFTËS

Tregu ndërkombëtar i naftës u karakterizua nga një luhatshmëri e lartë e çmimit të saj për fuçi. Prirja rritëse, e cila dominoi gjatë gjysmës së parë të vitit, çoi çmimin e naftës në nivelet e tij më të larta historike. Pika kulmore u arrit në muajin qershor kur një fuçi naftë tregtohej me rreth 134 dollarë amerikanë. Kjo erdhi si pasojë e dobësimit të monedhës amerikane kundrejt monedhave kryesore ndërkombëtare, e rritjes së përshpejtuar të çmimeve të lëndëve të para dhe si pasojë e përqendrimit të investimeve financiare në tregun e naftës në kushtet e rënies së lirë të vlerës së bursave kryesore ndërkombëtare¹⁰.

Gjatë kësaj periudhe, kërkesa për naftë në vendet e OECD, megjithëse po dëshmonte shenjat e para të rënies, shënonte akoma vlera të larta. Përballur me kushtet jo të mira klimaterike dhe trazirat gjeopolitike në disa prej rajoneve kryesore të prodhimit të naftës, oferta shënoi ritme të ngadalësuar të rritjes gjatë po të njëjtës periudhë. Muaji korrik i vitit 2008 shënoi pikën e ndryshimit të kahut të ecurisë së çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar. Të dhënat jo të favorshme mbi rritjen ekonomike në vendet e OECD, ngadalësimi i rritjes në disa prej vendeve kryesore në zhvillim si dhe vlerësimi i dollarit amerikan ndikuan në rënien e përshpejtuar të çmimit të naftës për fuçi.

Në tremujorin e fundit të vitit, çmimi për fuçi ra me mesatarisht 50 për qind dhe arriti në vlera të barabarta me ato të vitit 2004. Ndonëse ritmet e rritjes së kërkesës për naftë në ekonomitë e vendeve në zhvillim mbetën pozitive, ato nuk ishin të mjaftueshme për të mënjeluar kontraktimin e kërkesës si pasojë e dobësimit të kërkesës së brendshme në vendet e industrializuara. Në këto kushte, vendet e OPEK-ut vendosën në dy takimet e tyre në muajt tetor e nëntor, të ulin kapacitetet e tyre prodhuese me rreth 4.2 milionë fuçi, në mënyrë që të mundësonin ndryshimin e kahut të prirjes së çmimit. Gjatë vitit 2008, vlera e një fuçie naftë u rrit me 38 për qind krahasuar me vitin 2007, dhe i atribuohet rritjes së çmimit gjatë periudhës janar-qershor të vitit.

SHËNIME

¹ Rritja e çmimit të energjisë për vitin 2008 ka qenë 10.8 për qind ndërsa ajo e ushqimeve të përpunuara 6.1 për qind.

² PBB-ja në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 u rrit mesatarisht 2.3 për qind.

³ Norma mesatare e inflacionit në terma vjetorë për periudhën janar-gusht ishte 4.0 për qind, ndërsa për periudhën shtator-dhjetor ishte 2.1 për qind.

⁴ Vendet BRIK janë Brazili, Rusia, India dhe Kina.

⁵ Në vitin 2007, eksportet u rritën me 25.7 për qind.

⁶ Shpenzimet për konsum ranë me mesatarisht 0.4 për qind gjatë tre tremujorëve të parë të vitit kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë.

⁷ Importet ranë me 0.2 për qind në terma vjetorë ndërsa eksportet u rritën me 3.7 për qind.

⁸ Norma e inflacionit në muajin shtator ishte 4.7 për qind ndërsa në dhjetor 2.2 për qind.

⁹ Në datën 8 tetor 2008, Rezerva Federale (Fed), Banka Qendrore Evropiane (BQE), Banka e Suedisë, Banka e Anglisë, Banka e Kanadasë dhe Banka Kombëtare e Zvicrës ulën normat bazë të interesit me 0.50 pikë përqindje në një lëvizje të koordinuar të paprecedentë. Banka Qendrore e Kinës uli normën e saj me 0.27 pikë përqindje, ndërsa Banka e Japonisë u shpreh se mbështeste lëvizjen.

¹⁰ Dollari amerikan u nënçmua me rreth 12 për qind kundrejt monedhës së përbashkët evropiane gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

2.1 STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË


Megjithë luhatjet e ndjeshme, viti 2008 u karakterizua nga një stabilitet i kënaqshëm i çmimeve të konsumit. Inflacioni vjetor u luhat përgjatë intervalit 2.2 – 4.6 për qind, duke qenë brenda tolerancës së Bankës së Shqipërisë prej 2-4 për qind gjatë pjesës më të madhe të vitit. Norma mesatare e inflacionit vjetor gjatë vitit 2008 shënoi vlerën 3.4 për qind, duke qenë afër objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3 për qind.¹ I nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të lëndëve bazë (ushqime dhe naftë)² në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e çmimit të energjisë në vend³, inflacioni mesatar vjetor shënoi përkatësisht vlerat 3.7 dhe 4.2 për qind gjatë tremujorëve të parë dhe të dytë të vitit. Ndërkohë, inflacioni vjetor shënoi rënie gjatë gjysmës së dytë të vitit, si pasojë e rënies së çmimeve të lëndëve bazë në tregjet ndërkombëtare.

Megjithëse në rritje të vazhdueshme gjatë tre viteve të fundit, kërkesa e brendshme mbeti në nivele të kontrolluara edhe gjatë vitit 2008. Rënia e çmimeve të lëndëve bazë në tregjet botërore, e reflektuar në çmimet e naftës dhe të ushqimeve në tregun vendas, pritjet e ankoruara inflacioniste, nivelet e kontrolluara të zgjerimit monetar si dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore në përputhje me programin, ndihmuan në krijimin e një ambienti të përshtatshëm makroekonomik për kontrollin e presioneve inflacioniste. Rënia e inflacionit vjetor gjatë gjashtëmujorit të dytë, tregoi se goditjet e faktorëve të ofertës gjatë gjysmës së parë të vitit nuk u reflektuan në efekte të raundit të dytë apo në rritjen e pritjeve inflacioniste të agjentëve ekonomikë.

Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë monetare neutrale gjatë vitit 2008. Norma bazë e interesit u mbajt e pandryshuar në 6.25 për qind. Niveli i saj ishte në përputhje me mbajtjen e inflacionit brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste rreth këtij objekti, në kushtet kur kërkesa e brendshme dhe inflacioni i importuar ishin në nivele të larta. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë mori masa për shtrëngimin e standardeve të kredidhënies, duke garantuar cilësinë e portofolit të kredisë së bankave dhe duke frenuar ritmet e larta të rritjes së saj, të cilat kanë ushqyer kërkesën e brendshme gjatë kësaj periudhe.


Tremujori i fundit i vitit 2008 paraqiti një sjellje mjaft të ndryshme të treguesve ekonomikë. Nën ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike botërore,

Grafik 1. Inflacioni vjetor sipas tremujorëve (në përqindje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 2. Norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë.




aktiviteti ekonomik dhe presionet inflacioniste erdhën në rënie gjatë kësaj periudhe. Në linjë me parashikimet e Bankës së Shqipërisë, norma vjetore e inflacionit shënoi rënie të vazhdueshme, duke qëndruar mesatarisht në nivelin 2.5 për qind gjatë tremujorit të fundit dhe duke shënuar vlerën 2.2 për qind në muajin dhjetor.

2.1.1 ECURIA E ÇMIMEVE TË KATEGORIVE KRYESORE TË SHPORTËS SË MALLRAVE TË KONSUMIT

Ecuria e normës së inflacionit gjatë vitit 2008, reflektoi kryesisht efektin e rritjes globale të çmimeve të mallrave të përdorimit të gjerë (kryesisht mallrave ushqimorë dhe karburanteve). Inflacioni vjetor u luhat ndjeshëm përgjatë vitit. Në gjashtëmujorin e parë, ai u luhat në vlera mbi nivelin e tolerancës së objektivit të Bankës së Shqipërisë, duke arritur në 4.6 për qind në muajin mars; norma më e lartë kjo e 5 viteve të fundit. Rritja e fortë e çmimeve të disa prej lëndëve të para në tregjet botërore, si drithi dhe nafta, në prani të ofertës së pamjaftueshme vendase për prodhime bujqësore dhe të krizës energjitike, shkaktuan rritjen e presioneve inflacioniste në vend. Rritja e çmimit të energjisë, shtoi ndikimin e presioneve të brendshme inflacioniste në zhvillimet e çmimeve të mallrave të konsumit. Madhësia dhe ndodhja e njëkohshme e këtyre goditjeve, u reflektuan në norma të larta inflacioni gjatë pjesës së parë të vitit. Në gjashtëmujorin e dytë, norma vjetore e inflacionit u karakterizua nga vlera të ulëta të inflacionit në të gjitha kategoritë që ndikuan në rritjen e lartë të çmimeve në periudhën gusht 2007-qershor 2008. Si rezultat, në fundin e vitit 2008, norma e inflacionit ishte afër kufirit të poshtëm të tolerancës së objektivit të dëshiruar. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2008, norma mesatare e inflacionit në tremujorin e katërt ishte 1.2 pikë përqindjeje më e ulët.

Grafik 3. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Rënia e çmimeve të produkteve ushqimore, e ndikuar nga ecuria e prodhimit të brendshëm bujqësor dhe e çmimit të drithërave në tregun botëror si dhe rënia e çmimit të karburanteve, shkaktuan ndryshimin e prirjes së normës vjetore të inflacionit në pjesën e dytë të vitit.

Kontributet e disa prej kategorive të mallrave dhe shërbimeve në inflacionin total gjatë pjesës së dytë të vitit 2008, kanë ndryshuar dukshëm madhësinë me të cilën ndikuan në normën vjetore të inflacionit, krahasuar me periudhën njëvjeçare paraprirëse. Megjithatë vazhdon të japë efektin kryesor në normën e përgjithshme të inflacionit, gjatë tremujorit

të fundit të vitit, kategoria “Ushqime të përpunuara” ka pothuajse përgjysmuar kontributin e saj në inflacionin vjetor, krahasuar me periudhën shkurt-qershor. Ky kontribut ishte në vlera të përafërta me ato të shënuara para fillimit të krizës, në gjysmën e dytë të vitit 2007. Mesatarisht, kontributi i kësaj kategorie në normën e inflacionit në periudhën njëvjeçare gusht 2007-korrik 2008, ishte 2.5 pikë përqindjeje përkundrejt një inflacioni mesatar të periudhës prej 3.9 për qind. Në periudhën gusht-dhjetor '08, ky kontribut ra në 1.8 pikë përqindjeje, përkundrejt një inflacioni mesatar prej 2.5 për qind. Rënia e çmimeve të kësaj kategorie, duke filluar nga muaji gusht, ishte kryesisht rezultat i lehtësimit të presioneve të forta inflacioniste që vinin nga tregjet e huaja të këtyre mallrave, por njëkohësisht edhe i shuarjes - në pjesën më të madhe – të efekteve të rritjes së çmimit të bukës gjatë periudhës gusht 2007-shkurt 2008.

Inflacioni vjetor i kategorisë “Ushqime të papërpunuara”, shënoi vlera negative gjatë gjithë vitit 2008. Inflacioni i kësaj kategorie, ka rënë mesatarisht me 2.3 pikë përqindjeje që nga dhjetori i vitit të kaluar. Norma e inflacionit e kësaj kategorie ndikohet kryesisht nga çmimet e frutave dhe perimeve, të cilat janë shumë të luhatshme dhe me natyrë sezonale. Për periudhën maj-shtator '08, çmimet e frutave dhe zarzavateve shënojnë rënien vjetore më të ndjeshme, ndërkohë që në muajt në vazhdim, shënohet një rritje graduale e këtyre çmimeve që kulmon në muajin dhjetor.

	T3-07	T4-07	T1-08	T2-08	T3-08	T4-08
Ushqime të përpunuara (pp)	1.6	2.4	2.5	2.9	2.3	1.7
Bukë dhe drithëra (pp)	0.7	1.2	1.4	1.7	1.3	1.0
Alkol dhe duhan (pp)	0.2	0.3	0.1	0.1	0.0	0.1
Ushqime të papërpunuara (pp)	0.6	0.5	-0.3	-0.4	-0.9	-0.1
Fruta* (pp)	0.2	0.4	0.5	0.3	-0.1	-0.1
Perime* (pp)	0.3	-0.1	-0.9	-0.2	-1.3	-0.7
Shërbime (pp)	0.4	0.4	0.3	0.3	0.5	0.5
Çmime të administruara (pp)	0.4	0.1	0.3	0.7	0.8	0.3
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.2	0.0	0.2	0.6	0.6	0.7
Strehim (pp)	0.6	0.2	0.1	0.1	0.0	0.0
Mallra konsumi joushqimorë	0.0	0.1	0.2	0.3	0.3	0.2
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v, %)	3.6	3.6	3.7	4.2	3.0	2.5

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 1. Kontributi i kategorive në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).

Gjatë vitit 2008, norma vjetore e inflacionit të kategorisë “Shërbime” ishte 4.7 për qind, rreth 2 pikë përqindjeje më e lartë se vlera e inflacionit mesatar gjatë vitit 2007. Inflacioni i kësaj kategorie pësoi rritjen më të lartë në periudhën qershor-tetor, si rezultat i rritjes së akumuluar të çmimeve të shërbimeve hoteliere dhe të restoranteve dhe në mënyrë të veçantë, të shërbimeve të transportit. Çmimet e shërbimeve hoteliere dhe të restoranteve u rritën mesatarisht me 2.5 për qind, ndërkohë që shërbimet e transportit duke filluar nga muaji qershor, kanë shënuar një normë mesatare vjetore inflacioni prej 20 për qind.

Kategoria “Strehim” ka shënuar norma shumë të ulëta inflacioni që prej muajit shtator të vitit 2007, si rezultat i qëndrueshmërisë së çmimeve të


qirasë. Çmimet e kësaj kategorie kanë pësuar një rritje mesatare prej 0.5 për qind gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që rritja në katër vitet paraardhëse (2003-2007) ishte mesatarisht 4.3 për qind. Në nivel mesatar, çmimet e kësaj kategorie nuk ndryshuan gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008. Çmimet e qirasë janë ndikuar vazhdimisht nga ndryshimet në çmimet e tregut të banesave, duke pasqyruar situatën që ka mbizotëruar në këtë treg gjatë vitit të kaluar.

Çmimet e administruara u rritën mesatarisht me 4 për qind gjatë vitit 2008. Inflacioni vjetor i kësaj kategorie ka rënë që prej muajit mars '08, menjëherë pas rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Në tremujorin e dytë, rritja ishte mesatarisht 6.2 për qind dhe në tremujorin e fundit zbriti në 2 për qind. Rënia ishte kryesisht rezultat i uljes së çmimeve në zërin "komunikim"⁴.

Çmimet e kategorisë "Mallra të konsumit afatgjatë", pësuan rënie gjatë këtij viti. Brenda kësaj kategorie, grupmallrat "Pajisje audiovizuale" vazhduan të regjistrojnë vlera negative të normës vjetore të inflacionit, e cila në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008 shënoi vlerën -5.5 për qind.

Në kategorinë "Mallra konsumi joushqimorë", çmimet e karburanteve pësuan një rritje të ndjeshme gjatë tetë muajve të parë të vitit. Në muajt e mbetur, çmimi i këtij malli pësoi rënie graduale, duke kulmuar në muajin dhjetor '08 me vlerën -7.7 për qind. Gjithsesi, rënia e çmimit të karburanteve në tregun vendas nuk regjistroi ritmet e diktuar nga tregu ndërkombëtar. Kjo rënie, së bashku me vlerën negative të regjistruar në muajin nëntor, përbën uljen e parë të normës së inflacionit për nënkategorinë "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit" (ku bën pjesë dhe nafta), pas një periudhe të gjatë me inflacion të lartë që nga mesi i vitit 2007. Ky faktor, i ndërthurur me situatën e kënaqshme të çmimeve në tregun e mallrave ushqimorë dhe atë të furnizimit me energji elektrike, krijuan një klimë të karakterizuar nga presione të ulëta në inflacionin e brendshëm, në fundin e vitit 2008.

Grafik 4. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje).



2.1.2 TENDENCAT KRYESORE INFLACIONISTE GJATË VITIT 2008


Analiza e ecurisë së çmimeve të konsumit gjatë vitit 2008, sugjeron se presionet krahasimisht të larta inflacioniste të vëna re gjatë kësaj periudhe kanë reflektuar si ndikimin e presioneve të kërkesës së brendshme ashtu edhe goditjet që kanë ardhur nga ecuria e çmimeve të mallrave në tregjet botërore. Nivelet e larta dhe ecuria në rritje e inflacionit bazë dhe atij të mallrave të tregtueshëm gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, sugjeron se kërkesa e brendshme e ekonomisë ka qenë në nivele të larta gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, ecuria e inflacionit të mallrave të tregtueshëm dhe të komponentes jobazë të inflacionit vjetor, ka qenë nën ndikimin e fortë të goditjeve që kanë ardhur nga sektori i jashtëm i ekonomisë. Këto të fundit, janë edhe faktori kryesor që ka ndikuar në luhatjen e vlerave të inflacionit përgjatë vitit.

Viti 2008 u karakterizua nga vlera relativisht të larta të komponentes bazë (afatgjatë) të inflacionit. Mesatarja e matjeve kryesore të inflacionit bazë vjetor rezultoi 2.8 për qind apo 2-3.5 herë më e lartë se sa ajo e periudhës 2006-2007. Kjo prirje pasqyroi rritjen e vazhdueshme të kërkesës së brendshme dhe zhvillimet e tensionuara në ecurinë e çmimeve të lëndëve bazë ushqimore dhe joushqimore në tregjet e huaja, të vërejtura që në mesin e vitit 2006 e në vijim. Këto zhvillime u manifestuan edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2008. Kohëzgjatja dhe shkalla relativisht e lartë e përfshirjes së produkteve të rëndësishme të shportës së IÇK-së në valën e rritjes së çmimeve⁵, ndikuan në rritjen e vlerave të inflacionit bazë. Këta faktorë bënë që inflacioni bazë të arrinte pikën kulmore në periudhën maj-qershor 2008. Pas kësaj periudhe, prirja e këtij treguesi shënoi rënie graduale, si pasojë e rënies së çmimeve të produkteve bazë në tregjet botërore. Mesatarja e matjeve të inflacionit bazë vjetor shënoi vlerën 2.6 për qind gjatë pjesës së dytë të vitit. Rënia e inflacionit bazë është ndikuar edhe nga politika monetare e Bankës së Shqipërisë, e cila, nëpërmjet ndjekjes së një politike monetare të kujdesshme gjatë dy viteve të fundit, ka ndihmuar kontrollin e presioneve të kërkesës së brendshme në ekonomi. Ndërkohë, stabilizimi i vlerave të inflacionit bazë rreth prirjes afatgjatë të inflacionit total konfirmoi frenimin e presioneve inflacioniste të ndikuar nga faktorët e ofertës në ekonominë e vendit.



Në këndvështrimin sektorial të ndarjes së mallrave dhe shërbimeve të shportës së IÇK-së⁶, vlerësohet se presionet e shtuara inflacioniste gjatë vitit 2008, janë gjeneruar kryesisht nga ambienti i jashtëm i ekonomisë. Niveli mesatar i inflacionit të mallrave të tregtueshëm rezultoi rreth vlerës 2.7 për qind për vitin 2008. Ai regjistroi vlera rreth 2-3 herë më të larta se sa në dy vitet paraardhës. Nivelet më të larta të këtij komponenti të inflacionit u shënuan në periudhën mars-qershor 2008, duke u luhatur rreth një mesatareje prej 3.7 për qind. Gjashtëmujori i dytë i vitit 2008 u karakterizua nga ritme më të

përmbajtura të rritjes së çmimeve të ushqimeve në vendet partnere kryesore tregtare të Shqipërisë dhe në Eurozonë, si edhe të çmimeve të lëndëve të para dhe atyre bazë. Kjo sjellje u pasqyrua në vlera më të ulëta të inflacionit të mallrave të tregtueshëm gjatë periudhës referuese (1.9 për qind).



Presionet inflacioniste të gjeneruara veçanërisht nga zhvillimet në kërkesën e brendshme, gjetën pasqyrim në vlerat e inflacionit të sektorit të patregtueshëm të mallrave dhe të shërbimeve. Gjatë vitit 2008, niveli mesatar i tij ishte rreth 3.7 për qind. Vlerat relativisht të larta të inflacionit të këtij sektori u ndikuan edhe nga vendimet administrative të marra gjatë këtij viti për rritjen e çmimeve të disa mallrave dhe shërbimeve⁷. Inflacioni mesatar vjetor i këtij sektori, i pastruar nga ndikimi i rritjes së çmimeve administrative, do të rezultonte rreth 2.6 për qind.

Frenimi i ritmeve rritëse të vlerave të inflacionit bazë dhe të atij të mallrave të patregtueshëm, gjatë pjesës së dytë të vitit 2008 e në vijim, dëshmoi për praninë e një ekuilibri të përshtatshëm ndërmjet faktorëve të ofertës dhe të kërkesës së brendshme në mbështetje të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve në ekonominë e vendit në terma afatmesëm.

2.1.3 ÇMIMET E PRODHIMIT DHE TË IMPORTIT

Ecuria e çmimeve të importit dhe të prodhimit u ndikua nga rritja e ndjeshme e çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare gjatë pjesës më të madhe të vitit 2008. Presionet inflacioniste që këto çmime gjeneruan mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit, u reflektuan në norma të larta rritjeje të inflacionit në vend gjatë gjysmës së parë të vitit. Indeksi total i këtyre çmimeve⁸, pasi arriti nivelin më të lartë të gjashtë viteve të fundit në tremujorin e dytë (13.3 për qind), ra me 4.2 pikë përqindjeje në tremujorin

pasues. Kjo rënie ishte më e ndjeshme në çmimet e importit. Ndërkohë, rënia e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës në tregun botëror, u përcoll në çmimet e importit dhe të prodhimit gjatë tremujorit të tretë dhe në vazhdim.


• ÇMIMET E PRODHIMIT

Indeksi i çmimeve të prodhimit reflekton kostot me të cilat përballen bizneset në fazën e prodhimit dhe ndihmon në shpjegimin apo parashikimin e presioneve inflacioniste që mund të godasin ekonominë vendase. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008, ky indeks është rritur mesatarisht me 7.3 për qind, duke reflektuar kryesisht rritjen e kostos në nëngrupet “Industri ushqimore” dhe “Industri e produkteve ushqimore dhe pijeve”. Rritja e përshpejtuar e çmimeve të lëndëve bazë në tregun ndërkombëtar, ka ushtruar presione rritëse në kostot me të cilat përballen bizneset vendase në këto industri, pavarësisht qëndrueshmërisë së monedhës vendase kundrejt monedhave kryesore të huaja⁹. Ndonëse pesha që zënë këto dy grupe në shportën e IÇP-së është rreth 32 për qind, kontributi që këto dy industri dhanë në rritjen vjetore të indeksit të çmimeve të prodhimit është më shumë se gjysma e rritjes totale të këtij indeksi.

Çmimet e kategorisë “Ushqime të përpunuara” kanë lëvizur në të njëjtin kah me kostot në këto dy industri, por janë rritur me ritme më të moderuara. Kjo sjellje, nënkupton që një pjesë e kostove të prodhimit është përballuar nga prodhuesit, të cilët kanë pranuar një marzh më të ulët fitimi, duke mos i përcjellë çmimet e rritura te konsumatori.

Çmimet e industrisë përpunuese - grupi industrial me peshën më të madhe në shportën e IÇP-së - janë rritur mesatarisht me 3.7 për qind në terma vjetorë. Kostot e prodhimit në industrinë nxjerrëse janë rritur me ritme të përshpejtuara gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, pas një rritjeje me ritme të moderuara që prej tremujorit të dytë të vitit 2007.

Grafik 7. Ndryshime vjetore të çmimeve të konsumit (boshti djathtas) dhe të çmimeve të prodhimit dhe të importit (boshti majtas).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

	IÇP	IÇP Industria përpunuese gjithsej	IÇP Industria përpunuese ushqimore	IÇK- Kategoria "Ushqime të përpunuara"	IÇP Industria nxjerrëse
T3:06/T3:05	0.4	1.2	-2.1	1.1	8.4
T4:06/T4:05	-0.7	1.5	1.4	2.4	8.3
T1:07/T1:06	2.1	14.4	2.5	3.2	8.1
T2:07/T2:06	3.3	7.3	11.3	2.9	2.8
T3:07/T3:06	3.6	6.3	14.7	7.3	4.7
T4:07/T4:06	7.5	10.2	18.6	10.8	4.5
T1:08/T1:07	7.4	6.8	20.5	11.2	5.6
T2:08/T2:07	7.4	6.9	14.6	12.9	3.0
T3:08/T3:07	7.1	6.1	7.0	10.0	9.7
T1-3:08/T1-3:07	7.3	3.7	13.8	11.4	6.1

Burimi: INSTAT.


Tabelë 2. Normat vjetore të ndryshimit të disa përbërësve të IÇP-së dhe të IÇK-së të kategorisë “Ushqime të përpunuara” (në përqindje).

- ÇMIMET E IMPORTIT

Çmimet e importit të mallrave të konsumit kanë shënuar rritje vjetore dyshifrore që nga tremujori i tretë i vitit 2007. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, ato u rritën mesatarisht me 18 për qind në krahasim me mesataren historike të shënuar gjatë periudhës 2002 -2007. Në tremujorin e tretë, çmimet e importit të mallrave të konsumit ranë me 7 pikë përqindje në krahasim me fillimvitin. Inflacioni në vend ndoqi të njëjtën trajektore.

Çmimet e huaja arritën nivelin më të lartë historik prej 6.1 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2008. Në dy tremujorët e fundit të vitit, këto çmime u rritën me ritëm më të ngadaltë rritjeje, duke shënuar përkatësisht rritje prej 5.4 dhe 4.6 për qind. Tendenca në rënie e çmimeve të huaja u shkaktua kryesisht nga rënia e çmimeve të lëndëve bazë (ushqime dhe naftë) si dhe nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në këto vende. Në mungesë të të dhënave për tremujorin e katërt të vitit 2008, përafërsisht për inflacionin e importuar - matur nga çmimet e konsumit të ushqimeve¹⁰ të partnerëve kryesorë tregtarë¹¹ - dëshmon për vazhdim të rënies së inflacionit të importuar edhe në këtë tremujor. Ngadalësimi i ritmeve të inflacionit të importuar është shkaktuar si nga rënia e çmimeve të konsumit në këto vende, ashtu edhe nga ndikimi prapaveprues i mbiçmimit të monedhës tonë ndaj monedhës evropiane përgjatë një viti.

Grafik 8. Ndryshimet vjetore të çmimeve të huaja dhe të çmimeve në vend (grafiku majtas) dhe të çmimeve të huaja dhe në vend të mallrave ushqimorë (grafiku djathtas) dhe kursi i këmbimit.




Burim: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet në çmimet e importit të mallrave të konsumit (ushqime dhe veshje), reflektohen drejtpërdrejt në çmimet e mallrave të konsumit dhe në mënyrë të tërthortë në koston e prodhimit. Lidhja midis çmimeve të importit të mallrave të konsumit dhe çmimeve të konsumit vërtetohet të jetë statistikisht e rëndësishme dhe e menjëhershme.¹²


Çmimi mesatar i naftës në tregun vendas gjatë vitit 2008, ka ndjekur prirje të përafërt me ecurinë e çmimit në tregun ndërkombëtar. Çmimi i naftës me pakicë shënoi një rritje mesatare me rreth 15.5 për qind kundrejt vitit 2007, ku rritja më e lartë vërtetohet në tre tremujorët e parë të vitit. Ky çmim, në muajin dhjetor '08, ra në nivelet e fundvitit 2005. Periudha janar-gusht e vitit, u karakterizua nga një rritje konstante e çmimit të naftës për litër në tregun me pakicë. Zhvillimet në tregun ndërkombëtar të naftës dhe të lëndëve të para ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimin në tregun vendas, me një kohëvonesë mesatare të përçimit të kahut të ecurisë prej një muaji. Ndonëse çmimi i naftës në tregun ndërkombëtar u rrit me përafërsisht 38 për qind në terma vjetorë, rritja vjetore e çmimit në vend gjatë këtij harku kohor, ishte afërsisht 23 për qind. Ritmet e rritjes së çmimit vendas ishin më të zbutura, të shkaktuara kryesisht nga pozicioni i fortë i monedhës vendase kundrejt dollarit amerikan¹³, i cili shërbeu si zbutës i presioneve të mëtejshme rritëse. Tremujori i fundit i vitit 2008, shënoi edhe pikën e ndryshimit të kahut të tendencës së çmimit të naftës. Rënia e çmimit mesatar në terma vjetorë ishte përafërsisht 14 për qind. Monedha vendase shfaqti një tendencë nënçmuese kundrejt dollarit amerikan dhe pengoi rënien me ritme më të përshpejtuara të çmimit të naftës në tregun me pakicë.

Nëngrupi i shportës së mallrave të konsumit "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit", ndikohet drejtpërsëdrejti prej çmimit të naftës me pakicë në tregun vendas. Ai pësoi një rritje vjetore prej mesatarisht 9.2 për qind në vitin 2008. Ecuria e çmimeve të këtij nëngrupi ka reflektuar zhvillimet në tregun e naftës duke pësuar një rënie të përshpejtuar gjatë tre muajve të fundit të vitit. Ndonëse pesha e këtij nëngrupi në shportën e IÇK-së është krahasimisht e vogël, kontributi mesatar i tij në inflacionin vjetor të vitit 2008 ishte 0.23 pikë përqindjeje.

Grafik 9. Ndryshimet vjetore të indeksit të vlerës njësi për importet e mallrave të konsumit dhe të çmimeve të konsumit (në përqindje).



Grafik 10. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend e jashtë dhe i kursit të këmbimit lek/usd.



2.2. ZHVILLIMET KRYESORE MAKROEKONOMIKE

Ecuria e ekonomisë shqiptare është karakterizuar përgjithësisht nga tipare pozitive gjatë vitit 2008. Ekonomia shqiptare ka shënuar ritme të kënaqshme rritjeje ekonomike gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit, në prani të ruajtjes së treguesve kryesorë të stabilitetit makroekonomik. Ndërkohë, tremujori i fundit i vitit pasqyrojti një tablo cilësisht më të ndryshme të zhvillimeve ekonomike.

Nën ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike botërore, aktiviteti ekonomik në vend ka shfaqur shenja ngadalësimi ndërsa treguesit monetarë kanë patur luhatje të dukshme.

Sipas të dhënave të disponueshme, të cilat mbulojnë në pjesën më të madhe nëntëmujorin e parë të vitit, aktiviteti ekonomik në vend është karakterizuar nga ritme të larta rritjeje gjatë vitit 2008. Shifra e afarizmit në vëllim, e cila është një përafrues i nivelit të vlerës së shtuar në ekonomi, është rritur mesatarisht me 17 për qind gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Duke faktorizuar edhe ngadalësimin e aktivitetit ekonomik të vendit gjatë tremujorit të katërt, i sinjalizuar ky nga një sërë treguesish të tërthortë si: përqesimi i treguesit të tendencave ekonomike, i rezultuar nga përpunimi i opinioneve të bizneseve dhe konsumatorëve mbi gjendjen aktuale të ekonomisë dhe pritjet e tyre për të ardhmen; ngadalësimi i remitancave dhe eksporteve gjatë gjysmës së dytë të vitit; si dhe ngadalësimi i aktivitetit kreditues gjatë tremujorit të fundit; Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia e vendit është rritur në linjë me parashikimet e fillimvitit.

Rritja ekonomike në vend është mbështetur kryesisht në rritjen e shpejtë të kërkesës së brendshme. Kjo kërkesë ka shënuar rritje në të gjithë komponentët e saj: konsum; investime dhe shpenzime qeveritare. Ajo është financuar në masën më të madhe nga burimet e brendshme të financimit, duke u shoqëruar me një rritje të shpejtë të kredisë për ekonominë. Me gjithë ngadalësimin e ndjeshëm gjatë dy muajve të fundit të vitit, portofoli i kredisë së sistemit bankar për ekonominë është rritur me rreth 35 për qind gjatë vitit 2008. Kjo kredi ka mbështetur kryesisht rritjen e investimeve në ekonomi, e manifestuar kjo në peshën dominuese që zë kredia për biznese në portofolin dhe shtesën e portofolit të kredisë. Me gjithë ngadalësimin e treguar gjatë vitit 2008 edhe kredia për konsum ka shënuar një rritje të ndjeshme, duke dëshmuar për rritjen e konsumit privat në ekonomi.

Kërkesa e lartë e brendshme dhe goditjet e ekonomisë globale, në formën e çmimeve të larta të mallrave bazë, u reflektuan në nivele të larta inflacioni gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Inflacioni mesatar vjetor i çmimeve të konsumit shënoi vlerën 3.4 për qind gjatë vitit 2008, duke u karakterizuar nga vlera të larta gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Inflacioni vjetor kulmoi në vlerën 4.6 për qind në muajin maj, vlerë e cila përbën edhe nivelin më të lartë të inflacionit gjatë 5 viteve të fundit. Presionet e larta inflacioniste ndikuan në rritjen e inflacionit bazë dhe të inflacionit të mallrave të patregueshëm, të cilët janë edhe tregues sintetikë të balancave inflacioniste në ekonomi. Këto presione diktuan ndjekjen e një politike monetare të kujdesshme gjatë vitit 2008. Norma bazë e interesit është mbajtur e pandryshuar gjatë gjithë periudhës, duke synuar balancimin më të mirë të raporteve të kërkesës dhe ofertës si dhe duke kontribuar në kontrollin e pritjeve inflacioniste në ekonomi.

Ndërkohë, zhvillimet e tremujorit të fundit paraqitën një tablo më të ndryshme, të karakterizuar nga ngadalësim i aktivitetit ekonomik dhe rritje e pasigurisë në tregjet financiare. Thellimi i pasojave të krizës financiare dhe

ekonomike në rang botëror u shoqërua me uljen e çmimeve të lëndëve të para dhe një nivel më të ulët të inflacionit të importuar. Qetësimi i goditjeve të ofertës dhe ngadalësimi i kërkesës së brendshme gjatë tremujorit të fundit u shoqëruan me uljen progresive të vlerës së inflacionit, deri në nivelin 2.2 për qind në muajin dhjetor.

Kërkesa e brendshme është reflektuar gjithashtu në rritjen e deficitit tregtar dhe të deficitit të llogarisë korente gjatë vitit 2008. Kështu, deficitin e llogarisë korente arriti në 14.9 për qind të PBB-së, i ndikuar kryesisht nga rritja e shpejtë e importeve dhe ngadalësimi i remitancave përgjatë pjesës së dytë të vitit, si pasojë e forcimit të efekteve të krizës ekonomike në ekonominë e vendeve fqinje. Nga ana tjetër, duhet theksuar se një pjesë e faktorëve që kanë ndikuar në zgjerimin e llogarisë korente, si çmimet e larta të mallrave bazë të importit dhe zgjerimi i përkohshëm i deficitit buxhetor si pasojë e rritjes së investimeve publike për projektin e rrugës Durrës-Kukës, kanë natyrë të përkohshme. Në mungesë të këtyre faktorëve, deficitin e llogarisë korente do të shënonte një vlerë më të ulët.

Në terma makroekonomikë, deficitin e lartë të llogarisë tregtare sinjalizon për nivele të larta konsumi dhe investimesh në ekonomi, të cilat janë financuar nga kursimet e huaja në formën e hyrjeve të kapitalit. Flukset hyrëse valutore kanë qenë të mjaftueshme për ta mbyllur në terma pozitivë bilancin e pagesave.¹⁴ Në një analizë më afatgjatë, deficitin e llogarisë korente të Shqipërisë është një fenomen i natyrshëm, në kontekstin e nivelit të zhvillimit të vendit. Veçanërisht pozitiv është fakti që pjesa më e madhe e importeve të vendit përfaqësohet nga importet e makinerive dhe pajisjeve, si dhe importi i mallrave të ndërmjetëm në aspektin e konsumit. Megjithatë, rritja e deficitit të llogarisë korente është një zhvillim që duhet monitoruar në vazhdimësi. Në veçanti, politikat makroekonomike duhet të jenë të kujdesshme për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të bilancit të pagesave, si një nga aspektet kryesore të stabilitetit makroekonomik të vendit dhe një nga kushtëzuesit kryesorë të rritjes afatgjatë të ekonomisë së tij.

Politika fiskale ka patur një karakter më ekspansionist gjatë vitit 2008. Ky karakter është reflektuar në zgjerimin e investimeve publike dhe të deficitit buxhetor gjatë vitit 2008. Progresi në fushën e administrimit fiskal dhe rritja brenda parametrave të ekonomisë së vendit kanë bërë të mundur rritjen e të ardhurave buxhetore dhe kontrollin e deficitit fiskal në nivele të pranueshme. Niveli i borxhit publik shënoi rritje gjatë vitit 2008, duke arritur në 55.9 për qind të PBB-së nga 52.8 për qind një vit më parë. Megjithatë, përmirësimi i administrimit të borxhit publik në drejtim të zgjatjes së afatit të maturimit dhe diversifikimit të burimeve të financimit është zhvillim pozitiv, që ka ndihmuar rifinancimin e borxhit dhe kontrollin e impaktit të kostos së tij në treguesit e buxhetit.

Tabelë 3. Disa tregues të ekonomisë në vite.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Rritja reale e PBB-së (në %) ¹⁵	7.9	4.2	5.8	5.7	5.7	5.5	6.0*	6.0*
PBB (me çmime korente, në milionë lekë ¹⁶)	583,369	622,711	694,098	750,785	814,797	891,000	980,064*	1,064,000*
PBB (me çmime korente, në milionë usd) ¹⁷	4,065.3	4,444.8	5,694.0	7,303.4	8,156.1	9,082.6	10,841.4*	12,681.8*
PBB (në usd për frymë)	1,323	1,437	1,830	2,336	2,598	2,883	3,429*	3,963*
Numri i të punësuarve (në mijë) ¹⁸	921	920	926	931	932	935	966	970
Përqindja e papunësisë	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	13.8	13.5	12.6
Përqindja e inflacionit (fund v/v)	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	3.1	2.2
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së) ¹⁹	-6.9	-6.1	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5	-5.7
Borxhi publik (në % të PBB-së)	57.7	62.9	58.9	56.5	57.4	55.5	52.8	55.9
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së) ²⁰	16.3	21.0	18.4	17.2	17.3	16.4	15.1	18.3
Llogaria korente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-8.2	-10.4	-8.1	-6.9	-9.9	-7.2	-11.1	-15.2
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	143.5	140.1	121.9	102.8	99.9	98.1	90.4	83.9
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	129.0	132.4	137.5	127.6	124.2	123.1	123.6	122.8

*Vlerësime paraprake,

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë, IMF Country Report 09/73, Shkurt 2009.

Zhvillimet monetare kanë reflektuar përgjithësisht ecurinë e ekonomisë dhe politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Shkalla e ndërmjetësimit financiar në ekonomi është rritur më tej. Kështu, raporti i depozitave në sistemin bankar ndaj PBB-së u rrit në 80 për qind gjatë vitit 2008, krahasuar me nivelin 78 për qind të shënuar gjatë vitit 2007; ndërkohë që raporti i kredisë ndaj PBB-së u rrit në 37 për qind të PBB-së, nga 29.7 për qind.


Viti 2008 u karakterizua nga ritme relativisht të larta të ekspansionit monetar, të nxitura kryesisht nga rritja e shpejtë e kredisë për ekonominë. Ritmi mesatar i rritjes vjetore të M3 shënoi vlerën 12.3 për qind, duke treguar një ngadalësim të lehtë nga vlera 15.8 për qind e shënuar gjatë vitit 2007. Normat e interesit në tregun e parasë pësuan luhatje të ndjeshme gjatë vitit, në varësi të ecurisë së likuiditetit në sistem dhe të zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që kursi i këmbimit ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm gjatë vitit 2008.

Zhvillimi më i rëndësishëm i vitit 2008 ishte kriza financiare dhe ekonomike që përfshiu ekonominë botërore. Ndikimi i kësaj krize në ekonominë e vendit erdhi në rritje graduale gjatë tremujorit të fundit. Pasiguria që përcolli tronditja e sistemit financiar botëror u reflektua në tërheqjen e një pjese të depozitave nga sistemi gjatë tremujorit të fundit të vitit. Këto tërheqje sollën probleme likuiditeti në sistem dhe u shoqëruan me tendenca për rritjen e normave të interesit gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, kjo situatë ndikoi në mënyrë të natyrshme në uljen e gatishmërisë së sistemit për të kredituar ekonominë dhe rrjedhimisht, edhe në ngadalësimin e dukshëm të ritmit të kreditimit gjatë tremujorit të fundit. Ky zhvillim, i shoqëruar me uljen e remitançave gjatë kësaj periudhe, ndikoi në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik gjatë tremujorit të katërt. Në përgjigje të tij, Banka e Shqipërisë mori masa për injektimin e


likuiditetit dhe ruajtjen e besimit të publikut në sistemin bankar. Gjithashtu, ajo forcoi rregulloret e mbikëqyrjes gjatë vitit 2008, duke synuar forcimin e stabilitetit të sistemit financiar. Këto masa kanë rezultuar efektive dhe sistemi bankar shqiptar e ka përballuar me sukses goditjen e parë të krizës ekonomike dhe financiare botërore.

2.2.1 ECURIA E PRODHIMIT SIPAS SEKTORËVE

Megjithë ngadalësimin e vënë re gjatë tremujorit të fundit, ecuria e ekonomisë shqiptare ka rezultuar përgjithësisht pozitive gjatë vitit 2008. Aktiviteti ekonomik vendas ka regjistruar ritme të larta rritjeje gjatë tre tremujorëve të parë të tij. Shifra e afarizmit në vëllim regjistroi një rritje mesatare vjetore prej 17 për qind gjatë kësaj periudhe. Rritja më e lartë u regjistrua gjatë tremujorit të tretë të vitit. Normat më të larta të rritjes vjetore u regjistruan në degën e ndërtimit dhe në atë të tregtisë. Ndërkohë, shifra e afarizmit në vëllim për degët “industri”, “transport dhe komunikacion” dhe “hoteleri” paraqet një ngadalësim të ritmit të rritjes në krahasim me një vit më parë.



Zhvillimet në aktivitetin ekonomik gjatë vitit 2008, janë reflektuar edhe në ecurinë e treguesit të tendencës ekonomike (TTE²¹). Pas një rënijeje të lehtë në tremujorin e parë të vitit, ky tregues shënon rritje të njëpasnjëshme në dy tremujorët pasardhës dhe përsëri një rënie gjatë tremujorit të fundit të vitit²². Indeksi i Besimit të Biznesit sipas sektorëve, dëshmon për një prirje rënese në vlerat e këtij treguesi në sektorët e industrisë dhe të shërbimeve gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008. Në të kundërt, sektori i ndërtimit regjistroi një përmirësim të këtyre vlerave gjatë të njëjtës periudhë. Indeksi i Besimit




Konsumator - tregues i cili ka shënuar historikisht vlera negative - ka shfaqur një përmirësim gjatë tremujorit të dytë dhe atij të tretë të vitit 2008. Megjithatë, edhe ai shënoi rënie gjatë tremujorit të fundit të vitit, nën ndikimin e thellimit të krizës financiare dhe ekonomike në botë.

Hapësirë informuese 1: Përdorimi i treguesve të besimit për monitorimin e zhvillimeve ekonomike.

Duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka filluar të publikojë analizën dhe treguesit e përfuar nga vërtetimet e besimit të biznesit dhe të konsumatorit. Publikimi i rezultateve të vërtetimeve pason një periudhë disavjeçare studimi dhe testimi të këtyre treguesve. Përmirësimi i vazhdueshëm i hartimit të pyetësorëve dhe i metodologjisë së ndërtimit të treguesve - mbi baza të agreguara - ka pasur për qëllim përafrimin me metodologjitë moderne të përdorura në bankat qendrore të vendeve të zhvilluara.

Treguesit e besimit të përdorur nga Banka e Shqipërisë, ndërtohen duke u bazuar në informacionin e marrë pranë bizneseve dhe konsumatorëve në formë vlerësimi, opinionit dhe parashikimi. Vlerësimet mbledhen nëpërmjet katër pyetësorëve cilësorë²³ që i drejtohen bizneseve: të industrisë, të ndërtimit, të shërbimeve dhe konsumatorëve, çdo tremujor.



Qëllimi kryesor i ndërtimit të treguesve të besimit është t'i vijë në ndihmë procesit të njohjes më të mirë të sjelljes së agjentëve ekonomikë, veçanërisht në kushtet kur drejtimi i zhvillimit ekonomik është jo i qartë ose afër pikave të kthesës në ciklin e biznesit. Përdorimi i këtyre treguesve për të përshkruar zhvillimet ekonomike mbështetet në supozimin se besimi i agjentëve ekonomikë shoqëron ose paraprin procesin vendimmarrës dhe sjelljen e tyre. Kjo, do të thotë që gjykimi dhe vlerësimi i agjentëve ekonomikë do të reflektohet në sjellje konkrete dhe në marrje vendimesh me natyrë ekonomike. Rezultatet e studimeve empirike dëshmojnë se treguesit e besimit ofrojnë një informacion me vlerë në shpjegimin e sjelljeve ekonomike, ndonëse me intensitet të ndryshëm në vende të ndryshme, duke përbërë kështu një informacion të rëndësishëm për marrjen e vendimeve ekonomike. Në përgjithësi, ndryshime të mëdha të treguesve të besimit²⁴ japin sinjale për devijime, aktuale ose të pritshme, të prodhimit nga prirja e tij.

Në rastin tonë, opinionet e bizneseve dhe të konsumatorëve grumbullohen dhe shprehen në formë numerike nëpërmjet treguesve të balancës dhe të besimit. Treguesi i balancës shpreh në mënyrë të thjeshtuar (numerikisht), opinionet e agreguara të të intervistuarve të çdo sektori mbi një dukuri ekonomike të caktuar. Treguesi i balancës llogaritet si diferencë e përgjigjeve pozitive me ato negative, ku përgjigjet janë të shprehura në përqindje.


Treguesi i besimit ndërtohet për çdo sektor të ekonomisë dhe llogaritet si mesatare aritmetike e treguesve të balancave kryesore (zgjedhja e balancave bazohet në karakteristikat statistikore dhe kuptimin ekonomik të tyre). Bazuar në treguesit e besimit për çdo sektor, ndërtohet treguesi i tendencës ekonomike, i cili shpreh opinionet dhe pritjet e dy prej grupeve ekonomike kryesore mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik në vend: bizneset dhe konsumatorët.

Duke filluar nga vitit 2002, treguesit e besimit në Bankën e Shqipërisë kanë siguruar një panoramë relativisht të mirë të lëvizjeve ciklike të prodhimit, megjithëse janë tregues paraprakë të zhvillimeve në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe jo si zëvendësues të statistikave zyrtare. Testimi dhe përmirësimi në kohë i treguesve të besimit, së bashku me disponueshmërinë e serive më të gjata kohore nga statistikave zyrtare, synon shfrytëzimin sa më të mirë të informacionit që vrojtimet e besimit përmbajnë me qëllim monitorimin e zhvillimeve ekonomike në vend.

SEKTORI I PRODHIMIT

Sektori i prodhimit, i cili përmbledh aktivitetin ekonomik të degëve të ndërtimit dhe të industrisë, ka shënuar rritje të lartë gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Rritja e aktivitetit ekonomik të sektorit të ndërtimit ka qenë më e shpejtë se ajo e sektorit të prodhimit, pjesërisht edhe si pasojë e korrektimit të rritjes më të ngadaltë që ka patur ky sektor gjatë vitit të shkuar. Kontributi që dega e ndërtimit ka dhënë në aktivitetin prodhues, duke filluar nga tremujori i tretë i vitit 2007, ka ardhur në rritje dhe ka qenë më i lartë krahasuar me degën e industrisë. Deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2008, shifra e afarizmit në

Grafik 14. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim dhe e kontributeve për aktivitetin ndërtues dhe atë industrial ndër vite (ndryshime vjetore, në përqindje).



Burimi: INSTAT, Konjunktura tregues kryesorë ekonomike, korrik-shkator 2008.

vëllim për aktivitetin ndërtues është rritur me ritme më të larta krahasuar me aktivitetin industrial.

INDUSTRIA

Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008, treguesi i shifrës së afarizmit në vëllim për industrinë është rritur mesatarisht me rreth 7.4 për qind në terma vjetorë; vlerë kjo më e lartë sesa mesatarja vjetore e katër viteve të fundit (5.4 për qind). Ky tregues, është rritur me ritme të krahasueshme për nëndegën e industrisë përpunuese dhe atë të furnizimit me energji elektrike, gaz dhe ujë gjatë të njëjtës periudhë kohore. Ritmin më të lartë të rritjes vjetore e ka shënuar industria përpunuese, me mesatarisht 7.9 për qind. Nëndega e industrisë nxjerrëse, ka regjistruar ritmin më të ulët të rritjes vjetore, rreth 2 për qind nga 6 për qind që vlerësohet mesatarja vjetore e katër viteve të fundit.

Tabelë 4. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim (mesatarja e ndryshimeve vjetore të tremujorëve, në përqindje).

	2004	2005	2006	2007	2008*25
Industria	2.5	4.2	4.9	9.9	7.4
Industria nxjerrëse	-6.0	-9.7	16.8	22.8	2.0
Industria përpunuese	3.5	5.3	7.4	10.0	7.9
Energji elektrike, gaz, ujë	2.7	6.4	-6.7	5.1	7.6

Burimi: INSTAT, Konjuktura tregues kryesorë ekonomike, korrik shtator 2008.

INDUSTRIA PËRPUNUESE

Shifra e afarizmit në vëllim për industrinë përpunuese u rrit mesatarisht me rreth 7.9 për qind gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008, ritëm i krahasueshëm ky me dy vitet e mëparshme. Gjatë kësaj periudhe, normën mesatare vjetore më të lartë e ka regjistruar "industria e letrës, kartonit, botime" dhe "metalurgji, fabrikimi i makinave, pajisjeve, pajisjeve elektrike, elektronike, mjeteve të transportit", me përkatësisht rreth 35 dhe 34 për qind. Ndërkohë, është regjistruar rënie e këtij treguesi për "industrinë e këpucëve", "industrinë e tjera" dhe "industrinë tekstile". Kontributin më të lartë në rritjen vjetore të shifrës së afarizmit në vëllim e ka dhënë nëndega "metalurgji, fabrikimi i makinave, pajisjeve, pajisjeve elektrike, elektronike, mjeteve të transportit". Gjithashtu, kontributi i industrisë ushqimore regjistron rritje krahasuar me dy vitet e mëparshme.

PRODHIMI DHE PËRDORIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Viti 2008 dëshmon për një përmirësim të dukshëm të treguesve kryesorë të sektorit energjitik në vend, në krahasim me vitin paraardhës. Rritja e ndjeshme e prodhimit vendas, rezultat i situatës së favorshme hidrometeorologjike, u shoqërua jo vetëm me rënien e importit për këtë produkt por edhe me uljen e humbjeve kundrejt sasisë së prodhuar.


Tabelë 5. Bilanci i Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar (në GWh).

	2007	2008	Ndryshimi vjetor (në %)
Burimet	5,645	6,246	11
Prodhim	2,845	3,771	33

Import (përfshirë këmbimet)	2,800	2,475	-12
Përdorimet	5,645	6,246	11
Humbje/Prodhim (në përqindje)	60	46	-14
Energjia e konsumuar	5,514	6,037	9
-Konsumatorë familjarë	2,078	2,292	10
-Konsumatorë jofamiljarë	1,563	1,817	16

Burimi: Bilanci i energjisë elektrike – KESH.

Struktura e konsumit të energjisë gjatë vitit 2008 nuk shënon ndryshime thelbësore në krahasim me vitet e mëparshme. Bazuar në statistikat e prodhimit dhe përdorimit të energjisë, vazhdon mbizotërimi i konsumit familjar të energjisë, i cili së bashku me humbjet në rrjet, përbën rreth 67 për qind të energjisë së përdorur gjithsej.



Niveli i humbjeve në rrjet është përsëri i konsiderueshëm, me pasoja të drejtpërdrejta mbi gjendjen financiare të Korporatës Elektroenergjitike. Me qëllim përmirësimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në vend, KESH ndërmoi hapin e parë të rëndësishëm për reformimin administrativ të tij: ndarjen e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nga struktura organizative e korporatës. Përparësi tjetër e këtij sektori mbetet rritja e kapaciteteve prodhuese në vend. Investimet e ndërmarra në TEC-in e Vlorës dhe në hidrocentrale, synojnë përmirësimin e furnizimit të vendit me energji në të ardhmen.


NDËRTIMI

Sipas treguesit të shifrës së afarizmit në vëllim, rritja vjetore e sektorit të ndërtimit gjatë nëntë muajve të parë të vitit ishte mesatarisht 57 për qind. Sipas këtij treguesi, ritmi i rritjes së ndërtimit ka regjistruar normën më të lartë në tremujorin e parë, për t'u ngadalësuar disi gjatë dy tremujorëve të

mëpasshëm të vitit. Investimet në projekte të infrastrukturës rrugore dhe dalja e lejeve të ndërtimit nga “ngërçi” i tejzgjatur, gjykohej të kenë nxitur rritjen e aktivitetit të ndërtimit. Vëllimi i ndërtimit gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008 ka regjistruar një rritje mesatare vjetore prej rreth 87 për qind, duke shënuar normën më të lartë vjetore në tremujorin e dytë të vitit. Të dhënat paraprake nga vërtetimet flasin për rënie të këtij sektori dhe në tremujorin e fundit të vitit e në vazhdim.


Hapësirë informuese 2: Zhvillimet në tregun e banesave, në çmimet dhe qiratë²⁶.

Gjatë vitit 2008, tregu i banesave është karakterizuar nga frenimi i ritmit të rritjes së çmimeve dhe nga luhajtje të indeksit të qirasë. Kështu, indeksi i çmimit të banesave ka shënuar normat më të ulëta të rritjes vjetore që nga viti 2005. Ndryshimi vjetor i këtij indeksi nominal ka shënuar vlerën më të ulët gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008; rreth -3.7 për qind. Në terma realë²⁷, ky ndryshim ishte -6.5 për qind. Indeksi mesatar i çmimit të banesave gjatë vitit 2008 ra me 0.3 për qind në terma vjetorë, në kontrast me normat dyshifrore të rritjes, të regjistruara që nga viti 2005 (ndryshimi vjetor mesatar +16 për qind).




Frenimi në normën e rritjes së çmimeve të banesave mund të jetë i lidhur si me zbutjen e kërkesës për banesa ashtu edhe me një ofertë relativisht në rritje. Bazuar në të dhënat zyrtare, numri i lejeve të ndërtimit - që shpesh përdoret si një tregues i zhvillimeve në sektorin e ndërtimit - është rritur, çka sugjeron se investimi në këtë sektor pritet të zgjerohet në muajt e ardhshëm²⁸. Nga ana tjetër, në vërtetimin e aktivitetit kreditues, bankat u shprehën si për një rënie të kërkesës së individëve për kredi për blerje banese (balanca neto: -29.3 për qind), ashtu edhe për një forcim të standardeve të kredidhënies për këtë qëllim (balanca neto: -52 për qind), kryesisht gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008. Ndërkohë, indeksi i kushtimit në ndërtim nuk paraqet zhvillime të qenësishme gjatë vitit 2008. Zhvillimet në këtë indeks, tregojnë që çmimet në tregun e banesave udhëhiqen kryesisht nga faktorë të tjerë, të ndryshëm nga kostot e ndërtimit.

Gjatë vitit 2008, indeksi i qirasë shfaq luhatshmëri më të madhe krahasuar me indeksin e çmimit të banesave dhe njëkohësisht, një prirje më të qartë rënësë. Pas një rënieje vjetore prej 9.5 për qind gjatë tremujorit të dytë të vitit 2008, indeksi i qirasë u rrit me 7.5 për qind gjatë tremujorit të tretë, për t'u ulur sërish në tremujorin e katërt me rreth 5 për qind. Mesatarisht, gjatë vitit 2008, indeksi i qirasë pësoi një rënie prej 1.9 për qind krahasuar me vitin 2007.



SEKTORI I SHËRBIMEVE

Shifra e afarizmit në vëllim për sektorin e shërbimeve shënoi një rritje mesatare vjetore prej 12 për qind, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008. Ritmin më të lartë të rritjes vjetore gjatë kësaj periudhe, e regjistroi aktiviteti tregtar, i cili ka dhënë dhe kontributin më të lartë në rritjen e kësaj shifre për sektorin e shërbimeve.



Aktiviteti tregtar ka shënuar një ecuri të mirë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008. Norma mesatare vjetore më e lartë e rritjes është regjistruar në grupin “Tregti, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve dhe motoçikletave”, rreth 16 për qind. Ndërkohë, shifra e afarizmit në vëllim për tregtinë me pakicë dhe shumicë është rritur përkatësisht me 15 për qind dhe 11 për qind.

Tabelë 6. Ecuria e shifrës së afarizmit në vëllim sipas degëve të sektorit të shërbimeve ndër vite (mesatarja e ndryshimeve vjetore të tremujorëve, në përqindje).

	2004	2005	2006	2007	2008*
Shërbime	5.4	1.3	4.1	2.2	12.1
Tregtia	9.4	-1.9	5.7	0.2	12.3
Transporti dhe komunikacioni	-11.7	18.2	-3.4	13.0	11.9
Hotele	13.2	4.5	3.9	15.5	10.0

Burimi: INSTAT, Konjunktura tregues kryesorë ekonomike korrik-shtator 2008.

Përsa i takon transportit, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008, aktiviteti në transportin detar ka regjistruar një përmirësim, ndërsa aktiviteti në transportin hekurudhor dhe atë ajror shënon një ngadalësim të ritmeve të rritjes në terma vjetorë.

AKTIVITETI NË HOTELE

Nëntëmujori i parë i vitit 2008, regjistron një rritje mesatare vjetore të shifrës së afarizmit për hotelet prej 10 për qind. Kjo rritje, ndonëse mbetet në nivele dyshifrore, është më e ulët sesa rritja mesatare vjetore e regjistruar gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2007 (21 për qind). Numri i të punësuarve në hotele regjistron një rritje të konsiderueshme gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2008. Të punësuarit u rritën mesatarisht me 26.1 për qind kundrejt rritjes prej 7.8 për qind të regjistruar gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2007. Pagat kanë pësuar një rritje mesatare vjetore prej 24.7 për qind për të njëjtën periudhë, vlerë kjo më e ulët se mesatarja e nëntë muajve të parë të 2007-ës (31.9 për qind).

Tabelë 7. Tregues të aktivitetit të hoteleve (ndryshimi vjetor, në përqindje).

	2006	2007	9M -08
Shifra e afarizmit	3.95	15.5	10
Të punësuar	-2.88	6.25	26.1
Pagat	14.2	26	24.7


Burimi: INSTAT, Statistikat Afatshkurtra.

Gjatë vitit 2008²⁹, Shqipëria u vizitua nga rreth 2.6 milionë persona, ndër të cilët rreth 52 për qind ishin shtetas të huaj³⁰ dhe rreth 48 për qind ishin vizitorë me nënshtetësi shqiptare. Numri i vizitorëve të huaj në Shqipëri është rritur me rreth 21 për qind gjatë vitit 2008. Vlen për t'u përmendur se ndonëse rreth 46 për qind e vizitorëve kanë hyrë në Shqipëri gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, turistët kanë vizituar Shqipërinë edhe jashtë muajve të verës³¹. Në vitin 2008, pjesa më e madhe e turistëve kanë hyrë në Shqipëri nëpërmjet kufirit tokësor (rreth 70 për qind).

Sipas qëllimit të udhëtimit, pjesa më e madhe e vizitorëve të huaj kanë ardhur në Shqipëri për pushime, vizitë pranë të afërmeve dhe miq; pjesa e mbetur, e kanë vizituar për qëllime biznesi dhe profesionale apo për qëllime të tjera.


Edhe në vitin 2008, pjesën më të madhe të turistëve të huaj e përbëjnë evropianët (rreth 92 për qind), ndjekur nga amerikanët dhe aziatikët, me përkatësisht 5 për qind dhe 2 për qind. Ndër turistët evropianë, vendin kryesor e zënë vizitorët nga vendet e rajonit, kryesisht ato ballkanase: Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi.

Grafik 19. Numri i vizitorëve të huaj gjatë periudhës 2006-2008.



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Grafik 20. Raporti i vizitorëve të huaj për vitin 2008, sipas mënyrës së udhëtimit (majtas) dhe raporti i vizitorëve të huaj për vitin 2008, sipas qëllimit të udhëtimit (djathtas).



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2.2.2 TREGU I PUNËS DHE ECURIA E PAGAVE

• TREGU I PUNËS

Bazuar në të dhënat zyrtare të disponueshme deri në tremujorin e tretë të vitit 2008, vlerësohet se numri mesatar i të punësuarve ka ardhur në rritje, ndërkohë që numri mesatar i të papunëve të regjistruar ka ardhur në rënie. Norma e papunësisë ka vijuar të ndjekë prirjen rënëse, duke shënuar normën më të ulët në tremujorin e tretë të vitit 2008. Kjo rënie ka qenë kryesisht rezultat i rritjes së numrit mesatar të të punësuarve në sektorin privat bujqësor, duke reflektuar në një masë të madhe edhe matjen më të mirë të këtij treguesi.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, forca e aftë për punë dhe numri mesatar i të punësuarve u rritën përkatësisht me rreth 30,585 dhe 30,527 persona. Kontribuesi kryesor në këtë rritje ishte sektori privat bujqësor me

rreth 26,549 persona. Numri mesatar i të punësuarve në sektorin privat jobujqësor, u rrit me rreth 4,018 persona në tremujorin e tretë krahasuar me një tremujor më parë.


Tabelë 8. Ecuria e treguesve të papunësisë dhe të të punësuarve (në mijë persona).

	2007				2008			Ndryshimi në % T3'08/T3'07
	T 1	T 2	T 3	T 4	T 1	T 2	T 3	
Forca e aftë për punë	1080	1078	1078	1082	1080	1079	1110	3.0
I. Të punësuar gjithsej	933	933	936	939	939	939	970	3.6
a) Në sektorin shtetëror	168	167	167	167	167	167	167	-0.3
b) Në sektorin privat jobujqësor	223	224	227	230	231	231	235	3.6
c) Në sektorin privat bujqësor	542	542	542	542	542	542	569	4.9
II. Të papunë	148	145	142	143	141	140	140	-1.5
Shkalla e papunësisë	13.60	13.50	13.18	13.20	13.04	12.97	12.62	(0.56)*

Burimi. INSTAT, Konjunktura tregues kryesorë ekonomike, korrik-shtator 2008.

* Ndryshimi, në pikë përqindjeje.


Viti 2008 ka shënuar ritme më të shpejta rritjeje të numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet ekonomike jobujqësore, krahasuar me një vit më parë. Ky zhvillim ka pasqyruar jo vetëm ndikimin e masave administrative të marra për deklarimin e punonjësve, por edhe përmirësimin e aktivitetit ekonomik, kryesisht në degën e ndërtimit dhe në aktivitetin tregtar.



• ECURIA E PAGAVE


Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008 është vënë re një ngadalësim i ritmit të rritjes vjetore të pagave, si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat. Në terma nominalë, niveli i pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror³² u rrit mesatarisht me 8.8 për qind gjatë nëntë muajve të parë të vitit³³. Gjatë të njëjtës periudhë, paga mesatare e regjistruar në ndërmarrjet ekonomike vlerësohet të jetë rritur me rreth 15.1 për qind në terma nominalë

vjetorë.³⁴ Në termë realë, rritja vjetore e pagës mesatare për këtë periudhë vlerësohet në rreth 11.0 për qind.



Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, paga mesatare vjetore nominale, për sektorin e prodhimit është rritur mesatarisht me 19.8 për qind në degën e ndërtimit dhe me 11.8 për qind në degën e industrisë. Në sektorin e shërbimeve, rritja mesatare vjetore e këtij treguesi page ka rezultuar e lartë për tregtinë me pakicë dhe atë me shumicë, me përkatësisht 25.5 dhe 12.9 për qind.

Paga bazë minimale mujore, deri në tremujorin e tretë të vitit 2008 regjistrohej në nivelin e 17,000 lekëve. Kjo pagë bazë është rritur me rreth 21.4 për qind në termë vjetorë. Gjatë vitit 2008, niveli bazë i pagesës mujore të papunësisë ka mbetur në 5,980 lekë, rreth 14.1 për qind më i lartë se një




vit më parë. Ndhurma ekonomike mesatare mujore e plotë është rritur me rreth 37.2 për qind në terma vjetorë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2008, duke arritur në nivelin 3,405 lekë. Ndërsa ndihma ekonomike mesatare mujore e pjesshme, është rritur me rreth 45.1 për qind në terma vjetorë, për të shënuar nivelin 2,518 lekë.

Hapësirë informuese 3: Struktura e tregut të punës në Shqipëri dhe një vështrim krahasues me vendet e rajonit.

Papunësia dhe në veçanti, papunësia afatgjatë mbeten probleme serioze të një ekonomie në zhvillim. Përtej problemeve sociale që ajo sjell, nivele të larta dhe të qëndrueshme të normës së papunësisë sinjalizojnë për probleme strukturore të ekonomisë, të cilat mund të kufizojnë ritmin e rritjes ekonomike në periudhën afatgjatë. Ritmet pozitive të rritjes së aktivitetit ekonomik gjatë viteve të fundit janë shoqëruar me rritjen e punëzënies dhe rënien e normës së papunësisë. Gjatë vitit 2007, niveli i punësimit u rrit në rreth 56.4 për qind, nga rreth 48.7 për qind të shënuar në vitin 2006. Megjithatë, ai mbetet ende nën kriterin e Lisbonës prej 70 për qind. Tregu i punës karakterizohet nga një shkallë e lartë informaliteti, e cila vështirëson monitorimin e tij nëpërmjet të dhënave zyrtare dhe nga mungesa e fleksibilitetit, e cila reflekton edhe strukturën e kualifikimeve që ofron tregu.

Sipas Anketës për Forcën e Punës – 2007, të kryer nga INSTAT gjatë muajit qershor të vitit 2007, rezulton se: niveli i punësimit³⁵ në shkallë vendi për popullsinë në moshë 15-64 vjeç rezulton 56.4 për qind. Tregu i punës në Shqipëri karakterizohet nga një shkallë e ulët e punësimit të grupmoshës 15-24 vjeç, nën mesataren e ekonomive të tjera në zhvillim, që regjistrojnë një nivel të përafërt me 40 për qind. Në të kundërt, shkalla e pjesëmarrjes së grupmoshës 55-64 vjeç regjistrohet mbi mesataren e tregut të punës në ekonomitë e vendeve të tjera në zhvillim, rreth 30 për qind.

Grafik 24. Raporti i numrit të të papunëve të regjistruar sipas grupmoshës ndaj numrit të të papunëve të regjistruar (majtas) dhe raporti i numrit të të papunëve sipas nivelit arsimor ndaj numrit të të papunëve të regjistruar (djathtas) (në përqindje).



Burimi: INSTAT, tregues të punësimit dhe të papunësisë.

Sipas Anketës për Forcën e Punës, niveli i punësimit vjen duke u rritur për një nivel arsimor më të lartë, ndërkohë që norma e papunësisë vjen duke rënë. Kështu në popullsinë e moshës nga 15-64 vjeç, niveli i punësimit për ata që kanë arsim 8-vjeçar, për ata me arsim të mesëm dhe për ata me arsim të lartë është përkatësisht 55 për qind, 55.8 për qind dhe 71 për qind.

Tabelë 9. Tregu i punës.

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Shkalla e punësimit ³⁶ (%)	55.7	55.0	52.1	52.1	51.1	50.3	49.7	48.7	56.4
Shkalla e punësimit të meshkujve ³⁷ (%)	69.0	66.0	64.0	63.9	62.6	61.2	60.0	58.8	63.6
Shkalla e punësimit të femrave ³⁸ (%)	42.3	44.1	39.6	39.7	39.1	33.9	38.8	38.1	49.3
Punësimi sipas sektorëve kryesorë									
Bujqësia (%)	72.1	71.8	57.7	57.7	58.2	53.5	58.5	58.0	47.5
Industria (%)	7.7	5.4	6.0	7.6	7.2	3.1	7.9	8.0	8.8 ³⁹
Ndërtimi (%)	1.0	1.2	6.1	6.1	6.0	5.5	5.5	5.7	8.3
Shërbimet (%)	19.2	21.5	28.5	28.6	28.5	27.9	28.1	28.3	11 ⁴⁰
Shkalla e papunësisë (%)	18.4	16.8	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	13.8	13.5
Shkalla e papunësisë për meshkujt ⁴¹ (%)	16.4	14.9	14.2	13.6	12.9	12.4	12.1	11.8	14.4
Shkalla e papunësisë për femrat ⁴² (%)	21.4	19.3	19.9	19.1	18.2	17.5	17.2	16.8	12.2

Burimi: INSTAT, treguesit socialë, punësimi, papunësia, "Albania 2008 Progress Report"-EU.

Norma e papunësisë për periudhën në të cilën është kryer anketa është 13.5 për qind, ndërkohë që shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-24 vjeç e tejkalon këtë nivel. Papunësia afatgjatë gjatë vitit 2007 përbënte rreth 86.8 për qind të të papunëve të regjistruar⁴³. Sipas të dhënave të INSTAT, në lidhje me treguesit e papunësisë, grupmosha 15-19 dhe 21-34 vjeç zë përkatësisht 7 dhe 39 për qind të të papunëve të regjistruar.

Tabelë 10. Norma e papunësisë në Shqipëri dhe në rajon.

Norma e papunësisë (në %)	2005	2006	2007	2008		
				T1	T2	T3
Kroacia			9.6	14.7	13.2	12.4
Maqedonia	37.3	36	34.9	34.8	33.8	33.0
Turqia	10.2	9.9	9.9	11.6	8.9	9.8
Shqipëria	14.3	13.9	13.4	13.04	12.97	12.62
Bosnja dhe Hercegovina	44.7	44.2	42.9	39.9	41.0	40.5
Mali i Zi	18.5	14.7	11.9	11.8	11	10.7
Serbia	21.8	21.6	18.8	17.1	13	12.5

Burimi: "EU Candidate and Pre-Accession Countries Economic Quarterly", EU, 8 tetor 2008, 9 janar 2009.

2.3 BILANCI I PAGESAVE

Sektori i jashtëm i ekonomisë regjistroi një thellim të mëtejshëm të deficitit të llogarisë korente gjatë vitit 2008. Ky deficit, vlerësohet të ketë arritur në 14.9 për qind të PBB-së, kundrejt nivelit 10.4 për qind të shënuar një vit më parë. Zgjerimi i deficitit korent flet për një aktivitet të shtuar në sektorin e jashtëm të ekonomisë dhe kryesisht në atë të importeve. Pavarësisht rritjes së eksporteve, deficitit tregtar - kontribuesi kryesor në zgjerimin e deficitit korent - ka ardhur në rritje. Dërgesat nga emigrantët, ndonëse ranë me 16 për qind gjatë vitit 2008, kanë financuar rreth 33 për qind të deficitit tregtar. Viti 2008 karakterizohet gjithashtu, edhe nga një rritje e konsiderueshme e investimeve të huaja direkte neto (rreth 32 për qind). Treguesi relativ i tyre kundrejt PBB-së vlerësohet në 7.2 për qind, kundrejt nivelit 5.9 për qind që vlerësohej një vit më parë.

Tabelë 11. Tregues të bilancit të pagesave në vite.


	Në milionë euro			Në përqindje ndaj PBB-së		
	2006	2007	2008	2006	2007	2008
Llogaria korente	-471.0	-831.0	-1,290.6	-6.5	-10.4	-14.9
Bilanci tregtar	-1,658.9	-2,104.0	-2,415.5	-22.9	-26.6	-27.9
-Eksport	630.6	786.3	915.9	8.7	9.9	10.6
- Import	-2,289.6	-2,890.4	-3,331.4	-31.6	-36.5	-38.4
Shërbime (neto)	-31.5	12.9	-14.7	-0.4	0.2	-0.2
Të ardhura (neto)	208.8	217.3	309.4	2.9	2.7	3.6
Transferta korente (neto)	1,010.6	1,042.9	830.1	14.0	13.2	9.6
Llogaria kapitale dhe financiare	558.4	848.4	1,555.7	7.7	10.7	18.0
Bilanci i përgjithshëm	206.6	148.6	191.9	2.9	1.9	2.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3.1 LLOGARIA KORENTE

Viti 2008 u karakterizua nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të ekonomisë, i shprehur si në rritjen e shpenzimeve korente ashtu dhe në atë të të ardhurave⁴⁴. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 12 për qind krahasuar me vitin 2007, duke shënuar një nivel prej 9.2 miliardë eurosh. Nga këto, 62 për qind kanë shkuar për shpenzime. Rreth 93 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Ndërkohë, 62 për qind e të ardhurave ka hyrë në formën e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve dhe pjesa tjetër, në formën e transfertave korente (26 për qind) dhe të të ardhurave nga puna dhe nga investimet (12 për qind).

Grafik 25. Bilanci tregtar (majtas) dhe llogaria korente (djathtas), në përqindje të PBB-së sipas zërave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGTIA NË MALLRA

Fluksi i madh i shkëmbimeve tregtare që karakterizoi vitin 2008, rezultoi me një vëllim të përgjithshëm tregtar prej 4.2 miliardë eurosh, rreth 16 për qind më i lartë se viti paraardhës. Kontributi i tregtisë së mallrave në llogarinë korente mbetet në nivele të larta, rreth 46 për qind e të gjitha transaksioneve korente gjatë vitit.

	Importet (%)		Eksportet (%)		'08/'07 (%)	
	2007	2008	2007	2008	Import	Eksport
Ushqim dhe kafshë të gjalla	12.5	11.9	3.6	3.5	11.4	13.5
Pije dhe duhan	2.9	3.2	1.4	0.3	26.4	-76.2
Materiale të përpunuara	2.2	2.1	9.6	11.8	9.1	42.5
Lëndë djegëse	14.7	15.9	7.9	8.9	26.4	30.4
Yndyrna bimore dhe shtazore	1.1	1.5	0.1	0.0	52.8	-70.7
Produkte kimike	9.9	9.7	1.0	1.1	14.6	26.0
Mallra të përpunuar	24.8	23.9	21.3	25.3	12.4	38.5
Makineri dhe pajisje	20.7	22.0	4.2	4.1	23.8	14.8
Mallra të tjerë të përpunuar	11.2	9.9	50.8	44.9	4.2	3.0
Mallra të paklasifikuar diku tjetër	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Total	100.0	100.0	100.0	100.0	15.3	16.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 12. Struktura e tregtisë së jashtme.

Dinamika e tregtisë tregon për ritme të larta rritëse gjatë vitit 2008, si në importe (15.3 për qind) ashtu edhe në eksporte (16.5 për qind). Megjithatë, ritmi i rritjes vjetore të eksporteve dhe importeve gjatë vitit 2008 ka qenë më i ulët se ai i vitit paraardhës⁴⁵. Pavarësisht ritmeve thuajse të përafërta të rritjes së importeve dhe eksporteve, baza e ulët e këtyre të fundit bëri që deficitin tregtar të shënojë rritje të mëtejshme. Ky deficit arriti vlerën e 2.4 miliardë eurove, duke qenë 14.8 për qind më i lartë se në vitin 2007. Pamjaftueshmëria e kapaciteteve prodhuese në vend për të kënaqur kërkesën në rritje të ekonomisë shqiptare për mallra, ka bërë që raporti i mbulimit të importeve nga eksportet të mbetet në nivele të ulëta, rreth 27 për qind. Kjo vlerë nuk ka shënuar ndryshime të ndjeshme gjatë tre viteve të fundit.

Analiza e importeve sipas përdorimit përfundimtar të tyre, dëshmon një përqendrim të theksuar drejt mallrave të ndërmjetëm (56 për qind), ndërkohë që mallrat kapitalë dhe ata të konsumit përfaqësojnë përkatësisht 29 për qind dhe 15 për qind të totalit të importit, gjatë vitit 2008. Mallrat e ndërmjetëm përfaqësohen konsiderueshëm nga mallrat industrialë të përpunuar (57 për qind). Viti 2008 regjistron një rënie vjetore me rreth 6 pikë përqindje të peshës së importit të mallrave të konsumit, ndërkohë që rritjen më të lartë në vlerë e kanë regjistruar mallrat kapitalë me rreth 29 për qind.

	Pesha në totalin e importit		'08/'07 (në %)	Pesha në totalin e eksportit		'08/'07 (në %)
	2007	2008		2007	2008	
Vendet e BE-së - 15, nga të cilat	54.1	54.2	16.9	81.8	78.0	11.2
Itali	27.2	26.6	14.3	68.0	61.8	5.8
Greqi	14.6	14.7	17.7	8.3	8.8	23.5
Gjermani	5.5	6.1	29.2	2.4	2.7	27.8
Anëtarë të rinj të BE-së, nga të cilat	5.7	6.7	37.7	1.3	1.6	45.7
Bullgari	1.8	1.9	26.1	0.7	0.7	21.3
Çeki	0.8	0.8	19.0	0.0	0.1	83.7
Rumani	0.4	0.5	48.3	0.3	0.2	-37.7
Vende të tjera evropiane, nga të cilat	11.6	11.6	-12.6	0.3	2.2	662.4
Rusi	4.1	4.4	24.8	0.3	1.1	388.2
Ukrainë	2.6	1.5	-34.2	0.0	0.0	997.0
Vendet e Ballkanit	13.2	13.7	4.5	12.1	15.2	34.6
Bosnjë Hercegovinë	0.3	0.3	12.3	0.4	0.2	-51.5
Kroaci	0.9	1.0	19.8	4.8	0.2	111.5
Kosovë	0.6	0.6	20.7	0.1	6.6	60.3

Tabelë 13. Tregtia e jashtme sipas partnerëve tregtarë.

Maqedoni	1.9	2.2	33.4	2.4	2.9	45.9
Serbi	2.2	0.0	-97.8	1.8	0.1	-96.3
Mal i Zi	0.1	0.2	133.0	0.4	2.1	443.2
Turqi	7.3	6.0	-3.6	2.2	1.9	-1.4
ShBA	2.5	1.1	24.2	0.7	0.4	-32.5
Azi, nga të cilat	7.6	9.0	33.2	2.6	2.8	25.8
Kinë	6.7	7.5	30.9	2.6	2.8	26.4
Totali	100.0	100.0	15.3	100.0	100.0	16.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kahun e eksporteve shfaqet rritje pothuajse e të gjithë grupmallrave. Varësia e theksuar e eksporteve tona nga industria e tekstileve dhe këpucëve vazhdon të karakterizojë edhe vitin 2008, duke kontribuar me 43.4 për qind në totalin e tyre. Gjatë vitit 2008, rritje të fortë ka shfaqur artikulli “produkte minerale” (rreth 8 herë më e lartë se viti 2007) dhe “lëndë djegëse” (30 për qind). Ndërkohë, eksportet e kategorisë “pije dhe duhan” regjistrojnë një rënie të theksuar (76.2 për qind).

Tregu kosovar ashtu si edhe gjatë vitit të kaluar, vazhdon të thithë pjesën më të madhe të eksporteve tona me rajonin, duke qenë dhe i vetmi vend me të cilin kemi suficit tregtar. Partnerë të tjerë tregtarë që po konsolidohen në tregun shqiptar janë Gjermania dhe Rusia.

SHËRBIMET

Vlera e transaksioneve të shërbimeve u rrit me rreth 9 për qind në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 35 për qind të PBB-së. Bilanci i llogarisë së shërbimeve rezulton negativ me rreth 15 milionë euro. Suficiti i krijuar nga të ardhurat në “shërbime udhëtimi” dhe “shërbime të tjera” nuk mundi të mbulojë deficitin e krijuar në zërat “shpenzime transporti” dhe “shpenzime sigurimi”.

Tregtia në shërbime shfaqet dinamike veçanërisht në kahun e eksporteve, të cilat vazhdojnë të ruajnë epërsinë ndaj eksportit të mallrave me rreth 1.7 herë më shumë. Shërbimet e udhëtimit, kryesisht ato për qëllime personale, përbëjnë grupin më të madh si nga ana e eksportit ashtu dhe nga ana e importit të shërbimeve, respektivisht me 78 dhe 68 për qind. Zhvillim pozitiv konsiderohet rritja e prurjeve valutore nga eksporti në turizëm, që arritën nivelin e 1.2 miliardë eurove⁴⁶, dukshëm më i lartë se ai nga eksporti i mallrave. Njëkohësisht, kërkesa për mallra e shërbime e udhëtarëve shqiptarë në vendet e huaja, çoi në regjistrimin e një importi shërbimesh udhëtimi prej rreth 1 miliard eurosh. Këto shpenzime, vlerësohen të jenë rritur me rreth 14 për qind ndaj një viti më parë.

Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të transportit dhe të sigurimit, si rezultat i rritjes së importit të mallrave. Bilanci i zërit “shërbime të tjera” regjistron një suficit prej rreth 54 milionë eurosh, ku kontributin kryesor e japin shërbimet e komunikacionit, shërbimet qeveritare dhe ato në ndërtim. Ndërkohë, shërbimet financiare regjistrojnë një rezultat negativ prej rreth 2 milionë eurosh.

TË ARDHURAT DHE TRANSFERTAT KORENTE

Në fund të vitit 2008, bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale neto (309 milionë euro), vlerësohet të jetë rritur me mbi 40 për qind kundrejt vitit paraardhës. Kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat nga investimet e portofolit. Gjatë vitit 2008, Shqipëria ka paguar rreth 28 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm, të cilat vlerësohen në rritje kundrejt vitit 2007⁴⁷.

Totali i dërgesave nga emigrantët, për vitin 2008 vlerësohet të jetë rreth 800 milionë euro; shifër kjo e barabartë me 9.2 për qind të PBB-së. Dërgesat nga emigrantët shënojnë një rënie prej 16 për qind në terma vjetorë. Kriza ekonomike dhe financiare në vendet ku numri i emigrantëve shqiptarë është më i lartë, mendohet të ketë ndikuar në uljen e prurjeve valutore prej tyre. Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 33 për qind, me një rënie prej 12 pikësh përqindjeje kundrejt vitit të kaluar. Transfertat zyrtare vlerësohen në rreth 27 milionë euro, duke regjistruar rënie kundrejt një viti më parë.

2.3.2 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE


Llogaria financiare gjatë vitit 2008 karakterizohet nga lëvizje të konsiderueshme të kapitalit në të dyja kahet, si në flukset hyrëse ashtu edhe ato dalëse. Fluksi neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistron një vlerë pozitive prej rreth 1,56 miliardë eurosh ose rreth 2 herë më i lartë se ai i vitit paraardhës. Bilanci pozitiv i llogarisë kapitale dhe financiare shkon rreth 83 për qind për deficitin e llogarisë korente dhe vlerësohet në rreth 18 për qind e PBB-së. Rreth 78 milionë euro kanë hyrë në formën e transfertave kapitale dhe rreth 1,38 miliardë euro në formën e detyrimeve financiare të rezidentëve.

Investimet e huaja direkte (flukset hyrëse) kanë regjistruar një shifër rekord në vitin 2008, me rreth 680 milionë euro ose 42 për qind më shumë se viti i kaluar. Raporti i investimeve të huaja direkte neto ndaj PBB-së vlerësohet në 7.2 për qind; 1.2 pikë përqindjeje më i lartë se një vit më parë.

Shërbimi i borxhit të jashtëm për vitin 2008 përfaqëson 11 për qind të eksporteve tona gjatë vitit 2008, çka dëshmon për një aftësi paguese të kënaqshme. Ndërkohë, mjetet valutore të investuara jashtë vlerësohen të jenë ulur me rreth 93.8 milionë euro. Këtë vit, një rëndësi të veçantë marrin detyrimet financiare të jorezidentëve në formën e rënies së mjeteve financiare të rezidentëve⁴⁸. Kjo shumë regjistron vlerën 225 milionë euro.

Pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave rezulton pozitiv duke bërë që rezervat valutore të autoritetit monetar, të rriten me 191.9 milionë euro.

Grafik 26. Llogaria kapitale dhe financiare në përqindje të PBB-së, sipas zërave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Si rezultat, niveli i tyre në fund të vitit 2008 shënoi vlerën 1.69 miliardë euro, duke qenë i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 4.2 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

2.4 POLITIKA FISKALE DHE TREGUESIT KRYESORË FISKALË⁴⁹

Politika fiskale ka patur një karakter më ekspansionist gjatë vitit 2008, duke u reflektuar në rritjen e shpenzimeve publike dhe të deficitit buxhetor. Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore u rritën përkatësisht me 15.3 për qind dhe 22.6 për qind gjatë vitit 2008, duke u vlerësuar në 27.3 për qind dhe 32.9 për qind e PBB-së. Deficiti buxhetor për vitin 2008, vlerësohet të ketë arritur në 5.7 për qind të PBB-së, duke u thelluar me rreth 2.2 pikë përqindjeje në terma vjetorë. Kontribuesi kryesor në zgjerimin e mëtejshëm të deficitit fiskal, janë shpenzimet për investime, kryesisht ato për rrugën Durrës-Kukës. Në terma vjetorë, të shprehura në raport ndaj PBB-së, shpenzimet kapitale kanë pësuar një rritje prej rreth 2.8 pikë përqindjeje. Politika fiskale për këtë periudhë kohore, e karakterizuar përgjithësisht nga një natyrë ekspansioniste, ka shërbyer si një stimul fiskal për ekonominë.

Tabelë 14. Treguesit fiskalë në raport ndaj PBB-së (në përqindje), 2005-2008.

	2005	2006	2007	2008
Të ardhura totale	25.06	25.75	25.70	27.26
i. Grantet	0.76	0.90	0.13	0.29
ii. Tatime dhe dogana	16.64	17.41	18.06	19.28
• TVSH	7.92	8.34	8.97	10.07
• Tatim fitimi	2.36	2.50	2.15	1.70
• Akciza	2.27	2.58	2.93	3.06
• Tatimi mbi të ardhurat personale	0.91	0.96	1.52	2.29
iii. Pushteti vendor	1.48	1.25	0.96	1.06
iv. Kontributet	4.44	4.41	4.29	4.47
v. Jotatimore	1.74	1.78	2.26	2.16
Shpenzime totale	28.51	29.05	29.18	32.92
i. Korente	23.81	22.99	22.98	23.54
• Personeli	6.59	6.36	6.04	6.26
• Interesa	3.19	2.81	2.61	2.94
• Operative	3.01	2.56	2.58	2.72
• Subvencione	0.45	0.43	0.36	0.24
• Sigurimet shoqërore	6.86	6.74	7.14	7.16
• Pushteti vendor	2.45	2.55	2.18	2.55
• Ndihma + kompensimet	1.25	1.55	1.51	1.67
ii. Kapitale	4.71	5.74	5.83	8.68
iii. Mbështetje energji+ Hua KESH	-	-	0.35	0.24
iv. Të tjera	-	0.32	0.07	0.46
Balanca buxhetore	- 3.46	- 3.30	- 3.49	- 5.66
• Financim i brendshëm	2.86	2.65	2.94	2.31
• Financim i huaj	0.60	0.65	0.54	3.35

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, IMF Country Report 09/73, Shkurt 2009.

Pavarësisht ritmeve të larta të rritjes, si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet buxhetore nuk kanë përmbyshur nivelin vjetor të programuar prej Ministrisë së Financave⁵⁰. Duke iu referuar planit të rishikuar në muajin dhjetor '08⁵¹, të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore kanë përmbyshur përkatësisht 97.3 dhe

98.7 për qind të nivelit vjetor të programuar. Përqindjet e realizimit për të dy treguesit paraqiten në nivele më të larta ndaj viteve paraardhëse.

Tabelë 15. Plani dhe fakti për treguesit buxhetorë për vitin 2008.

	Fakti		Plani 2008 (në mld lekë)		Plani 2008 (në % ndaj PBB)		
	2008	Fillestar	Rishikuar	Akt normativ	Fillestar	Rishikuar	Akt normativ
Të ardhura totale	290.08	283.69	303.78	298.22	26.66	28.55	28.03
i. Grantet	3.05	4.73	4.67	2.51	0.44	0.44	0.24
ii. Tatime dhe dogana	205.18	195.71	209.71	209.71	18.39	19.71	19.71
• TVSH	107.09	99.90	104.90	106.90	9.39	9.86	10.05
• Tatim fitimi	18.11	14.42	18.42	18.42	1.36	1.73	1.73
• Akciza	32.51	38.49	37.49	35.49	3.62	3.52	3.34
• Tatimi mbi të ardhurat personale	24.38	16.27	23.27	23.27	1.53	2.19	2.19
iii. Pushteti vendor	11.31	15.58	15.58	13.08	1.46	1.46	1.23
iv. Kontributet	47.59	51.06	51.06	48.16	4.80	4.80	4.53
v. Jo-tatimore	22.95	16.60	22.76	24.76	1.56	2.14	2.33
Shpenzime totale	350.27	369.03	360.21	354.76	34.68	33.85	33.34
i. Korente	250.49	253.05	257.41	254.84	23.78	24.19	23.95
• Personeli	66.62	67.96	67.96	67.06	6.39	6.39	6.30
• Interesa	31.31	33.28	32.58	31.58	3.13	3.06	2.97
• Operative	28.96	28.02	28.64	28.08	2.63	2.69	2.64
• Subvencione	2.55	2.28	1.97	2.57	0.21	0.18	0.24
• Sigurimet shoqërore	76.21	76.00	78.67	77.87	7.14	7.39	7.32
• Pushteti vendor	27.12	29.57	31.65	29.15	2.78	2.97	2.74
• Ndihma + kompensimet	17.73	15.94	15.94	18.54	1.50	1.50	1.74
ii. Kapitale	92.37	105.58	94.42	91.14	9.92	8.87	8.57
iii. Mbështetje energji+ Hua KESH	2.52	-	0.48	0.48	-	0.05	0.05
iv. Fondi rezervë	-	10.40	9.90	5.70	0.98	0.93	0.54
Balanca buxhetore	- 60.19	- 85.35	- 56.42	- 56.54	- 8.02	- 5.30	- 5.31
• Financim i brendshëm	24.53	29.42	21.10	21.85	2.76	1.98	2.05
• Financim i huaj	35.66	55.93	35.33	34.69	5.26	3.32	3.26

PBB për 2008 (miliardë lekë) : 1,064 (IMF Country Report 09/73, Shkurt 2009)


Burimi: Ministria e Financave.

Përsa i përket shpërndarjes nëpër tremujorë, ndërsa të ardhurat shfaqin pothuajse njëtrajtshmëri, shpenzimet buxhetore janë përqendruar kryesisht në tremujorin e dytë dhe atë të katërt të vitit. Përqendrimi i lartë i shpenzimeve, sidomos në muajt e fundit të vitit - sikurse dhe në dy vitet paraardhëse – ka ushtruar presione rritëse ndaj normave të interesit në tregun e letrave me vlerë të qeverisë.

Në aspektin strukturor, gjatë vitit 2008 financat publike kanë qenë të orientuara drejt arritjes së objektivave dhe përparësive të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet⁵². Sikurse dhe në vitet e mëparshme, sfidat dhe prioritetet kryesore për politikën fiskale konsistojnë në:

- arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik;
- përmirësimin e administrimit të financave

Grafik 27. Realizimi i treguesve kryesorë fiskalë përgjatë tremujorëve, T1 1999-T4 2008.




Burimi: Ministria e Financave.

publike, të borxhit publik, të sistemit të mbledhjes së të ardhurave dhe përmirësimin e klimës së biznesit;

- konsolidimin e mëtejshëm fiskal (reduktim i raportit borxh publik ndaj PBB-së);
- zgjerimin e bazës tatimore dhe harmonizimin e politikave tatimore me përparësitë e zhvillimit të vendit.

Në vijë të përgjithshme, vlerësohet të jenë hedhur hapa pozitivë drejt përmbushjes së objektivave kryesorë, disa prej të cilëve kanë qenë pjesë e Marrëveshjes së PRGF/EFF të nënshkruar me FMN-në. Nëse i referohemi shkallës së përmbushjes së *benchmark*-ëve strukturorë të përcaktuar në këtë marrëveshje, zhvillimet e vitit 2008 rezultojnë përgjithësisht të kënaqshme.⁵³



• TË ARDHURAT BUXHETORE

Të ardhurat buxhetore u rritën me 15.3 për qind gjatë vitit 2008, duke arritur në 27.3 për qind të PBB-së. Rritja ekonomike e vendit dhe përmirësimi i administrimit të sistemit të mbledhjes së të ardhurave, kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave. Raporti i të ardhurave totale ndaj PBB-së vlerësohet të jetë rritur me rreth 1.6 pikë përqindjeje gjatë vitit 2008.

Kontributin më të lartë në rritjen e të ardhurave totale vijojnë ta japin të ardhurat nga tatimet dhe doganat, bazuar në peshën e konsiderueshme që ky grup të ardhurash zë në total (rreth 70 për qind).

Tabelë 16. Realizimi i të ardhurave buxhetore të ndara sipas zërave kryesorë.

Në miliardë lekë	Mesatare 2005-2007	2007	T1	T2	T3	T4	2008 Total
Të ardhura totale	228.39	251.56	63.59	71.40	73.93	81.16	290.08
i. Grantet	5.16	1.28	0.04	0.48	0.20	2.33	3.05
ii. Tatime dhe dogana	155.84	176.81	46.87	49.23	53.85	55.24	205.18
TVSH	75.52	87.77	24.02	25.72	28.25	29.10	107.09
Tatim fitimi	20.86	21.08	6.05	3.79	3.64	4.63	18.11
Akciza	23.42	28.73	6.52	8.42	9.94	7.63	32.51
Tatimi mbi të ardhurat personale	10.28	14.85	4.82	5.18	6.26	8.13	24.38
Taksat nacionale	13.27	14.53	3.40	3.91	3.68	3.43	14.42
Taksa doganore	12.49	9.85	2.06	2.21	2.08	2.32	8.66
iii. Pushteti vendor	10.83	9.37	2.42	3.04	2.94	2.91	11.31
iv. Buxhetet e pavarura	39.16	41.99	11.13	11.31	11.83	13.32	47.59
v. Jo-tatimore	17.40	22.11	3.13	7.34	5.11	7.37	22.95

Burimi: Ministria e Financave.

Peshën kryesore ndaj totalit të të ardhurave, vijon ta mbartë zëri “Të ardhura nga TVSH-ja” (rreth 37 për qind). Ndonëse norma e TVSH-së ka qenë e njëjtë me një vit më parë, të ardhurat nga ky zë kanë rritur ndjeshëm kontributin në rritjen e totalit të të ardhurave për vitin 2008. Një ndër faktorët që ka ndikuar

pozitivisht në këtë rritje është edhe ngushtimi i lehtësive ligjore që ekzistonin për TVSH-në deri në mesin e vitit 2007.

Të ardhurat nga “akcizat”, pavarësisht zhvillimeve në tregjet botërore gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, kanë ruajtur të njëjtën peshë në totalin e të ardhurave krahasuar me vitin paraardhës. Megjithatë, viti 2008 shënon ngadalësim në ritmet e rritjes së këtij zëri. Me përjashtim të muajit gusht '08, kur të ardhurat nga akcizat kanë shfaqur pikun e tyre⁵⁴, gjatë muajve në vijim ritmi i realizimit të këtij zëri ka pësuar tkurje. Kjo sjellje e të ardhurave nga akcizat, lidhet kryesisht me reflektimin në tregun vendas të çmimeve të reduktuara të karburanteve në tregjet botërore. Niveli vjetor i programuar për këtë zë rezulton të jetë përmbushur në masën 91 për qind.

Niveli i të ardhurave të akumuluar nga “tatimi mbi fitimin” ka pësuar një tkurje prej rreth 14 për qind në terma vjetorë. Faktor kryesor konsiderohet reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin në 10 për qind. Niveli vjetor i programuar për këtë zë rezulton të jetë përmbushur në masën 98 për qind.


Të ardhurat nga “tatimi mbi të ardhurat personale” kanë shfaqur ritmet më të larta të rritjes në terma vjetorë. Efekti pozitiv i ndryshimit të mënyrës së tatimit mbi të ardhurat, përpjekjet drejt formalizimit të ekonomisë⁵⁵ si edhe përcaktimi i pagës referuese mujore për të punësuarit në sektorin jopublik, janë ndër edhe gjatë vitit 2008. Krahas rritjes së lartë vjetore (rreth 64 për qind), të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale kanë tejkaluar planin vjetor me rreth 5 për qind.

Të ardhurat nga “taksat doganore” vijnë në rënien, në sajë të marrëveshjeve të ndryshme që synojnë lëvizjen e lirë të mallrave.


Të ardhurat nga pushteti vendor, ndryshe nga tendenca e shfaqur gjatë dy viteve të mëparshme, kanë patur ritme pozitive rritjeje. Kjo i atribuohet kryesisht rristurimit të taksave të cilat kaluan nën administrimin e pushtetit vendor. Pavarësisht rritjes pozitive, përqindja e realizimit të planit vjetor për vitin 2008 rezulton rreth 86 për qind.

“Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore”, kanë njohur rritjen më të lartë të 4 viteve të fundit. Faktor kryesor në këtë zhvillim konsiderohet rritja e bazës tatimpaguese për kontributet e sigurimeve shoqërore, si një prej elementeve të rëndësishme në uljen e vulnerabiliteteve fiskale, e nxitur kryesisht nga masat e marra drejt formalizimit të ekonomisë.

Të ardhurat e karakterit “jotatimor”, kanë treguar një frenim të ritmit të rritjes duke shënuar një nivel realizimi pak më të lartë se një vit më parë. Gjithsesi në krahasim me planin, diferencat mbeten modeste⁵⁶.



Grafik 30. Ndryshimi nominal vjetor i shpenzimeve, sipas kontributeve të grupeve kryesore, 2000–2008.



Burimi: Ministria e Financave, Illogaritje të Bankës së Shqipërisë.

• SHPENZIMET BUXHETORE

Gjatë vitit 2008, janë realizuar rreth 350.3 miliardë lekë shpenzime, 26 për qind e të cilave janë shpenzime kapitale. Ky raport është më i larti i regjistruar gjatë kësaj dekade. Zhvillim tjetër pozitiv që lidhet me performancën e shpenzimeve buxhetore, është norma e lartë e rritjes vjetore (22.6 për qind) dhe përqindja e lartë e realizimit ndaj planit. Megjithatë, përqendrimi prej 40 për qind i totalit vjetor të shpenzimeve vetëm gjatë tremujorit të fundit të vitit, ka shkaktuar luhatshmëri mbi *yield*-et në tregun e letrave me vlerë të qeverisë.

Shpenzimet për “personelin”, përfaqësojnë rreth 19 për qind të totalit të shpenzimeve. Me një normë rritjeje vjetore prej 13 për qind, ky zë ka përmbyshur rreth 99 për qind të planit.

Pesha e “shpenzimeve për interesa” (të borxhit të brendshëm dhe atij të huaj) ndaj totalit ka qëndruar në nivele të njëjta (rreth 9 për qind) me vitet paraardhëse. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, janë rritur ndjeshëm pagesat për borxhin e jashtëm.

“Subvencionet” dhe për vitin 2008 kanë vijuar prirjen rënëse të viteve të mëparshme. Ndërsa “shpenzimet e mirëmbajtjes” kanë ruajtur të njëjtat ritme rritjeje me vitet e mëparshme.

Gjatë vitit 2008 “Shpenzimet për sigurimet shoqërore” kanë shfaqur prirje rritëse, por me ritme më të moderuara në terma vjetorë.

Tabelë 17. Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas zërave kryesorë.

Në miliardë lekë	Mesatare 2005-2007	2007	2008				
			T1	T2	T3	T4	Total
Shpenzimet	258.94	285.67	53.10	84.22	80.05	132.89	350.27
Personeli	56.49	59.09	14.17	15.82	16.35	20.27	66.62
Interesa	25.54	25.59	6.93	8.10	7.97	8.31	31.31
Operative	24.19	25.26	3.70	6.75	6.17	12.33	28.96
Subvencione	3.67	3.54	0.21	0.68	0.62	1.05	2.55
Mbështetje+Huadhënie KESH	2.67	8.00	-	-	-	2.52	2.52
Sigurimet shoqërore	61.93	69.89	16.64	18.38	20.40	20.78	76.21
Buxheti vendor	21.35	21.34	3.78	6.69	6.73	9.93	27.12
Ndihmat+Kompensime	12.92	14.77	2.61	3.34	3.50	8.28	17.73
Investimet	48.84	57.04	5.07	22.95	17.49	46.86	92.37
Të tjera ⁵⁷	1.00	1.16	-	1.52	0.81	2.56	4.89

Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet për “buxhetin lokal”, ndryshe nga një vit më parë, kanë shfaqur ritme rritjeje pozitive, duke kontribuar në rritjen e totalit të shpenzimeve me rreth 2 pikë përqindjeje.

Përmirësimi i administrimit të “shpenzimeve kapitale”, nëpërmjet një rishpërndarjeje të fondeve drejt projekteve më të mëdha, ka përfaqësuar një prej përparësive të politikës fiskale gjatë vitit 2008⁵⁸. Ky vit fiskal është karakterizuar nga një nivel relativisht i lartë shpenzimesh kapitale krahasuar me vitet paraardhëse. Në vlerë nominale, janë realizuar 92.4 miliardë lekë, një pjesë e konsiderueshme e të cilave përfaqësohet nga shpenzimet për ndërtimin e segmentit rrugor Rrëshen – Kalimash. Shpenzimet për investime janë mbuluar në masën 54 për qind nga burimet e brendshme të financimit dhe pjesa e mbetur, nga ato të huaja. Shpenzimet kapitale vlerësohen të kenë arritur në 8.7 për qind të PBB-së, kundrejt 5.8 për qind që shënonin në vitin 2007.

• DEFICITI BUXHETOR DHE FINANCIMI I TIJ

Viti 2008, u mbyll me një deficit buxhetor prej 60.2 miliardë lekësh, duke u zgjeruar me rreth 76 për qind krahasuar me një vit më parë. Rreth 59 për qind e deficitit buxhetor është financuar nëpërmjet huamarrjes së jashtme. Në raport ndaj PBB-së, deficitit buxhetor vlerësohet të ketë arritur nivelin 5.66 për qind, duke u zgjeruar me rreth 2.2 pikë përqindjeje nga një vit më parë.


• BORXHI PUBLIK

Për vitin 2008, borxhi publik vlerësohet të jetë rreth 55.9 për qind e PBB-së, kundrejt nivelit 52.8 për qind të shënuar një vit më parë. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së huamarrjes së jashtme për financimin e shpenzimeve kapitale.


Gjatë vitit 2008, huamarrja e brendshme nëpërmjet emitimit të letrave me vlerë është rritur rreth 15 miliardë lekë. Në këtë vit, stoku i borxhit të qeverisë në bono thesari dhe obligacione 3-vjeçare është zvogëluar, duke rritur në një masë më të madhe huamarrjen në obligacione 5 dhe 7-vjeçare. Kjo reflekton strategjinë e ndjekur nga Ministria e Financave për zgjatjen e maturitetit të borxhit të brendshëm dhe rritjen e instrumenteve afatgjata të borxhit, duke treguar kujdes në fragmentimin e tregut⁶⁰.

Vetëm gjatë vitit 2008, huamarrja e jashtme vlerësohet të jetë rritur me rreth 29 për qind nga një


Grafik 31. Shpenzimet sipas grupeve kryesore në raport ndaj PBB-së, 2000-2008.




Grafik 32. Ndryshimi vjetor i deficitit buxhetor, financimit të huaj e të brendshëm, 2000-2008⁵⁹.



Grafik 33. Stoku i borxhit publik në përqindje ndaj PBB-së, 2000-2008.



vit më parë. Pjesa më e madhe përfaqësohet nga huamarrja në monedhën euro. Për vitin 2008, stoku i borxhit në këtë monedhë vlerësohet rreth 48 për qind ndaj totalit të stokut të borxhit të jashtëm ose 14 pikë përqindjeje më i lartë se një vit më parë.



Pjesë e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim është dhe përmirësimi i administrimit të borxhit publik. Në këtë kuadër, elementet kryesore konsistojnë në rritjen e periudhës së maturimit të borxhit të brendshëm dhe në përmirësimin e infrastrukturës së tregut të letrave me vlerë nga pikëpamja teknike (krijimi i një sistemi *'Delivery-versus-Payment'* për shitblerjen e letrave me vlerë të Qeverisë).

Për sa i përket objektivit të parë, ditët në maturim për vitin 2008 rezultuan 401 kundrejt 346 një vit më parë. E thënë ndryshe, borxhi i brendshëm afatgjatë zë rreth 39 për qind të totalit të borxhit të brendshëm, duke u rritur me 4 pikë përqindjeje në terma vjetorë. Në lidhje me objektivin e dytë, viti 2008 shënoi hedhjen e disa hapave të rëndësishëm për krijimin e bazës ligjore për implementimin e sistemit *'Delivery-versus-Payment'*, me qëllim zëvendësimin e sistemit aktual të *Book Entry*.

SHËNIME

¹ Banka e Shqipërisë përkufizon stabilitetin e çmimeve si një normë inflacioni vjetor prej 3 për qind, me mundësi luhatjeje ± 1 pikë përqindjeje rreth kësaj vlere qendrore.

² Çmimet e ushqimeve dhe të naftës u rritën mesatarisht me 53.9 dhe 41.9 për qind gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008.

³ Në muqjin mars'08, çmimi i energjisë elektrike u rrit me 23.7 për qind në nivel vjetor.

⁴ Në tremujorin e fundit, çmimet e këtij zëri pësuan një rënie me rreth 19.2 për qind.

⁵ Kryesisht rritja e çmimeve të drithërave dhe të produkteve ushqimore të përpunuara.

⁶ Matjet e inflacionit sipas sektorëve janë rishikuar në bazë të gjykimit mbi pjesën e importuar të mallrave të shportës së IÇK-së.

⁷ Mars 2008 - rritja e çmimit të energjisë elektrike; qershor 2008 - rritja e çmimeve në transportin urban.

⁸ Ky indeks është llogaritur si mesatare e peshuar e indeksit të prodhimit për industrinë përpunuese dhe indeksit të vlerës njësi për importet e mallrave të konsumit.

⁹ Rritja vjetore e çmimeve të prodhimit gjatë periudhës janar-shtator'08 për këto industri ishte përkatësisht 13.8 për qind dhe 14.2 për qind.

¹⁰ Koeficienti i korrelacionit dëshmon për një lidhje më të fortë statistikore midis kategorisë "Ushqime të përpunuara" për Shqipërinë dhe për këto dy vende sesa midis indeksit total të çmimeve të konsumit. Koeficienti i korrelacionit për periudhën 2002M1-2008M12 është 0.9, në rastin e parë dhe 0.5 në rastin e dytë.

¹¹ Itali dhe Greqi.

¹² Koeficienti i korrelacionit për periudhën 2004-2008 rezultoi 0.8.

¹³ Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit leku qëndronte 12 pikë përqindjeje më i vlerësuar kundrejt dollarit amerikan.

¹⁴ Rezervat valutore të Bankë së Shqipërisë janë rritur me rreth 192 milionë euro ose 0.9 pikë përqindjeje të PBB-së.

¹⁵ Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 2001-2006 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

¹⁶ Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.

¹⁷ PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.

¹⁸ Të dhënat e të punësuarve dhe normës së papunësisë 2008 i përkasin tremujorit të tretë, INSTAT.

¹⁹ Të dhënat për treguesit fiskal janë paraprake.

²⁰ Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria. Për konvertimin e stokut të borxhit të jashtëm në lekë është përdorur kursi i këmbimit i fundit të vitit.

²¹ TTE agregon tregues të veçantë të sektorëve kryesorë të aktivitetit ekonomik (industri, ndërtim e shërbime) si dhe të konsumatorëve. Seritë e treguesve, bazuar në informacionin e marrë nga vrojtimet e besimit të organizuara nga BSH, të cilat përdoren në ndërtimin e TTE, janë sezonalisht të rregulluara.

²² Më konkretisht, Treguesi i Tendencës Ekonomike shënon një rënie prej rreth 5 pikë përqindjeje gjatë T1'08, për t'u rritur përkatësisht me rreth 2 dhe 8 pikë përqindjeje gjatë T2'08 dhe T3'08. Ndërkohë, ky tregues ra me rreth 10 pikë përqindjeje në tremujorin e fundit të vitit.

²³ Pyetjet cilësore kërkojnë nga i intervistuari një përgjigje në formën e një opinioni/gjykimi/perceptimi për zhvillimet aktuale apo të pritura, në ndryshim nga pyetjet sasiore, të cilat kërkojnë që i intervistuari të përgjigjet me të dhëna sasiore.

²⁴ Nga gjetjet e studimeve empirike, treguesi i besimit të biznesit tenton të shfaqë një performancë më të mirë sesa treguesi i besimit të konsumatorit.

²⁵ 2008* - i referohet mesatares së ndryshimeve vjetore për tre tremujorët e parë të vitit 2008.

²⁶ Indeksi i çmimit të banesave dhe indeksi i qirasë llogariten nga Banka e Shqipërisë. Llogaritja përfshin vetëm qytetin e Tiranës.

²⁷ Kjo vlerë përfshihet duke deflatuar indeksin e çmimit të banesave me indeksin e çmimeve të konsumit.

²⁸ Gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2008, janë dhënë 31 leje ndërtimi më shume se në nëntëmuorin e parë të vitit 2007 (shifra i referohen vetëm qarkut të Tiranës).


- ²⁹ Të dhënat i referohen peridhës janar-shtator'08.
- ³⁰ Ndër vizitorët e huaj, rreth 93.7 për qind janë vizitorë me netë qëndrimi dhe rreth 6.3 për qind janë vizitorë njëditorë.
- ³¹ Një rritje e numrit të vizitorëve të huaj regjistrohet në muajt tetor dhe nëntor'08.
- ³² Buxhetor dhe jobuxhetor (INSTAT, Konjuktura tregues kryesorë ekonomikë korrik-shtator 2008).
- ³³ Ndryshimi është i shprehur në terma vjetorë.
- ³⁴ Paga mesatare llogaritet si raport i fondit të pagave me numrin e punonjësve, metodologji e INSTAT.
- ³⁵ Niveli i punësimit është raporti i të punësuarve kundrejt popullsisë në moshë pune.
- ³⁶ Raporti i numrit të të punësuarve ndaj popullsisë në moshën 15-64 vjeç (në përqindje).
- ³⁷ Raporti i numrit të meshkujve të punësuar ndaj popullsisë në moshën 15-64 vjeç (në përqindje).
- ³⁸ Raporti i numrit të femrave të punësuar ndaj popullsisë në moshën 15-64 (në përqindje).
- ³⁹ Industria përpunuese.
- ⁴⁰ Tregtia.
- ⁴¹ Raporti i numrit të meshkujve të papunë ndaj forcës së aftë për punë.
- ⁴² Raporti i numrit të femrave të papuna ndaj forcës së aftë për punë.
- ⁴³ Gjatë vitit 2008, papunësia afatgjatë regjistrohet të jetë luhatur rreth nivelit 66 për qind, sipas të dhënave të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
- ⁴⁴ Përkatësisht 16 dhe 7 për qind, në terma vjetorë.
- ⁴⁵ Ritmi i rritjes vjetore të eksporteve dhe importeve gjatë vitit 2007 ka qenë përkatësisht 24.7 për qind dhe 26.2 për qind.
- ⁴⁶ Rreth 20 për qind më të larta në terma vjetorë.
- ⁴⁷ Gjatë vitit 2007, Shqipëria, ka paguar 24 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.
- ⁴⁸ Kjo rënie regjistrohet kryesisht në investimet në formën e depozitave të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente.
- ⁴⁹ Të dhënat fiskale për vitin 2008, janë paraprake.
- ⁵⁰ Plani i Ministrisë së Financave ka qenë objekt rishikimi dy herë gjatë vitit 2008.
- ⁵¹ Plani i miratuar me akt normativ të Këshillit të Ministrave në dhjetor '08, rezultoi i reduktuar nga plani i miratuar nga Parlamenti në korrik '08 (me përkatësisht 5.6 dhe 5.5 miliardë lekë për të ardhurat dhe shpenzimet totale).
- ⁵² SKZHI dhe Programi Buxhetor Afatmesëm përbëjnë kornizën e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Kjo kornizë, pasqyron një bashkësi parimesh funksionale që garantojnë mbarrëvajtjen e procesit të planifikimit dhe të zbatimit të politikave nga ana e Qeverisë. SPI, ndihmon qeverinë në priorizimin e shpenzimeve bazuar në strategjinë kombëtare.
- ⁵³ Benchmark-et strukturorë përfshijnë fusha të tilla si: pakësimi i vulnerabiliteteve fiskale; përmirësimi i administrimit të shpenzimeve buxhetore; dhe, përforsimi i sistemit financiar, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së tregut të letrave me vlerë të qeverisë.
- ⁵⁴ Kjo shpjegohet me çmimet ende të larta të karburanteve si edhe me rritjen e importeve të mallrave të akcizës (pije alkoolike/ joalkoolike dhe duhani) sidomos gjatë muajit gusht '08.
- ⁵⁵ Si një masë konkrete mund të përmendim kanalizimin e pagave të punonjësve jobuxhetorë nëpërmjet sistemit bankar.
- ⁵⁶ Një mosrealizim prej rreth 1.8 miliardë lekësh.
- ⁵⁷ Te ky zë janë përfshirë transferimet kapitale për shpronësimet dhe shpenzimet për rindërtimin e Gërdecit.
- ⁵⁸ Autoriteti fiskal ka adresuar ministrinë përkatëse drejt hartimit të propozimeve të projekteve më cilësore si dhe drejt shmangies nga projektet e vogla, me përparësi projektet e mëdha.
- ⁵⁹ Grafiku paraqet kontributin e financimit të huaj dhe të brendshëm, në varësi të kahut të ndryshimit të deficitit buxhetor.
- ⁶⁰ Në mënyrë që instrumentet e përdorura në tregun e letrave me vlerë të mos çojnë drejt fragmentimit të këtij tregu, është menduar që obligacionet 3-vjeçare të maturohen.

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE


3.1 ZHVILLIMET MONETARE

Ecuria e treguesve monetarë gjatë vitit 2008 ka evidentuar stabilizimin e ritmeve të zgjerimit të ofertës së parasë në përputhje me ecurinë e mjeteve të brendshme neto, të cilat kanë reflektuar kërkesën për para të agjentëve ekonomikë. Ritmet e rritjes së M3 real kanë ardhur në rënie gjatë dy viteve të fundit, duke sugjeruar për kontrollin më të mirë të presioneve inflacioniste. Ky ngadalësim është kushtëzuar edhe nga shtrëngimi gradual i politikës monetare gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit. Gjatë vitit 2008, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë neutrale, duke ndihmuar në konsolidimin e mëtejshëm të ngadalësimit të ritmit të ekspansionit monetar. Në aspektin sektorial, zhvillimet monetare gjatë vitit 2008 kanë reflektuar nevojat më të larta për financim të sektorit privat, kërkesën më të ulët të sektorit fiskal dhe kontributin negativ të komponentit valutor. Kreditimi i sektorit privat ka vazhduar të gjenerojë flukse të larta monetare, duke dominuar shtesën e stokut të parasë edhe gjatë vitit 2008. Ndërkohë, zgjerimi i kredisë në valutë me ritme më të larta se depozitat, ka çuar në uljen e pretendimeve valutore të bankave ndaj jorezidentëve dhe për pasojë, në kontributin negativ të komponentit valutor në zgjerimin e parasë.



Zhvillimet monetare vazhdojnë të karakterizohen nga tendenca e zhvendosjes drejt përbërësve më pak likuidë. Pësha mesatare e depozitave ndaj parasë së gjerë rezultoi mbi 80 për qind gjatë vitit 2008, krahasuar me rreth 78 për qind në vitin 2007. Kjo rritje dëshmon për forcimin e vazhdueshëm të besimit në sistemin bankar dhe të interesit për përdorimin e instrumenteve të

tij. Kërkesa e sektorit privat për para, në pjesën më të madhe të vitit, ka qenë e orientuar drejt valutës, duke u reflektuar në ritmet më të shpejta të rritjes së agregatit M3 krahasuar me ritmin e rritjes së M2.



Ritmi mesatar vjetor i rritjes së M3 u ngadalësua në 12.3 për qind, krahasuar me rritjen prej 15.8 për qind gjatë vitit 2007. Ecuria e agregatit M3 ka shfaqur luhatje gjatë vitit, karakterizuar nga një rritje sezonale gjatë periudhës së verës, si dhe nga një zbutje e ritmeve të rritjes gjatë tremujorit të fundit. Këto luhatje janë reflektuar edhe në ecurinë e parasë në terma realë, ku ritmi i agregatit M3 në tremujorin e fundit është ngadalësuar në 8.3 për qind mesatarisht.

Zhvillimet në depozita gjatë vitit 2008 janë karakterizuar nga luhatje sezonale. Rritja vjetore e depozitave në total ka shënuar ritme të larta rritjeje kryesisht gjatë muajve të verës, duke përkuar edhe me flukse të larta të hyrjes së valutës në vend. Priorja në rritje e depozitave ka ndryshuar kah në tremujorin e fundit, duke shënuar një ngadalësim të ritmeve rritëse.

Ngadalësimi i ritmeve të rritjes së agregatëve monetarë në tremujorin e fundit ka ardhur kryesisht si rezultat i pasigurive të krijuara në tregjet financiare botërore. Ritmi mesatar vjetor i rritjes së depozitave në këtë periudhë u përgjysmua krahasuar me rritjen e së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Kjo sjellje ka reflektuar rrjedhjen e një pjese të depozitave nga sistemi bankar. Për pasojë është konstatuar një rritje e shpejtë e parasë në qarkullim, e cila ka ndikuar në zgjerimin e bazës monetare me ritme më të larta. Pasiguritë e krijuara u reflektuan edhe në një sjellje më të kujdesshme të bankave në financimin e ekonomisë. Vështirësitë e bankave për gjenerimin e mjaftueshëm të likuiditeteve si dhe një politikë më e kujdesshme e tyre drejt kreditimit, u reflektuan në ngadalësimin e rritjes së kredisë për ekonominë dhe të financimit të sektorit fiskal.

Hapësirë informuese 4: Ndryshimi i metodologjisë së statistikave monetare.

Statistikat monetare dhe financiare janë një pjesë e rëndësishme dhe e veçantë e statistikave kombëtare makroekonomike të një vendi. Ato paraqesin nga njëra anë flukset financiare ndërmjet sektorëve të ekonomisë dhe nga ana tjetër, mjetet dhe detyrimet financiare që iu korrespondojnë. Në fillimet e viteve 2000 u prezantuan për herë të parë nga FMN ndryshime në metodologjinë e llogaritjeve të statistikave monetare financiare. Këto ndryshime të rëndësishme u ndërmorën me qëllim përmirësimin e këtyre statistikave dhe përshtatjen me evoluimin e instrumenteve dhe tregjeve financiare. Statistikat e reja monetare përfshijnë të gjitha institucionet financiare në vend duke ofruar dhe një mbulim më të mirë dhe rigoroz të aktivitetit ekonomik të vendit.

Në Bankën e Shqipërisë, mbas një periudhe disavjeçare të përpunimit dhe konsolidimit të të dhënave monetare sipas standardeve të reja, tani së fundmi u realizua kalimi përfundimtar në përdorimin e këtyre statistikave. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, të dhënat për treguesit monetarë në raportet periodike të Bankës së Shqipërisë, u bazuan në standardin e “Statistikave Monetare” (SM), përkundrejt “Statistikave Ndërkombëtare Financiare” (SNF) të përdorur më parë. Standardi i ri i statistikave monetare përfshin disa ndryshime konceptuale në strukturë si edhe ndryshime teknike, të cilat nuk prekin analizën e treguesve monetarë dhe financiarë, përveçse përmirësojnë cilësinë e të dhënave në disa drejtime.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme është mbulimi institucional, i cili nënkupton përfshirjen e të gjitha institucioneve që pranojnë depozita dhe që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, metodologjia e Statistikave Ndërkombëtare Financiare përfshinte vetëm Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, ndërsa standardi i ri përfshin njëkohësisht grupin e shoqërive të kursim-kreditit si pjesë e grupit të institucioneve të tjera financiare.

Një tjetër ndryshim ka të bëjë me orientimin e të dhënave përsa i përket sektorizimit dhe klasifikimit të instrumenteve financiare. Standardi i ri ka në fokus treguesit financiarë dhe ecurinë e tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përkundrejt standardit të vjetër i cili kishte në fokus analizën e sektorëve dhe më pas, ecurinë e treguesve në secilin prej tyre. Në përgjithësi, ky standard bën një paraqitje më të detajuar të sektorëve ekonomikë dhe instrumenteve financiare.

Përveç ndryshimeve konceptuale, metodologjia e re dallon nga ajo e vjetra në klasifikimin e depozitave në parandë e gjerë M3. Ndryshimi kryesor konsiston në përjashtimin nga llogaritja e parasë së gjerë të depozitave të garancive në lekë, të depozitave të bllokuara në lekë si dhe të depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet, të cilat kanë kufizime përsa i përket likuiditetit dhe transferueshmërisë së tyre. Sipas metodologjisë së re, ato janë zhvendosur në kategorinë “Depozita të papërfshira në parandë e gjerë”.

Një ndryshim tjetër në metodologjinë e re është përfshirja e interesave të përlogaritur për instrumentet e Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, si edhe ato të shoqërive të kursim-kreditit që janë shtuar rishtazi me standardin e ri.


Ndryshime të tjera ka patur përsa i përket terminologjisë së përdorur, e cila gjithashtu është përshtatur sipas rekomandimeve të standardeve ndërkombëtare. Për shembull, është përdorur termi “aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit” në vend të “llogari kapitale” ose termi “korporata jofinanciare publike” në vend të “sektori publik”.

Peshën kryesore në ndryshimin e vlerave të treguesve të llogaritur sipas dy metodologjive e përbën përfshirja e depozitave të bllokuara në paranë e gjerë në metodologjinë e vjetër dhe përjashtimi i tyre në standardin e ri. Njëkohësisht, ndikim ka patur edhe përfshirja në këtë standard e depozitave të shoqërive të kursim-kreditit dhe interesave të përllogaritur. Këto ndryshime janë reflektuar kryesisht në vlerat e parasë së ngushtë M1 dhe agregatit monetar në lekë M2, ndërkohë që janë reflektuar më pak në paranë e gjerë M3. Megjithatë, ndryshimet midis dy metodologjive nuk prekin vlerësimin tërësor të treguesve monetarë për qëllimet e politikës monetare.

ZHVILLIMET NË STRUKTURËN KOHORE TË M3-IT

Struktura kohore e ofertës monetare, në terma të përgjithshëm, ka shfaqur prirje drejt mjeteve monetare më afatgjata. Megjithë rënien në fundin e vitit 2008, pesha e depozitave në total ndaj M3 është rritur mesatarisht me 2 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2007. Ndërsa struktura kohore e depozitave gjatë pjesës së parë të vitit nuk ka pësuar ndryshime thelbësore, në fundin e periudhës është konstatuar një prirje drejt përbërësve më afatshkurtër, e nxitur kjo nga pasiguritë e krijuara në kuadrin e krizës financiare globale. Pesha mesatare e depozitave pa afat ndaj depozitave me afat në tremujorin e fundit rezultoi në 30.7 për qind, rreth 1 pikë përqindjeje më e lartë krahasuar me pjesën tjetër të vitit.

Grafik 3. Ecuria e depozitave në total ndaj M3 dhe rritja vjetore sipas strukturës kohore.




Burim: Banka e Shqipërisë.

• PARAJA JASHTË BANKAVE

Zhvillimet në përbërësin më likuid të M3, paranë jashtë bankave, kanë rezultuar të luhatshme gjatë vitit 2008. Në gjysmën e parë të vitit, ky tregues ka vijuar prirjen rënëse në nivele të ulëta historike, duke pësuar një rënie mesatare vjetore prej - 4.4 për qind. Kjo tendencë vërehet edhe në ritmin e ulët të bazës monetare, e cila në terma vjetorë u rrit me vetëm 2.2 për qind


në pjesën e parë të vitit, krahasuar me normën prej 11 për qind të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, në fundin e periudhës është konstatuar një rritje e shpejtë e parasë jashtë bankave, e cila është ndikuar kryesisht nga rrjedhja e depozitave të sistemit bankar. Në të njëjtën kohë, presionet nga sektori fiskal për shkak të përqendrimit të shpenzimeve buxhetore në fundin e periudhës kanë nxitur rritjen e parasë në qarkullim. Pesha mesatare e parasë jashtë bankave ndaj M2 pësoi rënie në krahasim me vitin e kaluar, ndonëse gjatë tremujorit të fundit ky raport rezultoi rreth 3 pikë përqindje më i lartë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja e pretendimeve neto të sistemit ndaj qeverisë me rreth 30 miliardë lekë në fundin e periudhës, nxiti zgjerimin e M2 kryesisht nëpërmjet komponentit të saj likuid, parasë jashtë bankave.



• DEPOZITAT NË LEKË

Në terma afatmesëm, ecuria e depozitave në lekë ka qenë e qëndrueshme, në përputhje me kërkesën për likuiditet dhe zhvillimet sezonale në tregun e parasë. Përbërja strukturore e M2 është zhvendosur lehtësisht drejt depozitave në lekë, megjithë rritjen e komponentit likuid në fundin e periudhës. Pesha mesatare e depozitave në lekë ndaj M2 është rritur në 70 për qind gjatë vitit 2008, rreth një pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin e kaluar. Ruajtja e normave pozitive të interesit real në lekë ka ushtruar ndikim në zgjerimin e depozitave. Norma mesatare vjetore e rritjes së depozitave në lekë u luhet rreth vlerës 9.4 për qind, krahasuar me rritjen prej 12 për qind të vitit të kaluar. Ngadalësimi i ritmit të rritjes së depozitave në lekë gjatë vitit 2008 u konstatua në tremujorin e fundit, duke shënuar 5.5 për qind. Gjatë kësaj periudhe përbërja kohore e M2 pësoi një zhvendosje të lehtë sezonale drejt përbërësve monetarë më likuidë. Raporti i depozitave pa afat në lekë ndaj atyre me afat u rrit në 28.6 për qind, rreth tre pikë përqindje më i lartë krahasuar me pjesën tjetër të vitit.

Grafik 5. Ecuria vjetore e depozitave në lekë dhe pesha e tyre ndaj totalit të depozitave.




Burim: Banka e Shqipërisë.

ZHVILLIME NË STRUKTURËN VALUTORE TË M3-IT

Përbërësi valutë i parësë së gjerë ka vijuar prirjen rritëse të konstatuar në vitet e fundit. Gjatë vitit 2008 ritmi i rritjes së depozitave në valutë u karakterizua nga luhatje sezonale, ndërsa rritja mesatare vjetore rezultoi në 23.5 për qind. Rritja u përqendrua kryesisht në muajt e verës, periudhë e cila përkon me flukse të larta të remitançave në valutë. Kjo prirje ndryshoi kah në tremujorin e fundit, ku ritmi mesatar i rritjes u ngadalësua në 12 për qind. Megjithatë ngadalësimin në fundin e periudhës, pesha mesatare e depozitave në valutë ndaj depozitave totale është luhatur në rreth 43 për qind gjatë vitit 2008, krahasuar me peshën prej rreth 40 për qind një vit më parë.

Në terma afatgjatë, struktura valutë e parësë së gjerë është ndikuar gjithashtu nga kërkesa në rritje për kredi në monedhë të huaj, e cila reflektohet në kahun e ofertës në formën e depozitave në valutë. Struktura

Grafik 6. Ecuria vjetore e depozitave në valutë dhe pesha e tyre ndaj parësë së gjerë.



Burim: Banka e Shqipërisë.

kohore e depozitave në valutë ka pësuar zhvendosje drejt mjeteve monetare më afatgjata. Kjo prirje evidentohet në rritjen e peshës së depozitave me afat në valutë ndaj totalit të depozitave në valutë në 74 për qind, rreth 3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2007.

Hapesirë informuese 5: Rezerva valutore në Shqipëri, një analizë krahasuese.

Rezerva valutore e një vendi mbahet nga autoriteti monetar dhe përfshin rezervat e arit, arkën e monedhave dhe kartëmonedhave në valutë, depozitat në bankat e huaja, letra të ndryshme me vlerë si edhe pozicionin valutor në FMN¹. Mbajtja e rezervës valutore përgjithësisht ka për qëllim përballimin e situatave të papritura shkaktuar nga mungesa likuiditeti në tregjet ndërkombëtare. Ana tjetër e medaljes është kostoja oportune që ato mbartin nëse këto para do të investoheshin në një formë tjetër. Niveli dhe mjaftueshmëria e rezervës valutore ka qenë vazhdimisht çështje mjaft e debatuar midis analistëve e studiuesve. Shpeshherë vende të ndryshme janë komentuar për mbajtjen e niveleve të larta të rezervës. Në kuadrin e globalizimit, niveli i lartë i rezervave valutore është arsyetuar si një lloj siguracioni ndaj luhatshmërisë së madhe në lëvizjen e kapitalit. Ndërsa kundërshtuesit e kësaj teze mendojnë se rezervat në nivele të larta janë të panevojshme, pasi këto fonde mund të shfrytëzohen më mirë për zhvillimin e ekonomisë.

Strategjia e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rezervës valutore ka parashikuar rritjen e vazhdueshme të saj në përputhje me rritjen e vazhdueshme të aktivitetit të jashtëm tregtar dhe zgjerimit të sistemit financiar. Politika operacionale që ka ndjekur Banka e Shqipërisë në drejtim të mbajtjes së rezervës valutore ka qenë subjekt i marrëveshjeve të Qeverisë Shqiptare me misionet PRGF/EFF të FMN-së gjatë viteve të fundit. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje autoriteti monetar ka mbajtur një nivel minimum të rezervës valutore të barabartë me të paktën vlerën e tre muaj importeve. Në përfundim të marrëveshjes trevjeçare me FMN-në në janar të vitit 2009, rezerva valutore do të jetë subjekt i monitorimit të vazhdueshëm të autoritetit monetar.

Përcaktimi i nivelit optimal të rezervës valutore varet nga një sërë faktorësh, të cilët ndryshojnë në varësi të madhësisë së ekonomisë si edhe nivelit të zhvillimit të një vendi. Shqipëria është një vend me një ekonomi të vogël, të hapur dhe në zhvillim. Ajo karakterizohet nga një deficit i lartë dhe në rritje i llogarisë korente, duke regjistruar një rritje të shpejtë të borxhit të jashtëm afatshkurtër gjatë viteve të fundit si edhe karakterizohet nga një normë e lartë e euroizimit të parasë së gjerë. Në këtë kuadër është i nevojshëm monitorimi i rezervës ndaj treguesve që adresojnë këto karakteristika të ekonomisë shqiptare. Treguesi i rezervës matur ndaj importeve të mallrave dhe shërbimeve është një kriter që rekomandohet të përdoret në rastet kur madhësia dhe ecuria e deficitit korent përbëjnë ose mund të përbëjnë një burim destabiliteti për vendin. Monitorimi i rezervës ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër rekomandohet për të adresuar rreziqet që vijnë nga një tharje ose tkurrje e tregut të jashtëm të huamarrjes dhe për të dëshmuar aftësinë paguese të ekonomisë në raste krizash. Ndërsa në kushtet e euroizimit të pjesshëm të ekonomisë, mbajtja e rezervës në terma të parasë së gjerë adreson rastet e krizave të besimit, të shoqëruara me tërheqjen e papritur të depozitave.

Mbajtja e rezervës në terma të tre këtyre treguesve ndihmon për të kuptuar më mirë rreziqet potenciale nga faktorët që mund të çenojnë stabilitetin makroekonomik të ekonomisë shqiptare. Të tillë faktorë që karakterizojnë një ekonomi të vogël dhe të hapur në drejtim të bilancit të pagesave, me një sistem financiar me shkallë të lartë euroizimi sikurse ekonomia shqiptare, e bëjnë të përshtatshëm përdorimin e një ose disa kriterëve të mjaftueshmërisë së rezervës valutore.

Kriza financiare globale ka rikthyer edhe një herë në fokus debatin mbi mjaftueshmërinë e rezervave valutore. Vende të ndryshme janë më shumë të ekspozuara ndaj reziqeve të tilla si thellim i mëtejshëm i deficitit tregtar, tkurje/tharje e tregut të jashtëm të huamarrjes apo krizat e besimit në sistemin bankar të shoqëruara me tërheqjen e papritur të depozitave. Në këto kushte shqetësimi në lidhje me kostot e mbajtjes së një niveli të lartë të rezervës valutore është më pak aktual, përkundrajt nevojës për sasi më të mëdha rezervash për përballimin e situatave emergjente.

Treguesit e rezervës së vendeve të Evropës Qendrore e Lindore (EQL) kanë njohur një rënie të përgjithshme nga viti 2002 (tabelë 1). Megjithë këtë rënie, treguesit e vendeve si Serbia, Bullgaria, Kroacia apo Rumania konstatohet të jenë mbi nivelin mesatar të grupit të vendeve të EQL-së. Serbia shënon nivelin më të lartë të rezervës të matur ndaj këtyre treguesve, ndërsa Sllovenia nivelin më të ulët. Thuajse të gjitha vendet, përveç Sllovenisë dhe Lituanisë, plotësojnë kushtin tradicional të mjaftueshmërisë së rezervës; mbulimin me tre muaj importe (25 për qind e vlerës vjetore të importeve). Në përgjithësi, vërehet se vendet e EQL-së kanë shpenzuar një pjesë të rezervës valutore në vitin 2008, përveç Hungarisë dhe Çekisë. Hungaria e ka rritur rezervën e saj me rreth 10 miliardë dollarë (kryesisht si pasojë e kredisë së marrë nga FMN-ja), ndërsa Çekia me rreth 2 miliardë dollarë.

Për vitin 2008, treguesi i rezervës ndaj importeve në Shqipëri rezulton më i lartë se mesatarja e vendeve të rajonit. Në fund të vitit rezerva valutore e Shqipërisë është e aftë të mbulojë vlerën e mbi katër muajve importe mallrash dhe shërbimesh. Raporti i rezervës ndaj PBB-së është ulur nga 16.9 për qind në vitin 2002 në 15.1 për qind në vitin 2008, rreth 2.4 pikë përqindje nën mesataren e vendeve të EQL-së. E matur si raport ndaj parasë së gjerë rezerva valutore e Shqipërisë rezulton të jetë gjithashtu nën mesataren e vendeve të rajonit për vitin 2008. Në këtë kontekst, mbajtja e rezervës valutore në nivele të larta, do të vazhdojë të jetë në fokusin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës së ardhme, edhe në mungesë të marrëveshjeve formale me FMN.

Tabelë 1. Rezerva valutore dhe tregues të mjaftueshmërisë (vendet e Evropës Qendrore e Lindore).

	Rezerva valutore									Raporti i rezervës valutore ndaj borxhit afatshkurtër ¹	
	Stoku në fundin periudhës, në miliardë usd			Si përqindje ndaj:							
				PBB		Importe		Paraja e gjerë			
	2007	2008	Ndryshimi në '08 ²	2002	2008	2002	2008	2002	2008	2002	2008
Shqipëria	1.7	1.9	0.2	16.3	15.4	53.8	37.2	27.8	20.1	27.9	2.0
Maqedonia	2.1	1.8	-0.3	18.9	19.2	35.9	26.3	61.3	45.5	9.8	3.0
Serbia	13.9	13.6	0.4	14.2	26.0	38.6	57.4	66.7	92.3	2.1	5.0
Bosnje-Hercegovina	4.5	3.2	-1.3	19.8	16.5	34.0	25.7	47.1	34.2	3.7	1.8
Bullgaria	16.4	17.1	0.4	27.9	33.0	54.6	44.2	58.3	56.9	4.8	1.2
Kroacia	13.7	12.5	-1.0	25.6	19.5	54.9	39.7	36.1	31.1	1.5	0.6
Rumania	37.2	34.9	-2.7	13.4	16.3	34.3	40.6	58.1	51.3	2.8	0.9
Turqia	73.2	70.5	-1.8	11.6	8.8	52.1	32.5	30.5	20.6	1.4	1.0
Çekia	34.9	37.0	2.1	31.5	17.0	55.4	25.4	41.5	25.6	4.4	1.8
Hungaria	23.8	33.5	9.8	14.6	20.4	25.7	30.3	27.6	47.2	1.1	1.1
Polonia	65.7	62.2	-3.6	15.0	11.0	54.0	29.9	35.2	28.8	2.2	1.8
Sllovakia	18.0	17.9	0.8	36.0	17.8	50.4	23.5	49.7	34.7	3.4	1.5
Sllovenia	1.1	0.9	-0.2	29.5	1.7	65.0	2.7	45.1	3.6	5.3	0.1
Estonia	3.3	4.1	0.6	13.7	16.3	20.8	24.4	32.9	39.1	0.4	0.6
Latvia	5.6	4.2	-1.2	13.3	12.5	30.6	26.4	38.4	37.3	1.6	0.4
Lituania	7.6	6.2	-1.8	16.2	12.7	30.5	19.6	51.0	38.5	1.6	0.9
Mesatarja ³	21.5	21.4	0.0	19.2	17.5	41.5	32.4	43.9	40.5	3.1	1.6

¹ Borxh i jashtëm afatshkurtër, përkufizuar sipas standardeve të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) me maturitet deri në një vit. ² Ndryshimi që nga fundi i vitit 2007.

³ Mesatare e thjeshtë, duke përfshirë Shqipërinë në vitin 2002.

Burimi: BIS, FMN, të dhëna kombëtare dhe Banka e Shqipërisë.

KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT

Gjatë tre viteve të fundit, kreditimi i ekonomisë ka shfaqur rritje të qëndrueshme duke treguar për mbështetjen më të madhe që sistemi bankar i ka dhënë zgjerimit të prodhimit dhe rritjes së aktivitetit ekonomik në vend. Gjatë kësaj periudhe, raporti i kredisë ndaj prodhimit të brendshëm bruto është rritur mesatarisht me 7 pikë përqindje në vit dhe shënoi rritjen maksimale me 8.2 pikë përqindje në vitin 2007. Në vitin 2008 ky raport u rrit me 7.3 pikë përqindje duke arritur në 37 për qind. Kredia për ekonominë përbën rreth 50 për qind të parasë së gjerë dhe 47 për qind të aktiveve të sistemit bankar.


Grafik 7. Zhvillimet në portofolin e kredisë dhe treguesit e ndërmjetësimit.



Kredia për ekonominë gjatë vitit 2008 është zgjeruar me ritme vjetore më të ngadalta se një vit më parë, mesatarisht me 44 për qind². Megjithatë, në vlerë absolute ritmi vjetor i zgjerimit të kredisë për pjesën më të madhe të vitit ka ardhur në rritje, duke pasqyruar përfshirjen më të madhe të bankave në kredidhënie si dhe përmirësimin e treguesve të ndërmjetësimit. Në muajin dhjetor 2008, kredia për ekonominë pasqyroj rritjen më të ulët mujore të viteve të fundit duke reflektuar problemet e bankave për gjetjen e likuiditetit, shtrëngimin e kushteve të kredisë si dhe një kërkesë më të ulët për kredi. Për herë të parë gjatë 5 viteve të fundit, në muajin dhjetor, zgjerimi vjetor i kredisë u reduktua dukshëm në terma absolutë, duke shënuar një normë rritjeje vjetore në 35 për qind. Në përgjithësi, i gjithë viti 2008 është karakterizuar nga shtrëngimi i kriterëve (standardeve) të kredidhënies në përgjigje të masave rregulluese të marra nga Banka e Shqipërisë. Por, në pjesën e dytë të vitit³, vihet re një shtrëngim i standardeve të kredisë më i madh se sa pritej. Një faktor tjetër që ka ndikuar në reduktimin e kërkesës për kredi është dhe pasiguria për të ardhmen e aktivitetit ekonomik në vend si dhe pasiguria për ecurinë e të ardhurave të agjentëve ekonomikë.

Zhvillimet në strukturën valutore të kredisë gjatë vitit 2008, treguan një zhvendosje të lehtë të portofolit të kredisë drejt asaj në valutë. Në pjesën


më të madhe të vitit, kredia në valutë është rritur me ritme vjetore të larta dhe të qëndrueshme; prej mesatarisht 50 për qind. Portofoli i kredisë në valutë, sikurse edhe një vit më parë, u dominua nga kreditimi në euro, i cili përbën 90 për qind të tepicës së kredisë në monedhë të huaj. Preferenca për kredinë në valutë ka vazhduar të mbështetet nga interesa më të ulët të ofruar për kredinë në valutë. Ky faktor është cilësuar si më kryesori në vrojtimin e aktivitetit kreditues me bankat. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë konstaton se klientët e bankave tregtare vazhdojnë të mos faktorizojnë sa duhet rrezikun e kursit të këmbimit kur zgjedhin të marrin një kredi në valutë. Po kështu, sipas rezultateve të vërtetimit, faktorë të tjerë të rëndësishëm për preferencën e kredisë në valutë janë edhe gjenerimi i të ardhurave në valutë si dhe kuotimi i disa produkteve në euro. Edhe faktori i fundit, nuk shpreh sjellje racionale të individëve për sa kohë që ata marrin përsipër një ekspozim afatgjatë⁴ ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit përkundrejt kostos që mund të ketë konvertimi i kredisë nga lekë në euro, në momentin kur kryhet pagesa.




Kredia në lekë në gjithë tremujorin e katërt të vitit 2008, pasqyroj një rritje të moderuar të normës vjetore të rritjes në 35 për qind, duke u barazuar me atë të kredisë në valutë. Tkurja e ndjeshme e rritjes vjetore të portofolit të kredisë në valutë, dëshmoi për vështirësitë e bankave për sigurimin e likuiditetit në valutë, të ndikuara jo vetëm nga mungesa e tij në tregun ndërkombëtar, por edhe nga tërheqjet më të larta të depozitave në valutë. Kjo situatë i ka detyruar bankat të bëjnë një rivlerësim më të mirë të rrezikut të kredisë si dhe të jenë më të kujdesshme në zgjerimin e aktivitetit kreditues në monedhë të huaj.

Bizneset kanë qenë klientët më të preferuar të bankave edhe gjatë vitit 2008. Portofoli i kredisë për biznese tregoi një rritje të lartë dhe të qëndrueshme gjatë pjesës më të madhe të vitit; mesatarisht 44 për qind. Bankat kanë kredituar më shumë bizneset për mbulimin e nevojave për likuiditet dhe për financimin e investimeve në pasuri të paluajtshme. Ndërkohë, kredia për investime në

makineri ka vijuar ngadalësimin e ritmeve të rritjes, në linjë me tendencën rënëse të vërejtur gjatë vitit 2007.




Gjatë vitit 2008, bankat tregtare kanë vijuar të mbështesin me kredi sektorët kryesorë të ekonomisë, tregtinë, ndërtimin dhe industrinë. Rritja e qëndrueshme e kredisë për sektorin e ndërtimit - mesatarisht 59 për qind gjatë vitit 2008 kundrejt 63 për qind të shënuar gjatë vitit 2007 - ka rritur peshën e kredisë për ndërtimin në totalin e kredisë për biznese me 2 pikë përqindje, në mesatarisht 22 për qind për 2008-ën. Kredia për sektorin e tregtisë është rritur me ritme pothuajse të njëjta me një vit më parë duke ruajtur të pandryshuar peshën në portofolin e kredisë për biznese, në 38 për qind. Megjithatë zhvillimet pozitive për pjesën më të madhe të vitit, këta dy sektorë, në dy muajt e fundit të vitit, shfaqën ngadalësim të dukshëm. Kredia për sektorin e industrisë gjatë vitit 2008 është rritur me ritme më të ngadalta



se një vit më parë, mesatarisht 37 për qind⁵. Për pasojë, në fund të vitit, pesha e kredisë për këtë sektor është zvogëluar me 1 pikë përqindje, duke arritur në 25 për qind të portofolit të kredisë për biznese.


Ritmi vjetor i rritjes së kredisë për individë është ngadalësuar njëtrajtësisht përgjatë gjithë vitit, duke zbritur në 30 për qind, krahasuar me 62 për qind që shënonte në fund të vitit 2007. Kjo ka sjellë rënien e peshës së portofolit të kredisë të individëve në fund të vitit në 35.6 për qind krahasuar me 36.7 për qind që ishte në tetor të vitit 2007. Ngadalësimi i kredisë për individë është vënë re si për kreditimin për banesa ashtu edhe për konsum. Portofoli i kredisë për individë dominohet nga kredia për pasuri të paluajtshme, me 66 për qind të tij. Kjo kredi ka dhënë dhe kontributin kryesor në zgjerimin e tepricës së kredisë për individë si dhe ka kontribuar në rritjen e kreditimit në valutë në vitin 2008. Pasiguritë e krijuara për ecurinë e të ardhurave të individëve, si nga tregu i brendshëm i punës ashtu edhe nga burimet alternative nga jashtë, kanë bërë që bankat të tregohen më konservatore dhe më të kujdesshme në *banking*-un me pakicë. Ky fakt është pohuar edhe nga specialistët e kredisë të sistemit bankar, të cilët shprehen për shtrëngimin më të madh të standardeve kredituese për këtë grup krahasuar me bizneset.

Grafik 11. Zhvillimet në portofolin e kredisë për individë.



Shpërndarja gjeografike e burimeve dhe e përdorimit të fondeve, tregon se aktiviteti depozitues është më pak i përqendruar se sa ai kreditues. Depozitat në kryeqytet përbëjnë 43 për qind të depozitave totale të sistemit. Ndërkohë që investimi i fondeve në aktive dëshmon për një përqendrim të dukshëm të portofolit të kredisë në kryeqytet me 68 për qind. Shpërndarja gjeografike e grumbullimit të kursimeve dhe investimeve me kredi dëshmon për një sjellje më aktive në grumbullimin e kursimeve dhe më konservatore në investimin e fondeve. Po kështu, ajo është në linjë edhe me përqendrimin e aktivitetit ekonomik në rrethet kryesore të vendit, ku ndodhen pjesa më e madhe e bizneseve. Gjithsesi përqendrimi i lartë i kredisë në rrethin e Tiranës lidhet edhe me aspekte teknike të miratimit të kredive me shuma të mëdha, mbi një

nivel të caktuar, vetëm nga zyrat qendrore, duke mos pasqyruar mbulimin real me financim të zonave gjeografike të vendit.



Hapësirë informuese 6: Aktiviteti kreditues në Shqipëri, analizë krahasuese.

Shumë ekonomistë vlerësojnë se ekonomitë e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL) kanë kaluar një periudhë zhvillimi dhe boom-i ekonomik të suksesshme gjatë 5 viteve të fundit. Standardet e jetesës janë përmirësuar ndjeshëm dhe aktualisht sot këto ekonomi janë të integruara me pjesën tjetër të Evropës. Ndërkohë që sektori bankar në vendet e EQJL-së, gjatë kësaj periudhe ka qenë mjaft atraktiv për investitorët e huaj (kryesisht evropianë), për shkak të fitimeve të larta; pritshmërisë për një rritje të lartë ekonomike si dhe perspektivës së afërt të shumë prej vendeve të rajonit për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, tregjet financiare të këtyre vendeve edhe pse kanë shfaqur progres të ndjeshëm, kanë ofruar hapësirat e nevojshme për thellimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar.

Një nga pasojat e integritit ekonomik të vendeve të EQJL është edhe akumulimi i disbalancave ekonomike, të cilat kanë sjellë deficite të larta të llogarive korente dhe varësi më të madhe të tyre ndaj zhvillimeve në tregjet globale. Ndërsa këto disbalanca dukeshin të kontrollueshme përpara goditjes së krizës financiare, tani ato janë bërë problematike. Aktualisht sot ekonomistët janë të shqetësuar për ndryshimin e shpejtë të kushteve makroekonomike në ekonomitë e brishta të këtyre vendeve. Në veçanti, ata janë të shqetësuar për tkurrjen e ndjeshme ekonomike, zhvlerësimin e shpejtë të monedhave vendase, deficitet e mëdha të llogarisë korente dhe deficitet fiskale, si dhe dominimin e kredive në valutë të huaj të cilat ushtrojnë presion dhe sjellin shqetësim për zhvillimin e aktivitetit bankar në vend.

Dobësia kryesore e vendeve të EQJL, nuk qëndron në ekspozimin e tyre ndaj instrumenteve financiare toksike, që ishin shkaktarët e kësaj krize, por në shkallën e lartë të integritit me ekonominë globale dhe për pasojë në varësinë e krijuar prej zhvillimeve të saj. Në deklaratat më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, viti 2009 parashikohet një vit i vështirë për këto vende, dhe rritjet ekonomike të tyre pritet të zvogëlohen ndjeshëm. Goditjen kryesore këto vende do ta marrin nga tregtia, ku

eksportet parashikohen të bien ndjeshëm, që do të çojë në një thellim të mëtejshëm të disbalancës së jashtme. Një problem tjetër do të jetë financimi i këtij deficiti të krijuar. Investitorët ndërkombëtarë, për shkak të pasigurive të larta për të ardhmen do të ulin ndjeshëm investimet në këto vende. Një burim financimi i rëndësishëm për këto vende janë dhe remitanat nga jashtë, të cilat parashikohen në rënie të ndjeshme për shkak të rënies ekonomike të vendeve të zhvilluara. Gjithashtu edhe kostoja e marrjes hua të fondeve është rritur për shkak të pasigurive të mëdha dhe mungesës së likuiditetit të tepërt. Të gjitha këto goditje do të kenë një efekt negativ të ndjeshëm në financimin nga jashtë për këto vende.

Gjatë viteve të fundit kredia për sektorin privat në këto vende është rritur me ritme të larta mesatarisht prej 25 për qind ose 2.5 herë me shumë se mesatarja e vendeve të BE-së. Të dhënat tregojnë se rritjen më të shpejtë të kredisë gjatë viteve të fundit e shënon Rumania e ndjekur nga Bullgaria dhe Shqipëria. Aktualisht në këtë panoramë rajonale, Shqipëria vazhdon të renditet ndër vendet e fundit në peshën që portofoli i kredisë zë ndaj PBB-së së vendit. Ajo që bie në sy është fakti se raporti i aktiveve të sistemit bankar ndaj PBB-së është në nivelet më të larta të rajonit, duke u renditur shumë pranë niveleve të vendeve të reja të BE-së. Ky tregues nënvizon se sistemi jonë bankar e ka kapacitetin e nevojshëm për të luajtur një rol të lartë të ndërmjetësimit financiar. Në tre vitet e fundit, portofoli i kredisë së bankave përbën mesatarisht vetëm 50 për qind të depozitave të grumbulluara prej tyre. Megjithatë, është për t'u theksuar fakti se në vitet e fundit, ritmet e rritjes së portofolit të kredisë kanë qenë të larta, duke nënvizuar përfshirjen më të madhe të bankave në plotësimin e kërkesës së ekonomisë për fonde. Rritja vjetore mesatare e portofolit të kredisë në Shqipëri prej 44 për qind është për momentin rritja më e lartë e këtij treguesi për vendet e rajonit për vitin 2008.

Tabelë 2. Ecuria e treguesve të ndërmjetësimit në vendet e EQJL.

Në % për vitin 2008	Shqipëri	Turqi	Rumani	Bullgari	Maqedoni	Serbi	Kroaci	Hungari	Poloni	Çeki	mesatare për rajonin
Aktive/ PBB	86.9	65.5	64.9	88.1	67.8	58.6	97.4	99.8	57.2	111.8	79
Kredi sektori privat/ PBB	36.1	31.2	39.2	74.0	43.6	38.7	71.6	64.3	49.2	49.8	51
Kredi valutë/ PBB	25.8	24.5	22.0	39.80	9.7	17.5	47.2	41.8	12.0	7.0	25
Kredi në monedhën vendase/ PBB	10.3	3.5	19.8	33.4	33.9	21.0	24.3	22.6	32.0	46.5	26
M3/ PBB	76.1	41.2	33.1	68.7	51.2	13.2	74.0	56.1	52.6	71.4	51
Depozita totale/ PBB	57.8	27.0	27.0	53.1	46.3	31.9	65.3	53.2	45.0	59.8	45
Depozitat e individëve/ PBB	47.5	14.1	16.0	32.1	21.5	17.7	38.3	26.1	26.3	38.7	26
Depozitat në valutë/ PBB	24.3	12.9	9.9	26.8	21.7	21.7	37.3	14.2	8.5	6.2	18
Kredi hipotekore/ PBB	8.3	4.0	3.5	9.9		5.0	10.0	12.4	11.7	15.3	9.0

Burimi: Faqet e internetit të Bankave Qendrore dhe publikime të BIS.

Gjithashtu një tipar tjetër i zhvillimeve të përbashkëta të portofolit të kredisë të këtyre vendeve ka qenë edhe zgjerimi i përsheptuar i kredisë për individë. Vitet e fundit kjo kredi (dhe në veçanti ajo hipotekore), është rritur me ritme të larta, e nxitur nga rënia e normave të interesit si dhe rritja e situatës pasurore të individëve. Edhe pse e mirëpritur, rritja e shpejtë e kredisë është parë me shqetësim, sepse ajo ka kontribuar në thellimin e disbalancave makroekonomike dhe financiare në këto vende. Në veçanti, rritja e shpejtë e portofolit të kredisë ka mbështetur zgjerimin e kërkesës së brendshme duke ndikuar në përkeqësimin e llogarisë korente. Po kështu, në shumë prej këtyre vendeve, zgjerimi i shpejtë i portofolit të kredisë është financuar me fonde nga jashtë, duke e bërë më të ndjeshëm sistemin bankar nga zhvillimet ndërkombëtare. Një problem tjetër kryesor që shqetëson këto vende është euroizimi i lartë i portofolit të kredisë. Vitet e fundit ky fenomen është ndikuar nga hyrja e bankave të huaja me rëndësi rajonale të cilat kanë inkurajuar kreditimin në

monedhë të huaj. Ky rrezik vlerësohet më i madh në këto vende, pikërisht sepse pjesa më e madhe e individëve kanë marrë kredi në monedhë të huaj dhe janë të pambrojtur nga lëvizjet e kursit.

Në ndryshim nga vendet e rajonit, kredia për ekonominë në Shqipëri në pjesën më të madhe të saj është e mbështetur nga burime të brendshme fondesh, kryesisht në kursimet e individëve, duke sjellë një ekspozim më të ulët ndaj situatës globale. Po kështu, zgjerimi i kësaj kredie ka mbështetur më së shumti aktivitetin ekonomik të biznesit dhe më pak atë të individëve. Ndërkohë që kredia për individë ka financuar kryesisht blerjet e banesave primare për të jetuar. Zhvillimet në çmimet e banesave në Shqipëri më së shumti janë ndikuar nga një kërkesë reale e individëve për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre dhe si i tillë tregu i pasurive të paluajtshme në vend nuk paraqet zhvillime spekulative. Të gjithë këta faktorë mendohet se ekspozojnë vendin tonë në një masë më pak problematike ndaj zhvillimeve globale krahasuar me vendet e analizuara më sipër.

3.2 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Aktiviteti në tregjet financiare ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë vitit 2008. Tregjet financiare në vend vazhdojnë të karakterizohen nga një shkallë e ulët zhvillimi dhe integrimi me tregjet fqinje apo më gjerë. Këtë vit, ky tipar u kthye në “favor” të qëndrueshmërisë së stabilitetit financiar pasi ndihmoi në izolimin e tyre nga kriza financiare që preku vendet evropiane. Pasojat e kësaj vale u ndjenë në trajtën e ndikimit psikologjik që çoi në rrjedhje të depozitave në muajt e fundit të vitit. Kjo gjë shkaktoi pasiguri në sistemin bankar në tremujorin e fundit duke bërë që interesat në tregun ndërbankar të luhaten në nivele rekord. Për sigurimin e likuiditetit, disa nga bankat preferuan të ulnin pjesëmarrjen në tregun primar, gjë që çoi në rritje të *yield*-eve në dy muajt e fundit të vitit. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet injektimit të likuiditetit për të qetësuar dhe siguruar agjentët e tregut dha efekt pozitiv drejt uljes së nivelit dhe luhatshmërisë së normave të interesit në tregun ndërbankar, në fund të vitit.


Normat e interesave për depozitat kanë treguar prirje rritëse, si për monedhën vendase dhe për euron. Pavarësisht uljes së interesave për këtë të fundit në tregjet ndërkombëtare, bankat kanë preferuar të ruajnë nivele relativisht të larta për tërheqjen e fondeve në euro në tregun vendas. Diferenca midis normave të interesit ka rezultuar pozitive dhe mesatarisht më e lartë se vitin e kaluar, duke krijuar mbështetje për monedhën vendase. Në pjesën më të madhe të vitit, kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave ka qenë i qëndrueshëm, ndërkohë që ai ka filluar një nënçmim të lehtë në fund të periudhës. Nënçmimi i lekut përkon me prirjen e ecurisë së të gjitha monedhave të vendeve të Evropës Lindore dhe mbart si faktorë psikologjikë ashtu dhe ndryshimin e raportit kërkesë/ofertë në treg.

Ndryshe nga ecuria e interesave për depozitat, ato për kreditë kanë shfaqur prirje rënëse. Kjo ka ndikuar në ngushtimin e diferencës midis këtyre dy treguesve dhe uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar. Pozitive

është evidenca për rritjen e vëmendjes drejt kreditimit në lekë dhe rritjen e konkurrencës nëpërmjet normave të interesit në këtë treg.

- *TREGU NDËRBANKAR*


Tregu ndërbankar është karakterizuar nga një luhatshmëri më e theksuar e normave të interesit gjatë vitit 2008 duke bërë që këto të fundit të luhaten nga nivele pranë minimumit teorik (depozitë 1-ditore) në atë maksimum (kredi 1-ditore). Deri në muajin shtator, normat e interesit janë luhatur poshtë nivelit të normës bazë të interesit duke u rritur në momentet e llogaritjes së rezervës së detyruar. Krijimi i një mungese strukturore të likuiditetit në këtë periudhë krijoi kushte më të mira për transmetimin e politikës monetare; ndikoi në afrimin e normave të interesit në tregun ndërbankar pranë interesit bazë; dhe nxiti aktivitetin në tregun ndërbankar. Diferenca e interesit njëditor me atë bazë në këtë periudhë, llogaritet rreth 70 pikë bazë, nga 90 pikë bazë në vitin e kaluar. Vëllimi mesatar ditor i huadhënies u rrit në 2.3 miliardë lekë, nga 1.8 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Pavarësisht rritjes së vëllimit të tregtimit, tipare të tregut ndërbankar mbeten përqendrimi relativisht i lartë i fondeve dhe prania e kufizimeve për tregtim midis bankave. Këto pengesa u theksuan më tepër në muajt shtator-nëntor - në momentet e plotësimit të rezervës së detyruar (shtator), norma e interesit u rrit në 7.54 për qind ose 129 pikë bazë mbi normën e marrëveshjeve të riblerjes⁶. Nën shqetësimin për gjetjen e likuiditetit në kushtet e shfaqjes së rrjedhjes së depozitave (nëntor) interesi njëditor arriti në 7.16 për qind ose 91 pikë bazë mbi normën e marrëveshjeve të riblerjes. Vëllimi mesatar i huadhënies në këtë periudhë llogaritet 1.6 miliardë lekë duke shënuar rënie. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë⁷ për të siguruar mbështetje psikologjike dhe reale për tregun, dha efekt në uljen e kostos së sigurimit të likuiditetit në tregun ndërbankar dhe të luhatshmërisë së këtij treguesi. Gjatë muajit dhjetor, interesi njëditor zbriti në nivelin mesatar të vitit, 5.84 për qind.



TREGU PRIMAR DHE ECURIA E YIELD-EVE

Yield-et e bonove të thesarit në tregun primar kanë qenë relativisht të qëndrueshme gjatë pjesës më të madhe të vitit 2008. Lulatja e tyre është ndikuar kryesisht nga faktorë të strukturës së tregut. Në muajt e parë të vitit ato kanë përcjellë rritjen e normës bazë gjatë fundit të vitit 2007 duke u reflektuar në prirje rritëse, ndërsa në tremujorin e tretë vihet re një ulje e tyre pas krijimit të tepricave të mëdha të likuiditetit në treg. Yield-i 12-mujor i bonove të thesarit në tetor shënoi 7.94 për qind, nga 8.23 për qind në muajin janar. Gjatë dy muajve të fundit të 2008-ës, yield-et janë rritur duke përcjellë shtrëngimin e kushteve të likuiditetit në banka si efekt i kombinuar i fenomenit të tërheqjes së depozitave dhe rritjes së kërkesës së qeverisë. Në pjesën më të madhe të ankandeve për bono thesari, shumat e kërkuara dhe pjesëmarrja kanë qenë në nivele të kënaqshme.


Grafik 14. Diferenca midis maturiteteve të yield-eve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i kërkesës (raporti *bid/cover*) në ankande ka shënuar vlera të larta. Ecuria rënëse e yield-eve e vërejtur kryesisht në tremujorin e tretë, ndryshoi në muajt e fundit të vitit, kur situata e shtrënguar e likuiditetit si dhe kërkesa e lartë për financim u përcoll në rritje të tyre. Megjithë ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në ofrimin dhe garantimin e sistemit me likuiditet në këtë periudhë, në vazhdim u vu re një hezitim i bankave për të investuar në tregun primar të letrave me vlerë. Në kushtet kur pjesëmarrja e bankave në ankand ishte e ulët, kjo gjë solli rritje të yield-eve. Në muajin dhjetor yield-i 12-mujor rezultoi 8.56 ose 0.30 pikë përqindjeje më lart se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Yield-i i bonove 3-mujore gjatë këtij viti qëndroi mesatarisht në nivelin 6.25 për qind, i njëjtë me normën bazë të interesit ndërsa ai 6-mujor ndoqi të njëjtën prirje me atë 12-mujor.

Grafik 15. Ecuria e yield-it të letrave me vlerë të qeverisë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë këtij viti, preferenca e bankave për të investuar në instrumentet afatgjata ka vazhduar të rritet dhe kërkesa për to ka qenë e kënaqshme. Në të njëjtën kohë, ecuria e *yield*-eve është luhatur në varësi të ndryshimeve në raportet ofertë/kërkesë në treg. Gjatë pjesës së parë të vitit, ato kanë ndjekur ecuri të qëndrueshme dhe me prirje rënëse të përqendruar kryesisht në tremujorin e tretë. Diferencat midis maturiteteve janë zvogëluar, duke zbutur pjerrësinë e kurbës së *yield*-eve. Vlen për t'u theksuar ngushtimi i diferencës midis *yield*-it të obligacioneve 5-vjeçare dhe atyre 2-vjeçare, që tregon për përmirësimin e primit të rrezikut të perceptuar prej agjentëve për këto letra afatgjata krahasuar me periudhën e emetimit për herë të parë të tyre.


Yield-i mesatar i obligacioneve 2-vjeçare gjatë vitit 2008 u rrit me 0.15 përqind në krahasim me vitin 2007. Në muajt e fundit, kërkesa e bankave është kushtëzuar nga vështirësitë e lidhura me likuiditetin në treg duke u përcjellë në pjesëmarrje të ulët dhe *yield*-e të larta.

Grafik 16. Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER^a).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 17. Ecuria ditore e kursit të këmbimit euro/lek dhe usd/lek.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

• TREGU VALUTOR DHE ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT

Ecuria e kursit nominal efektiv të këmbimit ka pasqyruar një gamë të gjerë zhvillimesh gjatë vitit 2008. Monedha vendase ka vijuar të forcohet kundrejt shportës së valutave kryesore gjatë periudhës janar-prill, duke kulmuar në muajin prill (6.2 përqind në terma vjetorë). Ndërkohë, dy tremujorët pasardhës kanë reflektuar një ngadalësim të ritmeve të rritjes vjetore (1.4 përqind në muajin shtator), duke kaluar në kahun nënçmues në tremujorin e fundit të vitit (mesatarisht -3.2 përqind).

Në fund të vitit 2008, kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros dhe dollarit amerikan pasqyronte një rënie vjetore prej respektivisht 0.37 dhe 10 përqind. Megjithatë, në terma mesatarë vjetorë, leku është mbijmuar me 0.66 përqind dhe me 7.23 përqind kundrejt monedhës evropiane dhe dollarit amerikan, përgjatë vitit 2008.

Pavarësisht zhvillimeve në tremujorin e fundit, duhet theksuar se ecuria pozitive e monedhës vendase është mbështetur nga një sërë faktorësh si: ecuria e kënaqshme e treguesve makroekonomikë të vendit, rezultatja pozitive e bilancit të pagesave, ankorimi i inflacionit pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe përafrimi i këtij indikator me atë të vendeve të zhvilluara (Eurozonë), dhe diferenca pozitive e normave të interesit. Aktiviteti në tregun vendas të këmbimit valutor ka treguar rritje të vazhdueshme, jo vetëm si pasojë e zgjerimit të aktivitetit tregues, i


cili ka rezultuar me një rritje totale 31.1 për qind në terma vjetorë në vitin 2008, por edhe nga rritja e profesionalizmit të pjesëmarrësve të tregut. Këta të fundit, paraqesin një sjellje gjithnjë e më paraprirëse ndaj sezonalitetit të kursit të këmbimit. Në koncept, kjo nuk dallon shumë nga transaksionet “forward” që kryhen në tregjet e zhvilluara financiare, ku aktorët përpiqen të pasqyrojnë pritshmëritë e kursit të këmbimit duke ndihmuar zbehjen e efekteve sezonale. Në këtë linjë, vihet në dukje gjithashtu dhe fakti se izolimi i sistemit financiar shqiptar ndaj produkteve të sofistikuara të tregjeve financiare ndërkombëtare, të cilat rezultuan krijuesit e krizës financiare globale, ndihmoi në frenimin e depërtimit të efekteve që po përjetojnë disa nga vendet e zhvilluara evropiane (Britania e Madhe, Irlanda, Norvegjia)¹⁰ dhe ato të Evropës Lindore. Nga vizualizimi i ecurisë së monedhës evropiane kundrejt monedhave të vendeve të Evropës Lindore gjatë tremujorit të fundit të vitit, vihet re se në terma relativë, ecuria e lekut është e qëndrueshme dhe me një luhatshmëri ndjeshëm më të ulët.

Duke analizuar dinamikën e kursit të këmbimit në tregun vendas, vihet re se luhatshmëria e raportit euro/lekë ka qenë e moderuar në krahasim me vitin e kaluar si dhe pothuajse në të gjithë harkun kohor të një periudhe 5-vjeçare. Nga ana tjetër, monedha amerikane kundrejt lekut ka paraqitur një luhatshmëri ndjeshëm më të lartë si rrjedhojë e ecurisë dinamike që ka pasur dollari amerikan në tregjet ndërkombëtare.

• ECURIA E INTERESAVE PËR DEPOZITA DHE KREDI


Në përgjithësi, interesat për depozitat janë rritur si për monedhën vendase ashtu dhe për atë evropiane gjatë vitit 2008. Pavarësisht se norma bazë e interesit ka mbetur e pandryshuar, interesi i depozitave në lekë pa pësuar rritje veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit si pasojë e prezantimit të njëpasnjëshëm të ofertave promotionale me përdorim të kufizuar në kohë. Pavarësisht se muajt e verës dhe fundviti karakterizohen nga oferta tërheqëse për thithjen e depozitave, gjatë vitit 2008 kjo sjellje ka qenë më e theksuar duke bërë që normat e interesit të arrinin maksimume historike ndër vitet e fundit.

Grafik 18. Ecuria e euros në raport me monedhat e vendeve të Evropës Lindore (indeks tetor'08= 100).




Burimi: Bankat qendrore të shteteve përkatëse.

Grafik 19. Ecuria mesatare e raportit euro-monedhë vendase për shtetet e Evropës Lindore.




Burimi: Bankat qendrore të shteteve përkatëse.

Grafik 20. Luhatshmëria e lekut kundrejt monedhave kryesore¹² (mesatare vjetore).



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 21. Ecuria e interesave të depozitave në lekë dhe në euro.



Në terma mesatarë, norma e interesit për depozitat në lekë gjatë vitit 2008 ka qenë 0.92 pikë përqindjeje më e lartë se në vitin 2007. Kjo lëvizje mbart rritjen prej 0.75 pikë përqindjeje të normës bazë gjatë vitit 2007. Interesi mesatar i depozitave në lekë ra në muajt e parë, nga 5.43 për qind në janar në 4.99 për qind në mars, si pasojë e përfundimit të ofertave të fundvitit të kaluar nga bankat e nivelit të dytë. Nga muaji prill e në vazhdim, ky tregues është rritur duke arritur nivelin më të lartë të vitit, 6.72 për qind në gusht, si pasojë e promovimit agresiv të ofertave. Kjo strategji dukej të qe e lidhur me politika individuale të bankave për të rritur zotërimin në treg. Muaji shtator regjistroi rënie të interesave me 0.61 pikë përqindje dhe një prirje për rikthimin e tyre në nivelet e mëparshme. Efekti psikologjik që shkaktuan lajmet për pasigurinë në tregjet financiare në tremujorin e fundit, bëri që prirja korrektuese të frenohej dhe të zëvendësohej nga oferta të tjera afatshkurtra në fund të vitit për të ruajtur burimet e financimit.

Interesat për depozitat me afat në euro në përgjithësi, kanë patur prirje rritëse gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008. Kjo tendencë ka filluar në janar dhe ka arritur pikun në muajin gusht, duke regjistruar mesatarisht 4.22 për qind ose 1.21 pikë përqindjeje më lart se fundviti i kaluar. Prirja rritëse në këtë periudhë u ndikua si nga ndryshimi i normës bazë të BQE me +0.25 pikë përqindje, ashtu dhe nga promocionet e bankave të veçanta për tërheqjen e prurjeve në valutë të emigrantëve. Në tremujorin e fundit, duket se politika agresive lehtësuese e BQE ka orientuar, por nuk ka qenë faktor me ndikim të ndjeshëm në ecurinë e normave të interesit të depozitave me afat në euro në vend. Këto të fundit janë formuar nga prirja për të përforcuar vlerën e depozitave si mjet investimi të publikut, në kushtet e rritjes së perceptimit të pasigurisë. Në fund të muajit dhjetor, interesi i depozitave 12-mujore ka shënuar 4.70 për qind ose 0.03 pikë përqindjeje nën mesataren e gjithë vitit duke evidentuar prirje të lartë konkurrionale të sistemit bankar për depozitat në këtë monedhë.

Grafik 22. Ecuria e interesave të depozitave në lek dhe në euro.



Ruajtja e normave të larta të interesit ka bërë që spread-i midis tyre¹³ të shënojë 2.16 pikë përqindjeje në fund të vitit 2008 ose 0.04 për qind më lart nga muaji dhjetor 2007. Në terma mesatarë, ky tregues llogaritet 2.07 për qind ose 0.46 pikë përqindje më lart se ai i vitit 2007, ndikuar nga lëvizjet pozitive të normave të depozitave me afat në lekë.


Kërkesa për kredi ka vazhduar të jetë e lartë gjatë vitit 2008. Kjo duket se ka sjellë ulje të normave të interesit për kreditë, kryesisht në ato në lekë, në të

cilat bankat kanë shfaqur prirje konkurrionale (veçanërisht pas sinjalizimeve të Bankës së Shqipërisë për të nxitur rritjen e portofolit të kredive në lekë). Sezonalisht, interesat janë ndikuar nga politika agresive të disa bankave të veçanta që zotërojnë pjesë të ndjeshme të tregut.

Gjatë vitit, interesi mesatar i ponderuar për kreditë në lekë shënon 12.82 për qind nga 13.57 për qind vitin e kaluar. Në pjesën më të madhe, kredia e re është akorduar për financime afatshkurtra (*overdraft* për bizneset), në financimin e konsumit dhe në blerjen e pasurive të paluajtshme për individët. Këto të fundit, janë promovuar dhe nga ulje të interesave në tremujorin e fundit. Gjatë tremujorit të parë, norma e interesit për kreditë në lekë ka qenë rënëse duke ndjekur të njëjtën prirje me interesin me të cilin indeksohen – bono thesari 12-mujore – dhe regjistroi normën më të ulët të vitit në muajin mars, 12.25 për qind. Nga fillimi i gjashtëmujorit të dytë të vitit, sistemi bankar tregoi prirje për të ndjekur politika shtrënguese në aktivitetin kredidhënës, në përgjithësi. Krahazbatimit të standardeve më të rrepta, një pjesë e këtyre politikave u reflektua në rritje të normave të interesit. Në dy muajt e fundit të vitit, në aktivitetin kredidhënës vihet re një prirje drejt zhvendosjes së tij në monedhën vendase. Kjo politikë ka sjellë dhe ulje të interesit për kreditë në lekë pavarësisht rritjes së normave të interesit në tregjet e tjera. Në muajin dhjetor, norma mesatare e kredisë në lekë zbriti në 11.71 për qind, vlera më e ulët në katër vitet e fundit, të cilët kanë shënuar thellim të aktivitetit kredidhënës. Ky zhvillim ka reflektuar tendencën pozitive të sistemit bankar për financim në monedhën vendase duke kontribuar njëkohësisht dhe në uljen e kostos së ndërmjetësimit të sistemit.


Përgjithësisht, kredidhënia në monedhën evropiane përkoji me zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare, duke u përputhur me ndryshimet e Libor dhe Euribor edhe pse jo me të njëjtat marzhe. Norma mesatare e ponderuar e interesit për kreditë në euro shënoi 8.19 për qind në vitin 2008 krahasuar me 8.43 për qind në vitin 2007. Ky tregues arriti pikën më të lartë, 8.70 për qind në muajin shtator. Rritja reflekton kryesisht vlerësimin për shtrenjtimin e kostos së fondeve në tregun ndërkombëtar (muaji shtator përkon me pështjellimin e tregjeve financiare ndërkombëtare), politikat shtrënguese të ndjekura nga sistemi bankar dhe perceptimi i shtuar për rrezikun. Në muajt e fundit të vitit, norma e interesit për kreditë në euro u ul, pas rënies së interesave referencë Euribor dhe Libor në tregun ndërkombëtar. Pavarësisht ecurisë së këtyre të fundit, interesat në

Grafik 23. Ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kreditë në lekë dhe atë në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Spread-i i normës së interesave (norma e ndërmjetësimit) kredi-depozita për lekë dhe euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

euro në fund të vitit kanë vijuar të jenë relativisht më të lartë në kuadër të vazhdimit të tendosjes së standardeve kredidhënëse dhe aplikimit të marzheve relativisht më të gjera për kreditë në këtë monedhë.

Kostoja e ndërmjetësimit (*spread-i* kredi-depozita) në lekë dhe në euro ka vazhduar rënien gjatë vitit 2008. Në terma mesatarë ky tregues për lekun rezulton 7.2 pikë përqindje, nga 8.9 pikë përqindje vitin e kaluar. Norma mesatare e ndërmjetësimit për monedhën evropiane është 4.41 pikë përqindjeje, 0.84 pikë përqindjeje më poshtë krahasuar me vitin e kaluar (që rezultonte 5.25 pikë përqindjeje).

Rënia e normave të interesit për kreditë në lekë ka ngushtuar diferencën me ato të kredisë në euro. Ky tregues rezulton 4.6 pikë përqindjeje në vitin 2008 nga 5.1 pikë përqindjeje në vitin 2007.

SHËNIME

¹ Fondin Monetar Ndërkombëtar.

² Krahësuar me mesataren prej 55 për qind në vitin 2007.

³ Rezultatet e dala nga vërtetimi i aktivitetit kreditues për gjashtëmuorin II të vitit 2008, me oficerët e kredisë pranë bankave tregtare. Ky vërtetim u ndërmor në fund të muajit dhjetor dhe në fillim të muajit janar 2009.

⁴ Për afatin e shlyerjes së kredisë.

⁵ Gjatë vitit 2007, kredia për industrinë është rritur mesatarisht me 47 për qind.

⁶ I njëjti shqetësim u shfaq dhe në muajin tetor kur interesi njëditor kapi vlerën maksimale 7.69 për qind.

⁷ Në nëntor, Banka e Shqipërisë ndryshoi formën e ankandit për operacionet e tregut të hapur në ankande me shumë të pakufizuar (interes fiks norma bazë) nga ato me shumë të kufizuar që ishin zbatuar deri në këtë moment. Gjithashtu, në muajin dhjetor, interesi i kredisë njëditore u ul me 100 pikë bazë.

⁸ NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit, i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind). Një rritje e NEER do të thotë mbigjymim i lekut.

⁹ "Forward", quhet një kontratë dypalëshe ku bihet dakord për kryerjen e një veprimi valutator në një datë të ardhme. Kursi i këmbimit përcaktohet në datën e marrëveshjes dhe ndryshon nga kursi aktual vetëm nga diferenca e normave të interesit të dy monedhave në periudhën e përcaktuar.

¹⁰ Monedhat britanike, irlandeze dhe norvegjeze kanë paraqitur një rënie përkatësisht me 17, 14.5 dhe 14.4 për qind.

¹¹ Të dhënat, për arsye krahasuese janë kthyer në indeks me bazë periudhën 1 tetor 2008. Këtu nuk janë përfshirë Bullgaria dhe Maqedonia si rrjedhojë e implementimit të një kursi fiks të këmbimit.

¹² Llogaritshmëria e raporteve euro/lek dhe usd/lek është matur si devijimi standard mujor $[(x_t - \bar{x})^2 / (n - 1)]^{1/2}$, $\bar{x}$ = euro dhe dollar në raport me lekun dhe x_t – në periudhën t , $\bar{x}$ – mesatarja e periudhës i .

¹³ Llogaritur si diferencë midis interesit të ponderuar të depozitave me afat njëvjeçar në lekë dhe në euro.

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155


KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

4.1 INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Përdorimi i instrumenteve të politikës monetare ka për qëllim kryesor administrimin e likuiditetit me synim orientimin e normave afatshkurtra të interesit rreth nivelit të normës bazë të sinjalizuar nga Banka e Shqipërisë. Krahas përmbushjes së këtij objekti, instrumentet për zbatimin e politikës monetare janë përdorur edhe në funksion të zhvillimit të tregut ndërbankar të parasë. Në këtë kontekst, operacionet e tregut janë orientuar në drejtim të krijimit të një mungese strukturore të likuiditetit në sistemin bankar (nëntëmujori i parë) duke synuar rritjen e eficiencës së transmetimit të politikës monetare, nxitjen e aktivitetit në tregun ndërbankar dhe njëkohësisht, plotësimin e nevojave neto të tij.

Kriza ndërkombëtare e besimit në fillim të tremujorit të katërt të vitit 2008, nxiti tërheqjen e depozitave nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, e për rrjedhojë, theksoi mungesën e likuiditetit në sistemin bankar. Kjo gjë u reflektua në rritje të normave të interesit dhe ngadalësim të aktivitetit të bankave në tregun e parasë. Me qëllim lehtësimin e sistemit bankar, Banka e Shqipërisë aplikoi ndryshime në disa prej instrumenteve të saj. Këto masa dhanë efekt qetësues duke përçuar mesazhin se, brenda përmbushjes së kriterëve për kontrollin e rrezikut të aplikuar nga Banka e Shqipërisë, ajo është e gatshme të injektojë likuiditetin e nevojshëm për normalizimin e situatës në tregjet e parasë.

Grafik 1. Operacionet e tregut të hapur dhe përdorimi i lehtësive të përhershme.*



*Vlerat negative në përdorimin e instrumenteve në grafik reflektojnë operacionet për tërheqjen e likuiditetit, ndërsa vlerat pozitive korrespondojnë me operacionet për injektimin e likuiditetit. Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.1 OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR

Operacionet e tregut të hapur, të cilat konsistojnë në operacionin kryesor, operacione rregulluese dhe operacione strukturore, janë operacionet bazë për administrimin e likuiditetit nga banka qendrore. Dinamika e ngjarjeve të vitit 2008 kërkoi përdorimin e të gjitha instrumenteve të tregut të hapur.

• OPERACIONI KRYESOR I TREGUT

Marrëveshja e riblerjes dhe e anashjellë e riblerjes me maturim njëjavor është instrumenti kryesor për realizimin e operacioneve të tregut të hapur. Gjatë tremujorit të parë të vitit, për të administruar tepricën sezonale të likuiditetit të gjeneruar nga kthimi i parasë në sistem dhe nga fondet e buxhetit, Banka

e Shqipërisë tërhoqi likuiditet nëpërmjet marrëveshjes së riblerjes me maturim njëjavor mesatarisht 3.6 miliardë lekë në javë. Gjatë pjesës tjetër të vitit u operua nëpërmjet marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, duke injektuar mesatarisht 5.8 miliardë lekë në javë.

Për të rritur efektivitetin e politikës monetare dhe aktivitetin e tregut ndërbankar, Banka e Shqipërisë operoi nëpërmjet ankandave me shumë të shpallur (me çmim variabël) deri në muajin nëntor. Shuma e shpallur ishte



rezultat i analizave dhe parashikimit të nevojave neto të likuiditetit të sistemit bankar. Norma e interesit të ankandave të këtij tipi, deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit shënoi devijime të parëndësishme nga norma bazë e vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, 6.25 për qind. Në vijim, tensioni i krijuar në sistemin bankar nga rrjedhja e depozitave në fillim të tremujorit të fundit të vitit, u reflektua fillimisht si presion mbi normat e interesit të kërkesave të bankave për likuiditet nga Banka e Shqipërisë. Pavarësisht se shuma e shpallur në ankandet javore ishte më se e mjaftueshme për të përballuar kërkesën e sistemit për likuiditet, trysnia mbi normat u ndje për rreth pesë javë rresht.


Për të stabilizuar këtë prirje, Banka e Shqipërisë në mes të muajit nëntor, ndryshoi formën e ankandave të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor duke injektuar likuiditet nëpërmjet ankandit me çmim fiks - normën bazë të Bankës së Shqipërisë.

• OPERACIONET RREGULLUESE TË TREGUT

Në ndryshim nga operacioni kryesor i tregut, i cili përdoret me frekuencë javore, operacionet rregulluese të tregut përdoren me frekuencë të papërcaktuar, në situata të veçanta kur është e nevojshme zbutja e luhatjeve të normave të interesit të shkaktuara nga lëvizje të papritura dhe/ose afatgjata të likuiditetit të sistemit.

Në tremujorin e parë të vitit marrëveshjet e riblerjes me maturim një dhe tremujor u përdorën në funksion të pakësimit të shpejtë të tepricës së likuiditetit për të minimizuar presionet për rënien e normave e interesit.

Marrëveshjet e riblerjes me maturim njëmujor u përdorën në tre raste, duke tërhequr mesatarisht 0.9 miliardë lekë, ndërsa marrëveshjet e riblerjes me maturim tremujor u përdorën në shtatë raste, duke tërhequr mesatarisht 0.45 miliardë lekë. Ankandet mujore patën një raport mesatar kërkesë/ofertë¹ prej 49.5 për qind, ndërsa i njëjti raport për ankandet tremujore ishte më i ulët, 35.6 për qind.



Për të normalizuar shqetësimin për mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga faktori psikologjik gjatë tremujorit të fundit, Banka e Shqipërisë, krahas përdorimit të instrumentit kryesor, injektoi likuiditet nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëmuor dhe tremujor. Shuma mesatare e injektuar ishte respektivisht 3.2 miliardë lekë, në tre ankande njëmuore dhe në dy ankande tremujore. Ankandet mujore patën një raport mesatar kërkesë/ofertë prej 95 për qind, ndërsa i njëjti raport për ankandet tremujore ishte më i lartë, 148 për qind.

Raporti i ulët kërkesë/ofertë në të dyja rastet e ankandeve të marrëveshjeve të riblerjes, tregon për efektivitetin më të ulët që kanë operacionet në kushtet e tepicës së likuiditetit pasi është në vullnetin e bankave pjesëmarrja në to. Në të kundërt, në rast të operimit në kushtet e mungesës së likuiditetit, bankat janë në varësi të likuiditetit të injektuar nga Banka e Shqipërisë dhe për rrjedhojë, operacionet e bankës qendrore bëhen më përcaktuese në ecurinë e normave të interesit.

Për të rregulluar gjendjen e likuiditetit të sistemit bankar, në ditët e fundit të një prej periudhave të mbajtjes së rezervës së detyruar (muaji shtator), Banka e Shqipërisë përdori dy ditë rradhazi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me maturim njëditor, duke injektuar mesatarisht 2.5 miliardë lekë.

• OPERACIONET STRUKTURE TË TREGUT

Operacionet strukturore përdoren në rast të nevojës për rregullime afatgjata të strukturës së likuiditetit dhe realizohen nëpërmjet blerjes ose shitjes me të drejta të plota të bonove të thesarit. Në fillim të vitit 2008, në funksion të orientimit të operacioneve në drejtim të krijimit të një mungese



strukture të likuiditetit në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë uli portofolin e saj të bonove të thesarit me 2 miliardë lekë, nëpërmjet një ankandi të vetëm.

Ndërhyrjet me karakter strukturor patën kahun e kundërt në tremujorin e fundit të vitit. Duke vlerësuar se rrjedhja e depozitave nuk po reflektonte cilësitë e një dukurie të rikuperueshme për një periudhë të shkurtër kohore², Banka e Shqipërisë në fund të vitit 2008, organizoi pesë ankande për blerjen me të drejta të plota të bonove të thesarit nga bankat e nivelit të dytë. Në këto ankande u blenë bono thesari në nivelin mesatar prej 2.2 miliardë lekësh.

Hapësirë informuese 7: Ndryshimet e kuadrit operacional të bankave qendrore në përshtatje të situatës së tregjeve.

Kriza financiare e nisur në vitin 2007 dhe e përkthyer në një krizë ekonomike gjatë vitit 2008, ka nxjerrë në pah rolin e bankave qendrore si garantuese të stabilitetit makroekonomik dhe ruajtjes së atij financiar, krahas funksionit klasik të arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Turbullirat e shkaktuara vunë në pikëpyetje funksionimin e sistemit financiar si dhe paraqitën sfida për politikëbërësit dhe autoritetet rregulluese në të gjithë botën. Në këtë mjedis, bankat qendrore janë munduar të adresojnë rritjen e pasigurisë, luhatjes së tregjeve dhe të rrezikut të kredithënies duke ndërmarrë masa jokonvencionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me njëra tjetrën. Këto kanë rezultuar efektive në qetësimin e agjentëve, uljen e rrezikut të perceptuar dhe rifunksionimin e tregut ndërbankar, por ende nuk kanë zgjidhur të gjitha problemet që kanë shoqëruar krizën financiare në sektorin real. Më poshtë, është një përmbledhje e riformulimit të kuadrit operacional të dy bankave qendrore, asaj të ShBA-së dhe Eurozonës, si dhe disa ndryshime në instrumentet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në kuadrin e shtrëngimit të kushteve të likuiditetit.

Rezerva Federale

Fillimisht, për të lehtësuar tensionin në tregun ndërbankar, bankat qendrore funksionuan si huadhënës të fundit në rradhë duke ofruar likuiditet afatshkurtër. Përpara krizës, Rezerva Federale e ShBA ishte e kufizuar në gamën e kolateralit të bankave dhe të numrit të partnerëve për dhënien e huasë. Kolaterali që pranohej ishin letra me vlerë të qeverisë, letra me vlerë të renditura si AAA. Palët me të cilat bëheshin transaksionet ishin të kufizuara në 19 ndërmjetës (kryesisht banka investimi). Vështirësitë për likuiditet në tërë segmentet e tregut financiar në vitin 2007, bënë që kuadri rregullativ të modifikohet duke zgjeruar llojin e kolateralit që pranohej, numrin e partnerëve në transaksione dhe kohëzgjatjen e huadhënies. Kjo e fundit u shtri deri në 28-35 ditë, ndërkohë që lista e kundërpartisë përfshinte 7,000 banka. Norma e huadhënies zbriti me 50 pikë bazë dhe për të mos shkaktuar panik në treg, u ruajt anonimiteti i huamarrësve. Në këtë periudhë, u krijuan dhe marrëveshje swap³ me BQE dhe BKZ⁴ për furnizimin e tregut me këto dy valuta. Në shtator të vitit 2008, kohëzgjatja e huadhënies u shtri deri në 90 ditë dhe marrëveshjet swap u lidhën dhe me Bankën e Australisë, të Suedisë, të Danimarkës e të Norvegjisë e më vonë dhe me atë të Anglisë. Deri në fund të vitit, Fed krijoi disa skema me qëllim nxjerrjen e tregut të parasë nga ngërçi, duke hedhur likuiditet kundrejt garancive që nuk mund të tregtoheshin përfshirë këtu dhe aksione, apo blerjen e instrumenteve të mbështetura nga kredi hipotekore. Në këtë periudhë u shitën dhe letra me vlerë të qeverisë kundrejt borxheve që mbështeteshin te kredia konsumatore e për rrjedhojë,

konsideroheshin me rrezik të lartë. Përdorimi i kredive të dhëna në këtë mënyrë u shty përtej vitit 2008 dhe maturimi i tyre varionte nga 1-3 vjet.

Së bashku me këto masa, për të plotësuar kuadrin e mbështetjes nga Fed, kjo e fundit ndërmori, në mënyrë të njëpasnjëshme që prej muajit shtator 2007, ulje të normës bazë të interesit deri në kufirin e fundit, pranë 0 për qind.

Banka Qendrore Evropiane

Ngjarjet e dy viteve të fundit kanë prezantuar ndoshta sfidën më të madhe për Bankën Qendrore Evropiane (BQE) dhe kuadrin operacional që prej krijimit, mëse dhjetë vjet më parë. Në fillim të krizës (2007) në Evropë, roli i bankës qendrore si huadhënëse u pa i shkëputur nga roli si vendimmarrëse për politikën monetare. Kështu, ndërsa fillimisht BQE ofroi likuiditet si në monedhën evropiane ashtu dhe në atë amerikane (nëpërmjet swap-eve me Fed), ajo nuk veproi me normën e interesit duke e konsideruar këtë si instrument për kontrollin e presioneve inflacioniste. Në këtë kohë, BQE nuk kishte nevojë për të ndryshuar kuadrin rregullativ pasi ai ekzistues parashikonte një diapazon relativisht të gjerë për kolateral si dhe listën e kundërpartisë. Ky koncept i ndarjes së funksioneve u fashit me rëndimin e krizës dhe tejçimin e saj në ekonominë reale dhe kredidhënien për sektorin privat, në tremujorin e tretë të vitit 2008.

Në mes të muajit shtator 2008, tensionet në ShBA u reflektuan menjëherë në tregun e parasë në Evropë, i cili pak a shumë, pushoi të funksionuari. Për pasojë, BQE ndërmori një sërë masash korrektuese, disa prej të cilave të paprecedenta. Për të zbutur luhatshmërinë në normat e EONIA-s, në muajin tetor korridori i lehtësive të përhershme u ngushtua me 50 pikë bazë (me efekt deri në janar 2009). Në të njëjtën kohë, u kalua në ndërhyrje me operacione të tregut të hapur me ankande me shumë të pakufizuar dhe interes të fiksuar, normën bazë. Krahas operacioneve javore, u organizuan operacione për furnizimin me likuiditet me maturitet 3- dhe 6-muaj. Një lloj tjetër operacioni i veçantë që ai për rifinancim me maturim që përkon me periudhën e mbajtjes së rezervës së detyruar. Në këtë kohë, u morën masa për zgjerimin e mëtejshëm të listës së instrumenteve që mund të përdoren si kolateral në operacionet kredidhënëse të BQE-së. Përveçse me Fed-in, linja swap u krijuan dhe me Bankën Kombëtare të Zvicrës dhe u ofruan ankande për hedhjen e këtyre valutave në treg.

Masat e marra nga bankat qendrore të këtyre dy ekonomive kryesore kanë rezultuar të suksesshme në tejkalimin e problemeve me likuiditetin në tregun ndërbankar, por ende nuk kanë arritur të eliminojnë pasiguritë për kreditimin e ekonomisë.

Banka e Shqipërisë

Dinamika e zhvillimeve ndërkombëtare në tremujorin e fundit të vitit e cila u reflektua edhe në sistemin bankar shqiptar në formën e krizës së besimit ndaj institucioneve bankare, shkaktoi një rënie të shpejtë të likuiditetit të sistemit bankar. Pasiguria e krijuar nga kjo situatë u reflektua në mosfunksionimin normal të tregjeve të parasë dhe rritjen e primeve të rrezikut. Për të normalizuar situatën e krijuar në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë aplikoi disa ndryshime në instrumentet e saj, të cilat synonin të lehtësonin injektimin e likuiditetit, por duke ruajtur kriteret e garantimit të tij. Sipas rrjedhës kronologjike ndryshimet e bëra janë:

1. Zgjerimi i bazës së letrave me vlerë që janë objekt i marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes duke përfshirë krahas bonove të thesarit edhe obligacionet e emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim të mbetur jo më shumë se 365

ditë. Përfshirja e obligacioneve si objekt i marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, rriti aksesin për marrjen e likuiditetit me kosto normën bazë të Bankës së Shqipërisë, pasi obligacionet mund të përdoren vetëm si garanci për kreditë njëditore dhe kreditë brenda ditës që akordon Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë me kërkesën e tyre.

2. Zgjerimi i hapësirës së përdorimit të rezervës së detyruar nga 20 për qind në 40 për qind në ditë. Ky zgjerim kishte për qëllim krijimin e fleksibilitetit më të lartë për bankat e sistemit për administrimin më efektiv të luhatjeve të paparashikuara të likuiditetit. Nga ana tjetër, në periudhën afatgjatë zgjerimi i përdorimit të rezervës së detyruar, do t'i shërbejë rritjes së aktivitetit në tregun ndërbankar të parasë.

3. Kalimi i përkohshëm në një korridor asimetrik, duke ulur diferencën midis normës bazë të Bankës së Shqipërisë dhe kredisë njëditore nga 175 pikë bazë në 75 pikë bazë. Ulja e normës së kredisë njëditore kishte për qëllim uljen e rrezikut nga luhatja e normës së interesit afatshkurtër në rastet e daljeve të paparashikuara të likuiditetit si dhe uljen e luhatjes së normave të interesit në tregun ndërbankar të parasë.

4.1.2 LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore – janë instrumente në dispozicion të bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin (e papritur) në bazë ditore. Teorikisht, në kushtet e një pranie të rregullt të bankës qendrore në treg (nëpërmjet instrumentit kryesor të saj), të një tregu ndërbankar të zhvilluar dhe të mundësisë për përdorimin e rezervës së detyruar në bazë ditore, përdorimi i lehtësive të përhershme nga bankat e nivelit të dytë, duhet të jetë minimal.

Konkretisht, dy nga kushtet e mësipërme – prania e rregullt e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë dhe mundësia e përdorimit të rezervës së detyruar – kanë qenë të përmbushura në mënyrë të vazhdueshme në pesë vitet e fundit. Ndërkohë, që mbetet zhvillimi relativisht i ulët i tregut ndërbankar faktori, që edhe gjatë vitit 2008 ka sjellë një përdorim të gjerë të depozitës njëditore.

Përdorimi i depozitës njëditore gjatë të gjitha ditëve të punës të vitit 2008 ishte rezultat i tendencës së bankave të nivelit të dytë për mbajtjen e likuiditetit strukturor, likuiditet i cili për të ulur kostot e bankave është depozituar me afat njëditor pranë Bankës së Shqipërisë. Në vlera mesatare ditore, instrumenti i depozitës njëditore është përdorur 3.6 miliardë lekë në ditë në krahasim me 1.6 miliardë lekë në ditë në vitin 2007. Në ndryshim me vitin 2007, kur Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme gjatë gjysmës së parë të vitit në drejtim të tërheqjes së likuiditetit nëpërmjet instrumentit kryesor të saj (çka redukton përdorimin e depozitës njëditore), gjatë vitit 2008 është ndërhyrë për rreth dhjetë muaj në drejtim të injektimit të likuiditetit. Kahu i veprimeve të Bankës së Shqipërisë në kombinim me zhvillimin e ulët të tregut ndërbankar, ka rezultuar në rritjen e likuiditetit të depozituar për afat njëditor pranë Bankës së Shqipërisë.

Nga ana tjetër, rritja e nivelit të likuiditetit strukturor të bankave kryesisht gjatë nëntëmujorit të parë të vitit, ka minimizuar përdorimin e kredisë njëditore. Në harkun kohor dymbëdhjetëmujor, kredisë njëditore u përdor në 21 ditë pune, me një mesatare përdorimi 0.3 miliardë lekë. Kredisë njëditore pati përqendrim më të lartë gjatë tremujorit të fundit të vitit kryesisht nga bankat e vogla të sistemit, të cilat për shkak të ekzistencës së kufijve të tregtimit, kanë hasur vështirësi në gjetjen e likuiditetit në tregun ndërbankar.

4.1.3 INSTRUMENTE MBËSHTETËSE

Kredisë lombard është instrumenti i fundit kreditues i Bankës së Shqipërisë që iu akordohet bankave në vështirësi të përkohshme me likuiditetin, por që janë financiarisht të qëndrueshme. Ky instrument nuk gjeti asnjë përdorim gjatë vitit 2008.


4.1.4 REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar është instrument i politikës monetare që synon rregullimin e likuiditetit në sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit. Niveli i rezervës së detyruar korrespondon me 10 për qind të depozitave të bankave të nivelit të dytë deri në 2 vjet, në të treja monedhat – lek, euro, dollar amerikan. Ecuria e saj gjatë vitit 2008 ka reflektuar ecurinë e depozitave sipas monedhave përkatëse, me një muaj vonesë, pasi periudha e mbajtjes së rezervës së detyruar fillon në datën 24 të çdo muaji dhe korrespondon me gjendjen e depozitave të muajit kalendarik që i paraprin.

Niveli i rezervës së detyruar pasqyroi rritjen sezonale të depozitave në tremujorin e parë dhe atë të tretë të vitit, ndërkohë që u ndikua nga ulja e depozitave në tremujorin e fundit të tij. Rritja vjetore e rezervës së detyruar rezultoi 6.2 për qind.

Pesha mesatare e komponentit të rezervës së detyruar në lekë gjatë vitit 2008 ka qenë 56.35 për qind, duke u luhatur nga 57.25 për qind në fillim të vitit, në 56.34 për qind në fund të tij. Ndërsa peshat mesatare të komponentit të rezervës së detyruar në valutë kanë qenë respektivisht 32.57 për qind për rezervën e detyruar në euro (duke u luhatur nga 31.22 për qind në fillim të vitit, në 33.56 për qind në fund të tij) dhe 11.08 për qind për rezervën e detyruar në dollarë amerikanë (duke u luhatur nga 11.53 për qind në fillim të vitit, në 10.08 për qind në fund të tij).

Gjatë vitit 2008, mundësia e mesatarizimit të rezervës së detyruar në lekë duke përdorur 20 për qind të saj⁵, është shfrytëzuar në mënyrë më eficiente




nga bankat për të administruar luhatjet e papritura të likuiditetit. Kjo ka bërë që devijimi i gjendjes së llogarisë nga niveli i rezervës së detyruar në fund të periudhës së mbajtjes, të ulët nga një mesatare prej +0.8 miliardë lekë në vitin 2007, në një mesatare prej +0.5 miliardë lekë.

Megjithatë, përdorimi i rezervës së detyruar për pjesën më të madhe të bankave është i izoluar vetëm për administrimin e luhatjeve të papritura të

likuiditetit dhe jo për menaxhim aktiv të likuiditetit kundrejt pritjeve gjatë periudhës së mbajtjes. Ky menaxhim aktiv do t'i shërbente zhvillimit të tregut ndërbankar. Rritja e hapësirës së përdorimit të rezervës së detyruar nga 20 për qind në 40 për qind, në periudhën afatgjatë rrit mundësinë e menaxhimit aktiv të rezervave brenda periudhës së mbajtjes, duke mbështetur aktivitetin e tregut ndërbankar.

Ecuria e normave të remunerimit të rezervës së detyruar ka pasqyruar ecurinë e normave të interesit nga të cilat derivohen.⁶ Konkretisht, remunerimi i rezervës së detyruar në lekë ka mbetur i pandryshuar në nivelin 4.375 për qind, duke qenë se norma bazë e Bankës së Shqipërisë mbi të cilën llogaritet norma e remunerimit gjatë vitit 2008, mbeti e pandryshuar në nivelin 6.25 për qind.



Normat e remunerimit të rezervës së detyruar në valutë deri në muajin tetor 2008, bazoheshin në normat e tregut (Libor dhe Euribor) për afatin e maturimit njëmuor. Me hyrjen në fuqi të rregullores së rishikuar për rezervën e detyruar, remunerimi i rezervës së detyruar në valutë bazohet në normat bazë të bankave qendrore respektive – Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës Federale në ShBA. Uljet e aplikuara në normat nga këto banka, sollën uljen e normës së remunerimit me respektivisht 83 pikë bazë për rezervën e detyruar në euro dhe 270 pikë bazë për rezervën e detyruar në usd.⁷

4.2 ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Administrimi i rezervës valutore ka vijuar të realizohet në përputhje me objektivat dhe kriteret e parashikuara në bazën rregullative, përsa i takon rrezikut dhe kthimit gjatë procesit të investimit. Ky aktivitet, që përfaqëson një detyrë funksionale të Departamentit të Operacioneve Monetare, është pasuruar këtë vit me një shërbim të ri, atë të dhënies hua të letrave me vlerë. Aktiviteti i huadhënies ka ndihmuar në gjenerimin e të ardhurave shtesë nga administrimi i mjeteve të rezervës valutore, pa cënuar zhvillimin e aktivitetit të zakonshëm të procesit të administrimit dhe duke respektuar kufizimet e vendosura për shkallën e lejuar të rrezikut.

Ndërkaq, një nga zhvillimet më të rëndësishme në kuadër të procesit të administrimit të rezervës valutore lidhet me fillimin e krizës së besimit në

tregjet financiare ndërkombëtare në muajin shtator. Për t'iu përgjigjur situatës së krijuar me fillimin e kësaj krize, Këshilli Mbikëqyrës dhe strukturat e tjera të angazhuara në procesin e administrimit të rezervës, ndërmorën hapa deri në reduktimin e plotë të ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit. Banka e Shqipërisë ndjek një politikë konservatore në administrimin e fondit të rezervës, e shprehur si në gamën e instrumenteve të lejuara për investim ashtu dhe në kufizimet e parashikuara për rreziqet që mund të merren përsipër. Pavarësisht kësaj, në kushtet e ngjarjeve të paprecedenta të muajve të fundit të 2008-ës, kufizimi i investimeve vetëm në instrumente të emetuara nga qeveri dhe agjenci qeveritare u vlerësua si zgjidhja më e përshtatshme për situatën. Objektivi i sigurisë në investimin e fondeve të rezervës valutore përfaqëson një nga objektivat me rëndësi parësore në procesin e administrimit. Kjo gjë është reflektuar në lejimin e investimit të fondeve në institucione financiare që mbartin cilësi shumë të mira, përsa i takon reputacionit të tyre në shlyerjen e detyrimeve të mbartura. Përvoja e krijuar gjatë këtyre zhvillimeve të krizës ka qenë mjaft e dobishme dhe vetë këto zhvillime janë një argument më shumë për të theksuar rëndësinë që ka ndjekja e rrezikut të kreditit dhe investimi në drejtim të përmirësimit cilësor të aftësive profesionale të personelit përkatës, me qëllim vlerësimin e kujdesshëm të institucioneve dhe instrumenteve financiare, në të cilat do të investohen fondet e rezervës valutore.

• *STATISTIKA MBI ECURINË E REZERVËS VALUTORE GJATË VITIT 2008*

Gjatë vitit 2008 rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe raportuar në monedhën amerikane, është rritur me rreth 205.72 milionë dollarë, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 2,344.16 milionë usd.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën bruto paraqiten të grupuar si më poshtë:

- A. Në marrëdhënie me Ministrinë e Financave efekti ka qenë pozitiv 26.65 milionë usd, sipas zërave të mëposhtëm:
 - hyrje nga privatizimi, 158.83 milionë usd;
 - hyrje nga lëvrimi i huave të dhëna nga Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) etj., në masën 447.93 milionë usd⁸;
 - transferta, 580.11 milionë usd.
- B. Në marrëdhënie me bankat e nivelit të dytë efekti ka qenë pozitiv 20.38 milionë usd, sipas zërave të mëposhtëm:
 - derdhje nga bankat e nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyruar apo dhe veprime të tjera që lidhen me kapitalin e tyre, 113.25 milionë usd;
 - transferta, 92.87 milionë usd.
- C. Efekti i veprimeve të Bankës së Shqipërisë ka qenë pozitiv 213.92 milionë usd, sipas zërave të mëposhtëm:
 - hyrje nga lëvrimi i huave të dhëna nga FMN-ja, 7.94 milionë usd;
 - blerje të valutës nga bankat e nivelit të dytë, nga Ministria e Financave dhe institucione të tjera në shumën 316.03 milionë dollarë :

- 225.71 milionë usd (sistemi bankar),
- 85.86 milionë usd (Ministria e Financave),
- 4.46 milionë usd (institucione të tjera);
- të ardhurat e siguruara nga investimi i rezervës valutore deri në fund të muajit dhjetor llogariten në rreth 76.44 milionë usd. Efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit llogaritet në një vlerë pozitive prej 48.65 milionë usd;
- shlyerja e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së, 15.75 milionë usd;
- kryerja e pagesave të borxhit të jashtëm për Qeverinë Shqiptare, 61.87 milionë usd;
- transfertat rreth 12.07 milionë usd;
- shitja e valutës Ministrisë së Financave në shumën 145.45 milionë usd.

Gjatë vitit 2008 luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar negativisht vlerën e rezervës bruto, duke regjistruar një efekt rreth 55.23 milionë usd.

SHËNIME

¹ Oferta në këtë rast është shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë në ankandin e marrëveshjeve respektive të riblerjeve, ndërsa kërkesa korrespondon me kërkesën e bankave për të marrë pjesë në këto ankande.

² Operacioni më i gjatë i përkohshëm që ka në dispozicion Banka e Shqipërisë është 3 muaj.

³ Në konceptin e gjerë, swap janë shkëmbime të instrumenteve të investimeve, pagesave, detyrimeve, valutës. Marrëveshjet e lidhura midis Fed dhe BQE nënkuptojnë shkëmbimin e valutave, dollarë amerikanë dhe euro.

⁴ Banka Kombëtare e Zvicrës.

⁵ Gjatë vitit 2008, hapësira e përdorimit ditor të rezervës së detyruar në lekë ka qenë 20 për qind. Rritja e hapësirës së përdorimit në 40 për qind u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në datën 11.12.2008, por hyri në fuqi në 24.01.2009 me fillimin e periudhës së re të mbajtjes.

⁶ Normat e remunerimit të rezervës së detyruar janë 70 për qind të normave mbi të cilat derivohen.

⁷ Rritja e normave të interesit të remunerimit të rezervës të detyruar në valutë, në fillim të tremujorit të katërt të vitit reflekton rritjen e normave të interesit të Euriborit dhe Liborit, si rezultat i krizës së besimit pas falimentimit të Lehman Brothers.

⁸ Kjo shifër ka në përmbytje dhe derdhjen në favor të Ministrisë së Financave të shumës 230 milionë euro (disbursimi i kredisë për financimin e rrugës Rrëshen-Kalimash).

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155

KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE

5.1 ECURIA E SISTEMIT BANKAR

Viti 2008, në ndryshim nga ai paraardhës, prezantoi zhvillime mikse dhe të paqëndrueshme. Analiza e sistemit bankar tregon për një nivel në rritje të rrezikut dhe zvogëlim të kapacitetit të tij financiar. Gjysma e parë e vitit shfaq zhvillime më pozitive krahasimisht me gjysmën e dytë, kur në veçanti tremujori i fundit u dallua për kontributin e tij në përkeqësimin e treguesve kryesorë të sistemit bankar. Gjithsesi, luhatshmëria dhe performanca jo e mirë e disa prej treguesve kryesorë, nuk ka vënë në rrezik nivelin e kapitalit rregullator të nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të marra nga sistemi bankar.

Sistemi bankar vijon të jetë i angazhuar kryesisht në aktivitetin e grumbullimit të depozitave dhe rritjes së kredidhënies. Megjithatë me ritme më të moderuara, aktivet dhe burimet e sistemit u rritën më tej gjatë vitit 2008. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë duket gjithashtu të jetë rritur, si shprehje e rritjes së peshës së portofolit të kredive në totalin e aktiveve të sistemit. Për më tepër, kreditë me probleme u rritën ndjeshëm dhe me ritme të shpejta duke cënuar cilësinë e portofolit të kredive. Si rrjedhojë, rentabiliteti i matur me treguesin RoAA, u përkeqësua si pasojë e rritjes së shpenzimeve për provigjone për humbje nga kreditë, të cilat prekën rezultatin neto të sistemit. Niveli i treguesve të sipërpërmendur nuk konsiderohet të jetë kritik, por dinamika dhe intensiteti i zhvillimeve kërkon monitorim më të kujdesshëm edhe në vijimësi.

Performanca e sistemit bankar për vitin 2008, vlerësuar në këndvështrimin e ecuresë së rezultatit neto, ka qenë dukshëm më e dobët sesa gjatë vitit 2007. Rezultati neto ka shfaqur luhatshmëri gjatë vitit 2008. Ai përlogaritet 26.5 për qind më i vogël se një vit më parë dhe pasqyron kryesisht rritjen e shpejtë të shpenzimeve për provigjone, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Po kështu, shpenzimet e veprimtarisë kanë njohur një rritje të konsiderueshme si rrjedhojë e zgjerimit të vazhdueshëm të aktivitetit të sistemit bankar.

Treguesit	Dhjetor '08	Dhjetor '07	Dhjetor'06	Dhjetor'05
Rezultati neto (pas tatimit)	7.33	9.98	7.45	6.60

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Rezultati neto në miliardë lekë.

Rritja e rezultatit neto nga interesat dhe nga veprimtaritë e tjera edhe pse me ritëm më të ulët krahasuar me fundvitin 2007, ka pasqyruar rritjen e peshës së aktiveve që gjenerojnë interesa më të lartë si shprehje e orientimit në vazhdimësi të sistemit bankar drejt aktiveve me rrezik më të lartë dhe rritjen përgjithësisht të qëndrueshme të vëllimit të aktivitetit bankar.

Krahasuar me fundin e vitit 2007, niveli i NIM duket të jetë pothuaj i njëjtë, ndërkohë që komponentët e tij janë rritur në mënyrë përpjesëtimore. Ecuria e treguesit të NIM gjatë vitit 2008 flet për një prirje të lehtë graduale në rënie. NIM shënoi nivelin më të lartë prej 4.24 për qind në fund të tremujorit të parë, për të rënë në 4.19 për qind të fund të tremujorit të dytë dhe për të vijuar me 4.13 për qind përkatësisht në dy tremujorët e fundit. Të dy komponentët e tij evidentohen vijueshmërisht në rritje dhe ecuria e treguesit duket që u përcaktua nga rritja më e shpejtë e kostos së financimit nga bankat, kryesisht depozitave nga publiku, si shprehje e orientimit për të fituar treg në kahun e burimeve.

Tabelë 2. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative).

Treguesit	Dhjetor '08	Dhjetor '07	Dhjetor'06	Dhjetor'05
Të ardhura nga interesa/aktive mesatare që sjellin të ardhura (1)	8.06	7.26	7.05	6.81
Shpenzime për interesa/aktive mesatare që sjellin të ardhura (2)	3.94	3.17	2.83	3.08
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) – (2)]	4.13	4.09	4.22	3.73

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Vlen të theksojmë se treguesi i RoAA për vitin 2008 asnjëherë nuk arriti në nivelin e vitit 2007. RoAA për tremujorin e parë të vitit 2008 u përlllogarit në nivelin 1.17 për qind. Ai vijoi me një performancë më të lartë dhe të qëndrueshme për dy tremujorët e tjerë, me nivelin më të lartë të regjistruar në tremujorin e dytë, rreth 1.31 për qind, për t'u mbyllur në fundin e vitit 2008 me një nivel dukshëm më të ulët. Rënia e konsiderueshme e RoAA, veçanërisht në fund të vitit 2008, në krahasim me fundin e vitit 2007 buron para së gjithash nga rënia e ndjeshme e rezultatit neto të sistemit bankar.

Tabelë 3. Tregues kryesorë të rentabilitetit në përqindje(kumulative).

Treguesit	Dhjetor '08	Dhjetor '07	Dhjetor'06	Dhjetor'05
RoAA	0.91	1.48	1.36	1.40
RoAE	11.35	20.32	20.17	22.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1. Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i efikasitetit përlllogaritet në nivel më të lartë për fundin e vitit 2008 krahasuar me fundin e vitit 2007, përkatësisht 0.54 ndaj 0.50. Vlerësojmë se ecuria e këtij treguesi përgjithësisht shfaqet e balancuar dhe me komponentë që dallohen për një rritje progresive të qëndrueshme.

Sistemi bankar, ka prezantuar gjatë vitit 2008 rritje të totalit të aktiveve me rreth 91.8 miliardë lekë ose me 12.4 për qind, duke treguar moderim të ritmit të rritjes gjatë këtij viti kundrejt rritjes prej 118.1 miliardë lekë ose rreth 19 për qind, një vit më parë. Ndryshe nga panorama e tremujorit të tretë, ajo çka tremujori i fundit i vitit 2008 prezanton, është një rënie e totalit të aktiveve të sistemit me rreth 23.1 miliardë lekë ose me 2.7 për qind, e përcaktuar kryesisht nga bankat e mëdha të grupit G3.

Me gjithë dinamikën e grupbankave gjatë vitit 2008, çka tregon për rënien e peshës së bankave të mëdha në sistem dhe rritjen e ndikimit të bankave të vogla dhe të mesme, bankat e mëdha vijojnë të mbizotërojnë ndjeshëm.

Shkalla e ndërmjetësimit të sistemit bankar në ekonomi dhe kontributi i aktivitetit të kredidhënies duket të jenë rritur ndër vite si shprehje e rritjes së totalit të aktiveve dhe kredive ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.

Tabelë 4. Peshë e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.

Treguesi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Totali i aktiveve (në mld lekë)	270.8	318.5	339.3	373.6	426.4	496.6	624.3	742.9	834.1
Totali i aktiveve/PBB (në %)	50.2	53.5	51.6	50.2	51.9	59.3	69.4	75.9	78.0
Totali i kredive/PBB (në %)	5.3	4.7	5.9	6.8	8.5	15.3	22.0	29.9	37.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerat e treguesit Herfindahl, të përlogaritura përkatësisht për totalin e aktiveve, depozitave dhe kredive, tregojnë për nivele të qëndrueshme ende larg nivelit optimal, megjithëse me prirje drejt tij.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Indeksi H (aktivet)	0.32	0.30	0.27	0.21	0.18	0.15	0.15
Indeksi H (depozita)	0.37	0.35	0.31	0.24	0.20	0.17	0.17
Indeksi H (kredia)	0.17	0.15	0.11	0.10	0.11	0.11	0.12

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.

Viti 2008 vijon të prezantojë rritje të kredidhënies. Rritja përlogaritet rreth 104.3 miliardë lekë ose me 35.7 për qind, nga rritja me 94.5 miliardë lekë ose 47.7 për qind, gjatë vitit 2007. Ndërkohë, norma mujore e rritjes së kredisë paraqitet kaotike dhe pa një prirje të qartë kundrejt rritjes mesatare prej 2.13 për qind, të përlogaritur gjatë vitit 2008.

Rritja tremujore e kredisë	Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV
Në milionë lekë	20,870.6	33,510.6	30,796.7	19,137.5
Në %	7.1	10.7	8.9	5.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2008.

Tremujori i katërt i vitit 2008 shënon rritjen e kredive me probleme me rreth 10.77 miliardë lekë ose me 69.2 për qind krahasimisht me rritjen prej 640.6 milionë lekësh (ose 4.3 për qind) gjatë tremujorit të tretë. Gjatë vitit 2008 rritja e kredive me probleme përlogaritet në nivelin 16.5 miliardë lekë ose 167.6 për qind më shumë krahasuar me fundin e vitit 2007. Ritmet e rritjes së kredive me probleme konsiderohen shqetësuese. Në kushtet e një frenimi të mundshëm të rritjes së tepricës totale të kredive në periudhat e ardhshme mund të presim përkeqësim të mëtejshëm të cilësisë së saj, e shprehur në raportin "kredi me probleme bruto/totali i kredive bruto".

Si rrjedhojë e ritmit disa herë më të lartë të rritjes së kredive me probleme ndaj rritjes së tepricës totale të kredisë gjatë vitit 2008, u evidentua një përkeqësim i shpejtë i treguesit të cilësisë së portofolit të kredive “kredi me probleme ndaj tepricës totale të kredive” nga niveli 3.37 për qind në fundvitin 2007, në 6.64 për qind në dhjetor '08. Vlerësojmë se niveli i treguesit përbën një shifër rekord, më e larta gjatë gjashtë viteve të fundit. Ky tregues mbi baza neto përllogaritet në nivelin 3.9 për qind, më shumë se dy herë më i lartë nga niveli 1.8 për qind në fundvitin 2007.

Ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë për individët dhe bizneset vlerësohet e përkeqësuar gjatë vitit 2008, veçanërisht gjatë tremujorit të fundit të vitit. Treguesi i cilësisë së portofolit të kredive evidenton bizneset si më problematike - me kredi me probleme rreth 7.6 për qind në fund të vitit 2008, nga 3.6 për qind një vit më parë. Ndërkohë, ky tregues për individët përllogaritet rreth 5.5 për qind nga rreth 3 për qind në dhjetor '07.

Portofoli i kredive në lekë vazhdon të jetë më problematik në drejtim të cilësisë së tij, duke e prezantuar treguesin në nivelin 7.5 për qind kundrejt 6.3 për qind për atë në valutë. Megjithatë, duke marrë në konsideratë peshën ndjeshëm më të lartë të kredisë në valutë si dhe ritmin e përkeqësimit të treguesit të cilësisë së tij¹, vlerësojmë që situata është më shqetësuese për kredinë në valutë, pasi rreziku dhe pasojat që shoqërojnë këtë portofol janë të një rëndësie materialisht më të lartë.

Gjatë vitit 2008, kapitali i sistemit bankar u përfshi në ndryshime strukturore të rëndësishme, të cilat sollën rritjen e mbizotërimit të kapitalit të huaj të sistemit. Këto ndryshime strukturore si edhe shtimi i kapitalit të paguar² nga ana e bankave gjatë vitit 2008, kanë çuar në rritjen e kapitalit të huaj me 12.5 miliardë lekë (33 për qind) dhe rënien e kapitalit shqiptar me 266 milionë lekë (5.6 për qind). Në fund të muajit dhjetor 2008, kapitali i huaj i sistemit vlerësohet në 50.3 miliardë lekë apo me një peshë prej 91.8 për qind (nga 88.8 për qind në vitin e kaluar), ndërsa kapitali vendas në 4.5 miliardë lekë apo 8.2 për qind.

Në fund të vitit 2008 kapitali aksioner i sistemit paraqitet në nivelin 71.5 miliardë lekë. Gjatë këtij viti rritja e tij vlerësohet në 15.4 miliardë lekë (27.5 për qind), kundrejt rritjes me 14.5 miliardë lekë (34.3 për qind) gjatë vitit 2007. Kapitali i paguar vijon të jetë elementi më i rëndësishëm i kapitalit aksioner. Gjatë vitit 2008 kapitali i paguar i sistemit është rritur nga 41.1 miliardë lekë në 51.1 miliardë lekë ose me 24.3 për qind. Përkeqësimi i performancës së sistemit bankar gjatë 2008-ës ka bërë që rezultati neto i sistemit, të ketë një ndikim 2.6 miliardë lekë më pak në totalin e kapitalit aksioner të sistemit.

Raporti i aktiveve mbi kapitalin aksioner të sistemit ose ndryshe leva financiare e sistemit është zvogëluar gradualisht gjatë vitit 2008. Rënia e levës nga 13.1 në 11.7 përgjatë një viti, do të thotë se sistemi është mbështetur më pak në borxh për financimin e aktiveve. Ky nivel vlerësohet më i mirë sesa niveli i levës financiare për vendet e Evropës, ShBA dhe Kanada. Rënia e nivelit të levës për sistemin duket të jetë ndikuar nga grupi G3.

Totali i kapitalit rregullator të sistemit bankar raportohet në 58.6 miliardë lekë në fund të shtatorit 2008. Krahasuar me tremujorin paraardhës vlera e tij është rritur me 214 milionë lekë (0.37 për qind), ndërsa krahasuar me një vit më parë rritja rezulton në 12.4 miliardë lekë (26.9 për qind). Kapitali bazë vijon të mbizotërojë në përbërjen e kapitalit rregullator të sistemit, duke zënë 94.6 për qind, nga 93.7 për qind një vit më parë. Kjo tregon për një kapital rregullator cilësisht të mirë dhe të qëndrueshëm.

	Dhjetor'06	Dhjetor'07	Dhjetor '08
Kredi me probleme neto/kapital rregullator	6.8	9.9	21.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Ecuria e treguesit kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (në përqindje).

Në fund të dhjetorit 2008, pesha e kredisë neto me probleme ndaj kapitalit rregullator të sistemit përllogaritet 21.7 për qind, nga 9.9 për qind në fund të dhjetorit 2007 dhe 11.4 për qind në fund të tremujorit të kaluar. Rritja vjetore e treguesit është rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kredisë me probleme neto se ajo e kapitalit rregullator, konkretisht 193.7 për qind kundrejt vetëm 26.9 për qind. Për këtë arsye, aftësia e sistemit për të mbuluar me kapital rregullator humbjet e mundshme nga kredia rezulton të jetë zvogëluar dukshëm përgjatë një viti.

Si rrjedhojë e rritjes me ritme të krahasueshme të kapitalit rregullator të sistemit (29.6 për qind) dhe të totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të klasifikuara sipas rrezikut (25.8 për qind) gjatë vitit 2008, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin përllogaritet 17.2 për qind. Ky nivel vlerësohet 0.1 pikë përqindje më shumë krahasuar me një vit më parë dhe 0.3 pikë përqindje më pak, kundrejt një tremujori më parë.

Gjatë tremujorëve të parë të vitit 2008, treguesi ka ardhur në rritje, për të rigjetur përsëri prirjen rënëse në tremujorin e katërt. Rënia e treguesit në tremujorin e katërt duket të jetë ndikuar nga zbatimi i rregullave të rinj në klasifikimin e aktiveve sipas rrezikut.

Treguesi i mjaftueshmërisë vijon të shfaqë nivele më të larta në grupin e bankave të vogla G1, rreth 30.8 për qind. Ndërsa dy grupet e tjera shfaqin vlera më të ulta. Vlera e treguesit për G1, pas rënies me 9 pikë përqindje në tremujorin e dytë të vitit 2008, ka konsoliduar këtë prirje edhe gjatë tremujorëve në vazhdim, ndërsa për dy grupet e tjera kjo normë është e variueshme në kohë.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në %	G1	G2	G3	Sistemi
Dhjetor 2008	30.8	15.3	16.6	17.2
Dhjetor 2007	45.1	15.8	15.5	17.1
Dhjetor 2006	41.3	15.9	16.0	18.0
Dhjetor 2005	35.0	19.4	14.4	18.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave.

Sistemi bankar deri në muajin shtator të vitit 2008 paraqiste një gjendje të kënaqshme likuiditeti. Muajt në vazhdim u karakterizuan nga një zvogëlim i

bazës së depozitave në shumicën e bankave të sistemit. Ky fenomen ndikoi në përkeqësimin e situatës së likuiditetit, duke u konkretizuar në rënien e aktiveve likuide të sistemit, thellimin e gap-it të likuiditetit, rritjen e raportit kredi/depozita si edhe kufizimin e mundësisë së sistemit për të mbuluar në të ardhmen një tërheqje masive depozitash.

Ndër vite, totali i aktiveve likuide, duke përjashtuar tremujorin e fundit të 2008-ës, ka ardhur duke u rritur por me ritme të ulta, ndërsa pesha e tij ndaj totalit të aktiveve ka shfaqur tendencë të dukshme rënëse. Prirja rënëse e këtij treguesi është rezultat i natyrshëm i zhvillimeve që kanë përfshirë sistemin bankar gjatë viteve të fundit, ku gradualisht është kaluar nga investimet në aktive likuide të cilat konsiderohen përgjithësisht me rrezik të ulët, drejt investimeve në aktive afatgjata me rrezik më të lartë, por edhe me një marzh fitimi më të lartë, siç janë kreditë. Në vitin 2003, aktivet likuide përbënin 73.6 për qind të totalit të aktiveve; në vitin 2007 kjo peshë është ulur në 49.8 për qind, për të arritur në 42.8 për qind në vitin 2008.

Një burim i rëndësishëm financimi për disa nga filialet apo degët e bankave të huaja në Shqipëri janë huatë e marra nga bankat mëma, bankat e tjera të grupit dhe institucionet të tjera financiare jorezidente. Gjatë viteve të fundit, ky burim financimi ka ardhur duke u zgjeruar. Në fund të vitit 2005, fondet e huaja përbënin vetëm 2 për qind të totalit të detyrimeve të sistemit, ndërsa në fund të dhjetorit 2008 kjo peshë u rrit në 8.6 për qind.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i cili ndihmon në dhënien e një panorame sa më të plotë të situatës së likuiditetit në sistemin bankar është treguesi “kredi ndaj totalit të depozitave”. Treguesi duket të jetë përkeqësuar gjatë tremujorit të katërt të vitit dhe përllogaritet mbi 60 për qind. Rritja e treguesit ishte rrjedhojë e rënies së lartë të depozitave nga klientët, ndërsa kredia vijoi rritjen edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit (gjatë këtij tremujori ajo u rrit me 5.1 për qind).

Tabelë 9. Ecuria e treguesit kredi ndaj depozitave në përqindje.

	Lek	Euro	Usd	Të gjitha monedhat
2006	17	98	36	38
2007	22	97	34	46
2008	30	112	34	62

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 LICENCIMI DHE KUADRI RREGULLATIV

5.2.1 LICENCIMI

Procesi i licencimit, si pjesë e mbikëqyrjes bankare, gjatë vitit 2008 ka konsistuar në:

NDRYSHIME NË STRUKTURËN E AKSIONERËVE TË BANKAVE

Gjatë vitit që lamë pas u evidentuan ndryshime cilësore e sasiore të kapitalit

aksioner të bankave. Ndryshimet cilësore konsistojnë në rritjen e pjesës së kapitalit të huaj në kapitalin aksioner të bankave. Ndryshimet sasiore evidentohen në rritjen e masës së kapitalit të nënshkruar dhe të paguar të bankave. Hyrja në tregun shqiptar e subjekteve dhe bankave të cilat kanë eksperiencë në tregjet e huaja, vlerësohet se do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e sistemit bankar shqiptar, duke sjellë jo vetëm kapital por dhe ekspertizë në drejtim të menaxhimit dhe administrimit të rrezikut bankar.

Konkretisht në vitin 2008 u miratua:

- blerja e aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Union sh.a. në masën 12.5 për qind, nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- transferimi i pronësisë të 76.83 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksioner të Bankës Italiane të Zhvillimit sh.a., nga aksionerët ekzistues, tek Veneto Banca Holding S.c.p.A., Itali.

Në të gjitha transferimet e aksioneve të bankave të miratuara vërehet tendenca në rritje e pjesës së kapitalit të huaj nga pikëpamja e origjinës. Nga ana tjetër, vërehet hyrja e subjekteve dhe e bankave me eksperiencë ndërkombëtare, gjë që pritët të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e sistemit bankar shqiptar.

BASHKIME BANKASH DHE REVOKIM LICENCASH BANKARE

Në vitin 2007 u realizua bashkimi me përthithje i Bankës Italo Shqiptare me Bankën Amerikane të Shqipërisë. Ky fenomen i ri u shoqërua me aplikimin e praktikave të reja licencuese të panjohura dhe zbatuara më parë. Në vijim të kësaj praktike, në vitin 2008 iu revokua licenca Bankës Italo Shqiptare, aktiviteti i të cilës u transferua tek Banka Amerikane e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë në vitin 2008 miratoi ndryshimin e emrit të Bankës Amerikane të Shqipërisë në Banka Intesa Sanpaolo, Shqipëri (Intesa Sanpaolo Bank Albania).

Gjithashtu, në përfundim të procesit të transformimit të Degës së Bankës së Parë të Investimeve, në bankë dhe licencimit të Bankës së Parë të Investimit, Shqipëri, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi revokimin e licencës të Degës të Bankës së Parë të Investimeve.

Është e rëndësishme që të përmendet që revokimi i dy licencave bankare nuk ka qenë si efekt i dështimit të subjekteve në veprimtarinë e tyre, por ai lidhet me transformimet e ndodhura në sistemin bankar shqiptar.

Në fund të vitit 2008 operojnë 16 banka në Republikën e Shqipërisë, nga të cilat 14 janë banka dhe 2 janë degë të bankave të huaja. Gjatë vitit që u mbyll nuk ka patur kërkesë për licencim të ndonjë banke të re.

SHTESË VEPRIMTARIE NË ANEKSIN E LICENCËS

Karakteristikë tjetër e zhvillimeve në sektorin bankar gjatë vitit 2008 ishte edhe zgjerimi i veprimtarisë bankare në drejtim të shtimit të veprimtarive të lejuara ose të produkteve bankare. Në këtë vit u dha miratimi për të shtuar në

listën e veprimtarive të aneksit të licencës, të veprimtarisë së faktoringut dhe të financimit të transaksioneve tregtare të Bankës Credins. Gjithashtu, gjatë vitit 2008 u miratuan edhe 8 raste të reja të produkteve e-banking të cilat konsistojnë në implementimin e produktit të *internet banking* si dhe të kartave elektronike bankare e ATM-ve.

ZGJERIMI I RRJETIT TË BANKAVE

Zgjerimi i shpejtë i rrjetit të degëve dhe agjencive bankare në territorin e Shqipërisë vazhdoi edhe në vitin 2008. Konkretisht në këtë vit u miratuan dhe filluan veprimtarinë 113 degë dhe agjenci. Në fund të vitit që kaloi numri i përgjithshëm i degëve dhe agjencive arriti në 517 nga 404 që ishin në vitin 2007.

Tabelë 10. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2007.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë
1	Banka Raiffeisen	98		
2	Banka Kombëtare Tregtare	21	20	1
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	3	1	
4	Banka Italo Shqiptare		7	
5	Banka Italiane e Zhvillimit	4		
6	Banka e Tiranës	39	4	
7	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	5	19	
8	Banka Ndërkombëtare Tregtare	5		
9	Dega e Bankës Alfa	23	1	
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	8	15	4
11	Banka ProCredit	24	1	
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve ³	-	-	
13	Banka Emporiki	4	7	
14	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1	
15	Banka Credins	21	4	
16	Banka Popullore	33		
17	Banka Union	12	12	
18	Banka e Parë e Investimeve	4	1	
	TOTALI	306	93	5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 11. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2008.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë	Nr. degëve e agjencive
1	Banka Raiffeisen	101			101
2	Banka Kombëtare Tregtare	26	29	2	57
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	4	2		6
4	Banka Italiane e Zhvillimit	7			7
5	Banka e Tiranës	43	4		47
6	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	5	25		30
7	Banka Ndërkombëtare Tregtare	8			8
8	Dega e Bankës Alfa	48	1		49
9	Banka Intesa Sanpaolo, Shqipëri	18	16	4	38
10	Banka ProCredit	29	13		42
11	Banka Emporiki	10	10		20
12	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1		3
13	Banka Credins	23	6		29
14	Banka Popullore	39			39
15	Banka Union	15	16		31
16	Banka e Parë e Investimeve	6	4		10
	TOTALI	384	127	6	517

Burimi: Banka e Shqipërisë.

MIRATIME ADMINISTRATORËSH

Në vitin 2008 u paraqitën nga bankat 60 kërkesa për miratimin e administratorëve të emëruar prej tyre si kërkesë e ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Për këto kërkesa është dhënë miratimi paraprak i Bankës së Shqipërisë. Kërkesat e paraqitura për miratim paraprak të administratorëve konsistojnë në:

- emërimet e administratorëve për efekt të lëvizjeve të ndryshme në varësi të strukturave organizative të bankave, lëvizje paralele apo emërimet të reja;
- krijimet e pozicioneve të reja si efekt i krijimit të strukturave të reja në banka për shembull, njësitë për analizën e rrezikut;
- emërimet të reja si rezultat i vendosjes në drejtimin e bankave të përfaqësuesve të aksionerëve të rinj të tyre.

Në rastet e miratuara të administratorëve të bankave 10 prej tyre janë për anëtarë të këshillit drejtues të bankës, 12 raste janë për anëtarë të komitetit të kontrollit, 6 raste janë për drejtorë të përgjithshëm/ekzekutivë, 30 raste janë për drejtorë departamentesh/divizionesh/drejtorish dhe 2 raste janë për drejtues të njësisë së kontrollit të brendshëm.

MIRATIME TË NDRYSHIMEVE NË STATUTET E BANKAVE

Në bazë të nenit 24 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak, ndër të tjera edhe për ndryshimet në statutet e bankave. Në zbatim të kësaj kërkesë ligjore janë paraqitur kërkesa për miratim ndryshimesh në statut nga 6 banka.

Ndryshimet e paraqitura të statuteve të bankave lidhen me detyrimin për zbatimin e kërkesave të ligjit për bankat, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KRIJIMI I SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA

Në vitin 2008 shoqëria aksionere Fondi Besa sh.a. u pajis me licencën nr. 10, datë 26.12.2008 si subjekt jobankë për ushtrimin e veprimtarive financiare të parashikuara nga ligji për bankat. Në fund të vitit 2008 janë 7 subjekte financiare jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare. Konkretisht, 4 subjekte jobanka ushtrojnë veprimtarinë e kredidhënies, 5 subjekte jobanka kryejnë veprimtarinë e pagesave dhe të arkëtimit, 4 subjekte jobanka ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit të transaksioneve monetare, 5 subjekte ushtrojnë veprimtarinë e agjentit dhe të këshilltarit financiar, 3 subjekte ofrojnë garanci (të ndryshme nga garancitë bankare), 1 subjekt ushtron veprimtarinë e qirasë financiare dhe 1 subjekt ushtron veprimtarinë e pranimi dhe të administrimit të mjeteve të pagesave.

LICENCIMI I ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR DHE REVOKIME LICENCASH

Në Bankën e Shqipërisë, gjatë vitit 2008 iu dha licenca 81 zyrave të këmbimit valutor si dhe iu revokua licenca me kërkesën e tyre, 4 zyrave të këmbimit valutor. Gjithashtu si efekt i ndryshimeve në rregulloren "Për

licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” u miratua edhe veprimtaria shtesë, për 38 zyra të këmbimit valutor që punojnë si agjent për transferimin e parave për llogari të një subjekti jobankë (Unionit Financiar të Tiranës ose Ak – Invest). Në fund të vitit 2008 në tregun e këmbimit valutor operojnë 189 zyra.

LICENCIMI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE REVOKIME LICENCASH

Gjatë vitit 2008 u licencuan 9 shoqëri të reja të kursim-kreditit dhe iu revokua licenca 6 shoqërive si rezultat i bashkimit me një shoqëri ekzistuese. Konsolidimi i shoqërive të kursim-kreditit vazhdoi edhe gjatë vitit 2008 dhe si rezultat i tij numri i këtyre shoqërive në fund të vitit arriti në 133.

Tabelë 12. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2000 deri në fund të vitit 2008.

Nr	Subjektet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15	16	17	17	18	16
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7	7	7	6	6	7
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58	54	58	60	112	189
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113	131	130	131	125	130	133
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2	2	2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2.2 KUADRI RREGULLATIV

Ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe zbatimi i strategjisë afatmesme dhe afatgjatë të Bankës së Shqipërisë, krijuan shtysën në vazhdimësi edhe përgjatë vitit 2008, të procesit të rishikimit të kuadrit rregullativ mbikëqyrës.

Viti 2008 finalizoi hartimin e disa rregulloreve të reja dhe njohu ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes bankare.

Akte të reja rregullative me rëndësi për mbikëqyrjen bankare të miratuara gjatë këtij viti:

- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, e cila harmonizon kërkesat e reja të ligjit për bankat me tërësinë e rregullave dhe kriterëve të autoritetit mbikëqyrës për llogaritjen, mbikëqyrjen dhe raportimin e ekspozimeve të mëdha të bankës ndaj një personi/klienti ose grupi personash/klientësh të lidhur ose në një marrëdhënie të veçantë me bankën, me qëllim administrimin e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi i përqendruar ndaj tyre.
- Rregullorja “Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja”, e cila përcakton rregullat e autoritetit mbikëqyrës lidhur me kontrollin e brendshëm, si pjesë e qeverisjes së përgjegjshme të bankave, të cilat synojnë promovimin e një sistemi të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm si faktor kryesor në drejtimin dhe administrimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja.

- Rregullorja “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, e cila fokuson kryesisht kërkesat rregullatore mbi mënyrën dhe formën e dhënies së informacionit për klientët për produktet dhe shërbimet bankare të ofruara, për publikimin në veçanti të normave efektive të interesit të depozitave/kredive, për metodën e llogaritjes së normës efektive të interesit për kreditë, elementet e kontratës së kredisë dhe depozitave, për marketingun e produkteve dhe shërbimeve, ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të klientit, trajtimin e ankesave të këtij të fundit si dhe krijimin e strukturave (funksioneve) të veçanta lidhur me këto ankesa etj..
- Rregullorja “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, e cila fokuson kryesisht kërkesat rregullatore të autoritetit mbikëqyrës për publikimin e informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja për publikun dhe pjesëmarrësit e tregut, në disa kategori kryesore (veprimtaria kryesore e bankës, organizimi dhe drejtimi (qeverisja) i përgjithshëm, ecuria (performanca) financiare, gjendja financiare, praktikat dhe strategjitë e administrimit të rrezikut, ekspozimet ndaj rreziqeve dhe politikat kontabël).
- Rregullorja “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, e cila përcakton kërkesat minimale për kushtet teknike dhe të sigurisë të subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare, me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë të sigurt të veprimtarisë së tyre.
- Disa ndryshime të rëndësishme u realizuan në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”, të cilat lidhen me administrimin e rrezikut të kredisë për bankat dhe degët e bankave të huaja dhe i shërbejnë forcimit në vazhdimësi të masave të ndërmarra nga autoriteti mbikëqyrës për minimizimin e rrezikut nga kredidhënia e bankave të sistemit.
- Po kështu disa ndryshime u realizuan në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, të cilat morën shtysë nga situata aktuale e problemeve të shfaqura në sistemet financiare në botë dhe të cilat synojnë parandalimin e fenomeneve negative edhe në sistemin bankar shqiptar. Këto ndryshime konsistojnë kryesisht në vendosjen e kufijve më prudencialë të treguesve të ekspozimeve të mëdha dhe në teknikat e llogaritjes dhe njohjes së kolateralit të parashikuara në rregullore, me qëllim shpërndarjen dhe diversifikimin e rrezikut që rrjedh nga përqendrimi në investimet e bankave në tregjet financiare ndërkombëtare.

5.3 MBIKËQYRJA NË VEND

FUNKSIONIMI I NJËSISË

Zyra e Inspektimeve është përgjegjëse për vlerësimin e aktivitetit të bankave dhe për kontrollin e respektimit të kuadrit ligjor e rregullativ nga ana e

tyre. Puna e kryer është bazuar në garantimin e zhvillimit të një aktiviteti të shëndoshë financiar. Organizimi i punës është bërë në bazë të kriterëve të ciklit mbikëqyrës, të përcaktuar nga politika operative e mbikëqyrjes. Duke qenë një hallkë e rëndësishme e përmbushjes së misionit të Bankës së Shqipërisë, ajo ka ushtruar detyrimet e saj duke iu përmbajtur parimeve mbikëqyrëse, duke i qartësuar, thelluar e respektuar ato. Puna intensive e kryer dhe kujdesi i vazhdueshëm e kanë bërë një hallkë të rëndësishme në ruajtjen e stabilitetit financiar.

Veçori e aktivitetit gjatë vitit 2008 është angazhimi në drejtim të analizës së thelluar të aktivitetit të subjekteve të licencuara, veçanërisht operatorëve bankarë. Kjo dukuri është shoqëruar me evidentimin e plotë të disa problematikave si dhe angazhimin intensiv të zgjeruar të burimeve njerëzore. Në vijimësi të praktikave të ngritura, është mbajtur në vëmendje të veçantë objektivi i punës për të parandaluar fenomenet në prioritet ndaj adresimit të tyre pas shfaqjes së dobësive. Për këtë, janë marrë në konsideratë ndikimet që mund të kenë pozicione të veçanta rreziku si dhe janë paralajmëruar dukuri, me qëllim marrjen e masave në kohë.

Përveç respektimit të ciklit mbikëqyrës, është mbajtur një kontakt i vazhdueshëm me bankat për të tërhequr vëmendjen në kohë për dukuri që kanë përbërë shqetësim mbikëqyrës gjatë gjithë vitit. Janë bërë përpjekje për të marrë masat për adresimin në kohë të fenomeneve të shfaqura veçanërisht për çështjet e cilësisë së portofolit të kredive, mënyrën e aplikimit të normave të interesit dhe për më tepër, administrimin e likuiditetit.

Gjatë vitit janë trajtuar edhe ankesa të bëra nga klientë. Numri i tyre, megjithëse modest, është në rritje në krahasim me vitet e kaluara dhe natyra e problematikës është tregues i një ndërgjegjësimi në rritje të publikut për shërbimet e bankave, çka ngre nevojën për një vëmendje të vazhdueshme për adresimin e duhur të problemeve.

BASHKËPUNIMI ME AUTORITETE TË TJERA

Duke marrë në konsideratë zhvillimet në tregjet financiare, veçanërisht ato të muajve të fundit të vitit dhe rëndësinë e bankave me kapital ndërkombëtar, i është kushtuar vëmendje bashkëpunimit me autoritete të tjera mbikëqyrëse. Ky bashkëpunim ka qenë kryesisht me vendet nga të cilat kanë origjinën e kapitalit bankat që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri si dhe ato të rajonit.

Në vijim të marrëveshjes shumëpalëshe të bashkëpunimit të nënshkruar me gjashtë vende të rajonit, me qëllim promovimin e një koordinimi të strukturuar në fushën e mbikëqyrjes bankare, është realizuar shkëmbimi i informacionit për veçoritë mbikëqyrëse të çdo vendi dhe janë hedhur hapat për zgjerimin dhe konkretizimin e bashkëpunimit.

Është forcuar bashkëpunimi me Bankën e Greqisë, autoritetin mbikëqyrës të sistemit bankar në këtë vend, duke shkëmbyer eksperiencë dhe informacion, dhe nëpërmjet pranisë së këtij autoriteti në kontrollin në Shqipëri të zgjerimeve të bankave me origjinë kapitali nga Greqia.

Ka patur një bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Është siguruar pjesëmarrja e vazhdueshme në kuadrin e projektit të binjakëzimit të këtij institucioni me homologun e tij gjerman, të financuar nga Komuniteti Evropian.

Është intensifikuar shkëmbimi i informacionit dhe koordinuar aktiviteti me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, veçanërisht në muajt e fundit të vitit 2008, në kuadrin e menaxhimit të situatës së likuiditetit të bankave.

Gjatë vitit 2008 janë kryer këto inspekte:

Banka	12 inspekte të plota
Institucione financiare jobanka	1 inspektim i plotë
Shoqëri të kursim-kreditit	1 inspektim i plotë
Zyra të këmbimit valutor	34 inspekte
Ambiente fizike të degëve të bankave dhe të zyrave të këmbimit valutor	201 inspekte

Burimi: Banka e Shqipërisë.

PROBLEMATIKA TË EKZAMINIMEVE

• BANKAT

Veprimtaria bankare ka njohur zhvillime të ndryshme gjatë vitit 2008. Pjesa e parë, përreth 9 muaj, ka parë zgjerim të vazhdueshëm të aktivitetit, rritje të vëllimit të punës, të shërbimeve bankare, të kreditimit të ekonomisë, shtrirje më të madhe të rrjetit të degëve. Kjo dukuri ka qenë vijim i zhvillimeve të vazhdueshme të bankave, të ndodhura në vitet e fundit. Është konstatuar rritje e ndjeshme e konkurrencës, e shprehur kjo në llojet e produkteve të ofruara dhe çmimet e tyre. Këto zhvillime kanë tërhequr vëmendjen mbikëqyrëse për të ndjekur me kujdes ecurinë financiare, cilësinë e vendimeve të marra dhe pasojat e tyre.

Pjesa e dytë e vitit, ka patur një tkurrje të përgjithshme të aktivitetit bankar. Kjo ka ardhur si rezultat i shfaqjes së krizës financiare ndërkombëtare. Por, në ndryshim nga vendet e tjera ku ka patur zhvillime të brendshme që e kanë stimuluar, problemet e shfaqura në sistemin bankar shqiptar kanë ardhur për shkak të tërheqjeve të depozitave nga klientët si pasojë e një mungese besimi të shfaqur. Kjo mungesë besimi është ndikuar nga informacionet që vinin nga tregjet ndërkombëtare si dhe nga zhurmat informale që kanë qarkulluar në vend. Tkurrja është evidentuar me rënien e ndjeshme të depozitave të klientëve, veçanërisht të depozitave me afat të individëve. Në vijim të këtyre ngjarjeve si dhe të parashikimeve për një rënie të rritjes ekonomike të vendit gjatë vitit 2009, bankat kanë rishikuar planet e tyre strategjike duke përafruar një qasje më konservative ndaj rritjes së aktivitetit. Zhvillimet në treg, sjelljet e konsumatorëve e të bizneseve, situata e brendshme e likuiditetit dhe zhvillimet ekonomike që kanë ndikuar bankat mëmë në vendet e origjinës, janë faktorët kryesorë që i kanë dhënë formë planeve për vitin 2009. Megjithatë, zhvillimet e periudhës së fundit të vitit 2008 treguan edhe një herë se sistemi bankar është i shëndoshë dhe likuid, duke përballuar edhe situata vështirësie të kërkesës në rritje për tërheqjen e fondeve.

Lidhur me situatën e tre muajve të fundit të vitit 2008, janë ndjekur në mënyrë intensive zhvillimet në sistemin bankar. Për këtë qëllim, është kërkuar raportimi me baza ditore i situatës së tërheqjeve të depozitave të klientëve dhe i disa zërave të veçantë të bilancit që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me përballimin e fenomenit. Është ngritur baza e nevojshme e të dhënave dhe janë bërë përpunimet e tyre për të përgatitur materiale informuese e analizuese lidhur me zhvillimet në sistem me një frekuencë 1-javore. Përveç kësaj, është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me secilën prej bankave për marrjen e informacionit në kohë reale mbi ecurinë rutinë të aktivitetit apo të zhvillimeve të veçanta që kanë përbërë shqetësim mbikëqyrës.

Në vëmendje të veçantë të bankave gjatë vitit ka qenë zhvillimi i funksionit të menaxhimit të rrezikut. Kjo është bërë në varësi të madhësisë së bankës dhe llojit të rrezikut të marrë përsipër. Në disa prej bankave janë ngritur njësi të veçanta që merren me analizën e rrezikut ndërsa të tjerat kanë krijuar pozicione pune për këtë qëllim.

Mangësitë e konstatuara gjatë mbikëqyrjes në vend përmbledhen në përshtatjen e strukturave me zhvillimet e bankës çka nënkupton krijimin e njësive të reja, delegimin e autoriteteve të punës si dhe mbështetjen e tyre me anë të politikave të veprimit dhe procedurave të punës. Janë evidentuar disa mangësi në sistemet e kontrollit të brendshëm. Në njësinë e kontrollit të brendshëm është konstatuar nevoja për përmirësim të cilësisë së punës, për mbulimin e tërësisë së veprimtarisë si dhe ndjekjen e adresimit të problemeve. Në mënyrë të vazhdueshme i është dhënë përparësi vëmendjes së organeve drejtuese në drejtim të veprimtarisë aty ku nuk ka qenë e mjaftueshme, për mirëfunksionimin e njësive organizative apo krijimin dhe stabilizimin e strukturave kur ka qenë e nevojshme. Rëndësi e veçantë i është kushtuar cilësisë së punës për menaxhimin e rreziqeve.

Mbikëqyrja në vend i ka kushtuar vëmendje të veçantë nivelit të kapitalizimit të bankave. Përveç analizës së gjendjes, është kërkuar respektimi në mënyrë rigoroze i kufijve rregullativë si dhe parashikimit të nevojave për kapital e gjetjes së burimeve. Për uljen e rreziqeve të përqendrimit është kërkuar zgjerimi i bazës së klientelës si në marrëdhëniet e detyrimeve ashtu edhe të kreditimit. Shpërndarja e rrezikut të kredisë në degë të ndryshme të ekonomisë ka qenë gjithashtu, pjesë e rekomandimeve të lëna. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ruajtjes së nivelit të mirë të likuiditetit të bankave, administrimit të duhur të tij si dhe sigurimit të fondeve të nevojshme për përballimin e situatave të vështira. Në vijim të pasaktësive të konstatuara në raportimin e të dhënave periodike me bazë mujore, bankave u është rekomanduar marrja e të gjitha masave të nevojshme për shmangien e dukurisë dhe rritjen e kontrollit për saktësimin e të dhënave të dërguara.

PROBLEME QË LIDHEN ME ZBATIMIN E RREGULLOREVE

Përgjithësisht vërehen respektime të mira të kuadrit rregullativ. Mangësitë kanë qenë të pranishme, por në shumicën dërrmuese të rasteve nuk kanë patur ndikim material në situatën e ekspozimit ndaj rreziqeve.

Shkeljet janë konstatuar më së shumti lidhur me mosrespektimin e:

- a) Ligjit për bankat. Shkeljet ndaj tij kanë të bëjnë veçanërisht me ekspozimin ndaj personave të lidhur me njëri-tjetrin. Këto shkelje janë konstatuar për shkak të mosevidentimit të saktë të grupeve të lidhura të biznesit, që në momentin e marrjes së vendimit për mbështetje me kredi.
- b) Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Niveli i rrezikut ndaj kredimarrësve është shqyrtuar në mënyrë të vazhdueshme dhe në disa raste është konstatuar respektim jo i drejtë i kësaj rregulloreje, veçanërisht për sa i përket klasifikimit të kredive dhe nivelit të provigjoneve të krijuara. Plotësimi i dokumentacionit në përputhje me këtë rregullore ka qenë një kërkesë e vazhdueshme në vijim të konstatimeve.
- c) Rregullores “Për pozicionet e hapura valutore”. Ekzistojnë disa raste sporadike të mosrespektimit të kësaj rregulloreje, megjithatë kanë qenë situata të përkohshme dhe të cilat janë përmirësuar në një kohë të shpejtë.
- d) Rregullores “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”. Mosrespektimet kanë qenë kryesisht të natyrës teknike si dhe të interpretimit të kërkesave rregullative.
- e) Rregullores “Për ekspozimet e mëdha”. Janë konstatuar mosraportime apo raportime jo të sakta të ekspozimeve të bankave. Kjo, për shkak të ndryshimeve rregullative të prezantuara gjatë vitit, të cilat megjithatë, janë përmirësuar në vijimësi.
- f) Rregullores “Për veprimtarinë valutore”. Vërejtjet për zbatimin e kësaj rregulloreje lidhen kryesisht me qëllimin e transfertave apo me dokumentacionin mbështetës.
- g) Rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Mangësitë janë të lidhura me parandalimin e transaksioneve të dyshimta, ngritjen dhe respektimin e strukturave, trainimin e personelit, krijimin e një baze të dhënash, raportimin e transaksioneve të dyshimta dhe zbatimin e kërkesave të ligjit të ri që ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2008.
- h) Rregullores “Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë”. Mosrespektimet e kësaj rregulloreje ndeshen relativisht më shpesh çka tregon nevojën për investim më të madh të bankave për përmirësimin e sistemeve të teknologjisë dhe informacionit. Këto përmirësime duhet të bëhen në drejtim të vlerësimit të sistemeve, garantimit të sigurisë fizike, hartimit të planit të operimit, dokumentimit të veprimtarisë, planit të rikuperimit në rast fatkeqësie. Gjithashtu, është rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme kontrolli i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, nga shoqëri të specializuara.
- i) Rregullores “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”. Mangësitë lidhur me këtë rregullore kanë të bëjnë me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe kohën e dorëzimit të tij në Bankën e Shqipërisë. Zbatimi i kësaj rregulloreje është përmirësuar ndjeshëm gjatë vitit 2008.
- j) Udhëzimit “Për transparencën e operacioneve dhe shërbimeve

bankare". Mosrespektimet e udhëzimit kanë të bëjnë me dhënien e informacionit klientëve lidhur me ndryshimin e kushteve të punës në respektim të kontratave, publikimin e plotë të normës referencë të interesit, njoftimin e klientit për të gjitha shpenzimet e lidhura me kredidhënien, përcaktimin e qartë të llojit të kredisë në kontratat përkatëse, penalitetet ndaj të cilave janë të ekspozuar, publikimin e plotë të informacionit për kreditë etj.. Gjatë inspektimeve është vënë gjithashtu theksi në njoftimin e klientëve për rreziqet ndaj të cilave ekspozohen gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

- k) Manualit të Kontabilitetit Bankar. Një nga problemet më evidente ka qenë klasifikimi i investimeve në letra me vlerë sipas përcaktimeve të manualit. Mosklasifikimi i saktë ka sjellë shfaqjen e kostove më të ulëta për bankat.

• SUBJEKTET FINANCIARE

Në këtë grupim përfshihen dy lloje subjektësh, institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Ndërsa të parat nuk mund të grumbullojnë depozita nga publiku, të dytat mund të grumbullojnë depozita në bazë të përcaktimeve të ligjit përkatës.

Problematikat më të shpeshta të ndeshura në ekzaminimet e kryera kanë të bëjnë me moslogaritjen e saktë dhe respektimin e normave mbikëqyrëse të përcaktuara në rregulloret e hartuara për funksionimin e tyre. Këto norma mbikëqyrëse janë kryesisht të lidhura me nivelet e rrezikut.

Gjatë inspektimit të subjekteve i është kushtuar mjaft rëndësi përmirësimit të strukturave të brendshme si nga pikëpamja organizative ashtu edhe nga ajo rregullative, për shmangien e mashtrimeve të mundshme. Për këtë është kërkuar si çështje me rëndësi, përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe i punës së njësive të kontrollit të brendshëm. Në vijim, është kërkuar përmirësimi i procesit kreditues duke filluar që nga analiza e aftësisë kredimarrëse deri në klasifikimin e saktë të portofolit të kredisë në përputhje me rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

Në bazë të mangësive të konstatuara, është rekomanduar edhe hartimi i planeve të zhvillimit sa më realiste dhe sa më pranë mundësisë së realizimit të tyre, funksionimi i të gjitha strukturave në bazë të kuadrit të brendshëm rregullativ, investime në sisteme të teknologjisë së informacionit dhe respektimi i kërkesave të rregullores për teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, për krijimin e sigurisë së nevojshme të funksionimit normal të aktivitetit.

• ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR

Janë kryer 34 inspektime të këtyre subjekteve. Mangësitë në punën e tyre janë të përsëritura dhe konsistojnë në mungesën e raportimeve ose të saktësisë së të dhënave në to; mosdhënien e faturave të këmbimit klientëve; mungesën e mbajtjes së kontabilitetit apo mangësi dokumentacioni në lidhje me kërkesat e rregullores për funksionimin e tyre.

5.4 REGJISTRI I KREDIVE

Funksionimi i Regjistrit të Kredive konsiderohet një element i rëndësishëm për garantimin e stabilitetit të sistemit bankar. Regjistri i Kredive përbën bazën elektronike të të dhënave identifikuese dhe veçanërisht, të të dhënave të kreditit, të individëve, të personave fizikë tregtarë dhe të personave juridikë, që kanë kredi pranë një banke dhe/ose një dege të një banke të huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë. Regjistri i Kredive ka dy qëllime kryesore:

- vlerësimin dhe minimizimin e rrezikut të kredisë me të cilin përballet sistemi bankar, duke rritur mundësitë për kryerjen e transaksioneve të shëndosha kredituese;
- forcimin dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezikun.

Regjistri i Kredive ka filluar të funksionojë “live” më 3 janar 2008. Që nga ky moment, Regjistri i Kredive i ka siguruar bankave tregtare informacionin e nevojshëm për të gjykuar drejt dhe shpejt mbi besueshmërinë e aplikuesve për kredi, duke rritur kështu mundësitë për një proces kredidhënieje të shëndoshë.

Monitorimi i vazhdueshëm i raportimeve të bankave në Regjistrin e Kredive për të siguruar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmban Regjistri i Kredive, monitorimi i përdorimit të të dhënave të Regjistrit të Kredive nga bankat e nivelit të dytë, trajtimi i kërkesave individuale të kredimarrësve për marrjen e raportit të kredisë, projekti për përfshirjen e institucioneve të mikrofinancës në Regjistrin e Kredive etj., kanë qenë përparësitë e Zyrës së Regjistrit të Kredive gjatë vitit të parë të funksionimit të saj.

RAPORTIMI I TË DHËNAVE

Të gjitha kreditë në sektorin bankar, pavarësisht nga vlera e tyre, janë raportuar në Regjistrin e Kredive. Në këtë kuadër, bankat janë të detyruara të raportojnë në Regjistrin e Kredive çdo kredi të re të lëvruar, disbursim të ri të kredisë, kredi të paguar dhe kredi të fshirë nga bilanci, si dhe të dhënat për personat e lidhur dhe kolateralet që i mbështesin, brenda ditës së nesërme të punës; si dhe përditësimin e portofolit të kredive dhe klasifikimet përkatëse të tyre, brenda 15 ditëve të muajit të ardhshëm.

KONFIDENCIALITETI DHE TRANSPARENCA

Informacioni që përfaqësohet në bazën e të dhënave, mbrohet dhe shfrytëzohet në përputhje me kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në çdo rast, për të shmangur keqinterpretimin e informacionit që gjendet në Regjistrin dhe rritjen e transparencës, kredimarrësit lejohen që nëpërmjet një procedure të përcaktuar dhe të qartë, t’i drejtohen Bankës së Shqipërisë për të verifikuar informacionin që ekziston rreth tyre në Regjistrin si dhe për të kërkuar ndryshimet e nevojshme.

Gjithashtu, për një transparencë më të plotë, në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë ‘www.bankofalbania.org’ ekziston gjithë informacioni përkatës lidhur me Regjistrin e Kredive.

Përfshirja e institucioneve të mikrofinancës dhe subjekteve jobanka në Regjistrin e Kredive

Regjistri i Kredive synon të përfshijë të dhëna nga të gjitha institucionet financiare që kanë të licencuar nga Banka e Shqipërisë, aktivitetin e kredidhënies. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë është angazhuar për hartimin dhe ndjekjen e projektit për të përfshirë si raportues dhe përdorues të të dhënave edhe institucionet e mikrofinancës dhe subjektet financiare jobanka që kanë të licencuar aktivitetin kreditues. Projekti u ideua dhe po realizohet në disa etapa. Në etapën e parë u prezantua projekti, kërkesat ligjore dhe teknike, si dhe u realizua njohja me infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe databazën e kredidhënies së këtyre institucioneve. Etapa e dytë kishte si qëllim vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve për plotësimin e kërkesave si dhe përcaktimin e gatishmërisë për hyrjen në sistemin e Regjistrit të Kredive. Etapa e tretë, e cila do të finalizohet gjatë vitit në vijim, synon përfshirjen e institucioneve në Regjistrin e Kredive dhe sigurimin e besueshmërisë së këtij procesi.

INFORMACIONET QË SKICOHEN NGA REGJISTRI I KREDIVE

Gjatë këtij viti, Regjistri i Kredive është përdorur kryesisht në shërbim të bankave, duke rritur mundësitë e tyre për kryerjen e transaksioneve të shëndosha kredituese dhe ka shërbyer si instrument shtesë në administrimin nga ana e tyre të rrezikut të kredisë. Konkretisht, Regjistri i Kredive vë në dispozicion të bankave tregtare, informacionin e nevojshëm për të gjykuar drejt dhe shpejt mbi aftësitë për të shlyer detyrimet financiare dhe besueshmërinë e aplikuesit për kredi, duke shkurtuar kohën e nevojshme të vendimmarrjes për dhënien e kredisë, duke ndikuar në rritjen e cilësisë dhe uljen e kostove të kredisë.

Sistemi i Regjistrit të Kredive siguron gjithashtu, një nivel të gjerë produktesh në shërbim të realizimit të funksioneve të Bankës së Shqipërisë. Raportet që skicon Regjistri i Kredive, synojnë të mbështesin misionin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në drejtim të përmirësimit të vlerësimit të administrimit të rrezikut të kredisë, të monitorimit të nivelit të huave problematike, të vlerësimit të cilësisë së portofoleve të kredisë, të evidentimit të përqendrimeve të kredisë sipas bankave dhe sipas sektorëve të ekonomisë, të vlerësimit të detajuar të ekspozimit të bankave ndaj financimit sipas monedhave, të vlerësimit të detajuar të llojit të kolateraleve dhe të garancive të përdorura, të evidentimit të lidhjeve që ekzistojnë midis subjekteve të ndryshme kredimarrëse etj.. Një pjesë e raporteve, shërbejnë gjithashtu dhe për monitorimin efektivitetit të funksionimit të Regjistrit të Kredive lidhur me raportimet e bankave, si dhe lidhur me përdorimin e informacionit të Regjistrit të Kredive nga bankat. Këto raporte janë një instrument efikas dhe i shpejtë, pasi janë në kohë reale dhe ndihmojnë për një orientim të shpejtë të njohjes së tendencave të sistemit bankar.

SHËNIME

¹ Vetëm gjatë tremujorit të fundit, treguesi i cilësisë për kredinë në valutë u rrit me 2.72 pikë përqindje kundrejt rritjes me 1.91 pikë përqindje të këtij treguesi për kredinë në lekë.

² Në kapitalin e paguar përfshihet edhe kapitali i dhuruar për degët e bankave të huaja, si edhe primet e emetimit.

³ Në vitin 2007 aktiviteti i Degës së Bankës së Parë të Investimeve u transferua tek Banka e Parë e Investimeve sh.a. përfshirë edhe aktivitetin e degëve dhe agjencive. Ky transferim u finalizua me revokimin e licencës së Degës së Bankës së Parë të Investimeve me vendimin nr. 28, datë 09.04.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155

KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

6.1 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Gjatë vitit 2008, sistemet e pagesave pranë Bankës së Shqipërisë kanë reflektuar siguri dhe eficiencë, karakteristika këto të domosdoshme për funksionimin normal të sistemit të pagesave. Klerimi dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave, në monedhën kombëtare Lek, realizohet nëpërmjet dy sistemeve të pagesave “Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS” dhe “Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël - AECH”, në përputhje me rregullat e shlyerjes së pagesave ndërbankare. Sistemi i shlyerjes së pagesave në kohë reale (AIPS) ka qenë i aksesueshëm nga pjesëmarrësit në 99.88 për qind të orarit të tij të operimit. Thënë ndryshe, në 246 ditë pune sistemi ka qenë i padisponueshëm vetëm për 2 orë e 22 minuta, si pasojë e problemeve teknike dhe/ose problemeve të komunikimit me rrjetin e SWIFT-it.

6.1.1 SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE - AIPS

Një total prej 56,717 transaksionesh u procesuan dhe u shlyen në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 91 milionë lekësh. Kundrejt vitit 2007, vëllimi i pagesave të shlyera në 2008-ën rezulton të jetë rritur 25 për qind, ndërkohë që vlera e transaksioneve të shlyera është rritur 37 për qind.

Sistemi AIPS	2006	2007	2008
Numri i transaksioneve	38,793	45,480	56,717
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,376	3,745	5,146
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	87	82	91

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Ecuria e transaksioneve në AIPS për periudhën 2006-2008.

Numri më i madh i transaksioneve të shlyera është përqendruar në tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë që qarkullimi më i madh i likuiditetit rezulton në tremujorin e tretë të vitit 2008.

Sistemi AIPS	Tremujori				Viti 2008
	I	II	III	IV	
Numri i transaksioneve	12,845	15,147	14,005	14,720	56,717
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	1,047	1,237	1,576	1,286	5,146
Vlera mesatare/transaksion (mln lekë)	82	82	113	90	91

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Shpërndarja e transaksioneve në AIPS sipas tremujorëve të vitit 2008.

Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar dhe shlyer rreth 231 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej 21 miliardë lekësh. Vlera totale e likuiditeteve të qarkulluara në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, rezulton të jetë rreth 5 herë vlera e produktit të brendshëm bruto (PBB) për vitin¹. Aktualisht, të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri janë pjesëmarrëse direkte për shlyerje në sistemin AIPS.

Në mënyrë më të detajuar, llojet e transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, dhe pesha e tyre relative ndaj totalit, paraqiten në tabelën në vijim:

Tabelë 3. Llojet e transaksioneve në AIPS.

Lloji i transaksioneve në AIPS	Vëllim		Vlerë (miliardë lekë)	
	Numri i transaksioneve	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione/instrumente financiare BSH	4,364	8%	3,053.2	59%
Transferta cash për/nga emisioni	9,052	16%	249.3	5%
Pagesa ndërbankare	8,512	15%	833.8	16%
Pagesa për klientët	29,068	51%	484.9	9%
Shlyerje për sistemet e klerimit neto	5,721	10%	524.7	10%
Totali	56,717	100%	5,146	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga totali i transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, vëmë re se pagesat për klientët që bankat shlyejnë ndërmjet tyre zënë rreth 51 për qind ndaj totalit, përfshirë këtu dhe pagesat që bankat transferojnë çdo ditë në llogarinë e buxhetit të shtetit, për llogari të klientëve të tyre. Përsa i përket vlerës së transaksioneve, qarkullimin më të lartë të likuiditetit, rreth 59 për qind ndaj totalit, e zënë transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, për përmbushjen e objektivave operacionalë të saj. Në rubrikën “shlyerje për sistemet e klerimit neto” përfshihen transaksionet për shlyerje neto të rezultateve nga sistemet e klerimit, si: klerimi i pagesave me vlerë të vogël në sistemin AECH, klerimi i çqeve bankare dhe personale në lekë, shlyerjet neto për letrat me vlerë të qeverisë dhe shlyerjet neto të rezultateve të pagesave në lekë me karta VISA, për të cilat Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit shlyerës.

Nga pikëpamja e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të stabilitetit të sistemeve të pagesave, vlerësohet edhe shkalla e përqendrimit të pagesave në nyje (pjesëmarrës) të veçanta të rrjetit. Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS, reflektojnë peshën që zë aktiviteti i një numri të caktuar bankash (3 ose 5 banka), kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem.

Tabelë 4. Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	Vëllim transaksionesh	Vlerë (mld lekë)
	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka	51%	70%
5 banka	62%	85%
Totali (vlerë absolute)	56,717	5,146

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një instrument i rëndësishëm në sistemin AIPS është edhe kredia brenda ditës (ILF), një kredi e kolateralizuar me interes zero, që Banka e Shqipërisë i ofron bankave pjesëmarrëse për administrimin e likuiditetit brenda ditës. Procedurat për akordimin e kredive brenda ditës janë mjaft të thjeshta dhe lëvrimi i fondeve bëhet brenda orës 10.00 të ditës së punës, në vijim të kërkesës së vetë bankës.

Kredi brenda ditës (ILF)	2007	2008
Numri i transaksioneve	675	579
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	218	221
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	322	382

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Numri dhe vlera e kredive brenda ditës për pjesëmarrësit në sistemin AIPS.

6.1.2 SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH

Një total prej 113,682 transaksione pagesash u kleruan në sistemin AECH gjatë vitit 2008, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 150 mijë lekësh. Kundrejt vitit 2007, vëllimi i pagesave të kleruara gjatë vitit 2008, rezulton të jetë rritur 58 për qind, ndërkohë që vlera e transaksioneve të kleruara është rritur 47 për qind.

Sistemi AECH	2006	2007	2008
Numri i transaksioneve	48,889	71,857	113,682
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	7.77	12.01	17.61
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.16	0.17	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e pagesave në AECH për periudhën 2006-2008.

Në sistemin AECH, procesohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1 milion lekë si dhe llogariten pozicionet neto shumëpalëshe për shlyerje neto në sistemin AIPS. Nga 16 banka që operojnë në Shqipëri, aktualisht 14 banka janë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në sistemin AECH, duke procesuar çdo ditë në sistem pagesat e klientëve të tyre. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AECH janë procesuar rreth 462 pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 71.6 milionë lekësh. Vëllimi dhe vlera më e madhe e pagesave të procesuara në sistemin AECH, vihet re në tremujorin e katërt të vitit 2008.

Sistemi AECH	Tremujori				Viti
	I	II	III	IV	2008
Numri i transaksioneve	24,317	29,179	27,872	32,314	113,682
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3.88	4.45	4.29	5.00	17.61
Vlera mesatare /transaksion (milionë lekë)	0.16	0.15	0.15	0.15	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Shpërndarja e pagesave në AECH sipas tremujorëve të vitit 2008.

Pagesat e kleruara në sistemin AECH, procesohen në dy seksione (seksioni I - 09.00 deri në 11.00; dhe seksioni II - 12.00 deri në 14.30) gjatë ditës së punës dhe, në përfundim të secilit seksion, shlyhen për rezultat neto në sistemin AIPS. Vërehet se për periudhën njëvjeçare, në seksionin e parë janë kleruar vëllimi dhe vlera më e madhe e pagesave për klientët.

Tabelë 8. Shpërndarja e pagesave në AECH sipas seksioneve të klerimit gjatë vitit 2008.

Sistemi AECH	Seksioni		Viti
	I	II	2008
Numri i transaksioneve	63,266	50,416	113,682
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	10.69	6.92	17.61
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.17	0.14	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH, reflektojnë peshën që zë aktiviteti i një numri të caktuar bankash pjesëmarrëse në sistem, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem. Treguesi i përqendrimit tregon se 5 banka zotërojnë rreth 63 për qind të totalit të pagesave me vlerë të vogël në sistemin bankar.

Tabelë 9. Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH.

Sistemi AECH	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksioni (mld lekë)
	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka	45%	49%
5 banka	63%	64%
Totali (vlerë absolute)	113,682	17,612

Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.1.3 INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE

Në funksion të publikimit të treguesve statistikorë për instrumentet e pagesave në Shqipëri, gjatë vitit 2008 u rishikua metodologjia "Për raportimin e instrumenteve të pagesave", bazuar në të dhënat që raportojnë bankat mbi instrumentet e pagesave. Metodologjia e re synon:

- Grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave periodike dhe ndërtimin e një baze të dhënash mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Shqipëri. Kjo ka për qëllim të analizojë tendencat dhe të ndihmojë publikun në njohjen e zhvillimit të sistemit të pagesave në Shqipëri.
- Monitorimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave në mënyrë që të vlerësohet shkalla e rreziqeve që përmbajnë këto dhe të sigurohet transparenca në marrëveshjet që kanë të bëjnë me instrumentet dhe shërbimet e pagesave.
- Përputhjen me statistikat e raportuara nga Banka Qendrore Evropiane dhe BIS Basle, duke synuar publikimin e të dhënave për Shqipërinë në *Blue Book* dhe *Red Book* (botime të Bankës Qendrore Evropiane mbi pagesat) në të ardhmen.

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2008, numri total i llogarive bankare të klientëve, të vlefshme për të kryer pagesa në lekë apo në valutë të huaj, është 1,573,830, nga të cilat rreth 91 për qind janë llogari individuale. Më pak se 1 për qind nga totali i numrit të llogarive, janë të aksesueshme nga interneti (*home banking*) për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë.

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive	Të aksesueshme nga interneti
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,573,830	11,108
1 - llogari të rezidentëve (a+b)	1,564,084	10,751
a - individuale	1,429,294	6,958
b – kompani	134,790	3,793
2- llogari të jo rezidentëve (a+b)	9,746	357
a - individuale	9,311	314
b - kompani	435	43

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Tabelë 10. Numri total i llogarive bankare të klientëve në 31 dhjetor 2008.

Në fund të vitit 2008, në Republikën e Shqipërisë operojnë 16 banka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash në 438 degë/agjenci bankare në të gjithë vendin. Gjatë këtij viti, janë shtuar makinat ATM dhe терминаlet POS për përdorimin e kartave, përkatësisht me 45 dhe 61 për qind krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2007.

Përshkrimi	Totali
Makina ATM (Automated Teller Machines)	642
prej të cilave:	
1 - ATM me funksion tërheqje cash	642
2 - ATM me funksion urdhër transferta	59
3 - ATM me funksion depozitim cash	73
Terminale POS (Point of Sale)	2,953
prej të cilave :	
1- terminale POS me funksion tërheqje cash	907
2- terminale pagesash EFTPOS	2,915
Terminale për përdorimin e parasë elektronike	-

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Tabelë 11. Numri total i ATM dhe POS në 31 dhjetor 2008.

Një formë mjaft e njohur për kryerjen e pagesave është edhe përdorimi i instrumenteve të pagesave elektronike, të cilat po gjejnë përdorim gjithnjë e më të shpeshtë edhe në Shqipëri. Në 31 dhjetor 2008, vërehet një rritje prej 17 për qind e numrit të kartave në qarkullim, krahasuar me fundin e vitit 2007. Këtu, peshë të konsiderueshme kanë patur kartat e kreditit të emetuara gjatë këtij viti, numri i të cilave është rritur me 53 për qind, kundrejt fundvitit 2007.

Numri i kartave sipas funksioneve	31 dhjetor 2008
Karta me funksion cash-i	512,232
Karta me funksion pagese	498,003
prej të cilave :	
1- karta debiti	482,072
2- karta krediti	15,931
Karta me funksion para elektronike	-
Numri total i kartave në qarkullim	512,232
prej të cilave:	
- karta me më shumë se një funksion	498,003

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Tabelë 12. Numri total i kartave bankare në qarkullim në 31 dhjetor 2008.

Gjatë vitit 2008, në total u procesuan 8,205,143 transaksione me karta, me një qarkullim total vjetor prej 93.7 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve,

rreth 96 për qind përbëjnë tërheqje cash nga ATM-të, tregues ky i një ekonomie me përdorim të lartë të cash-it. Thënë ndryshe, në përpjesëtim me numrin e popullsisë² në Shqipëri, mesatarisht një në gjashtë persona është mbajtës i një karte. Çdo kartëmbajtës kryen jo më shumë se 16 transaksione në vit, nga të cilat 15 transaksione janë tërheqje cash nga banka. Krahësuar me statistikën e vendeve të rajonit, sistemi bankar shqiptar është akoma në hapat e parë të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

Tabelë 13. Numri total i transaksioneve të realizuara me karta bankare gjatë vitit 2008.

Transaksione me karta sipas llojit të transaksionit	Vëllim	Vlerë (mln lekë)
1- ATM tërheqje cash	7,910,609	89,067.43
2- ATM depozitime	133	2.10
3- Urdhërtransferta nëpërmjet ATM-ve	271	9.37
4- Tërheqje cash në terminale POS	2,999	451.51
5- Pagesa me karta në terminale POS	291,131	4,196.19
prej të cilave :		
- pagesa me karta debiti	187,720	2,013.81
- pagesa me karta krediti	103,411	2,182.38
Totali i transaksioneve me karta	8,205,143	93,726.60

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Në fund të vitit 2008, gjashtë janë bankat që ofrojnë shërbime "home banking", në formën e produkteve që mundësojnë aksesimin e llogarisë bankare nga shtëpia, nëpërmjet një linje interneti apo një software-i që banka i vë në dispozicion klientit të saj.

Përdorimi i këtij shërbimi lidhet ngushtë me ekzistencën e infrastrukturës si dhe aftësinë e klientëve për të përdorur internetin dhe teknologjitë bashkëkohore. Krahësuar me vitin 2007, gjatë vitit 2008 vërehet një rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve "home banking", përkatësisht prej 108 dhe 116 për qind.

Tabelë 14. Numri total i transaksioneve "home banking" gjatë vitit 2008.

Home Banking	2006	2007	2008
Numri i transaksioneve	19,096	42,447	88,261
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	16.83	48.49	104.88

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

6.1.4 ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË SI MBIKËQYRËSE E SISTEMIT TË PAGESAVE

Gjatë vitit 2008, është punuar për harmonizimin e kuadrit rregullativ ekzistues të sistemit të pagesave me *Acquis Communautaire*, si dhe me standardet më të mira ndërkombëtare për sistemet e pagesave. Në këtë kuadër, janë rishikuar disa rregullore si dhe janë miratuar rregullore të reja, duke synuar përshtatjen e tyre me direktivat e BE-së.

i. Rregullore "Për instrumentet e pagesave elektronike".

Rishikimi i rregullores synon përmirësimin e kuadrit rregullativ për emetimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, në zbatim të funksionit

të Bankës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbikëqyrjen e funksionimit normal të sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja ka si objekt përcaktimin e standardeve të transparencës ndaj klientit lidhur me kushtet, rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave nëpërmjet instrumenteve të pagesave elektronike në Republikën e Shqipërisë, përcaktimin e llojeve të instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe raportimit të informacionit gjatë përdorimit të tyre.

ii. Rregullore “Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare (IBAN)”.

Rregullorja “Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare (IBAN)”, synon standardizimin e numrave të llogarive që përdoren për kryerjen e pagesave, me qëllim nxitjen dhe përmirësimin e sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja ka si objekt përcaktimin e strukturës së numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare për përdorim në Republikën e Shqipërisë (IBAN-i shqiptar) si dhe përcaktimin e procedurave për krijimin, kontrollin e vlefshmërisë dhe përdorimin e tij nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Projekti për zbatimin e IBAN-it në Shqipëri është planifikuar të zbatohet në dy faza:

- (1) Krijimi dhe informimi i klientëve në lidhje me numrin e llogarisë së tyre në formatin IBAN. Bankat mund të përcaktojnë vetë datën e saktë të transferimit të plotë në formatin IBAN si dhe kohëzgjatjen e procesit të transferimit, me kusht që transferimi të përfundojë brenda datës 1 qershor 2009.
- (2) Përdorimi dhe kontrolli i detyrueshëm i IBAN-it për të gjitha pagesat e dërguara/marra nga bankat. Duke filluar nga data 1 janar 2010, bankat janë të detyruara të kontrollojnë vlefshmërinë e IBAN-it të llogarisë së dërguesit/përfituesit të përfshirë në instruksionin e pagesës, në hyrje apo dalje, pavarësisht marrjes së informacionit mbi IBAN-in në formë elektronike apo letër. Duke filluar nga kjo datë, edhe sistemet shqiptare të pagesave do të bëjnë kontrollin e vlefshmërisë së llogarive të përfshira në instruksionet e pagesave dhe do të refuzojnë urdhërpagesat në fjalë, në rast pasaktësie.

iii. Dokumenti “Politika e Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes”.

Dokumenti “Politika e Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes”, synon të sqarojë objektivat e mbikëqyrjes për sistemet e pagesave dhe të shlyerjes, rolin e Bankës së Shqipërisë, fushën ku zbatohet mbikëqyrja, mënyrën se si zhvillohet procesi i mbikëqyrjes, parimet dhe standardet ku bazohet ky proces, si dhe bashkëpunimin me autoritete të tjera mbikëqyrëse. Dokumenti synon të përshkruajë përgjegjësitë themelore të bankës qendrore në mbikëqyrjen e sistemit të pagesave dhe në zbatim të këtyre përgjegjësiave, përcakton objektivat dhe aktivitetet e mbikëqyrjes bazuar në parimet dhe

standardet ndërkombëtare. Ai gjithashtu, thekson nevojën e bashkëpunimit me bankat qendrore dhe institucione të tjera mbikëqyrëse.

Përtë plotësuar më tej kuadrin ligjor të një sistemi modern pagesash, vlerësohet urgjente nevoja e hartimit të një ligji shqiptar “Për sistemin e pagesave”, draftimi i të cilit tashmë ka filluar. Angazhimi i institucioneve shtetërore si dhe bashkëpunimi me bankat tregtare, do të ndihmojnë Bankën e Shqipërisë për arritjen e këtij qëllimi, si një kusht i domosdoshëm për funksionimin e sistemit kombëtar të pagesave dhe përputhjen me direktivat e BE-së.




6.2 EMISIONI I PARASË

Monedha në qarkullim në fund të vitit 2008 arriti vlerën e 203,713,429 mijë lekëve, në krahasim me 161,161,883 mijë lekë në fund të vitit 2007. Rritja më e madhe u konstatua në tremujorin e katërt, periudhë e cila korrespondon me zhvillimet e papritura në tregun financiar ndërkombëtar dhe rezonancën e tyre edhe në tregun e brendshëm.

6.2.1 STRUKTURA E MONEDHËS NË QARKULLIM

- KARTËMONEDHA**

Struktura e kartëmonedhës në qarkullim u karakterizua nga një rritje e peshës së prerjeve të mëdha 1000 dhe 5000 Lekëshe, kryesisht e diktuar nga kërkesat e bankave të nivelit të dytë për të përballuar fluksin e pagesave në rritje dhe mbushjen e bankomateve me prerjet e lartpërmendura. Në fund të muajit dhjetor 2008 u hodh në qarkullim për herë të parë edhe kartëmonedha e re, e prerjes 2000 lekë me kurs ligjor.




• MONEDHA METALIKE


Struktura e monedhës metalike edhe këtë vit vazhdoi të orientohet nga një rritje e peshës së prerjeve të mëdha 50 dhe 100 Lek. Një nga faktorët kryesorë që ndikoi në këtë rritje ishte përdorimi i këtyre monedhave për të zëvendësuar kartëmonedhën e prerjes 100 Lek, e cila pushoi së pasuri kurs ligjor më 31.12.2008.

Grafik 3. Struktura e monedhës metalike.

Struktura e monedhës metalike 31.12.2007



Struktura e monedhës metalike 31.12.2008



Burim: Banka e Shqipërisë.

• MONEDHA METALIKE KUNDREJT KARTËMONEDHËS

Në fund të vitit 2008 raporti i përgjithshëm midis vlerës së kartëmonedhave dhe monedhave metalike rezultoi pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar. Zëvendësimi gradual i kartëmonedhës së prerjes 100 Lekë me monedha metalike dhe kërkesat për monedha metalike nga ana e tregtisë me pakicë, dhe kryesisht e supermarketeve të çelura rishtas, ishin faktorët kryesorë që raporti mbetet i pandryshuar megjithë rritjen e dukshme të kartëmonedhës.

Grafik 4. Raporti i monedhës metalike kundrejt kartëmonedhës.

Monedha metalike ndaj kartëmonedhës në qarkullim 2007



Monedha metalike ndaj kartëmonedhës në qarkullim 2008



Burim: Banka e Shqipërisë.

6.2.2 TREGUES TË QARKULLIMIT TË PARASË

VLERA MESATARE E NJË KARTËMONEDHE NË QARKULLIM

Vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim në fund të vitit 2008 arriti në 1,065 lekë, nga 1,013 lekë që ishte në fund të vitit 2007.

KOEFICIENTI I KTHIMIT TË PARASË

Koeficienti i kthimit të parasë në Bankën e Shqipërisë në vitin 2008, rezultoi 0.575 krahasuar me vlerën 0.750 për vitin 2007. Kjo tregon se, në raport me paranë në qarkullim, bankat e nivelit të dytë kanë kthyer më pak para pranë arkave të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2008, gjë e cila pasqyrohet edhe në rritjen e parasë në qarkullim.

CILËSIA E MONEDHËS NË QARKULLIM

Në zbatim të standardeve bashkëkohore dhe shtimit të shpejtë të numrit të bankomateve në bankat e nivelit të dytë edhe gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë tërhoqi nga qarkullimi rreth 19.4 milionë copë kartëmonedha të papërshtatshme për përdorim, duke i zëvendësuar ato me kartëmonedha të përshtatshme për përdorim. Rreth 40 për qind e sasisë së tërhequr përbëhet nga emisione që i përkasin periudhës para vitit 1996. Kartëmonedhat e reja të hedhura në qarkullim në vitin 2008, zënë 27.74 për qind të mesatares totale të kartëmonedhave në qarkullim.

SHTYPJA DHE RISHTYPJA E KARTËMONEDHAVE

Gjatë vitit 2008 u shtyp dhe u hodh në qarkullim për herë të parë kartëmonedha e re e prerjes 2000 Lekë, me kurs ligjor. Hedhja e saj në qarkullim plotësoi një lloj hendeku që ekzistonte midis prerjes 1000 Lekë dhe prerjes 5000 Lekë, duke lehtësuar kryerjen e veprimeve me para në dorë nga publiku. Gjithashtu, gjatë vitit 2008, u rishtyp dhe u hodh në qarkullim edhe kartëmonedha e prerjes 1000 Lekë, emetim i vitit 2007.

TËRHEQJA NGA QARKULLIMI

Më 31 dhjetor 2008, kartëmonedhat e prerjes 200 Lekë, emetime të viteve 1993, 1994, 1996 dhe të prerjes 100 Lekë, emetime të të gjitha viteve, pushuan së pasuri kurs ligjor.

6.3 MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Një rëndësi të veçantë në veprimtarinë e përditshme të Bankës së Shqipërisë zë edhe komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun, pasi ajo beson se një komunikim i hapur dhe transparent ndihmon në rritjen e besueshmërisë dhe të efektivitetit të vendimmarrjes së saj. Përtej detyrimeve ligjore dhe komunikimit zyrtar, gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë është përpjekur të zhvillojë një komunikim interaktiv dhe të drejtpërdrejtë me grupe të ndryshme të publikut shqiptar.

Gjatë vitit 2008, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe takimesh me aktorët e sistemit bankar dhe financiar,

përfaqësues të ndryshëm të medias dhe akademikë, leksione në klasat e shkollave të mesme dhe auditorët e universiteteve, aktivitete këto të cilat kanë kulmuar me organizimin e takimit rajonal në qarkun e Kukësit, që mbledhi në një tryezë të përbashkët diskutimi përfaqësuesit e sistemit bankar, të pushtetit vendor dhe akademikët e Shqipërisë dhe të Kosovës.

Komunikimi zyrtar i Bankës së Shqipërisë edhe gjatë vitit 2008, është mbështetur në shtyllat e mëposhtme institucionale:

1. Dalje në publik të Guvernatorit: fjalime, intervista, deklarata për shtyp, nëpërmjet të cilave ai ka përcjellë në publik qëndrimet e Bankës së Shqipërisë për çështje të caktuara të momentit.
2. Botime periodike të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë publikon një set të plotë raportesh mbi aktivitetet më të rëndësishme të saj si politika monetare, mbikëqyrja bankare, stabiliteti financiar, sistemet e pagesave etj.. Nëpërmjet tyre ajo përçon në publik jo vetëm rezultatet e punës së saj, por edhe procesin e vendimmarrjes si edhe dobishmërinë e tij për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë së vendit.
3. Faqja e internetit e Bankës së Shqipërisë, vazhdon të shihet nga ne si një mjet efikas për të informuar publikun rreth rolit dhe punës tonë në një kohë reale. Ajo vizitohet nga një numër gjithnjë në rritje të interesuarish.
4. Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë, një konkurs i hapur mbarëshqiptar për studentët e diplomuar, i cili synon të nxisë kërkimin shkencor në çështje që lidhen me ekonominë shqiptare dhe sistemin bankar të saj, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve kërkimore në këtë fushë.
5. Edukimi ekonomiko-financiar i publikut, një iniciativë e Bankës së Shqipërisë për të zhvilluar kulturën ekonomike të shoqërisë shqiptare me qëllim krijimin e një ambienti që merr vendime racionale ekonomike dhe vepron në përputhje me sinjalet e bankës qendrore.

Edukimi ekonomik dhe financiar i publikut është shndërruar tashmë në një filozofi institucionale e cila shprehet në veprime konkrete. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka ideuar programe edukimi gjithëpërfshirëse për nga qëllimi dhe të specifikuara për nga aplikimi me grupe të ndryshme interesi.

Gjatë vitit 2008 programi ynë edukues "Banka Qendrore në jetën e përditshme" është shtrirë, përveç Tiranës, edhe në rrethin e Vlorës. Janë zhvilluar në këto dy rrethe seminare trajnuese me mësuesit e lëndës së ekonomisë në shkollat e mesme; janë shpërndarë broshura edukative në shkolla; janë zhvilluar takime e biseda rreth bankës qendrore dhe rolit të saj në ekonomi me nxënës e mësues; janë shpërndarë pyetësorë nëpërmjet të cilëve është tërhequr opinioni i tyre rreth punës edukuese të Bankës por edhe njohurive që kanë mbi Bankën Qendrore; është krijuar stenda "Banka Qendrore në jetën e përditshme" e cila do t'u dhurohet shkollave për t'u vendosur në sallonet e tyre; është zhvilluar konkursi "Vlera e Vërtetë e Parasë" mbi njohuritë e nxënësve të gjimnazeve rreth politikës monetare të Bankës Qendrore. Gjithë këto aktivitete edukuese të zhvilluara nga Banka me

nxënës e mësues, kanë synuar kuptimin dhe zgjerimin e të kuptuarit të rolit, objektivave dhe funksioneve të Bankës së Shqipërisë nga ky grup interesi. Për arsye që lidhen me profesionin e mësuesit, por edhe me rolin e brezit të ri në të ardhmen e vendit, grupi i nxënësve e mësuesve është trajtuar me vëmendje të veçantë nga Banka. Mësuesit nëpërmjet punës së përditshme përçojnë njohuri tek nxënësit e tyre, por edhe në ambientin ku jetojnë. Nga ana tjetër, të rinjtë shumë shpejt do të jenë pjesëtarë aktivë në jetën ekonomike të vendit e si të tillë me vendimet e tyre do të luajnë rol të rëndësishëm në të.

Gjatë vitit 2008, programi i edukimit është mbështetur në tri drejtime kryesore:

- *ZGJERIMI I NUMRIT TË GRUPEVE TË INTERESIT TË PËRFSHIRA NË PROGRAMIN EDUKUES "BANKA QENDRORE NË JETËN E PËRDITSHME".*

Gjatë vitit 2008 Banka e Shqipërisë ka punuar për edukimin e publikut jo vetëm duke thelluar programin e saj edukues me grupet tashmë të përfshira në të, por edhe në drejtim të zgjerimit e përfshirjes së grupeve të tjera të interesit në këtë program. Nisur nga parimi që ne jemi të ndihmuar në realizimin e objektivave tanë, të vendosur në një ambient të miredukuar rreth financave, Banka gjatë këtij viti ka vendosur një raport bashkëpunimi edhe me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve të interesuara në fushën e edukimit. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka takuar përfaqësues të këtij grupi e ka këmbyer ide rreth këtij angazhimi të përbashkët, nën sloganin "Ka gjithmonë diçka më shumë për të mësuar rreth parasë!". Synimi ynë është që ky grup interesi të na ndihmojë si ndërmjetës për të arritur tek publiku i gjerë.

Po kështu, janë përfshirë në programin tonë edukues edhe punonjësit socialë. Nisur nga veçori të profesionit që ata kanë, të kontakteve të tyre të drejtpërdrejta me atë që ne e quajmë grupi "publiku i përgjithshëm", punonjësit socialë janë parë nga Banka si "ambasadorë" të saj.

Për këtë grup interesi është ideuar e zhvilluar një program i veçantë trainimi, nëpërmjet të cilit synohej krijimi i njohurive rreth aktivitetit të Bankës së Shqipërisë dhe rolit të saj në ekonominë e vendit, në përgjithësi dhe në jetën e përditshme të secilit, në veçanti.

Në përfundim, pothuaj të gjithë pjesëmarrësit në këtë trainim janë regjistruar në listën e shpërndarjes së botimeve të Bankës dhe ruajnë kontakte të vazhdueshme me të.

- *GRUPI I STUDENTËVE.*

Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2008 ka vijuar të ruajë një marrëdhënie të vazhdueshme me studentët e universiteteve të ndryshme të vendit, veçanërisht ata të degës së ekonomisë.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, në periudha të ndryshme të vitit, sipas një kalendari të caktuar, mban leksione me tema të ndryshme në auditorët e

universiteteve. Këto leksione shoqërohen me organizimin e "Ditës së Bankës" për studentët. Aktiviteti ndërtohet mbi një format standard, për të gjitha fakultetet. Në ambientet e tyre ndërtohet një minipanair me botime të Bankës dhe po këtu, zhvillohen biseda të lira me grupe studentësh.

Gjithashtu, ka vazhduar shpërndarja në këto universitete e botimeve formale të Bankës (raporte periodike), artikujve të ndryshëm shkencorë që publikohen në këto botime, materialeve studimore e përmbledhjeve të temave shkencore të mbajtura në aktivitete të organizuara nga Banka, broshurave edukative e fletëpalosjeve; në një numër të konsiderueshëm. Bibliotekat e Universiteteve të vendit janë të regjistruara në listën zyrtare të Bankës për shpërndarjen e botimeve dhe i përfitojnë ato rregullisht.

Biblioteka e Bankës tonë është e hapur për studentët një herë në javë, por ajo asiston studentët edhe në ditë të tjera, sipas kërkesës së tyre dhe në përputhje me rregulloret e Bankës.

- *STENDAT E BOTIMEVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË.*

Përgjatë vitit 2008 janë vendosur stenda të botimeve edukative të Bankës në ambientet e frekuentuara prej publikut të bankave tregtare që zhvillojnë aktivitet në qytetin e Tiranës. Broshurat dhe fletëpalosjet e vendosura në to janë tërhequr në masë të madhe nga klientët e bankave. Po kështu stenda të tilla janë ekspozuar edhe në ambiente të qendrave të mëdha tregtare në Tiranë, për periudha të caktuara të vitit. Kjo ka rezultuar një mënyrë e mirë për njohjen dhe përdorimin nga publiku, të mjaft prej botimeve edukative të Bankës, dedikuar atij.

Viti 2008 ka shënuar edhe shtrirjen më të madhe territoriale të punës për edukimin. Kështu, janë përfshirë përveç Tiranës edhe rrethet e Vlorës, Kukësit, e më pas do të vazhdohet me ato të Korçës, Gjirokastrës dhe Shkodrës.

6.4 INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

6.4.1 ÇËSHTJE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Në vijim të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Komunitetin Evropian (BE) dhe Shtetet Anëtare më 12 qershor 2006, gjatë vitit 2008, vazhdoi procesi i ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga vendet anëtare. Deri në fund të vitit 2008, MSA-ja ishte ratifikuar nga 24 vende anëtare të BE-së, ndërsa pritet hyrja në fuqi e saj në fillim të vitit 2009. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti, vazhdoi zbatimi i Marrëveshjes së Ndërmjetme mbi Tregtinë dhe Çështjet e Lidhura me Tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006.

Detyrimet që rrjedhin nga MSA për Bankën e Shqipërisë lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE,

garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare për bankat dhe institucionet e tjera financiare komunitare, liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (*acquis communautaire*) në këto fusha.

Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integrimit Evropian dhe ka përcjellë pranë saj raportet mujore të progresit, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me *acquis*-in të akteve juridike të miratuara nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012, Banka e Shqipërisë vijoi punën për nismat ligjore dhe veprimtaritë zbatuese që duhet të ndërmerren nga ana e saj. Kështu, në përputhje me ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i cili hyri në fuqi në muajin qershor të vitit 2007, është rishikuar kuadri rregullator i mbikëqyrjes bankare, sidomos në fushën e drejtimit, transparencës dhe kontrollit të brendshëm të bankave.

Më 5 nëntor 2008, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit 2008 për Shqipërinë, shoqëruar edhe me Strategjinë e Zgjerimit 2008-2009 të Bashkimit Evropian. Të dy këto dokumente përshkruan progresin e bërë nga Shqipëria dhe sfidat me të cilat përballet ajo, duke skicuar njëkohësisht edhe përqasjen e Komisionit Evropian, për të udhëhequr dhe mbështetur vendin tonë në të ardhmen. Raporti analizoi progresin e arritur nga Shqipëria për periudhën 1 tetor 2007 - 30 shtator 2008 në drejtim të përmbushjes së kritereve të Kopenhagenit.

Komisioni Evropian nëpërmjet raportit evidentoi vazhdimin e konsensusit politik mbi politikat themelore ekonomike si dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend, ndërsa vlerësoi ritmet e shpejta të ekonomisë dhe besueshmërinë e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbajtjen e inflacionit brenda objektivave të vendosur.

Në të njëjtën kohë, Komisioni Evropian nënvizoi stabilitetin e sistemit financiar, i cili u mbështet nga mjedisi i favorshëm ekonomik dhe forcimi i mbikëqyrjes financiare. Gjithashtu, raporti vlerësoi edhe zhvillimet pozitive në sistemin bankar në vend, duke theksuar forcimin e mbikëqyrjes së kujdesshme bankare me qëllim ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë si dhe duke e vlerësuar kuadrin rregullator të mbikëqyrjes bankare në përafrim të vazhdueshëm me standardet më të mira ndërkombëtare.

Komisioni vlerësoi miratimin e një sërë rregulloreve në zbatim të ligjit të ri “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili hoqi dispozitat që kishin të bënin me trajtimin e ndryshëm të degëve të bankave të huaja nga bankat shqiptare, ndërsa u vlerësuan edhe projektet në sistemet e pagesave. Ai bëri gjithashtu, thirrje për forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së kujdesshme bankare si dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse rajonale.

Në raport, Komisioni theksoi edhe domosdoshmërinë e bërjes së ndryshimeve në kuadrin ligjor në lidhje me liberalizimin e lëvizjes së lirë të kapitalit në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA.

Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë rregullisht në takimet periodike të zhvilluara ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së gjatë vitit 2008, si në Takimin për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën ashtu edhe në Takimin për Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, ku Banka e Shqipërisë prezantoi zhvillimet kryesore në fushën e politikës monetare, atë të kursit të këmbimit, në sektorin e jashtëm dhe në sistemin bankar. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë është përfaqësuar edhe në Takimin XII të Komitetit të Përbashkët BE-Shqipëri, të zhvilluar në muajin dhjetor, ku është raportuar rreth zhvillimeve më të fundit ekonomike në vend.

Në datën 19 dhjetor 2008, Komisioni Evropian miratoi Programin Kombëtar për Shqipërinë nën IPA 2008 – Komponenti i Asistencës së Tranzicionit dhe Ngritja e Institucioneve. Instrumenti për Para-Anëtarësim (IPA), përbën asistencën financiare të BE-së.

Pjesë e projekteve shqiptare që do të financohen nga IPA 2008 është edhe projekti i binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me një ose dy banka qendrore anëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, i cili synon forcimin e kapaciteteve institucionale të saj, veçanërisht në fushat e mbikëqyrjes bankare, statistikave, sistemeve të pagesave dhe zbatimit të politikës monetare. Objektivi kryesor i këtij projekti është përgatitja e Bankës së Shqipërisë në rrugën e integritimit evropian, duke ndihmuar në përafrimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullativ dhe atij ligjor, si dhe në përmirësimin e praktikave aktuale sipas standardeve të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Projekti ka për qëllim të kontribuojë edhe në përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit, nëpërmjet zbatimit të efektshëm të politikës monetare si dhe sigurimit të një sistemi bankar të sigurtë, të qëndrueshëm dhe të zhvilluar mirë. Projekti është hartuar në përputhje me përparësitë e shprehura në dokumentet strategjike të BE-së dhe të Republikës së Shqipërisë si Dokumenti i Partneritetit Evropian për Shqipërinë, Dokumenti Indikativ i Planifikimit Shumëvjeçar MIPD 2007-2009 si dhe Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit 2007-2012.

Për herë të parë gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë ka përfituar asistencë teknike nga Instrumenti TAIX (Technical Assistance and Information Exchange) i Bashkimit Evropian. Ky instrument ofron asistencë teknike në fushën e përafrimit dhe zbatimit të legjislacionit komunitar për vendet që janë kandidatë ose kandidatë potenciale për anëtarësim në BE, nëpërmjet organizimit të vizitave të ekspertëve evropianë në vend, organizimit të seminareve ose takimeve të diskutimit të ndryshme, si dhe organizimit të vizitave studimore në institucionet e vendeve të BE-së.

Kështu, në vijim të aplikimeve të bëra nga Banka e Shqipërisë në fund të vitit 2007 pranë njësisë TAIX të Komisionit Evropian, gjatë vitit 2008 u zhvillua

një vizitë pune e një eksperti sloven mbi amendimet e ligjit për Bankën e Shqipërisë dhe një seminar mbi lëvizjen e lirë të kapitalit me pjesëmarrjen e personelit të Bankës së Shqipërisë, AMF-së, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Shoqatës së Bankave.

6.4.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

- *MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN)*

Republika e Shqipërisë është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar që prej muajit tetor të vitit 1991. Kuota e saj gjatë vitit 2008 mbeti e pandryshuar, në shumën prej 48.7 milionë sdr³, ashtu si edhe votat e saj (737 vota ose 0.03% e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së). Shqipëria ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën, San Marinon dhe Timorin Lindor. Kjo konstituencë ka një total prej 90.968 votash (ose rreth 4.1 për qind e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së) dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian, z. Arrigo Sadun, i cili shërben si Drejtor Ekzekutiv i konstituencës.

Në datat 14 mars dhe 11 korrik 2008, autoritetet shqiptare të përfaqësuar nga Kryeministri, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Ministri i Financave i paraqitën zyrtarisht FMN-së Letrat e Mirëkuptimit dhe Memorandumet e Politikave Ekonomike dhe Financiare.

Mbi bazën e këtyre dokumenteve si dhe të vlerësimeve të misioneve rishikuese të FMN-së, të cilat e vizituan Shqipërinë në muajt tetor-nëntor 2007 dhe prill-maj 2008, Bordi Ekzekutiv i FMN-së në datat 28 mars dhe 25 korrik 2008 kreu përkatësisht rishikimin e katërt dhe të pestë të ecursisë së Shqipërisë, lidhur me zbatimin e marrëveshjes trevjeçare PRGF/EFF, të miratuar në datën 27 janar 2006. Këto rishikime mundësuan disbursimin në total të 4.8 milionë sdr për Shqipërinë gjatë vitit 2008, duke e çuar totalin e shumës së lëvruar që nga miratimi i marrëveshjes në 14.6 milionë sdr.

Në konkluzionet e tij me rastin e përfundimit të këtyre rishikimeve, Bordi Ekzekutiv u shpreh se performanca makroekonomike e Shqipërisë ka mbetur e fortë, rritja ekonomike është optimiste, ndërsa kuadri ekzistues i politikës monetare ka qenë i përshtatshëm, duke pasqyruar kështu angazhimin e fuqishëm të autoriteteve shqiptare në ndjekjen e politikave të drejta makroekonomike.

Gjatë vitit 2008, Shqipëria u vizitua nga misioni i pestë dhe i gjashtë rishikues i FMN-së. Vizita e misionit të pestë e muajve prill-maj përveç konsultimeve për vlerësimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja trevjeçare PRGF/EFF, u përqendrua edhe në konsultimet për nenin IV të “Neneve të Marrëveshjes së FMN-së”, ndërsa misioni i gjashtë dhe i fundit rishikues i muajve tetor – nëntor u përqendrua vetëm në vlerësimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja trevjeçare PRGF/EFF.

Shqipëria gjithashtu i pagoi FMN-së gjatë vitit 2008 rreth 10.1 milionë sdr në kuadër të shlyerjeve të detyrimeve (pagesa principali, interesa, shpenzime

periodike etj.), të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e kaluara PRGF si dhe ajo ekzistuese PRGF/EFF.

Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka përfaqësuar rregullisht Republikën e Shqipërisë në vendimarrjen e Bordit të Guvernatorëve, i cili është dhe organi më i lartë i FMN-së. Një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet me FMN-në gjatë këtij viti, kanë zënë dhe mbledhjet e pranverës dhe ato vjetore të FMN-së dhe të Bankës Botërore, të organizuara përkatësisht në muajt prill dhe tetor. Në to, delegacioni i Bankës së Shqipërisë, i kryesuar nga Guvernatori, ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë FMN-së, të cilat janë përqendruar në zhvillimet më të fundit makroekonomike si dhe në çështjet që lidhen me stabilitetin monetar dhe atë financiar. Gjatë takimeve janë evidentuar marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet FMN-së dhe autoriteteve shqiptare si dhe është vlerësuar puna e bërë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të kontrollit të inflacionit dhe rritjes së besueshmërisë në publik. Përfaqësuesit e lartë të FMN-së kanë shprehur gatishmërinë për të vazhduar projektet e ndihmës teknike për Bankën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë u vizitua edhe nga misioni konsultues për hartimin e buxhetit të vitit 2009. Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2008 ka vazhduar të përfitojë nga asistenca teknike e FMN-së, në lidhje me trainimin e personelit të saj. FMN-ja ka ofruar konsulencë rreth përmirësimit të procesit të hartimit të politikës monetare, modelimit dhe parashikimeve ekonomike, zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve të mbikëqyrjes bankare etj..

- *MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE*

Shqipëria është anëtare e Grupit të Bankës Botërore që prej vitit 1991 dhe ka përfituar nga ky institucion një total fondesh prej 997.5 milionë eurosh për 67 projekte. Gjatë vitit 2008, bazuar në arritjet e larta të rritjes ekonomike, Shqipëria ka fituar statusin e vendit me të ardhura mesatare, një sinjal shumë pozitiv ky për investitorët dhe tregjet e huaja financiare për ardhmërinë ekonomike të vendit.

Edhe gjatë vitit 2008, bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Grupin e Bankës Botërore vazhdoi në kuadrin e marrëveshjes “Për administrim dhe konsulencë të investimit të rezervës valutore”, të nënshkruar në muajin shtator 2005. Kështu, Grupi i Bankës Botërore i ka ofruar asistencë teknike Bankës së Shqipërisë nëpërmjet programit RAMP (Programi Këshillues për Administrimin e Rezervës Valutore), në kuadër të Partneriteteve për Investimet Sovrane (SPI). Kjo konsulencë dhe asistencë teknike është konkretizuar nëpërmjet vizitave të ekspertëve të Thesarit të Bankës Botërore si dhe pjesëmarrjes së punonjësve të Bankës së Shqipërisë në seminare të organizuara nga Banka Botërore jashtë vendit. Bashkëpunimi teknik në kuadër të programit RAMP është përqendruar në hartimin e një baze të re rregullatore si dhe në adresimin e disa çështjeve teknike në lidhje me administrimin e rezervës valutore.

Në muajt janar – shkurt, me mbështetjen e Programit të Konvergjencës të Bankës Botërore, u zhvillua në Tiranë në dy seri, takimi i diskutimit me temë “Mbi përfaqshjen e BE-së për një kuadër më të mirë rregullator”, me qëllim

familjarizimin e personelit të Bankës së Shqipërisë me disa aplikime si të çështjeve ligjore ashtu edhe të ekonomisë në lidhje me hartimin e politikave rregullatore, organizimin e proceseve rregullatore sipas praktikave që mbizotërojnë në BE, njohjen me teknikat analitike në hartimin e politikave rregullatore etj..

Në takimet e zhvilluara nga ana e delegacionit të Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e lartë të Grupit të Bankës Botërore në kuadër të mbledhjeve të pranverës dhe vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore janë prezantuar zhvillimet makroekonomike në Shqipëri si dhe masat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik nga presionet inflacioniste. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Bankës Botërore kanë shprehur mbështetjen për hapat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë si dhe kanë ofruar asistencë në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës financiare, me theks të veçantë në zhvillimin e institucioneve të mikrofinancës dhe shoqërive të kursim-kreditit.

• MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2008 ka vijuar të mbajë kontakte të vazhdueshme me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe për sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2007, BERZH-i vlerësoi pozitivisht kuadrin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbajtjen e inflacionit brenda objektivave si dhe forcimin e mbikëqyrjes bankare nëpërmjet ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili hyri në fuqi në muajin qershor të vitit 2007 si edhe marrjes së masave për bankat me një normë të lartë të huave të këqija ose me një normë të lartë të rritjes së kredidhënies.

Në kuadër të nxitjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe BERZH-it, u zhvillua një vizitë zyrtare pranë Bankës së Shqipërisë nga një delegacion polak i përbërë nga Presidenti i Bankës Kombëtare të Polonisë dhe nga Drejtorja Përfaqësuese e grupit Shqipëri – Bullgari – Poloni në BERZH, e cila nga ana e saj ka shprehur angazhimin e BERZH për të vazhduar mbështetjen financiare dhe investimet në Shqipëri, në përputhje dhe me fushat parësore të përcaktuara në strategjinë e këtij institucioni.

Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë ka vazhduar mbajtjen e marrëdhënieve të ngushta me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) gjatë vitit 2008. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë në Mbledhjen e 78-të Vjetore të BIS-it, të zhvilluar në muajin qershor në Bazel të Zvicrës, ku në takimet e zhvilluara me përfaqësues të këtij institucioni dhe të bankave të tjera anëtare ka theksuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit teknik ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të tjera qendrore në fushat me interes të përbashkët. BIS-i ka qenë veçanërisht aktiv në ofrimin e asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë nëpërmjet seminareve dhe trainimeve të organizuara nga Instituti i Stabilitetit Financiar, i cili promovon stabilitetin financiar ndërkombëtar përmes shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes së sistemit financiar.

• *MARRËDHËNIET ME BANKAT QENDRORE DHE BASHKËPUNIMI
TEKNIK*

Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me bankat e tjera qendrore, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka zhvilluar gjatë vitit 2008 vizita zyrtare pranë Bankës së Izraelit, Bankës Kombëtare të Suedisë dhe Bankës së Kanadasë ku është takuar me homologët e tij, ndërsa ka marrë pjesë edhe në shumë konferenca dhe seminare rajonale dhe ndërkombëtare. Këto vizita dhe konferenca kanë shërbyer për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit teknik gjithnjë e në rritje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve homologe.

Për herë të parë gjatë vitit 2008, Guvernatori Fullani përfaqësoi Bankën e Shqipërisë në seminarin e pestë Euro - Mesdhetar, një forum i përvitshëm i nivelit të lartë, i cili ul në një tavolinë bisedimesh përfaqësues të Eurosistemit me bankat qendrore të Rajonit të Mesdheut, joanëtare të Eurozonës. Këtë vit seminari u përqendrua në zhvillimet ekonomike dhe financiare të kohëve të fundit që po karakterizojnë ekonominë e Zonës së Mesdheut, në strategjitë e politikave monetare dhe përshtatshmërinë e kurseve të këmbimit, si dhe në tendencat e fundit të sektorit bankar, me një vëmendje të veçantë mbi ndërlikimet që vijnë nga kriza globale financiare.

Në planin rajonal, vlen të theksohet organizimi në muajin maj nga Banka e Shqipërisë i takimit XIX të Klubit të Guvernatorëve të Detit të Zi, Azisë Qendrore dhe Ballkanit ku ndër të ftuarit e nderit ishte dhe Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane, z. Lucas Papademos. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë mori pjesë edhe në takimin XX të Klubit i cili zhvilloi punimet në muajin shtator në Sarajevë. Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë shërbeu si Zëvendëskryetare e këtij Klubi.

Po në planin rajonal gjatë vitit 2008, në vijim të nismës së Bankës së Greqisë, guvernatorët dhe kryetarët e autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të rajonit zhvilluan dy takime, në Athinë dhe Sofje. Takimet u zhvilluan në kuadrin e Memorandumit të përbashkët të Mirëkuptimit, i nënshkruar në Athinë në muajin korrik të vitit 2007, i cili synon rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare në vendet e Evropës Juglindore, si dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në rajon. Memorandumi përcakton fushat dhe termat e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes bankare, në pajtim edhe me regjimet ekzistuese mbikëqyrëse dhe rregullatore në çdo vend.

Ndërkohë, në muajin maj një delegacion i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i kryesuar nga Guvernatori z. Hashim Rexhepi zhvilloi një vizitë zyrtare në Bankën e Shqipërisë, gjatë të cilës u vlerësuan jo vetëm marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit midis dy institucioneve por u shpreh edhe gatishmëria për vazhdimin e këtij bashkëpunimi teknik.

Gjatë vitit 2008, Banka e Italisë, Banka Kombëtare e Austrisë, Banka Kombëtare e Çekisë, Banka Kombëtare e Polonisë dhe Banka Kombëtare e Suedisë kanë qenë ofrueset më të mëdha të asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet organizimit të kurseve e seminareve si dhe

organizimit të vizitave të punës të ekspertëve të huaj pranë Bankës së Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, janë intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit teknik me bankat qendrore të Bullgarisë dhe Rumanisë, si vende të anëtarësuara vitet e fundit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore. Vazhdimi i bashkëpunimit teknik afatgjatë me Bankën Kombëtare të Suedisë në fushat e hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare, operacioneve monetare dhe stabilitetit financiar përbën një tjetër zhvillim të rëndësishëm të vitit 2008.

Si në vitet e kaluara ashtu edhe gjatë vitit 2008, në funksionin e bashkërendimit të asistencës teknike përparësi ishte dhe ofrimi i ekspertizës teknike për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQRK) nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kështu, janë realizuar disa vizita pune të delegacioneve të BQRK-së pranë Bankës së Shqipërisë, të përqendruara në fusha si kontrolli i brendshëm, teknologjia e informacionit dhe sistemet e pagesave, mbikëqyrja *off-site*, burimet njerëzore, shërbimi ligjor etj..

6.5 NDRYSHIME NË LEGJISLACIONIN BANKAR GJATË VITIT 2008

Banka e Shqipërisë, si autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ndërmori nismën e hartimit dhe miratimit të ligjit nr. 9974, datë 28.07.2008 "Për kontratën e riblerjes së titujve".

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji u finalizuan përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të krijuar infrastrukturën e duhur ligjore për zhvillimin e tregut të marrëveshjeve të riblerjes ndërmjet bankave tregtare, duke kontribuar jo vetëm në rritjen e efektivitetit të transmetimit të politikës monetare, por duke krijuar njëkohësisht mundësinë e përdorimit të këtyre marrëveshjeve si instrumente fleksibël, për të siguruar dhe investuar likuiditet në tregun ndërbankar.

Ndryshim tjetër ligjor i rëndësishëm gjatë vitit 2008 ka qenë dhe miratimi i disa ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë, që kanë të bëjnë kryesisht me lehtësimin dhe shkurtimin e afateve kohore të procedurave për ekzekutimin e kolateralit të kredive.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, Banka e Shqipërisë ka hartuar, në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë për Sigurimin e Depozitave, projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave". Ky projektligj ka për qëllim kryesor përafrimin e kuadrit ligjor në lidhje me skemën e kompensimit të depozitave të siguruara si dhe të kompetencave të Agjencisë, në funksion të hapave të integritetit të vendit tonë në Bashkimin Evropian si dhe përmirësimin e kushteve ligjore për funksionimin e shëndoshë të sistemit bankar në Republikën e Shqipërisë.

• *PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATIV NË LIDHJE ME PAGESAT DHE SISTEMET E PAGESAVE*

Një nga objektivat dytësorë të Bankës së Shqipërisë është: “nxitja dhe mbështetja e sistemeve të pagesave”, dhe në funksion të përmbushjes së këtij objektiivi detyra kryesore e saj është: “nxitja e funksionimit normal të sistemeve të pagesave”.

Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2008, në bashkëpunimin me Fondin Monetar Ndërkombëtar filloi punën për hartim e projektligjit për sistemet e pagesave në Republikën e Shqipërisë, i cili është në proces diskutimi me aktorët e interesuar të fushës. Miratimi i këtij ligji është një detyrim që rrjedh nga MSA dhe Dokumenti i Partneritetit Evropian si dhe nga prioritetet afatmesme të parashikuara në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA.

Në vitet e fundit promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të sistemeve të pagesave po merr një rëndësi të veçantë duke u përcaktuar në statutet e bankave qendrore si një nga objektivat dytësorë të rëndësishëm të tyre, krahas stabilitetit financiar. Kjo për vetë faktin se dështimi në mirëfunksionimin e një sistemi pagesash (joeficient) cënon stabilitetin financiar të vendit (pengesa në kryerjen e transfertave; vështirësi në likuiditet; vendosjen në vështirësi financiare të bankave; destabilizim i sistemit financiar; destabilizim i çmimeve), çfarë mund të sjellë edhe cënim të stabilitetit të çmimeve që është objektiivi primar i një banke qendrore.

Gjithashtu në kuadrin e masave për reduktimin e parasë fizike në ekonominë shqiptare, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa masa rregullative me qëllim modernizimin e sistemeve të pagesave dhe të pagesave në Republikën e Shqipërisë.

• *POLITIKA E MBIKËQYRJES SË SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE TË SHLYERJES*

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet vendimit nr. 38, datë 11.06.2008 të Këshillit Mbikëqyrës, miratoi dokumentin “Politika e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes”, nëpërmjet të cilit përcaktohet roli i Bankës së Shqipërisë në fushën e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave; objektivat e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave; parimet dhe standardet e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes; subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë; aktivitetet që kryen Banka e Shqipërisë për të përmbushur objektivat; dhe bashkëpunimin me mbikëqyrjen bankare në tërësi.

• *INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE*

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet vendimit nr. 11, datë 06.02.2008 të Këshillit Mbikëqyrës, miratoi rregulloren “Për instrumentet e pagesave elektronike” e cila ka për objekt të saj përcaktimin e standardeve të transparencës ndaj klientit lidhur me kushtet, rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave nëpërmjet instrumenteve të pagesave elektronike në Republikën e Shqipërisë;

llojeve të instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe mënyrës së mbrojtjes dhe raportimit të informacionit gjatë përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

Rregullorja ka synuar të adoptojë standardet më të mira, në lidhje me emetimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike në përputhje me direktivat dhe rekomandimet e BE-së, si dhe praktikat më të mira të bankave qendrore.

• *PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR MBI MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARIVE FINANCIARE*

Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë, pas konstatimit të paqartësive ligjore të vërejtura gjatë zbatimit të ligjit nr. 9396, datë 12.5.2005 "Për qiranë financiare", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9630, datë 30.10.2006 "Për faktoringun", i ndryshuar, në lidhje me rregullimin e çështjes së mbikëqyrjes së veprimtarisë së qirasë financiare dhe faktoringut nga subjektet e parashikuara në këto dy ligje, propozoi ndryshimet përkatëse të cilat tashmë kanë hyrë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ndryshimet në këto dy ligje synojnë të përmirësojnë kuadrin ligjor sa i përket përfshirjes së subjekteve tregtare të krijuara me objekt të vetëm ushtrimit e veprimtarisë së qirasë financiare ose të faktoringut, nën autoritetin mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, duke evituar në këtë mënyrë një situatë ligjore që në të ardhmen mund të përbënte rrezik për stabilitetin financiar por edhe mundësi për abuzim të këtyre shoqërive për qëllime të paligjshme.

• *NDRYSHIMI I KUADRIT RREGULLATOR ME HYRJEN NË FUQI TË LIGJIT "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"*

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2008 vijoi procesin e rishikimit të kuadrit rregullator (akteve nënligjore) ekzistues në fushën e mbikëqyrjes, me qëllim përshtatjen e tij me kërkesat e ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i cili hyri në fuqi në 01.06.2007, si dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me *Acquis Communautaire* në këtë fushë, në përputhje me angazhimet e ndërmarra në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Gjatë vitit 2008, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja". Rregullorja fokuson procesin dhe sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja, si pjesë e rëndësishme e qeverisjes së përgjegjshme të bankave. Kjo parasheh kërkesat dhe rregullat për organizimin e kontrollit të brendshëm të zbatueshëm nga subjektet e kësaj rregulloreje. Ajo përfshin disa kritere bazë që synojnë promovimin e një sistemi të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm, si faktor kryesor në drejtimin dhe administrimin e bankave.

Këshilli Mbikëqyrës miratoi rregulloret "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" dhe "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja". Rregulloret janë harmonizim i kërkesave të reja të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"

lidhur me transparencën e bankave në tërësinë e produkteve dhe shërbimeve, që ofrojnë për klientelën dhe publikun në tërësi dhe forcimin e disiplinës së tregut, lidhur me rritjen e kërkesave për publikimin e informacionit mbi gjendjen financiare dhe profilin e rrezikut të bankave dhe degëve të bankave të huaja etj..

Rregullorja “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja” u hartua në mbështetje dhe zbatim të kërkesave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të kërkesave të shtyllës së tretë – Disiplina e Tregut, të Marrëveshjes së Re të Kapitalit (Basel II) të Komitetit të Baselit. Ajo parashtron kryesisht kërkesat rregullatore të autoritetit mbikëqyrës, për publikimin e informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja për publikun dhe pjesëmarrësit e tregut.

Gjithashtu u miratuan disa ndryshime në rregulloret “Për administrimin e rrezikut të kredisë”; “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja”. Këto ndryshime lidhen me administrimin e rrezikut të kredisë dhe janë plotësim në vazhdimësi i forcimit të masave të ndërmarra nga autoriteti mbikëqyrës për minimizimin e rrezikut nga kredidhënia e bankave të sistemit. Rregulloret parashikojnë kryesisht masa të veçanta për monitorimin e rrezikut nga kredidhënia në monedhë të huaj ose të indeksuar me kurs këmbimi, e cila mund të shfaqë rrezik kryesisht në rastet kur kredimarrësit gjenerojnë të ardhura në monedhë vendase.

Miratimi i rregullores “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, përcakton në mënyrë të hollësishme kushtet teknike dhe të sigurisë në zonën e sportelit dhe për administrimin e vlerave monetare, kërkesat për mbrojtjen me personel të ambienteve dhe kërkesat për transportin dhe shoqërimin e vlerave monetare fizike, bazuar në ligjin “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, si dhe përcakton disa kërkesa të reja shtesë për kushtet teknike dhe të sigurisë për zyrat e këmbimit valutor dhe subjektet financiare jobanka.

SHËNIME

¹ Vlera e PBB-së marrë nga “IMF Country Report – February 2009”.

² INSTAT – Numri i popullsisë, Janar 2008.

³ Në datën 31 dhjetor 2008 (referuar faqes zyrtare të FMN-së), kursi zyrtar i sdr-së me dollarin amerikan dhe euron ishte: 1 sdr = 1.540270 usd, 1 sdr = 1.106750 euro.

		Fq.
FJALA E GUVERNATORIT		11
KAPITULLI I. ZHVILLIMET NË EKONOMITË DHE TREGJET E HUAJA	1	15
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	2	27
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE	3	67
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	4	93
KAPITULLI V. STABILITETI FINANCIAR DHE MBIKËQYRJA BANKARE	5	107
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	6	129
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008	7	155

KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2008



KPMG Albania Sh.p.k.
"Deshmoret e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPTJ91619001D

Telephone +355 4 2274 524
+355 4 2274 534
Telefax +355 4 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
internet www.kpmg.al

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Tiranë, 11 mars 2009

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë ("Banka"), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i datës 31 dhjetor 2008, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse. Pasqyrat financiare të Bankës të datës 31 dhjetor 2007 u audituan nga një auditues tjetër, raporti i të cilit mban datën 7 mars 2008 dhe shpreh një opinion pa rezerva mbi këto pasqyra.

PËRGJEGJËSIA E DREJTIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë të paraqitura në Shënimin 2 (a) të pasqyrave financiare. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm, mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

PËRGJEGJËSIA E AUDITUESVE

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International, a Swiss cooperative.

kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomalitë materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

OPINIONI

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2008, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në Shënimin 2 (a) të pasqyrave financiare.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

KPMG Bulgaria OOD

KPMG Bulgaria OOD
37 Fridtjof Nansen Street
Sofia 1142
Bulgaria

7.2 PASQYRAT FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Tabelë 1. Bilanci më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumt janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
AKTIVET			
Aktive në monedhë të huaj			
Ari dhe metale të çmuara	5	5,265	923
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	6	6,910	7,031
Depozita në bankat e huaja	7	58,824	40,976
Investime të vlefshme për shitje	8.1	132,339	124,096
Investime të mbajtura për tregtim	8.2	10,614	8,747
Aktive të tjera në monedhë të huaj	9	1,577	752
Totali i aktiveve në monedhë të huaj		215,529	182,525
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	5	2,462	63
Kredi tranzite	10.1	69	95
Kredi ndaj qeverisë	10.2	3,000	-
Kredi ndaj bankave vendase	10.3	20,072	1,509
Investime të vlefshme për shitje	11	74,594	66,523
Letra me vlerë të qeverisë për në rezervë	12	-	5,909
Aktive të tjera vendase	13	4,547	3,503
Totali i aktiveve vendase		104,744	77,602
Totali i aktiveve		320,273	260,127
DETYRIMET			
Detyrime në monedhë të huaj			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	14	12,869	13,946
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	15	1,178	1,183
Detyrime të tjera të huaja		261	251
Totali i detyrimeve në monedhë të huaj		14,308	15,380
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	16	203,713	161,162
Detyrime ndaj bankave vendase	17	67,803	67,051
Detyrime ndaj qeverisë	18	21,096	14,313
Të ardhura për t'u shpërndarë		-	3
Detyrime të tjera vendase	19	1,480	927
Totali i detyrimeve vendase		294,092	243,456
KAPITALI I VET DHE REZERVAT			
Fondi i themelimit	20	2,500	2,500
Rezerva ligjore	21	7,515	5,181
Rezerva e rivlerësimit	22	(15,837)	(22,759)
Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme		1,947	1,755
Rezerva të tjera	23	15,748	14,614
Totali i kapitalit të vet dhe rezervat		11,873	1,291
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat		320,273	260,127

Bilanci duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 162 deri në faqen 199, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Tabelë 2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2007
			riklasifikim
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	24	6,503	6,755
Shpenzime për interesa dhe komisione	25	(607)	(337)
Totali neto nga veprimet me jorezidentë		5,896	6,418
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	26	4,972	4,633
Shpenzime për interesa dhe komisione	27	(2,751)	(2,302)
Totali neto nga veprime me rezidentë		2,221	2,331
Të ardhura operative të tjera, neto	28	1,891	30
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto	29	673	652
Humbje neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit valutor		4,670	(8,035)
Totali i të ardhurave operative		15,351	1,396
Shpenzime të tjera administrative			
Shpenzime personeli	30	(769)	(660)
Shpenzime zhvlerësimi	13	(135)	(117)
Shpenzime amortizimi	13	(84)	(69)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(375)	(420)
Totali i shpenzimeve të tjera administrative		(1,363)	(1,266)
Të ardhurat neto nga aktiviteti i Bankës		13,988	130
Transferim në rezervën e rivlerësimit		(4,670)	8,035
Fitimi bruto para shpërndarjes		9,318	8,165
Zbritje për provigjoneve të llogaritura (shënimi 19)		(20)	-
Fitimi neto para shpërndarjes		9,298	8,165
Rimarrje në të ardhura nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		38	26
Shtesë në kapital themeltar		-	(1,750)
Shtesë në rezervën ligjore		(2,334)	(1,431)
Shpërndarja e fitimit në favor të buxhetit të shtetit		(6,941)	(5,010)
Të drejta ndaj qeverisë për interesin e letrave me vlerë për mbulim humbje		(61)	-
Totali		9,298	8,165

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 162 deri në faqen 199, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Tabelë 3. Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe rezervave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Fondi i themelimit	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme	Rezerva të tjera	Fitim i pashpërndarë	Fitimi neto	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2006	750	3,750	(15,856)	2,660	8,706	-	-	10
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	130	130
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	(8,035)	-	-	-	8,035	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	1,124	-	-	-	-	1,124
Sistemim i rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme 2006 (shënimi 13)				(1,706)				(1,706)
Rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme 2007	-	-	-	827	-	-	-	827
Fonde nga qeveria për mbulim humbje të kapitalit					5,908		-	5,908
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(26)	-	26	-	-
Të tjera rivlerësime	-	-	8	-	-	-	-	8
Shpërndarja e fitimit (Shënimi 20, 21)	1,750	1,431	-	-	-	(26)	(8,165)	(5,010)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	2,500	5,181	(22,759)	1,755	14,614	-	-	1,291
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	13,988	13,988
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	4,670	-	-	-	(4,670)	-
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	2,169	-	-	-	-	2,169
Rezerva në ar dhe metale të çmuara	-	-	-	-	7,042	-	-	7,042
Rivlerësimi i aktiveve 2008 (shtypshkronja, shënimi 13)	-	-	-	230	-	-	-	230
Fonde nga qeveria për mbulim humbje të kapitalit dhe zbritje interesi nga fitimi	-	-	-	-	(5,908)	-	(61)	(5,969)
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(38)	-	38	-	-
Të tjera rivlerësime	-	-	83	-	-	-	-	83
Zbritje për provigjone nga fitimi (shënimi 19)	-	-	-	-	-	-	(20)	(20)
Shpërndarja e fitimit (shënimi 21)	-	2,334	-	-	-	(38)	(9,237)	(6,941)
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,500	7,515	(15,837)	1,947	15,748	-	-	11,873

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe rezervave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 162 deri në faqen 199, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Tabelë 5. Pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumatat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe).

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2007
Flukset e parave nga operacionet			
Fitimi neto i vitit		9,298	8,165
Zëra jomonetarë në pasqyrimin e operacioneve			
Të ardhura nga interesat (në monedhë të huaj)		(6,503)	(6,755)
Shpenzime për interesat (në monedhë të huaj)		607	337
Të ardhura nga interesat (në monedhë vendase)		(4,972)	(4,633)
Shpenzime për interesat (në monedhë vendase)		2,751	2,302
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto		(673)	(652)
(Fitimi) / Humbja nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(1,881)	114
Fitim nga kontratat <i>forward</i>		-	(41)
Amortizimi i grantit dhe ndihmës		(3)	(73)
Provizione për hua të dyshimta		18	(2)
Zhvlerësimi dhe amortizimi		219	186
Flukset e parave para lëvizjes së kapitalit punues		(1,139)	(1,052)
Ndryshime në kapitalin punues			
Ulje në depozita me Fondin Monetar Ndërkombëtar		121	831
Ulje në aktive të tjera në monedhë të huaj		238	(37)
Ulje në kreditë tranzite		26	44
(Rritja) në kredi ndaj qeverisë		(3,000)	-
(Rritje) / ulje në aktive të tjera vendase		(491)	(122)
(Ulje) në detyrimet ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar		(992)	(1,313)
(Ulje) në detyrimet ndaj institucioneve financiare		(6)	(62)
Rritje në detyrime të tjera të huaja		10	64
Rritje në detyrimet ndaj bankave vendase		756	17,657
(Ulje) / Rritje në detyrimet ndaj qeverisë		6,783	(1,631)
(Ulje) / rritje në detyrime të tjera vendase		554	(27)
Blerja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim të huaja		(17,708)	(18,185)
Shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim të huaja		16,670	18,155
Flukset e parave të gjeneruara nga operacionet		2,961	15,374
Interesa të marrë		7,003	6,857
Interesa të paguar		(2,834)	(2,364)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitete operacionale		5,991	18,815

Tabelë 6. Pasqyra e flukseve të parave (vazhdim) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 (të gjitha shumatat janë në milionë lekë, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2007
Fluksi nga investimet			
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(283)	(207)
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara		(278)	(15)
Blerja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje të huaja		(338,361)	(242,240)
Blerje e letrave me vlerë të vlefshme për shitje vendase		(180,678)	(180,212)
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë të vlefshme për shitje të huaja		337,258	230,159
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë të vlefshme për shitje vendase		177,137	185,658
(Rritje) / ulje në marrëveshjet e riblerjes		(18,496)	3,143
Rregullime për efekt kursi këmbimi		883	(136)
Fluksi neto i (përdorur) / gjeneruar nga investimet		(22,818)	(3,850)
Flukset e parave prej financimit			
Rritja në ar dhe metale të tjera të çmuara		7,042	-
Rritja / (ulja) në emetimin e parasë në qarkullim		45,500	(3,500)
Rimarrje e fondeve nga qeveria për mbulimin e humbjeve të kapitalit		(61)	-
Fitimi i shpërndarë		(6,941)	(5,010)
Fluksi neto i (përdorur) / gjeneruar nga financimet		45,540	(8,510)
Rritja në para gjatë vitit		28,713	6,455
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	31	53,169	46,714
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	31	81,882	53,169

Pasqyra e flukseve të parave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 162 deri në faqen 199, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në 11 mars 2009 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Ardian Fullani



Gubernator i Bankës

Artan Toro



Drejtor i Departamentit të Kontabilitetit dhe Financës

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2008 (TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË, NËSE NUK SHPREHET NDRYSHE)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe në zbatim të këtij ligji detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor;
- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor, si dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- të licencojë ose të revokojë këtë licencë bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
- të disponojë dhe të administrojë rezervat e saj valutore;
- të veprojë me cilësinë e bankierit, këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë; dhe
- të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës, miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 50, datë 26 janar 2001 dhe politika të tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Këto politika kontabël janë përgjithësisht në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë;

- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë;
- ari është matur me vlerë të drejtë;
- ndërtesat janë matur me vlerën e rivlerësuar.

(c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare prezantohen në LEK Shqiptar ("LEKË"), e cila është monedha funksionale e Bankës. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në LEK është rrumbullakosur në milionin më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza vijueshmërie. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në shënimin 4 jepet informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare. Ndryshimi më i rëndësishëm nga SNRF sqarohet më poshtë:

SNK 39 'Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja'

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat mbi aktivet dhe detyrimet janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të të drejtave të konstatuara, llogaritur bazuar në metodën lineare (shënimi 3.a). Kjo metodë nuk është në përputhje me SNK 39, i cili kërkon llogaritjen mbi bazën e interesit efektiv. Gjithashtu, huatë nga institucionet financiare ndërkombëtare janë njohur me kosto në vend të njohjes me vlerë të drejtë siç kërkohet nga SNK 39.

a. Njohja e interesave dhe komisioneve

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen sipas parimit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa përfshijnë interesat e fituar nga kuponat si edhe amortizimin e çdo primi apo skontoje apo çdo diference tjetër ndërmjet vlerës fillestare kontabël të instrumentit fitimprurës dhe vlerës së tij në maturim, llogaritur bazuar në metodën lineare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat mbi gjithë aktivet dhe detyrimet për tregtim konsiderohen të lindin me operacionet tregtuese të Bankës dhe prezantohen së bashku me gjithë ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve në të ardhurat nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet lindin nga shërbimet financiare të siguruara nga Banka dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që shërbimi kryhet. Shpenzime dhe të ardhura të tjera operative përfshijnë fitimet dhe humbjet që vijnë nga shitjet dhe ndryshimet në vlerën e tregut të aktiveve dhe detyrimeve financiare të vlefshme për shitje.

b. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në LEK me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Disa zëra jomonetarë të shprehur në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk rivlerësohen.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet fillimisht në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe më pas transferohet në llogarinë "Rezerva të rivlerësimit" në Kapital, siç parashikon ligji nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura nga Banka (LEK për njësi të monedhës së huaj) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor 2008 dhe 2007 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Dollari Amerikan ("USD")	87.91	82.89
Monedha Evropiane ("EURO")	123.80	121.78
Stërlina Angleze ("GBP")	127.66	166.02
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("SDR")	136.07	130.84
Jen Japonez (JPY)	0.9743	0.7401
Ari ("XAU") për 1 onz	76,042.15	69,337.49

c. Të ardhurat nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto

Të ardhurat nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto përbëhet nga fitime minus humbje që lidhen me aktivet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe përfshijnë gjithë ndryshimet e realizuara dhe të porealizuara në vlerën e drejtë, interesat dhe diferencat nga ndryshimet në kursin e këmbimit.

d. Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në të ardhura dhe shpenzime në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë mbi jetëgjatësinë e qirasë.

e. Tatimi dhe politika e Bankës për shpërndarjen e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”.

Politika e shpërndarjes së fitimit të Bankës nga aktiviteti bankar bazohet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji i gjithë fitimi i realizuar kalon në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Në bazë të nenit 64, pika (a) e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, fitimi/humbja neto si rezultat i rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të shprehura në monedha të huaja, transferohet në kapital tek një llogari rezervë “Rezerva e rivlerësimit”. Në bazë të nenit 64, pika (b), Qeveria e Republikës së Shqipërisë lëshon letra me vlerë të borxhit me norma interesi të tregut për të mbuluar vlerën negative të rezervës së rivlerësimit si rezultat i aktivitetit të Bankës.

Në përputhje me kërkesat e nenit 9 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën transferohet 25 % e fitimit neto të çdo viti, derisa shuma e rezervës arrin 500 % të fondit të themelimit (shiko politikën kontabël 3.f).

Në bazë të nenit 11 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, asnjë transferim, shpërndarje apo pagesë sipas neneve 8, 9 ose 10 të këtij ligji nuk do të bëhet nëse aktivet e Bankës janë më pak se shuma e detyrimeve dhe fondit të themelimit. Në këto kushte, bazuar në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” sipas nenit 7, Ministria e Financave duhet t’i transferojë Bankës letra me vlerë të qeverisë me interes të negociueshëm, në shumën e nevojshme për të mbuluar pamjaftueshmërinë.

f. Rezerva ligjore

Në përputhje me kërkesat e nenit 9 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën transferohet 25 % e fitimit neto të çdo viti, derisa shuma e rezervës arrin 500 % të fondit të themelimit. Pas shpërndarjes së rezervës siç kërkohet nga ligji “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka përcakton pjesën e mbetur që do t’i paguhet Buxhetit të Shtetit.

g. Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Të gjitha aktivet financiare të mbajtura deri në maturim ose aktive financiare të vlefshme për shitje njihen fillimisht me kosto në datën e pagesës. Investimet financiare të mbajtura për tregtim njihen në datën e tregtimit. Banka fillimisht i njeh kreditë dhe paradhëniet, depozitat dhe detyrimet financiare në datën e lindjes së tyre.

Një aktiv apo detyrim financiar fillimisht matet me kosto.

(ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3(h), (i), (j) and (k).

(iii) Çregjistrimi (Mosnjohja)

Banka çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të parasë që vijnë nga aktivi financiar ose kur transferon të drejtat mbi aktivin financiar për të marrë flukset e parasë të kontraktuara, në një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar. Interesat në aktivin financiar të transferuar të cilat janë krijuar apo mbajtur njihen si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar. Banka nxjerr jashtë bilancit ato kredi dhe investime në letra me vlerë të cilat vlerësohen si të pambledhshme (shiko shënimin 4).

(iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në bilanc atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të Bankës.

(v) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes. Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë rregullisht të gatshme dhe paraqesin transaksionet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Për investimet e tregtuara në tregje financiare të organizuara, vlera e drejtë përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në tregjet e kapitalit në mbylljen e biznesit në datën e bilancit. Për investimet që nuk ka një çmim të kuotuar tregu, përcaktohet një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së drejtë duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër thuajse të njëjtë.

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë bilanci Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë

zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Aktivitet financiare, me përjashtim të atyre klasifikuar si “Të mbajtura për tregtim”, vlerësohen në çdo datë bilanci nëse kanë pësuar rënie në vlerë. Aktivitet financiare pësojnë rënie në vlerë kur ka evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit financiar, janë ndikuar flukset e ardhshme të parave që pritet të merren nga investimi. Për aktivitet financiare të mbajtura me kosto, shuma e zhvlerësimit është diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar si më poshtë:

- për huatë e krijuara nga Banka - shuma e rikuperueshme e huasë së krijuar llogaritet bazuar mbi vlerësimin në fund të vitit për huatë, duke përfshirë dhe interesin e akumuluar. Në përcaktimin e shumave të rikuperueshme nga huatë për personelin, drejtuesit duhet të konsiderojnë shumë faktorë, duke përfshirë dhe historinë e pagesave të ish-punonjësve. Provigjoni për rënien në vlerë të huave raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim dhe zbritet nga kategoria përkatëse e aktiveve në bilanci. Kur vendoset që një hua nuk mund të rikuperohet më, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore janë përfunduar dhe humbja përfundimtare është përcaktuar, huaja hiqet nga librat.
- për aktivitet financiare të mbajtura deri në maturim – vlera e mbartur e aktivit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjone dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- për aktivitet financiare të vlefshme për shitje – në qoftë se rënia në vlerën e drejtë të një aktivi të disponueshëm për shitje është kaluar direkt në kapital dhe ka një evidencë objektive që aktivi mund të jetë zhvlerësuar, humbja e akumuluar që është njohur direkt në kapital do të hiqet nga kapitali dhe do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe nëse aktivi financiar nuk është çregjistruar.

(vii) Marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë

Investimet e dhëna hua nën marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë raportohen në bilanci dhe maten në përputhje me politikat kontabël të zbatueshme për aktivet me vlerë të tregtueshme dhe aktivet e vlefshme për shitje. Investimet e dhëna hua nën marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë vazhdojnë të njihen në bilancin e Bankës. Për letrat me vlerë të dhëna hua, banka merr kolateral në formë monetare ose letra me vlerë të tjera. Banka regjistron në interesa vlerën e të ardhurave nga huadhënia e letrave me vlerë.

h. Paraja dhe ekuivalentet e saj.

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, llogari

rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj. Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në bilanc.

Për përpilimin e pasqyrës së flukseve të parave, Banka përfshin dhe arin dhe metalet tjera të çmuara tek paraaja dhe ekuivalentet e saj (politika kontabël 3.I).

i. Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme.

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Banka ka kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë mbahen me vlerën e drejtë në bilancin kontabël, duke i kaluar kostot direkte të transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e "Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto". Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas regjistrimit fillestar.

j. Investime të vlefshme për shitje

Këto investime, në momentin e parë, njihen me kosto. Më pas, letrat me vlerë të vlefshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas parimit të të drejtave të konstatuara.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, kur vlera progresive e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

k. Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare joderivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhën afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me kosto dhe në vazhdim interesat prej tyre regjistrohen kur konstatohen.

l. Ari dhe metalet e tjera të çmuara

Ari dhe metalet e tjera të çmuara mbahen me vlerë tregu duke u bazuar në

çmimin e Tregut të Arit në Londër (London Bullion Market), në datën e bilancit.

m. Aktivet e qëndrueshme

(i) Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve të qëndrueshme vlerësohen me koston historike zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, përveç ndërtesave, të cilat paraqiten me shumën e rivlerësuar, që është llogaritur duke përdorur metodën e koston së zëvendësimit.

Çdo rritje nga rivlerësimi e ardhur nga rivlerësimi i ndërtesave kreditohet në llogarinë e kapitalit tek "Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara", përveç rastit kur kjo rritje anulon rënien nga vlerësimi të të njëjtit aktiv, të njohur më parë në fitim ose humbje, rast ky kur rritja nga rivlerësimi njihet direkt në fitim ose humbje deri në masën e rënies së njohur paraprakisht.

Çdo rënie në vlerën e mbetur të ndërtesave, rezultuar nga procesi i rivlerësimit njihet direkt fitim ose humbje deri në masën e balancës së njohur në rezervën e rivlerësimit, rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm i ndërtesave. Kostoja e aktivit përfshin dhe shpenzime që lidhen direkt me blerjen e tij.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një aktivi të qëndrueshëm regjistrohet me vlerën e mbartur të këtij aktivi, nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike nga ky aktiv do të jenë për Bankën dhe që kosto e zëvendësimit të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar regjistrohet nga bilanci. Kostot e mirëmbajtjes ditore të aktiveve të qëndrueshme njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Zhvlerësimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur norma specifike për çdo aktiv, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të tij. Toka nuk zhvlerësohet.

Vlerësimi i jetës së dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasimore është si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|-------------|
| • Ndërtesa, Zyra Qendrore | 40 vjet |
| • Ndërtesa, degët | 25 vjet |
| • Aktive transporti | 5 - 10 vjet |
| • Pajisje zyre | 3 - 20 vjet |

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

n. Aktivet e patrupëzuara

(i) Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë

Kostot e shtypjes së kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

(ii) Programet kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 2 vjet.

o. Rënia në vlerë e aktiveve jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie të saj. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e këtij aktivi.

Humbja nga rënia e vlerës njihet kur vlera e mbetur e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës nga përdorimi i aktivitetit dhe vlerës së tregut zvogëluar me kostot e shitjes. Për llogaritjen e vlerës nga përdorimi, aktualizohen flukset e ardhshme të parasë nga përdorimi i këtij aktivi, me një normë interesi e cila reflekton vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të lidhura me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka patur ndonjë ndryshim në vlerësimin e përdorur për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë rimerret vetëm për pjesën që vlera aktuale e mbetur të mos e tejkalojë vlerën e mbetur neto nga amortizimi apo zhvlerësimi, nëse kjo humbje nuk do të ishte njohur më parë.

p. Grantet

Grantet fillimisht regjistrohen si të ardhura të shtyra kur ekziston siguria

se ato do të përfitohen dhe Banka do të veprojë në përputhje me kushtet e këtij granti. Grantet që lidhen me zëra shpenzimi kalojnë tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës që është bërë shpenzimi. Grantet që lidhen me blerjen e aktiveve kalojnë tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së aktivit përkatës në shumën që i përket zhvlerësimit ose amortizimit që i zbritet aktivitetit.

q. Huatë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Huatë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar shprehen në SDR (Special Drawings Rights).

r. Marrëveshjet e riblerjes

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në marrëveshje për të riblerë këtë aktiv, me një çmim fiks në një datë të caktuar ('REPO'), marrëveshja regjistrohet si depozitë dhe aktivi vazhdon të jetë i regjistruar në pasqyrat financiare të Bankës.

Marrëveshjet e riblerjes fillimisht maten me kosto. Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Bazuar mbi rregulloren e Bankës mbi marrëveshjet e riblerjes, Bankës nuk i kërkohet të vendosë garanci për këto letra me vlerë.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i pësuar mbi marrëveshjet e riblerjes njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

s. Provigjone

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi.

t. Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Kontributet e Bankës ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

(ii) Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës regjistrohen atëherë kur Banka në mënyrë të dukshme ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension, ose të ofrojë përfitime për të paguar në rastin e largimit vullnetar të punonjësve. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që do të pranohet, dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

(iii) Përfitime afatshkurtra.

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi. Një provigjon mund të regjistrohet për shumën që pritët të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para, nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

u. Informacioni krahasues

Kur është e nevojshme, shifrat e periudhave të mëparshme riklasifikohen për qëllime krahasimi. Më 31 dhjetor 2007, Banka ka përfshirë në interesin dhe komisionet dhe të ardhura operative të tjera, neto, një shumë neto prej 652 milionë lekësh, që lidhet me të ardhurat neto nga letrat me vlerë të tregtueshme. Kjo shumë u prezantua si e ardhur neto nga letrat me vlerë të tregtueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008. Gjithashtu, disa shuma që përfshiheshin tek 'Fluksi neto i përdorur nga financimet', e që nuk lidheshin me flukse fizike të parasë u riklasifikuan në zëra jomonetarë në 'Fluksi neto nga operacionet'.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMIT DHE GJYKIMEVE

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 36)

Burimet kryesore të pasigurisë në matje Fonde të lejuara për humbje nga kreditë

Aktivet e regjistruara me kosto vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(g)(vi).

Përbërësit specifikë të kundërpartisë për totalin e provigjoneve për rënie në vlerë aplikohen ndaj aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, dhe bazohen në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme miratohet në mënyrë të pavarur.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu kërkon përdorimin e një metode vlerësuese. Për instrumentet financiare të cilat nuk tregtohen në mënyrë sistematike, dhe që transparenca në çmim është e vogël, vendosja e vlerës së drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi të cilat variojnë në bazë të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe rreziqeve të tjera të cilat kanë një ndikim në instrumentin financiar. Gjithashtu referohuni “Vlerësimi të Instrumenteve Financiare” më poshtë.

Gjykime në përdorimin e politikave kontabël

Gjykime në përdorimin e politikave kontabël përfshijnë:

Shtypshkronja

Më 31 dhjetor 2007 Banka ka kontrolluar veprimtarinë e Shtypshkronjës, një entitet biznesi i përfshirë në shtypjen e materialeve të sigurisë së lartë të Qeverisë dhe publikimeve të Bankës së Shqipërisë. Banka nuk i ka konsoliduar pasqyrat financiare të shtypshkronjës për shkak të statusit të paqartë të pronësisë me Qeverinë Shqiptare.

Shtypshkronja ka ushtruar veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare deri në datën 30 shtator 2008 në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 5 shtator 2007 “Për mbylljen e veprimtarisë ekonomike-financiare të Shtypshkronjës”, ndryshuar me vendimin nr. 862, datë 18 qershor 2008. (shënimi 32.)

Vlerësimi i instrumenteve financiare

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare aktive, vlera e drejtë përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në treg ose atyre të kuotuar nga tregtues të instrumenteve. Për të gjitha instrumentet financiare Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto, flukset e skontuara të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekziston një vlerë tregu dhe metoda të tjera. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në një përcaktim të vlerës së drejtë e cila reflekton çmimin e instrumentit financiar që do të ishte përcaktuar nga tregu në datën e bilancit.

Banka përdor metoda gjerësisht të njohura të vlerësimit për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve të thjeshta financiare, që përdorin vetëm të dhëna të publikuara tregu dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Çmime të publikuara janë të disponueshme në bursa për ato letra me vlerë të cilat janë të listuara. Disponibiliteti i vlerës së publikuar redukton nevojën për gjykim dhe vlerësim nga drejtimi i Bankës, dhe redukton pasigurinë e shoqëruar me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponibiliteti i çmimeve të publikuara në bursë

dhe faktorëve të marrë në llogaritje, varion sipas produkteve dhe tregjeve, dhe ndikohet prej ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Për instrumente më komplekse, Banka përdor modele vlerësimi të sajat, të cilat janë të zhvilluara nga modele vlerësimi të njohura gjerësisht. Përbërësit e këtyre modeleve mund të mos jenë të publikuar në treg, dhe përcaktohen duke iu referuar çmimeve e normave të tregut ose bazohen në vlerësime e supozime. Modelet e vlerësimit që përfshijnë një numër të konsiderueshëm përbërësish që nuk gjenden në treg, kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi. Të tilla gjykime dhe vlerësime kërkojnë nga drejtimi për të përcaktuar modelin e vlerësimit, flukset e ardhshme të parasë nga instrumentet financiare të cilat po vlerësohen, mundësinë e aftësisë apo paaftësisë paguese të palëve të treta, dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme të skontimit.

5. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Ari depozitë në bankat e huaja	5,265	923
Ar dhe metale të çmuara në kasafortë	2,462	63
Totali	7,727	986

Më 31 dhjetor 2008, vlera e arit të vendosur në depozita dhe llogari rrjedhëse në bankat e huaja, ishte 5,265 milionë lekë (2007: 923 milionë lekë).

Ari dhe metale të tjera të çmuara të përfshira në aktive vendase përfshin gjendjet e arit jomonetar, platinit dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuara me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 2,462 milionë lekësh (2007: 63 milionë lekë).

Diferenca negative prej 301 milionë lekësh (2007: pozitive prej 126 milionë lekë), rezulton nga rivlerësimi i arit i regjistruar në rezervën e rivlerësimit.

Rritja e sasisë në ar dhe metale të çmuara u bë në bazë të ligjit nr. 9862, datë 24 janar 2008 "Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi sasinë e arit dhe të metaleve të tjera të çmuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë në Bankën e Shqipërisë". Ligji pas dekretimit është botuar në Fletoren Zyrtare nr.10, datë 13 shkurt 2008 dhe ka hyrë në fuqi me 27 shkurt 2008. Vlera e këtij ari të kaluar në rezervë në datën 27 shkurt 2008, bazuar në kursin e këmbimit fiks në Londër ishte 7,042 milionë lekë (shënimi 23).

6. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)	6,269	6,868
Të drejtat speciale të tërheqjes ("SDR")	639	160
Interes i përlogaritur	2	3
Totali	6,910	7,031

Kuotat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar ("FMN") rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë pranë FMN-së, në përputhje me ligjin nr. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Këto depozita kanë si kundërparti huatë e dhëna nga FMN për Republikën e Shqipërisë siç paraqitet në shënimin 14.

Të drejtat speciale të tërheqjes ("SDR") përfaqësojnë depozitat e vendosura pranë FMN-së. Këto depozita kanë një interes të përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 dhjetor 2008 ishte 0.82% p.a. (2007: 3.5% p.a.).

7. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Llogari rrjedhëse	53,509	9,472
Depozita afatshkurtra	5,292	31,369
Interes i përlogaritur	23	135
Totali	58,824	40,976

Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja kanë norma interesi që bazohen në monedhën e depozitës apo llogarisë rrjedhëse. Depozita afatshkurtër njëditore është me normë interesi 0.01%.

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË NË MONEDHË TË HUAJ

8.1. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje paraqitur në vlerë tregu është si më poshtë:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Nota thesari të qeverive të huaja	75,473	89,821
Investime afatmesme të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS)	39,011	26,448
Investime me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS)	8,723	6,432
Bono thesari të agjencive	5,269	-
Nota thesari të agjencive	3,863	1,395
Totali	132,339	124,096

Notat e thesarit të qeverive të huaja kanë kurse kuponash që variojnë nga 0.875% në 9% (2007: 2.05% në 9%). Interesi paguhet në baza gjashtëmujore (Usd dhe Gbp) dhe vjetore (Euro) si dhe maturimet variojnë nga prill i vitit 2009 në qershor të vitit 2021. Norma e brendshme e kthimit varion nga 0.74% në 5.81% (2007: 2.95% në 5.8%).

Investimet afatmesme të BIS përbëhen nga letra me vlerë me kupona fikse, të përcaktuara në Usd, Euro dhe Gbp me kurse që variojnë nga 2.5% në 5.85% (2007: 2.5% në 4.7%). Interesi është i pagueshëm në baza vjetore për investimet në Euro dhe gjashtëmujore për investimet në Usd dhe në Gbp

dhe maturimet variojnë midis marsit 2009 dhe marsit të vitit 2014. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.84% në 5.88% (2007: 3.3% në 5.95%).

Investimet me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS) janë të shprehura në Euro dhe Jpy me normë të brendshme kthimi që varion nga 0.11% në 4.51% (2007: 0.32% në 4.39%) dhe me kufij maturiteti nga shkurt 2009 në qershor 2009.

Notat e agjencive janë të shprehura në Usd me kurse kuponi nga 2.75% në 4.75% (2007: 3.25% në 7.12%). Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë nga dhjetor 2009 deri në dhjetor 2010. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.11% në 3.26% (2007: 4.24% në 5.2%).

Bono thesari të agjencive janë të shprehura në Usd me normë të brendshme kthimi që variojnë nga 1.93% në 3.01% dhe me kufij maturiteti nga mars 2009 në korrik 2009.

8.2. INVESTIME TË MBAJTURA PËR TREGTIM

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj, klasifikuar si “Të mbajtura për tregtim” paraqitet me vlerë tregu si më poshtë:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Nota thesari të qeverisë	5,667	5,818
Nota thesari të agjencive	4,752	2,929
Bono thesari të qeverisë	195	-
Totali	10,614	8,747

Notat e qeverisë të shprehura në Usd, kanë kurse kuponi fiks, që variojnë ndërmjet 1.125% dhe 7.5% (2007: 3.37% dhe 6%). Interesi është i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe maturiteti varion ndërmjet nëntorit 2009 dhe nëntorit 2017.

Notat e agjencive të shprehura në Usd, kanë kurse kuponi fiks, që variojnë ndërmjet 2.25% dhe 5% (2007: 4.12% dhe 5.37%) dhe kurse të ndryshueshme që variojnë ndërmjet 0.56% dhe 4.59% (2007: nuk ka pasur investime me kurse të ndryshueshme). Interesi është i pagueshëm në baza të ndryshme që variojnë nga mujore në vjetore dhe maturiteti varion ndërmjet shtator 2009 dhe shkurt 2012.

Bonot e thesarit të qeverisë të shprehura në Usd, me kupon zero, maturohen ndërmjet nëntor 2009 dhe dhjetor 2009.

Duke filluar nga data 25 korrik 2006, ky portofol administrohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në kuadrin e marrëveshjes së Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore “Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë” (Program Manaxhimi për Rezervë dhe Këshillim) e lidhur me datë 23 shtator

2005. Investimet në këtë portofol njihen në pasqyrat financiare në datën e tregtimit.

9. AKTIVE TË TJERA NË MONEDHË TË HUAJ

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare		
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)	355	353
Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA)	12	12
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)	6	6
Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)	65	61
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	52	48
Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)	20	19
Totali i kuotizacioneve	510	498
Arka në valutë	1,067	4
Të drejta ndaj IBRD	-	250
Totali i aktiveve të tjera në monedhë të huaj	1,577	752

Më 31 dhjetor 2008, aktive të tjera në monedhë të huaj përbëhen nga kuotizacionet për pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare financiare prej 510 milionë lekësh (2007: 498 milionë lekë) (shënimi 33), si dhe nga arka në valutë me një vlerë prej 1,067 milionë lekësh (2007: 4 milionë lekë).

Të drejta ndaj IBRD përfaqëson shumën për t'u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë nga aktiviteti i administruar nga IBRD, gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes së transaksionit (shiko shënimin 8.2).

10. KREDI PËR PALËT E TRETA

10.1. KREDI TRANZITE

Totali prej 69 milionë lekësh (2007: 95 milionë lekë) përfaqëson kredi për sektorin e shërbimeve, akorduar Bankës Italo-Shqiptare (sot Intesa SanPaolo Bank) për t'u shpërndarë huamarrësve me qëllim mbështetjen e programeve qeveritare. Për këtë hua nuk është vendosur kolateral.

10.2 KREDI NDAJ QEVERISË

Kredia ndaj qeverisë prej 3,000 milionë lekësh është kredi afatshkurtër me interes 7.44% në vit, e cila maturohet më datë 2 shkurt 2009.

10.3 KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

Kredia ndaj bankave vendase përfaqëson marrëveshje të anasjellta riblerjeje

të vendosura midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë në vlerën 20,072 milionë lekë me afat maturimi njëjavor dhe tremujor (2007: 1,509 milionë lekë me afat maturimi njëjavor). Në 31 dhjetor 2008, normat e interesit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes variojnë nga 6.25% në 7.65% (2007: 6.25%).

11. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Bono thesari afatshkurtër të Qeverisë Shqiptare	74,594	66,523
Totali	74,594	66,523

Më 31 dhjetor 2008, bonot e thesarit afatshkurtra përfaqësojnë bono thesari të qeverisë me kupon zero, me afat maturimi afatshkurtër, të cilat maturohen në periudhën janar - dhjetor 2009. Norma e tyre e kthimit në blerje varion nga 6.05% në 8.65% (2007: 6% në 7.94%).

12. LETRA ME VLERË TË QEVERISË SHQIPTARE PËR NË REZERVË

Në datë 31 dhjetor 2007 Ministria e Financave ka emetuar një letër me vlerë me çmim prej 5,909 milionë lekësh (vlerë nominale 6,000 milion lekë), e cila mbart interes të barabartë me normat e interesit të bonove të thesarit të tremujorit të fundit me datë maturimi 27 mars 2008 dhe me "call option" të kushtëzuar me transferimin e arit nga Qeveria Shqiptare.

Ministria e Financave i ka transferuar Bankës letrat me vlerë të sipërpërmendura pasi më 31 dhjetor 2007 totali i kapitalit të paguar dhe detyrimeve të Bankës tejkaloi totalin e aktiveve në shumën 7,118 milionë lekë. Letrat me vlerë janë emetuar në bazë të nenit 7, të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997, me qëllim mbulimin e deficitit të përmendur më lart. Ministria, me transferimin e pronësisë së arit nga Qeveria Shqiptare tek Banka e Shqipërisë me datë 27 shkurt 2008, fitoi të drejtën e tërheqjes së letrës me vlerë.

13. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto	2,645	2,263
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto	305	111
Kredi punonjësve	1,167	1,037
Debitorë të tjerë	333	3
Numizmatika	38	40
Inventari	48	38
Të tjera	11	11
Totali	4,547	3,503

Në 31 dhjetor 2008 Banka ka përfshirë në kategorinë “Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme”, vlerën e ndërtesës së shtypshkronjës. Metoda e rivlerësimit është ajo e kostos së zëvendësimit, që rezultoi në shumën prej 234 milionë lekësh, nga vlera neto kontabël e ndërtesës prej 4 milionë lekësh. Efekti në rritje nga rivlerësimi i ndërtesës në shumën prej 230 milionë lekësh u kreditua direkt në llogarinë e Rezervës së Rivlerësimit në kapital. Gjithashtu, në këtë kategori është përfshirë dhe vlera e ndërtesave të degëve prej 176 milionë lekësh, rindërtuar gjatë vitit 2008.

Në 31 dhjetor 2007 Banka ngarkoi një vlerësues të pavarur për të rivlerësuar ndërtesat e saj të përfshira në kategorinë ‘Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme’. Rivlerësimi është kryer me metodën e kostos së zëvendësimit me një shumë të rivlerësuar prej 1,938 milionë lekësh, nga një vlerë kontabël neto e kategorisë së ndërtesave prej 1,179 milionë lekësh. Rritja në rivlerësim prej 826 milionë lekësh është kredituar direkt në rezervën e rivlerësimit në kapitalin e vet, me një rënie në rivlerësim prej 69 milionë lekësh e përfshirë tek ‘Shpenzime të përgjithshme të Bankës’.

Në 26 dhjetor 2006 nga një vlerësues i pavarur, u krye një rivlerësim i ndërtesës kryesore të Bankës bazuar në kapitalizimin e të ardhurave nga qiraja dhe çmimi i shitjes për qendra të reja biznesi në afërsi të ndërtesës, që solli një rezervë rivlerësimi prej 1,706 milionë lekësh. Ndërtesat e Bankës janë rivlerësuar në vitin 2007 duke përdorur metodën e kostos së zëvendësimit bazuar në kërkesat e SNK 16 për Aktivet e Qëndrueshme. Korrigjimi i vlerës së mëparshme u regjistrua në pasqyrat financiare të Bankës në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2007.

Në 31 dhjetor 2008 kreditë e punonjësve përfshijnë provigjone për çështje gjyqësore që lidhen me to, në masën 10 milionë lekë (2007: 10 milionë lekë).

Në 31 dhjetor 2008, vlera e regjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës arrin në shumën 1,352 milionë lekë (2007: 1,218 milionë lekë).

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për çdo kategori më 31 dhjetor 2008 paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Aktive transporti	Ndërtime në proces	Totali
Kosto/Vlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2008	1,942	778	241	48	3,009
Shtesa	264	77	12	164	517
Transferime	176	-	-	(176)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,382	855	253	36	3,526
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2008	-	576	170	-	746
Amortizimi i vitit	45	74	16	-	135
Gjendja më 31 dhjetor 2008	45	650	186	-	881
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,337	205	67	36	2,645
Gjendja më 31 dhjetor 2007	1,942	202	71	48	2,263

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për çdo kategori me 31 dhjetor 2007 paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa konstruksiione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Aktive transporti	Ndërtime në proces	Totali
Kosto/Vlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2007	2,964	710	200	33	3,907
Shtesa	6	121	41	39	207
Pakësime	-	(53)	-	-	(53)
Transferime	24	-	-	(24)	-
Sistemim i rivlerësimit të ndërtesës 2006	(1,706)	-	-	-	(1,706)
Sistemim i eliminimit të rivlerësimit 2006	189	-	-	-	189
Rivlerësimi i ndërtesave të Bankës	758	-	-	-	758
Eliminim në rivlerësim	(293)	-	-	-	(293)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	1,942	778	241	48	3,009
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2007	69	560	155	-	784
Amortizimi i vitit	35	67	15	-	117
Pakësime	-	(51)	-	-	(51)
Sistemim i eliminimit të rivlerësimit 2006	189	-	-	-	189
Eliminim në rivlerësim	(293)	-	-	-	(293)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	-	576	170	-	746
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2007	1,942	202	71	48	2,263
Gjendja më 31 dhjetor 2006	2,895	150	45	33	3,123

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Kartëmonedha të prera dhe monedha të shtypura	Totali i aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2008	353	2,453	2,806
Shtesa	24	254	278
Pakësime			
Gjendja më 31 dhjetor 2008	377	2,707	3,084
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2008	338	2,357	2,695
Amortizimi i vitit	14	70	84
Gjendja më 31 dhjetor 2008	352	2,427	2,779
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2008	25	280	305
Më 31 dhjetor 2007	15	96	111

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara për çdo kategori me 31 dhjetor 2007 paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Kartëmonedha të prera dhe monedha të shtypura	Totali i aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2007	338	2,454	2,792
Shtesa	15	-	15
Pakësime	-	(1)	(1)
Gjendja më 31 dhjetor 2007	353	2,453	2,806
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2007	314	2,312	2,626
Amortizimi i vitit	24	45	69
Gjendja më 31 dhjetor 2007	338	2,357	2,695
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2007	15	96	111
Më 31 dhjetor 2006	24	142	166

14. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit ('PRGF')	6,116	6,821
Llogaria e letrave me vlerë tek FMN	4,871	5,042
Llogari e FMN-së në lekë	1,878	2,077
Interes i përllogaritur	4	6
Totali	12,869	13,946

Huatë PRGF janë të lidhura me kuotizacionet për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të Qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përfshijnë programet e mëposhtme:

"Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 2" u miratua me marrëveshjen e datës 13 maj 1998 në shumën 45,040,000 sdr, duke u disbursuar nga viti 1999 deri në vitin 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2008 është 11,241,400 sdr (2007: 19,660,900 sdr), dhe është ekuivalente e 1,530 milionë lekë (2007: 2,573 milionë lekë). Kjo është një hua me maturitet të kthyeshme deri në vitin 2011, në 10 kështe gjashtëmujore duke filluar nga viti 2004. Norma e interesit është 0.5% dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.

"Huaja e Uljes së varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 3" u miratua me marrëveshjen e datës 21 qershor 2002 në shumën 28,000,000 sdr dhe është disbursuar deri më 20 qershor 2005. Gjendja në fund të vitit 2008 është 26,400,000 sdr (2007: 27,600,000 sdr) dhe është ekuivalente e 3,592 milionë lekëve (2007: 3,611 milionë lekë), me një interes prej 0.5% i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, me 10 kështe të barabarta.

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit” (PRGF 4) dhe “Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm” (EEF) u miratuan me marrëveshjen trevjeçare të datës 27 janar 2006 në shumën 17,045,000 sdr. Disbursimi i dy transheve të treta të PRGF 4 prej 1,217,500 sdr secili, u bë në vitin 2008, me një interes prej 0.5 % i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Gjendja më 31 dhjetor 2008 është 7,305,000 sdr (2007: 4,870,000 sdr) dhe është ekuivalente e 994 milionë lekëve (2007: 637 milionë lekë). Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, në dhjetë këste gjashtëmujore të barabarta.

E përfshirë në llogaritë e FMN-së është dhe huaja “Lehtësia e Financimit Afatmesëm” (EFF) e disbursuar prej 7,305,000 sdr gjatë viteve 2006-2008 është ekuivalente e 936 milionë lekëve. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas katër vjet e gjysmë, brenda 10 vjetëve. Interesi i këtyre kredive është i ndryshueshëm dhe paguhet çdo tre muaj. Më 31 dhjetor 2008 interesi ishte 1.84 për qind (2007: 4.77 %).

15. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JO VENDASE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Detyrime tranzite (Shënimi 10.1)	69	95
Hua e Republikës së Greqisë	1,090	1,072
Detyrime ndaj Bankës Botërore	14	12
Interes i përlogaritur	5	4
Totali	1,178	1,183

Detyrime tranzite prej 69 milionë lekësh përfaqëson huanë e dhënë nga Banka Evropiane e Investimeve dhe përbëhet nga huaja prej 0.5 milionë eurosh (shënimi 8.1). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek siguruesit e financimit.

Huaja e Republikës Greke prej 8.8 milionë eurosh është dhënë me qëllim financimin e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind, e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

Detyrimi ndaj Bankës Botërore përbëhet nga llogaritë e organizatave ndërkombëtare pranë Bankës së Shqipërisë, si Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA) dhe Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

16. PARA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2008 dhe 2007 gjendja e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë:

Vlera Nominale lekë	31 dhjetor 2008		31 dhjetor 2007	
	Copë (në mijë)	Totali lekë (milionë)	Copë (në mijë)	Totali lekë (milionë)
100	4,121	412	5,906	591
200	16,022	3,204	13,183	2,637
500	61,830	30,915	52,883	26,441
1,000	84,030	84,030	69,202	69,202
2,000	502	1,004	-	-
5,000	16,349	81,744	12,074	60,368
Monedha		2,404		1,923
		203,713		161,162

17. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Në monedha të huaja		
Rezerva e detyrueshme	26,583	23,848
Llogari të bankave të nivelit të dytë	77	1,964
	26,660	25,812
Në monedhë vendase		
Rezerva e detyrueshme	34,316	32,837
Llogari të bankave të nivelit të dytë	1,668	3,148
Depozita njëditore	5,120	5,211
	41,104	41,196
Interes i përlogaritur	39	43
Totali	67,803	67,051

Interesi mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- gjendjet në lekë: 70% e normës së fitimit të marrëveshjeve të riblerjes: 4.375 % më 31 dhjetor 2008 (70% e normës së marrëveshjeve të riblerjes: 4.375% më 31 dhjetor 2007);
- gjendjet në usd: 70% e normës bazë të Bankës Federale: 0.7% më 31 dhjetor 2008 (70% e normës së usd libor njëmuore: 3.40% më 31 dhjetor 2007);
- gjendjet në euro: 70% e normës bazë të Bankës Qendrore Evropiane: 2.28% më 31 dhjetor 2008 (70% e normës së euros libor njëmuore: 3.11% më 31 dhjetor 2007).

Depozitat njëditore kanë normë interesi prej 4.5% (2007: 4.5%).

18. DETYRIME NDAJ QEVERISË

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Fitim për t'iu shpërndarë Qeverisë	1,741	-
Depozita në emër të Qeverisë	19,335	14,280
Të tjera	20	33
Totali	21,096	14,313

Depozita në emër të qeverisë prej 19,335 milionë lekësh, përfshin llogarinë kryesore prej 6,408 milionë lekësh, fonde të donatorëve ndërkombëtarë të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri prej 2,029 milionë lekësh, fonde rezervë të qeverisë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) prej 2,503 milionë lekësh, si dhe fonde të tjera me destinacion për financime prej 8,395 milionë lekësh.

Zëri "Të tjera" përmban fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit prej 20 milionë lekësh (2007: 19 milionë lekë).

19. DETYRIME TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Detyrimi ndaj Shtypshkronjës	-	215
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	891	586
Detyrimi neto ndaj fondit të pensionit	-	6
Detyrim ndaj institucioneve financiare jobankare	206	16
Marrëdhënie me të tretët	239	-
Të tjera	143	104
Totali	1,480	927

Skema e fondit të pensionit përbëhet nga kontributi i punonjësve në vlerën 2 % të pagës së tyre bruto si dhe kontributi i punëdhënësit 15 % mbi totalin e pagave. Në 31 dhjetor 2008, vlera e aktiveve të fondit të pensionit e investuar në letra me vlerë të qeverisë me afat maturimi 12-mujor është 272 milionë lekë (2007: 391 milionë lekë) dhe në obligacionet e Qeverisë me afat maturimi 5-7 vjeçar është 302 milionë lekë (2007: 69 milionë lekë).

Vlera e akumuluar e kontributeve të derdhura nga punonjësit e sigurur në fond deri në 31 dhjetor 2008 është 43 milionë lekë (31 dhjetor 2007: 35 milionë lekë), ndërkohë që totali i kontributeve të derdhura nga Banka në Fond që nga krijimi i Fondit deri në 31 dhjetor 2008 është në vlerën 359 milionë lekë (31 dhjetor 2007: 302 milionë lekë). Pasqyra e ndryshimit të kontributeve dhe aktiveve neto të vlefshme për përfitim fond pensioni është si më poshtë:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Aktive në 1 janar	466	372
Të ardhura nga investimi (humbje)		
Interesa	43	31
Të ardhura neto nga investimi	43	31
Kontributi i pjesëmarrësve	8	12
Kontributi i punëdhënësit	57	51
Totali i kontributeve	65	63
Rritja neto	108	94
Aktive më 31 dhjetor	574	466
Detyrime më 31 dhjetor	574	472
Neto në fund të vitit	-	6

Marrëdhëniet me të tretët prej 239 milionë lekësh përbëhen nga kapitali, rezervat dhe fitime të mbartura nga veprimtaria e shtypshkronjës nga data e mbylljes së saj deri në fund të vitit 2008. Marrëdhëniet me shtypshkronjën me datë 30 shtator 2008 ishin 230 milionë lekë (shënimi 32) dhe deri në fund të vitit 2008 janë transferuar aktive me vlerë 5 milionë lekë në Bankën e Shqipërisë. Janë kryer edhe 15 milionë lekë shpenzime për shtypshkronjën dhe janë shlyer 19 milionë lekë detyrime të të tretëve ndaj saj.

Në zërin “Të tjera”, përfshihen kryesisht shpenzime të llogaritura prej 75 milionë lekësh (2007: 54 milionë lekë), të cilat lidhen me mirëmbajtjen e sistemit AIPS, AECH, komisione për administrimin e rezervës valutore nga IBRD, SWIFT etj..

Në këtë zë është përfshirë edhe provigjoni i pretendimeve për disa çështje ligjore, krijuar në kushte normale biznesi. Në 31 dhjetor 2008, një provigjon prej 39 milionë lekësh (2007: 21 milionë lekë) është njohur në lidhje me këto pretendime.

Gjatë vitit 2008 lëvizjet në provigjon janë (shënimi 28):

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Gjendja në 1 janar	21	19
Provigjon shtesë për periudhën	20	8
Rimarrje gjatë periudhës	(2)	(6)
Gjendja në fund të vitit	39	21

Provigjoni shtesë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008 është njohur në kapital, si zbritje nga fitimi.

20. FONDI I THEMELIT

Në bazë të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 9852, datë 28 dhjetor 2007 dhe bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, datë 23 janar 2008 fondi i themelimit u rrit me 1,750 milionë lekë.

21. REZERVA LIGJORE

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, në fund të çdo viti financiar Banka duhet të shtojë fondin e rezervës së përgjithshme me një shumë prej 25% të fitimit neto të Bankës, deri sa të arrijë 500 % të fondit të themelimit të Bankës.

Për arsye të rritjes së fondit të themelimit më 28 dhjetor 2007, në vitin 2007 Banka nuk mundi ta rrisë rezervën ligjore në masën 25% të fitimit neto, duke transferuar në rezervën ligjore shumën prej 1,431 milionë lekësh. Në vitin 2008 Banka transferoi në rezervë 2,334 milionë lekë.

22. REZERVA E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit	(18,870)	(23,540)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	2,916	747
Rivlerësime të tjera	117	34
Totali	(15,837)	(22,759)

Gjatë vitit 2008, fitimi neto nga rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit nga luhatja e kursit të këmbimit është në një vlerë prej 4,670 milionë lekësh (gjatë vitit 2007: humbja neto 8,035 milionë lekë).

Rivlerësimi i letrave me vlerë me vlerën e tregut, gjatë vitit 2008 ka luhatje pozitive prej 2,169 milionë lekësh (2007: 1,124 milionë lekë).

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” neni 64, pika (a), fitim/humbja neto që rezulton nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve në valutë të huaj, transferohet në kapital në një llogari rivlerësimi “Rezerva të rivlerësimit nga kursi i këmbimit”.

Në vijim të po këtij neni, pika (b), gjatë vitit 2008 Ministria e Financave ka rriemtuar letra me vlerë të Qeverisë me një total prej 23,540 milionë lekësh (2007: 15,505 milionë lekë) për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave deri në fund të vitit 2007. Këto letra me vlerë kanë një maturitet të rinovueshëm prej gjashtë muajsh (shënimi 33).

Totali prej 23,540 milionë lekësh përfaqëson mbulimin e humbjeve për periudhën 2003 deri në 2007.

23. REZERVA TË TJERA

Përbërësit e rezervave të tjera janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Rezervë speciale për bilancin e pagesave	7,209	7,209
Fonde nga qeveria për mbulimin e përkohshëm të mungesës së kapitalit (shënimi 12)	-	5,908
Rezerva në ar dhe metale të çmuara (shënimi 5)	7,042	-
Fondi i investimit	301	301
Të tjera	1,196	1,196
Totali	15,748	14,614

Rezerva speciale për bilancin e pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Evropian për Shqipërinë si asistencë financiare për të mbështetur Shqipërinë në procesin e transformimit të ekonomisë në një ekonomi tregu. Këto grante i përkasin periudhës 1992 – 1993, në mbështetje të qëndrueshmërisë së bilancit të pagesave si dhe për të forcuar pozicionin e rezervave. Kjo rezervë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 1995.

Fondi i investimit përbehet nga një fond i krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës me qëllim blerjen e një godine të re për Bankën.

“Të tjera” përfshin rezerva të krijuara nga shpërndarja e fitimit gjatë viteve 2002-2007 në vitet respektive me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

24. TË ARDHURA NGA INTERESAT DHE KOMISIONET (JOREZIDENTËT)

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	4,492	5,040
Interesa nga depozitat me afat	1,587	1,145
Interesa nga depozitat në sdr me FMN	29	33
Të tjera (skonto)	395	537
Totali	6,503	6,755

25. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (JOREZIDENTËT)

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Amortizimi i primit të letrave me vlerë	499	222
Shpenzime për interesa nga huatë e institucioneve të huaja	13	13
Shpenzime për interesa nga llogaritë e FMN	64	69
Të tjera	31	33
Totali	607	337

26. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	4,571	4,362
Interesa nga huatë qeveritare	-	6
Të ardhura nga interesat e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes	351	227
Të tjera	50	38
Totali	4,972	4,633

27. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Shpenzime për interesa mbi rezervën e detyruar	2,270	1,915
Shpenzime për interesa mbi marrëveshjet e riblerjes	103	140
Shpenzime për interesa mbi depozitat e qeverisë	206	184
Të tjera	172	63
Totali	2,751	2,302

28. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
		riklasifikim
Fitim (humbje) neto nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	1,881	(114)
Amortizimi i grantit dhe ndihma (shënimi 19)	3	73
Provizione për çështje ligjore dhe të tjera (shënimi 19)	-	(8)
Të tjera	7	38
Fitim neto nga kontratat <i>forward</i>	-	41
Totali	1,891	30

29. TË ARDHURA NGA LETRAT ME VLERË TË TREGTUESHME, NETO

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
		riklasifikim
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë të tregtueshme	337	396
Fitim /(humbje) neto nga shitja e letrave me vlerë të tregtueshme	307	41
Fitim i parealizuar nga rivlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për tregtim	29	215
Totali	673	652

30. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, kontributet për sigurimet shoqërore, kontributet për planin e pensionit dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Më 31 dhjetor 2008 Banka ka patur 418 punonjës (2007: 391 punonjës).

31. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Depozita në bankat e huaja (shënimi 7)	58,801	40,841
Likuiditete në monedhë vendase	14,287	11,338
Likuiditete në monedhë të huaj (shënimi 9)	1,067	4
Ari i mbajtur jashtë vendit (shënimi 5)	5,265	923
Ari dhe metalet e tjera të çmuara në vend (shënimi 5)	2,462	63
Totali	81,882	53,169

32. SHTYPSHKRONJA

Siç është detajuar në shënimin 4, Banka ka kontrolluar aktivitetin e

Shtypshkronjës. Në zbatim të vendimit nr. 598, datë 05 shtator 2007, të Këshillit të Ministrave për “Mbylljen e veprimtarisë ekonomike-financiare të ndërmarrjes shtetërore “Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë””, ndryshuar me vendimin nr. 862, datë 18 qershor 2008, aktiviteti ekonomik dhe financiar i shtypshkronjës u mbyll më 30 shtator 2008.

Sipas pikave 7 dhe 8 të vendimit nr. 598, kapitalet e patrupëzuara dhe inventari ekonomik transferohen për llogari të Ministrisë së Financave, teknologjia dhe makineritë për shtypjen e pullave fiskale i transferohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Sipas pikës 10 të po këtij vendimi administrimi (pronësia) i ndërtesës i mbetet Bankës së Shqipërisë.

Pas mbylljes së aktivitetit, Banka ka përfshirë në “Detyrime të tjera vendase” (shënimi 19) një shumë prej 230 milionë lekësh (2007: 215 milionë lekë), e cila përfaqëson shumën e pagueshme ndaj shtypshkronjës në datën e mbylljes së saj (shiko më poshtë ‘Për t’u arkëtuar nga Banka’), plus një shumë shtesë prej 8 milionë lekësh (2007: zero) e cila përfaqëson transferime të tjera ndërmjet Bankës dhe shtypshkronjës në mbyllje të aktivitetit. Këto transferime u bazuan në vendimet e sipërpërmendura. Banka nuk ka marrë ende një vendim për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Më poshtë është paraqitur pozicioni financiar i Shtypshkronjës më datë 30 shtator 2008 (data e mbylljes) dhe 31 dhjetor 2007.

	30 shtator 2008	31 dhjetor 2007
AKTIVET		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	5	6
Inventari	45	49
Për t’u arkëtuar nga Banka (shënimi 17)	230	215
Totali i aktiveve	280	270
KAPITALI I VET		
Kapitali themeltar	51	51
Rezerva ligjore	19	19
Rezerva e investimit	24	24
Rezerva të tjera	6	6
Fitimi i mbartur	179	169
Totali i kapitalit të vet	279	269
Detyrime të tjera	1	1
Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve	280	270

	Periodha 9-mujore deri më 30 shtator 2008	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2007
Të ardhura	57	52
Shpenzime	(46)	(51)
Fitimi i vitit	11	1

33. ANGAZHIME DHE GARANCI

(i) Pjesëmarrja në institucionet financiare ndërkombëtare

Në vitet e kaluara Republika e Shqipërisë është anëtarësuar me kuotizacione

në një sërë institucionesh financiare ndërkombëtare, përfshirë këtu Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Agjencinë Ndërkombëtare të Zhvillimit, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe, Korporatën Ndërkombëtare Financiare, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankën Islamike të Zhvillimit. Shuma e këtyre kuotizacioneve të Republikës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2008 përfshin kuotizacione të paguara nga Banka në shumën prej 510 milionë lekësh (2007: 499 milionë lekë).

Për datën 31 dhjetor 2008 është konfirmuar nga IBRD, MIGA dhe EBRD shuma prej 820 milionë lekësh (2007: 793 milionë lekë), nga e cila 412 milionë lekë (2007: 409 milionë lekë) janë paguar nga Banka e Shqipërisë dhe 402 milionë lekë (2007: 379 milionë lekë) janë paguar nga Republika e Shqipërisë dhe nuk janë përfshirë në bilancin e Bankës, dhe një pjesë e kuotizacioneve në Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe prej 6 milionë lekësh (2007: 5 milionë lekë), që gjithashtu nuk janë përfshirë në bilancin e Bankës, mbështeten nga Nota Premtuese.

Në datë 31 dhjetor 2008 janë konfirmuar nga IBRD dhe MIGA 8,565 milionë lekë (2007: 8,075 milionë lekë) kuotizacione me qëllim mbështetjen e Republikës së Shqipërisë, të kërkueshme prej emetuesit. Banka e Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë janë në proces të negocimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për ndarjen e kontributit origjinal dhe pronësinë e kuotizacioneve tek institucionet financiare ndërkombëtare mes palëve.

(ii) Bono thesari të emetuara nga Ministria e Financave

Në 31 dhjetor 2008, letra me vlerë e emetuar nga Ministria e Financave për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave të krijuara në periudhën 2003-2007 rezulton të jetë 23,540 milionë lekë, me terma maturimi të rinovueshëm çdo gjashtë muaj.

34. AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 dhjetor 2008, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra me vlerë nominale 237 miliardë lekë, obligacione me afat nga 2 vjet deri 7 vjet me vlerë nominale 145 miliardë lekë. Këto instrumente financiare përfaqësojnë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Më 31 dhjetor 2008 vlera e arit dhe e metaleve të tjera të çmuara në kujdestari në emër të Qeverisë është bërë zero (2007: 6,129 milionë lekë).

35. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo formës së mirëfilltë ligjore.

Banka e Shqipërisë nuk ka palë të lidhura përveçse marrëdhënieve me drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Më 31 dhjetor 2008 dhe 2007, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përbëhen nga:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Kredi për stafin drejtues		
- Staf drejtues	132	110
Totali	132	110

Kreditë kanë norma interesash prej 0.5 % dhe janë të pagueshme në 30 vjet, duke filluar pas një periudhe prej dy vitesh, me këste të barabarta mujore. Këto kredi janë të kolateralizuara.

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2007
Shpenzime administrative		
-Shpenzime telefoni		
-Drejtorët dhe Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	5	4
-Paga dhe bonuse		
-Drejtorët dhe Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës	101	90
-Kontributi i Bankës në skemën e fondit të pensionit		
-Drejtorët dhe administratorët	8	7
Totali i shpenzimeve administrative	114	101

36. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

(a) Struktura e administrimit të rrezikut

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Rezerva valutore administrohet nga Banka e Shqipërisë dhe investimi i saj realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili bazohet në rregulloren "Mbi politikën e administrimit të rezervës valutore", të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Strategjia e saj e investimit varet kryesisht nga funksioni i veçantë i një banke qendrore, i cili rregullohet në përputhje me kërkesat e ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

Rezerva, sipas nevojave të likuiditetit, investohet në instrumente financiare afatshkurtra dhe letra me vlerë me të ardhura konstante. Pjesa tjetër e portofolit mbahet në sdr dhe në ar monetar.

Këto instrumente e ekspozojnë bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i likuiditetit,
- rreziku i kreditimit,

- rreziku i tregut,
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të mësipërme si dhe objektivat, politikat dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tij.

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e lidhura me detyrimet financiare në kohën e duhur.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit të rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Banka administron rrezikun e likuiditetit nëpërmjet investimit në depozita afatshkurtra në bankat e huaja dhe investime në letra me vlerë të borxhit në tregje likuide dhe të sigurta.

Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj. Në të njëjtën kohë ajo duhet të operojë në përputhje me politikat monetare dhe të këmbimit. Portofoli përcaktohet çdo vit bazuar në parashikimet mujore dhe vjetore të nevojave për likuiditet për çdo monedhë. Investimet në letra me vlerë të borxhit konsiderohen si instrumente me likuiditet të mjaftueshëm.

Lidhur me detyrimet në monedhë vendase, Banka nuk është e ekspozuar ndaj këtij rreziku për shkak të karakterit të saj të një banke qendrore.

Tabela e mëposhtme paraqet detyrimet financiare të Bankës në bazë të maturitetit kontraktual si dhe aktivet financiare në bazë të maturitetit të pritshëm në datën e bilancit. Flukset e pritshme të parasë mund të variojnë nga rezultatet e kësaj analize.

31 dhjetor 2008	Deri një muaj	Një deri në tre muaj	Tre muaj deri në 1 vit	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Totali
Detyrime ndaj FMN-së	361	118	281	476	4,266	7,367	12,869
Detyrime ndaj institucioneve financiare jövendase	-	-	-	-	69	1,109	1,178
Detyrime të tjera të huaja	261	-	-	-	-	-	261
Paraja në qarkullim	203,713	-	-	-	-	-	203,713
Detyrime ndaj bankave vendase	67,803	-	-	-	-	-	67,803
Detyrime ndaj Qeverisë	21,096	-	-	-	-	-	21,096
Detyrime të tjera vendase	589	-	-	891	-	-	1,480
Totali i detyrimeve 2008 (datës së maturimit kontraktual)	293,823	118	281	1,367	4,335	8,476	308,400
Totali i aktiveve 2008 (datës së maturimit të pritshëm)	113,428	36,821	41,838	33,601	83,169	11,416	320,273

31 dhjetor 2007	Deri një muaj	Një deri në tre muaj	Tre muaj deri në 1 vit	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Totali
Detyrime ndaj FMN-së	218	139	347	555	4,324	8,363	13,946
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	-	-	-	-	95	1,088	1,183
Detyrime të tjera të huaja	251	-	-	-	-	-	251
Paraja në qarkullim	161,162	-	-	-	-	-	161,162
Detyrime ndaj bankave vendase	67,051	-	-	-	-	-	67,051
Detyrime ndaj Qeverisë	14,313	-	-	-	-	-	14,313
Detyrime të tjera vendase dhe të ardhura të shtyra	930	-	-	586	-	-	930
Totali i detyrimeve 2007 (datës së maturimit kontraktual)	243,339	139	347	1,141	4,419	9,451	258,836
Totali i aktiveve 2007 (datës së maturimit të pritshëm)	68,789	39,789	29,076	15,286	96,769	10,418	260,127

(c) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i pakësimit të vlerës së rezervës valutore për shkak të paafësisë paguese ose zvogëlimit të cilësisë së kreditimeve të institucioneve financiare ose emetuesve të letrave me vlerë, dhe instrumenteve në të cilat rezerva valutore është vendosur.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit administrohet nëpërmjet përcaktimit të kufijve mbi nivelin total të ekspozimit të lejuar ndaj institucioneve financiare dhe emetuesve të ndryshëm. Kufijtë e ekspozimit llogariten bazuar në kriteret e kreditimit të kundërpartisë të cilat janë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Rreziku i kreditimit gjithashtu zvogëlohet nëpërmjet krijimit të një portofoli të larmishëm.

Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të qeverisë.

Tabela e mëposhtme tregon aktivet financiare që paraqesin rrezikun e kreditimit në datën e bilancit:

Aktivet	2008	2007
Ari në bankat e huaja (shënimi 5)	5,265	923
Të drejtat speciale të tërheqjes tek Fondi Monetar Ndërkombëtar (shënimi 6)	639	160
Depozita në bankat e huaja (shënimi 7)	58,824	40,976
Investime të vlefshme për shitje të huaja (shënimi 8.1)	132,339	124,096
Investime të mbajtura për tregtim të huaja (shënimi 8.2)	10,614	8,747
Kredi ndaj Qeverisë (shënimi 10.2)	3,000	-
Kredi ndaj bankave vendase (shënimi 10.3)	20,072	1,509
Investime të vlefshme për shitje vendase (shënimi 11)	74,594	66,523
Letra me vlerë të Qeverisë për në rezervë (shënimi 12)	-	5,909
Totali i aktiveve	305,347	248,843

Një analizë e përqendrimit të aktiveve financiare sipas kundërpartisë në datën e bilancit paraqitet si më poshtë:

Kriteret e kreditimit	Ari në bankat e huaja	Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN	Depozita në bankat e huaja	Investime të vlefshme për shitje (të huaja)	Investime të mbajtura për tregtim (të huaja)	Kredi ndaj Qeverisë	Kredi ndaj bankave vendase	Investime të vlefshme për shitje (vendase)	Totali
Banka Qendrore	4,436	639	17,620	-	-	-	-	-	22,695
BIS Basle	-	-	37,474	47,734	-	-	-	-	85,208
Letra me vlerë të qeverive dhe agjencive të huaja	-	-	-	84,605	10,614	-	-	-	95,219
Banka Tregtare	829	-	3,730	-	-	-	-	-	4,559
Qeveria Shqiptare B1	-	-	-	-	-	3,000	-	74,594	77,594
Pa kategori	-	-	-	-	-	-	20,072	-	20,072
Totali 2008	5,265	639	58,824	132,339	10,614	3,000	20,072	74,594	305,347

Qeveria Shqiptare është kategorizuar bazuar në kriteret e Standart & Poor's ose ekuivalentët e tyre.

Kriteret e kreditimit	Ari në bankat e huaja	Të drejtat speciale të tërheqjes tek FMN	Depozita në bankat e huaja	Investime të vlefshme për shitje (të huaja)	Investime të mbajtura për tregtim (të huaja)	Kredi ndaj bankave vendase	Letra me vlerë të Qeverisë për në rezervë	Investime të vlefshme për shitje (vendase)	Totali
Banka Qendrore	923	160	11,730	-	-	-	-	-	12,813
BIS Basle	-	-	1,173	32,880	-	-	-	-	34,053
Letra me vlerë të qeverive dhe agjencive të huaja	-	-	-	91,216	8,747	-	-	-	99,963
Banka Tregtare	-	-	28,073	-	-	-	-	-	28,073
Qeveria Shqiptare B1	-	-	-	-	-	-	5,909	66,523	72,432
Pa kategori	-	-	-	-	-	1,509	-	-	1,509
Totali 2007	923	160	40,976	124,096	8,747	1,509	5,909	66,523	248,843

Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kreditimit sipas pozicionit gjeografik në datën e bilancit paraqitet si më poshtë:

	Evropë	SHBA	Republika e Shqipërisë	Të tjera	Totali
Ari në bankat e huaja	5,265	-	-	-	5,265
Të drejtat speciale të tërheqjes tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	-	-	-	639	639
Depozita në bankat e huaja	53,521	5,303	-	-	58,824
Investime të vlefshme për shitje të huaja	101,600	30,739	-	-	132,339
Investime të mbajtura për tregtim të huaja	-	10,614	-	-	10,614
Kredi për qeverinë	-	-	3,000	-	3,000
Kredi ndaj bankave vendase	-	-	20,072	-	20,072
Investime të vlefshme për shitje vendase	-	-	74,594	-	74,594
31 dhjetor 2008	160,386	46,656	97,666	639	305,347

	Evropë	SHBA	Republika e Shqipërisë	Të tjera	Totali
Ari në bankat e huaja	923	-	-	-	923
Të drejtat speciale të tërheqjes tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	-	-	-	160	160
Depozita në bankat e huaja	37,346	3,630	-	-	40,976
Investime të vlefshme për shitje të huaja	90,060	34,036	-	-	124,096
Investime të mbajtura për tregtim të huaja	-	8,747	-	-	8,747
Kredi ndaj bankave vendase	-	-	1,509	-	1,509
Investime të vlefshme për shitje vendase	-	-	66,523	-	66,523
Letra me vlerë të Qeverisë për në rezervë	-	-	5,909	-	5,909
31 dhjetor 2007	128,329	46,413	73,941	160	248,843

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të kredidhënësit apo kredimarrësit) do të ndikojë në të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Elementet kryesore të rrezikut të çmimit që ndikojnë Bankën janë:

- Rreziku i normave të interesit i lidhur me ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare për shkak të ndryshimit të normave të interesit;
- Rreziku i këmbimit i lidhur me ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj janë paraqitur në secilin prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit

Operacionet e Bankës janë të ekspozuara ndaj rrezikut të normave të interesit, i cili ndikon në çmimet e aktiveve interesprurëse (duke përfshirë investimet) dhe detyrimeve që paguajnë interes. Objektivi kryesor i Bankës është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve duke përcaktuar synimin e politikës monetare. Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të normave të interesit monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Banka e zbut këtë rrezik duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi detyrimet që paguajnë interes. Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tillë që e ardhura nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, e cila minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare. Instrumentet me norma të ndryshueshme interesi përmbajnë rrezikun e ndryshimit në bazën për përcaktimin e normave të interesit. Këto instrumente detajohen si më poshtë:

31 dhjetor 2008	Norma mesatare	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Totali
Aktivet					
Investime të mbajtura për tregtim	2.6%	439	533	-	972
Totali		439	533	-	972
Detyrimet					
Detyrime ndaj FMN	1.84%	-	-	936	936
Totali		-	-	936	936
Ndryshimi nga norma e ndryshueshme e interesit		439	533	(936)	36
Ndjeshmëria ndaj 100 b.p. rritje		4	5	(9)	-
31 dhjetor 2007					
Detyrimet					
Detyrime ndaj FMN	4.77%	-	-	690	690
Totali		-	-	690	690
Ndryshimi nga norma e ndryshueshme e interesit		-	-	(690)	(690)
Ndjeshmëria ndaj 100 b.p. rritje		-	-	(7)	(7)

Një përmbledhje e aktiveve interesprurëse dhe detyrimeve që paguajnë interes (përfshirë instrumentet e mësipërme me normë të ndryshueshme) sipas datës së maturimit në 31 dhjetor 2008 dhe 2007 paraqitet si më poshtë:

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Pa interes	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara	829	-	-	-	-	-	4,436	5,265
Depozita tek Fondit Monetar Ndërkombëtar	639	-	-	-	-	-	6,271	6,910
Depozita në banka të huaja	58,801	-	-	-	-	-	23	58,824
Investime të vlefshme për shitje	-	8,183	17,892	29,038	74,264	2,962	-	132,339
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	-	1,282	8,836	496	-	10,614
Aktive të tjera në monedha të huaja	-	-	-	-	-	-	1,577	1,577
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	2,462	2,462
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	69	69
Kredi ndaj qeverisë	-	3,000	-	-	-	-	-	3,000
Kredi ndaj bankave vendase	14,566	5,438	-	-	-	-	68	20,072
Investime të vlefshme për shitje	27,167	20,200	23,946	3,281	-	-	-	74,594
Aktive të tjera vendase	-	-	-	-	-	1,177	3,370	4,547
Totali	102,002	36,821	41,838	33,601	83,100	4,635	18,276	320,273
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	361	118	281	476	4,266	1,550	5,817	12,869
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	-	-	-	-	-	1,090	88	1,178
Detyrime të tjera të huaja	261	-	-	-	-	-	-	261
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	203,713	203,713
Detyrime ndaj bankave vendase	67,764	-	-	-	-	-	39	67,803
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	21,096	21,096
Detyrime të tjera vendase	206	-	-	-	-	-	1,274	1,480
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	11,873	11,873
Totali	68,592	118	281	476	4,266	2,640	243,900	320,273
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2008	33,410	36,703	41,557	33,125	78,834	1,995	(225,624)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2008	33,410	70,113	111,670	144,795	223,629	225,624	-	-

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Pa interes	Totali
Aktivet								
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	923	923
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	160	-	-	-	-	-	6,871	7,031
Depozita në banka të huaja	32,961	7,880	-	-	-	-	135	40,976
Investime të vlefshme për shitje	3,705	6,646	9,479	13,679	88,586	2,001	-	124,096
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	-	659	8,088	-	-	8,747
Aktive të tjera në monedha të huaja	250	-	-	-	-	-	502	752
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	63	63
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	95	95
Kredi ndaj bankave vendase	1,508	-	-	-	-	-	1	1,509
Investime të vlefshme për shitje	26,650	19,328	19,597	948	-	-	-	66,523
Letra me vlerë të qeverisë për në rezervë	-	5,909	-	-	-	-	-	5,909
Aktive të tjera vendase	-	-	-	-	-	1,048	2,455	3,503
Totali	65,234	39,763	29,076	15,286	96,674	3,049	11,045	260,127
Detyrimet dhe kapitali i vet								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	218	139	347	555	4,324	1,928	6,435	13,946
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	-	-	-	-	-	1,072	111	1,183
Detyrime të tjera të huaja	251	-	-	-	-	-	-	251
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	161,162	161,162
Detyrime ndaj bankave vendase	61,896	-	-	-	-	-	5,155	67,051
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	14,313	14,313
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	3	3
Detyrime të tjera vendase	-	-	-	-	-	-	927	927
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	1,291	1,291
Totali	62,365	139	347	555	4,324	3,000	189,397	260,127
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2007	2,869	39,624	28,729	14,731	92,350	49	(178,352)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2007	2,869	42,493	71,222	85,953	178,303	178,352	-	-

Rreziku i këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen si pasojë e diferencës në strukturën e monedhave midis aktiveve dhe detyrimeve. Nga një këndvështrim kontabël, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit gjatë kryerjes së transaksioneve me instrumente financiare në monedhë të ndryshme nga ajo vendase.

Struktura e monedhave të rezervës valutore përcaktohet nga struktura e monedhave të detyrimeve të Bankës Qendrore dhe të Qeverisë. Si rrjedhim rezervat kryesore janë në Euro dhe Usd.

	LEKË	USD	EURO	GBP	Të tjera	Totali
Aktivët						
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	5,265	5,265
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	5,812	-	-	-	1,098	6,910
Depozita në bankat e huaja	-	10,536	39,865	1,023	7,400	58,824
Investime të vlefshme për shitje	-	38,867	81,270	7,329	4,873	132,339
Investime të mbajtura për tregtim	-	10,614	-	-	-	10,614
Aktive të tjera në monedhë të huaj	335	616	625	-	1	1,577
Ari dhe metale të çmuara	2,462	-	-	-	-	2,462
Kredi tranzite	-	-	69	-	-	69
Kredi ndaj Qeverisë Shqiptare	3,000	-	-	-	-	3,000
Kredi ndaj bankave	20,072	-	-	-	-	20,072
Investime të vlefshme për shitje	74,594	-	-	-	-	74,594
Aktive të tjera vendase	4,211	2	334	-	-	4,547
Totali i aktiveve	110,486	60,635	122,163	8,352	18,637	320,273
Detyrimet						
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	6,749	-	-	-	6,120	12,869
Detyrime ndaj institucioneve financiare të huaja	14	-	1,164	-	-	1,178
Detyrime të tjera të huaja	-	261	-	-	-	261
Para në qarkullim	203,713	-	-	-	-	203,713
Detyrime ndaj bankave vendase	41,133	6,172	20,498	-	-	67,803
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	9,345	248	11,503	-	-	21,096
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera vendase	1,454	19	7	-	-	1,480
Totali i detyrimeve	262,408	6,700	33,172	-	6,120	308,400
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2008	(151,922)	53,935	88,991	8,352	12,517	11,873
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2007	(134,948)	50,563	72,351	9,816	3,509	1,291

	LEKË	USD	EURO	GBP	Të tjera	Totali
Aktivët						
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	923	923
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	6,429	-	-	-	602	7,031
Depozita në bankat e huaja	-	8,286	27,552	1,514	3,624	40,976
Investime të vlefshme për shitje	-	39,969	70,638	8,303	5,186	124,096
Investime të mbajtura për tregtim	-	8,747	-	-	-	8,747
Aktive të tjera në monedhë të huaj	335	415	2	-	-	752
Ari dhe metale të çmuara	63	-	-	-	-	63
Kredi tranzite	-	-	95	-	-	95
Kredi ndaj bankave	1,509	-	-	-	-	1,509
Investime të vlefshme për shitje	66,523	-	-	-	-	66,523
Letra me vlerë të qeverisë për në rezervë	5,909	-	-	-	-	5,909
Aktive të tjera vendase	3,497	2	4	-	-	3,503
Totali i aktiveve	84,265	57,419	98,291	9,817	10,335	260,127
Detyrimet						
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	7,120	-	-	-	6,826	13,946
Detyrime ndaj institucioneve financiare të huaja	11	-	1,172	-	-	1,183
Detyrime të tjera të huaja	-	251	-	-	-	251
Para në qarkullim	161,162	-	-	-	-	161,162
Detyrime ndaj bankave vendase	41,225	6,274	19,552	-	-	67,051
Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare	8,797	310	5,205	1	-	14,313
Të ardhura për t'u shpërndarë	3	-	-	-	-	3
Detyrime të tjera vendase	895	21	11	-	-	927
Totali i detyrimeve	219,213	6,856	25,940	1	6,826	258,836
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2007	(134,948)	50,563	72,351	9,816	3,509	1,291
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2006	(132,642)	52,343	73,612	9,753	(3,056)	10

(e) Rreziku operacional


Rreziku operacional është rreziku i humbjes direkte dhe indirekte si rezultat i një shumëllojshmërie shkaqesh të lidhura me operacionet e Bankës si personeli, teknologjia dhe infrastruktura, si dhe faktorë të jashtëm përveç kreditimit, rreziqet e tregut dhe të likuiditetit, të lindura nga kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet përgjithësisht të pranura të sjelljes organizative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e Bankës.

Manaxhimi i rrezikut operacional mbështetet nga standarde të përgjithshme të Bankës për manaxhimin e rrezikut operacional dhe politika të gjera të përbashkëta që përshkruhen në rregulloret e drejtimit të stafit dhe një numri kërkesash të detyrueshme, si dhe përcaktimi i sistemeve të hollësishme të kontrollit të brendshëm për pjesë të ndryshme të aktiviteteve të Bankës

37. NGJARJET PAS DATËS SË MBYLLJES SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas bilancit që mund të kenë nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.

SHTOJCA
STATISTIKORE



PËRMBAJTJA E SHTOJCËS STATISTIKORE

ÇMIMET, PRODHIMI DHE TREGU I PUNËS	204
1.1 Indeksi i çmimeve të konsumit	204
1.2 Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore	205
1.3 Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim	206
1.4 Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të indeksit të kushtimit në ndërtim	206
1.5 Prodhimi i brendshëm bruto sipas metodës së shpenzimeve	207
1.6 Vlera e shtuar sipas aktivitetit ekonomik	207
1.7 Punësimi, papunësia dhe pagat	208
FINANCAT E QEVERISË	208
2.1 Të ardhurat e buxhetit të qeverisë	208
2.2 Shpenzimet e buxhetit të qeverisë	209
2.3 Financimi i deficitit buxhetor	209
2.4 Shpenzimet sipas klasifikimit funksional (COFOG)	210
2.5. Borxhi i brendshëm	210
STATISTIKAT MONETARE E BANKARE	211
3.1 Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	211
3.2 Kundërpartitë e agregatëve monetarë	212
3.3 Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në lekë sipas sektorëve	213
3.4 Depozitat me afat në lekë sipas sektorëve	213
3.5 Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në valutë sipas sektorëve	214
3.6 Depozitat me afat në valutë sipas sektorëve	214
3.7 Kredia për ekonominë sipas sektorëve	215
3.8 Bilanci sektorial i bankave paradepozituese	216
3.9 Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë	217
TREGJET FINANCIARE	218
4.1 Normat e interesit për kredinë e re sipas monedhave	218
4.2 Normat e interesit për depozitat e reja sipas monedhave	219
4.3 Normat e interesit për bonot e thesarit	220
KURSET E KËMBIMIT	220
5.1 Kurset e këmbimit të Lek-ut kundrejt monedhave kryesore	220
NORMAT E INTERESIT TË INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE	221
6.1 Normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë	221
STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM	222
7.1 Bilanci i pagesave	222
7.2 Eksporti i mallrave sipas partnerëve	223
7.3 Eksporti sipas grupmallrave	223
7.4 Importi i mallrave sipas partnereve	224
7.5 Importi sipas grupmallrave	224

ÇMIMET, PRODHIMI DHE TREGU I PUNËS

1.1 INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT (Indekse)

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
IQK Totali dhjetor 2007=100	IQK Totali dhjetor 2007=100	Ushqime dhe pije jo- alkoolike	Pije alkoolike dhe duhan	Veshje dhe këpucë	Qira, ujë lëndë dëgjëse dhe energji	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	Shëndeti	Transporti	Komunikimi	Argëtim dhe kulturë	Shërbimi arsimor	Hotele, kafene dhe restorante	Mallra dhe shërbime të ndryshme
2005 ¹⁾	92.8	92.2	85.1	103.1	90.7	101.7	97.0	93.6	102.7	101.1	92.4	92.1	98.1
2006	95.0	93.2	89.9	100.3	95.3	100.4	100.3	96.8	101.9	102.1	97.7	94.3	99.2
2007	97.8	95.9	98.5	99.3	99.5	100.0	99.8	97.3	100.0	101.5	100.3	97.6	99.5
2008	101.1	100.9	100.7	96.5	103.3	100.1	100.8	104.7	94.4	103.5	100.3	101.0	100.4
2008 Janar	100.5	101.0	100.0	98.7	100.4	100.2	100.4	100.5	100.0	100.1	100.0	100.3	100.1
Shkurt	101.5	103.6	100.1	98.1	100.1	100.2	100.8	100.9	100.0	100.1	100.1	100.4	100.3
Mars	102.4	104.3	100.3	97.4	103.9	100.2	100.8	101.7	100.0	100.4	100.0	100.5	100.4
Prill	102.0	103.5	100.3	97.1	103.7	100.1	100.8	101.7	99.9	100.0	100.0	100.4	100.3
Maj	101.0	100.7	100.0	96.8	103.7	100.1	100.8	103.6	99.9	99.9	100.0	100.4	100.3
Qershor	100.2	98.1	99.9	96.7	103.3	100.2	100.7	107.8	99.9	99.8	100.1	100.4	100.3
Korrik	99.6	96.5	99.9	95.3	103.3	100.0	100.6	109.8	99.9	99.7	100.1	100.5	100.3
Gusht	100.2	98.0	100.3	94.9	103.6	100.0	100.7	109.1	99.9	100.1	100.1	100.8	100.3
Shtator	101.3	100.1	101.6	95.1	104.2	100.1	101.0	108.6	90.8	110.4	100.5	101.2	100.4
Tetor	101.3	100.9	101.6	95.4	104.3	100.2	101.1	106.9	80.8	110.4	100.9	102.2	100.6
Nëntor	101.3	101.0	101.5	96.0	104.5	100.1	101.1	104.2	80.8	110.3	101.1	102.3	100.8
Dhjetor	102.2	103.5	102.3	96.1	104.9	100.1	101.1	101.2	80.7	110.2	101.1	102.3	101.1

Burimi: INSTAT

1) Të dhënat vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe për vitet në vazhdim, janë Indekse mesatare vjetore të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore, ndërsa të dhënat mujore pasqyrojnë indeksin e çmimeve të konsumit.

1.2 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT SIPAS GRUPEVE KRYESORE. (në përqindje)

	IÇK Totali dhjetor 2007=100	Ushqime dhe pije jo- alkoolike	Pije alkoolike dhe duhan	Veshje dhe këpucë	Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	Shëndeti	Transporti	Komunikimi	Argëtim dhe kulturë	Shërbimi arsimor	Hotele, kafene dhe restorante.	Mallra dhe shërbime të ndryshme
2005 ¹⁾	2.0	-1.9	1.5	-3.4	9.0	-1.7	7.0	5.1	-0.2	0.0	11	12	13
2006	2.5	0.2	12.1	-2.8	7.0	-0.9	1.2	1.1	-2.5	1.3	3.8	1.8	1.9
2007	3.1	5.4	4.0	0.1	1.0	-0.1	0.0	2.8	0.0	-2.6	-0.7	5.2	0.5
2008	2.2	3.5	2.3	-3.9	4.9	0.1	1.1	1.2	-19.3	10.2	1.1	2.3	1.1
2008 ²⁾ Janar	3.0	5.0	3.7	-0.7	1.4	0.0	1.0	4.3	0.0	-2.5	-0.8	5.5	0.7
Shkurt	3.6	6.5	3.6	-1.2	1.1	0.1	1.3	4.8	0.0	-2.4	-0.2	5.2	1.0
Mars	4.6	7.7	3.7	-1.8	4.8	0.0	1.3	5.6	0.0	-2.2	-0.3	5.0	1.1
Prill	4.4	7.6	3.1	-2.4	4.5	-0.1	1.3	5.2	-0.1	-2.1	-0.3	4.4	1.2
Maj	4.2	7.1	2.2	-2.7	4.5	0.1	0.8	7.5	-0.1	-2.0	-0.3	3.3	1.2
Qershor	4.0	6.1	1.1	-2.6	4.1	0.3	0.7	12.4	-0.1	-2.1	-0.1	3.1	0.6
Korrik	3.7	5.6	0.9	-3.8	3.6	0.2	0.6	14.3	-0.1	-2.3	0.0	2.9	0.7
Gusht	2.5	2.9	0.9	-3.8	3.9	0.1	0.6	10.9	-0.1	-2.2	0.0	2.6	0.7
Shtator	2.7	2.9	1.4	-3.9	4.4	0.0	1.2	10.8	-9.2	10.3	0.0	2.2	0.8
Tetor	2.8	4.1	1.5	-3.9	4.5	0.2	1.1	9.1	-19.2	10.7	0.7	2.9	1.2
Nëntor	2.6	4.0	1.5	-3.8	4.6	0.0	1.1	5.3	-19.3	10.7	0.9	2.4	1.4
Dhjetor	2.2	3.5	2.3	-3.9	4.9	0.1	1.1	1.2	-19.3	10.2	1.1	2.3	1.1

Burimi: INSTAT

1) Të dhënat vjetore dhe për vitet në vijim, matin variacionin e indekseve të muajit dhjetor të vitit n me indeksin e muajit dhjetor të vitit n-1.

2) Të dhënat mujore dhe për muajt në vijim, matin ndryshimet vjetore të indekseve, në përqindje.

1.3 INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMIT DHE INDEKSI I KUSHTIMIT NË NDËRTIM (indekse)

	IÇP Indeksi Totali 2005=100	Indekset e çmimeve të prodhimit duke përjashtuar ndërtimin			Indeksi i kushtimit në ndërtim
		Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Prodhi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	Totali Tremujori IV 1999=100
	1	2	3	4	5
2005 ¹⁾	100.0	100.0	100.0	100.0	122.3
2006	100.1	108.7	100.7	94.5	123.7
2007	104.2	114.1	110.4	91.1	126.8
2008 ²⁾ T I	110.0	120.9	112.9	91.5	127.3
T II	111.5	117.5	114.7	91.5	128.3
T III	111.7	124.7	114.4	91.5	128.8
T IV					129.0

Burimi: INSTAT.

1) Të dhënat vjetore dhe për vitet në vijim, janë indekse mesatare vjetore të çmimeve të prodhimit.

2) Të dhënat tremujore edhe në tremujorët vijues, përfaqësojnë indekse të çmimeve të prodhimit me bazë aktivitetin ekonomik.

1.4 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË PRODHIMIT DHE TË INDEKSIT TË KUSHTIMIT NË NDËRTIM (në përqindje)

	IÇP Totali 2005=100	Indekset e çmimeve të prodhimit duke përjashtuar ndërtimin			Indeksi i kushtimit në ndërtim ²⁾
		Industria nxjerrëse	Industria përpunuese	Prodhi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	Totali Tremujori IV 1999=100
	1	2	3	4	5
2005	5.1	4.5	4.9	7.2	1.4
2006	0.1	8.7	0.7	-5.5	1.1
2007	4.1	5.0	9.6	-3.6	2.5
2008 ¹⁾ T I	7.4	5.56	6.78	0.85	0.7
T II	7.4	2.96	6.92	0.84	1.3
T III	7.1	9.69	6.09	0.00	1.5
T IV					1.4

Burimi: INSTAT.

1) Të dhënat tremujore të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe për tremujorët në vijim, matin ndryshimin e tremujorit korrent me tremujorin e njëjtë të vitit të mëparshëm, pra ndryshimin vjetor.

2) Ndryshimet mesatare vjetore të indeksit të kushtimit në ndërtim.

1.5 PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO SIPAS METODËS SË SHPENZIMEVE (në milionë lekë)

	Prodhimi i Brendshëm Bruto (sipas metodës së shpenzimeve)											Ndryshimet e gjendjeve + mospërpulthe statistikore
	Kërkesa e brendshme							Eksporti neto				
		Konsumi Final			Formimi Bruto i Kapitalit Fiks			Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	Importet e mallrave e shërbimeve (fob)			
		Konsumi Final i Popullatës	Konsumi Final i Administratës Publike	Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse								
1 = 2 + 8 + 11	2 = 3 + 7	3 = 4 + 5 + 6	4	5	6	7	8 = 9 - 10	9	10	11		
1996	346,403	442,922	337,561	31,852	229	73,279	-72,151	38,782	110,934	-24,367		
1997	346,198	443,090	336,678	35,167	306	70,939	-84,626	33,739	118,365	-12,267		
1998	409,209	505,182	376,824	41,987	340	86,030	-97,362	44,376	141,738	1,389		
1999	471,578	545,403	437,004	389,573	408	108,399	-77,321	74,588	151,910	3,497		
2000	523,043	615,863	449,879	399,935	490	165,984	-105,583	93,453	199,036	12,764		
2001	583,369	695,596	471,816	410,448	700	223,780	-119,983	107,524	227,507	7,755		
2002	622,711	771,573	535,551	465,180	800	236,021	-154,037	122,044	276,081	5,175		
2003	694,098	878,374	597,453	520,954	914	280,921	-171,642	141,290	312,931	-12,635		
2004	750,785	947,566	668,187	584,659	1,044	279,378	-168,169	165,097	333,265	-28,612		
2005	814,797	1,025,525	724,171	634,471	1,192	301,354	-200,824	185,970	386,794	-9,904		
2006 ¹⁾	891,000	1,102,927	789,752	696,492	1,371	313,175	-208,087	219,970	428,057	-3,839		

Burimi: INSTAT.

1) PBB-- Të dhënat e vitit 2006 janë jo përfundimtare.

1.6 VLERA E SHITUAR SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (në milionë lekë)

	Prodhimi i brendshëm bruto (sipas aktivitetit ekonomik)										Taksa mbi produktet (-) Subvencionet
	Vlera e shtuar bruto (me çmimet bazë)							Shërbime të ndërmjetme financiare të matura indirekti (-)			
	1 = 2 + 8	2 = 3 + 4 + 5 + 6 + 7	Bujqësi, gjueti dhe pyjet	Industri	Ndërtim	Shërbime gjithsej	PBB (me çmime korrente në milionë lekë)				
1996	346,403	324,861	121,757	32,835	17,011	161,317	8,058	21,542			
1997	346,198	319,588	104,506	28,973	20,172	177,085	11,148	26,610			
1998	409,209	363,515	110,782	28,322	19,335	225,808	20,731	45,694			
1999	471,578	424,067	114,997	32,320	26,943	271,232	21,424	47,512			
2000	523,043	463,971	122,908	37,529	39,979	282,063	18,508	59,072			
2001	583,369	523,613	128,039	39,449	56,450	317,570	17,895	59,756			
2002	622,711	554,994	134,508	39,592	69,165	330,981	19,252	67,717			
2003	694,098	612,398	149,013	54,927	87,047	342,260	20,849	81,699			
2004	750,785	660,668	151,324	68,031	94,432	365,611	18,729	90,117			
2005	814,797	714,128	151,640	78,319	101,759	405,917	23,508	100,669			
2006 ⁽¹⁾	891,000	773,530	156,592	88,321	114,214	444,849	30,446	117,470			
2007 ⁽²⁾	982,737	849,026	163,213	77,377	121,090	521,471	34,125	133,711			

Burimi: INSTAT.

1) PBB-- Të dhënat e vitit 2006 janë jo përfundimtare.

2) PBB-- Të dhënat e vitit 2007 janë paraprake.

1.7 PUNËSIMI, PAPUNËSIA DHE PAGAT (në mijë, ose në rast të kundërt, sikurse përcaktohet)

	Forca e aftë për punë					Të punësuar gjithsej			Papunësia		Pagat	
									Të papunë të regjistruar gjithsej			
	1 = 2 + 6	2 = 3 + 4 + 5	Në sektorin shtetëror	Në sektorin privat bujqësor	Në sektorin jo-bujqësor						Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror (në lekë)	Paga minimale zyrtare (në lekë)
			3	4	5				6	7	8	
2005	1,085	932	175	542	215				153	26,808	11,800	
2006	1,084	935	169	542	224				150	28,822	14,000	
2007 ¹⁾	1,383	1,198	167	569	230				185	33,750	16,100	
2008 T 1	1,080	939	167	542	231				141	35,800	16,000	
T 2	1,106	966	167	569	231				140	35,943	16,000	
T 3	1,110	970	167	569	235				140	36,093	17,000	

Burimi: INSTAT.

1) Të dhënat për treguesit e punësimit dhe të papunësisë janë bazuar në Anketën e Forcave të Punës (AFP) 2007.

FINANCAT E QEVERISË

2.1 TË ARDHURAT E BUXHETIT TË QEVERISË (të dhëna progresive, në milionë lekë, fundi i periudhës)

	Totali i të ardhurave							Të ardhura tatimore			Të ardhura nga buxheti i pavarur (kontribute)			Të ardhura jo tatimore	
	1 = 2 + 3 + 7	2	3 = 4 + 5 + 6	Të ardhura nga ndihmat											
2005	204,163	6,168	183,816												
2006	229,444	8,025	205,523												
2007	251,555	1,280	228,164												
2008 ¹⁾ Mars	63,594	41	60,420												
Prill	87,807	250	82,618												
Maj	111,542	466	103,004												
Qershor	134,889	521	123,998												
Korrik	161,135	623	147,274												
Gusht	184,974	705	170,124												
Shtator	208,922	721	192,617												
Tetor	235,074	731	217,757												
Nëntor	262,447	1,491	239,365												

Burimi: Ministria e Financave.

1) Të dhëna paraprake.

2.2 SHPENZIMET E BUXHETIT TË QEVERISË (Të dhëna progresive në milionë lekë, fundi i periudhës)

	Totali i shpenzimeve											
		Shpenzime korente										
		Shpenzime për personelin	Interesat	Shpenzime operative mirëmbajtje	Subvencionet	Shpenzime për sigurimet sociale dhe të tjera	Shpenzime për buxhetin lokal	Shpenzime korente të tjera	Shpenzime kapitale	Transferime kapitale	Shpenzime të tjera	
	1 = 2+10+11+12	2=3+4+5+6+7+8+9	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2005	232,339	193,964	53,674	26,029	24,515	3,653	55,874	19,999	10,218	38,375		-
2006	258,816	204,860	56,709	25,006	22,794	3,835	60,029	22,713	13,775	51,108	2,848	-
2007	285,674	224,976	59,087	25,594	25,259	3,536	69,892	21,340	20,268	57,040	658	3,000
2008 ¹⁾ Mars	53,098	48,032	14,172	6,926	3,703	207	16,640	3,776	2,608	5,066		
Prill	78,466	67,306	19,631	9,190	5,744	287	22,642	6,105	3,707	10,262		898
Maj	105,621	87,291	24,700	12,359	7,856	700	28,623	8,222	4,831	16,984		1,346
Qershor	137,320	107,787	29,991	15,021	10,451	884	35,022	10,469	5,950	28,016		1,517
Korrik	166,722	129,752	35,646	18,758	12,804	961	41,796	12,723	7,062	34,744		2,227
Gusht	193,878	149,778	40,912	21,065	14,615	1,388	48,759	14,812	8,227	41,816		2,284
Shtator	217,317	169,539	46,344	22,994	16,624	1,506	55,423	17,196	9,452	45,450		2,328
Tetor	251,860	190,962	52,083	25,505	19,619	1,595	61,908	19,618	10,634	58,531		2,367
Nëntor	284,341	212,829	58,034	28,599	22,182	1,791	68,130	22,338	11,756	69,135		2,376

Burimi: Ministria e Financave.

1) Të dhëna paraqirake.

2.3 FINANCIMI I DEFICITIT BUXHETOR (Të dhëna progresive në milionë lekë, fundi i periudhës)

	Financimi i deficitit											
	Deficiti	Financimi i brendshëm					Financimi i jashtëm					Ndryshimi i gjendjes së arkës
		2 = 3 + 9	3=4+5+6+7+8	Bono thesari	Eurobono	Huadhënie	Obligacione	Të tjera detyrime	9=10+11	Hua afatgjatë		
1				4	5	6	7	8			10	11
2005	-28,176	28,176	23,298	-4,047	0	0	0	27,345	4,878	5,857	-979	
2006	-29,372	29,372	23,623	-20,045	0	0	0	43,668	5,749	5,346	403	
2007	-34,119	34,119	28,829	-23,662	-5,549	0	46,250	11,790	5,289	5,010	279	
2008 ¹⁾ Mars	10,496	-10,496	-10,589	-4,420	0	0	9,870	-16,039	93	271	-178	
Prill	9,341	-9,341	-9,877	-4,220	0	-1,000	10,320	-14,977	536	501	35	
Maj	5,921	-5,921	-7,225	-6,257	0	-1,000	13,820	-13,787	1,303	1,265	38	
Qershor	-2,431	2,431	-8,464	-7,178	0	-1,000	18,695	-18,981	10,896	10,751	145	
Korrik	-5,588	5,588	-5,931	-8,178	0	-2,827	16,861	-11,787	11,519	11,380	139	
Gusht	-8,904	8,904	-9,493	-8,230	0	-2,827	20,361	-18,797	18,396	17,788	609	
Shtator	-8,395	8,395	-10,313	-8,202	0	-2,827	21,599	-20,881	18,708	18,202	506	
Tetor	-16,786	16,786	-8,036	-11,087	0	-2,827	19,099	-13,221	24,822	24,195	627	
Nëntor	-21,894	21,894	-11,192	-13,239	0	-1,526	15,899	-12,326	33,086	32,313	773	

Burimi: Ministria e Financave.

1) Të dhëna paraqirake.

2.4 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (COFOG) (të dhëna progresive, në milionë lekë, fundi i periudhës)

	Shpenzimet totale											
	Shërbime të përgjithshme publike ¹⁾	Mbrojtja	Rendi dhe siguria publike	Çështjet ekonomike	Mbrojtja e mjedisit	Srrehimi dhe komoditetet e komunitetit	Shëndetësia	Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare	Arsimi	Mbrojtja sociale	Të tjera	
	1 = 2 + 3 + 4 + 5 + 6 + 7 + 8 + 9 + 10 + 11 + 12	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2007	285,674	54,385	11,494	15,171	51,833	88	12,671	24,104	3,219	31,630	77,421	3,658
2008 ²⁾ Mars	53,098	12,438	1,840	2,760	5,253	18	1,231	4,760	552	6,589	17,658	0
Prill	78,466	17,329	2,511	3,860	10,562	29	2,065	6,816	858	9,400	24,138	898
Maj	105,621	22,917	3,026	5,071	16,932	35	3,340	8,773	1,196	12,404	30,582	1,346
Qershor	137,320	28,161	4,181	6,551	27,270	46	4,242	10,914	1,480	15,496	37,461	1,517
Korrik	166,722	34,647	4,968	7,859	33,815	53	5,173	12,933	1,751	18,550	44,747	2,227
Gusht	193,878	39,209	5,557	9,160	40,616	73	6,593	15,044	2,019	21,181	52,141	2,284
Shtator	217,317	43,735	6,320	10,346	44,260	81	7,335	17,056	2,311	24,027	59,576	2,328
Tetor	251,860	49,090	7,113	11,958	56,575	157	8,225	19,570	2,673	27,498	66,634	2,367
Nëntor	284,341	54,802	7,793	13,734	66,763	172	9,372	22,151	3,070	30,740	73,362	2,376

Burimi: Ministria e Financave.

1) Përfshin dhe shpenzimet për interesa.

2) Të dhënat janë paraprake.

2.5. BORXHI I BRENDSHËM¹⁾ (të dhëna progresive, në milionë lekë, fundi i periudhës)

	Stoku i borxhit të brendshëm							Të tjera
	Bono	Thesari	Obligacione dy vjeçare	Obligacione tre vjeçare	Obligacione pesë vjeçare	Obligacione shtatë vjeçare	Obligacione rivlerësi të valurës me B.Sh	
	1 = 2 + 3 + 4 + 5 + 6 + 7 + 8	2	3	4	5	6	7	8
2005	315,853	275,917	32,210	6,000	0	0	0	1,726
2006	348,936	261,242	53,120	16,050	6,360	0	12,164	0
2007	369,536	232,211	66,460	25,250	24,110	6,000	15,505	0
2008 ¹⁾ T 1	374,986	227,791	70,130	25,950	29,610	6,000	15,505	0
T 2	390,212	225,032	71,430	25,100	33,110	12,000	23,540	0
T 3	390,888	224,008	71,630	23,100	36,610	12,000	23,540	0

Burimi: Ministria e Financave.

1) Të dhënat janë paraprake.

STATISTIKAT MONETARE E BANKARE*

3.1 AGREGATËT MONETARË DHE PËRBËRËSIT E TYRE

	M2						M3
	M1			Depozitat me afat në lekë	Depozitat në valutë		
	Paraja jashtë korporatave depozituese	Depozitat pa afat në lekë					
	1	2	3 (1+2)	4	5 (4+3)	6	7 (5+6)
	Gjendja në fund të periudhës (milionë Lekë)						
2006 Dhjetor	163,264.3	79,126.4	242,390.7	234,982.1	477,372.8	189,094.6	666,467.4
2007 Dhjetor	154,956.2	87,719.3	242,675.5	263,461.7	506,137.2	251,472.3	757,609.5
2008 Janar	146,947.6	78,772.8	225,720.4	276,133.0	501,853.4	257,028.2	758,881.6
Shkurt	147,128.6	74,100.7	221,229.4	279,584.9	500,814.3	261,016.8	761,831.0
Mars	146,812.6	68,392.9	215,205.5	283,044.0	498,249.6	256,264.3	754,513.9
Prill	146,158.6	69,457.3	215,615.9	284,576.7	500,192.6	259,241.5	759,434.1
Maj	144,960.1	70,790.2	215,750.3	286,799.9	502,550.2	255,599.5	758,149.7
Qershor	145,807.1	73,572.3	219,379.4	287,753.4	507,132.8	266,566.6	773,699.4
Korrik	150,830.0	75,132.1	225,962.1	290,424.3	516,386.4	270,705.3	787,091.7
Gusht	152,262.4	74,552.3	226,814.6	293,897.7	520,712.3	287,620.1	808,332.4
Shtator	152,707.1	75,306.5	228,013.6	294,711.7	522,725.4	297,638.1	820,363.5
Tetor	165,297.3	74,413.5	239,710.8	284,651.3	524,362.0	282,284.0	806,646.0
Nëntor	173,252.8	76,833.6	250,086.4	277,657.2	527,743.6	272,635.2	800,378.8
2008 Dhjetor	195,808.5	87,045.0	282,853.5	272,055.1	554,908.7	260,690.3	815,598.9
	Ndryshimi vjetor në përqindje						
2006 Dhjetor	9.08	6.95	8.38	15.88	11.95	29.03	16.32
2007 Dhjetor	- 5.09	10.86	0.12	12.12	6.03	32.99	13.68
2008 Janar	- 5.47	4.52	- 2.21	13.19	5.71	32.19	13.40
Shkurt	- 4.79	3.54	- 2.16	12.26	5.40	29.63	12.61
Mars	- 4.25	- 4.87	- 4.45	12.77	4.63	26.64	11.19
Prill	- 4.39	- 2.08	- 3.66	12.03	4.68	25.87	11.06
Maj	- 4.45	0.48	- 2.89	12.20	5.19	23.65	10.76
Qershor	- 2.86	4.29	- 0.58	12.78	6.59	31.52	14.04
Korrik	- 0.69	3.23	0.58	13.93	7.67	28.49	14.03
Gusht	1.15	5.95	2.68	14.36	8.96	21.84	13.22
Shtator	3.45	6.94	4.58	13.80	9.59	25.69	14.93
Tetor	15.08	5.41	11.90	8.59	10.08	17.47	12.56
Nëntor	21.17	6.65	16.30	6.20	10.76	14.91	12.14
2008 Dhjetor	26.36	- 0.77	16.56	3.26	9.64	3.67	7.65

Burimi: Banka e Shqipërisë

* Të dhënat e muajit dhjetor 2008 konsiderohen të dhëna paraprake

3.2 KUNDËRPARTITË E AGREGATËVE MONETARË

	Mjetet valutore neto	Mjetet e brendshme			Të tjera neto
		Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	Pretendime ndaj sektorëve të tjerë*		
	1	2	3	4 (2+3)	5
Gjendja në fund të periudhës (milionë Lekë)					
2006 Dhjetor	233,241.6	292,397.5	195,845.7	488,243.2	(7,680.0)
2007 Dhjetor	232,100.7	314,296.9	294,114.6	608,411.5	(6,748.9)
2008 Janar	240,560.7	304,427.1	296,198.5	600,625.6	(7,733.7)
Shkurt	236,109.0	304,648.3	309,236.0	613,884.3	(7,236.0)
Mars	215,840.4	302,626.2	316,594.6	619,220.8	(7,262.4)
Prill	208,975.9	303,714.5	326,559.0	630,273.5	(7,230.7)
Maj	196,229.0	307,793.4	334,634.3	642,427.7	(8,634.3)
Qershor	198,188.0	307,766.6	348,496.5	656,263.1	(8,991.9)
Korrik	200,505.3	311,077.0	357,271.5	668,348.5	(10,206.3)
Gusht	226,652.8	307,561.3	365,310.1	672,871.4	(8,034.1)
Shtator	236,477.1	306,874.7	378,017.6	684,892.3	(6,338.6)
Tetor	221,434.6	310,398.3	386,650.1	697,048.4	(6,294.5)
Nëntor	225,486.8	292,525.3	395,632.1	688,157.4	(7,354.7)
2008 Dhjetor	206,667.7	322,065.6	396,569.2	718,634.8	(5,847.1)
Ndryshimi vjetor në përqindje					
2006 Dhjetor	10.65	3.94	56.48	20.11	(14.60)
2007 Dhjetor	(0.49)	7.49	50.18	24.61	(12.12)
2008 Janar	0.04	4.71	48.54	22.54	(4.06)
Shkurt	(2.19)	4.08	48.11	22.41	87.05
Mars	(8.09)	4.30	44.76	21.69	8.26
Prill	(9.66)	5.30	43.88	22.29	(17.34)
Maj	(12.24)	6.73	43.29	23.09	(6.83)
Qershor	(8.95)	7.88	45.10	24.89	35.49
Korrik	(9.75)	8.93	45.59	25.87	26.63
Gusht	(7.95)	6.79	44.27	24.33	4.64
Shtator	(7.15)	12.79	44.85	28.48	36.03
Tetor	(10.54)	13.64	43.79	28.59	(4.43)
Nëntor	(3.66)	5.48	42.75	24.11	10.99
2008 Dhjetor	(10.96)	2.47	34.83	18.12	(13.36)

Burimi: Banka e Shqipërisë

*"Pretendime ndaj sektorëve të tjerë" përfshin kredinë për ekonominë dhe pretendime të tjera ndaj sektorëve mbajtës së parasë së gjerë.

3.3 LLOGARITË RRJEDHËSE DHE DEPOZITAT PA AFAT NË LEKË SIPAS SEKTORËVE* (në milionë Lekë)

	Totali (1+2+3+4+5)					
	Qeveria lokale	Korporatat jofinanciare publike	Korporata të tjera financiare	Korporata të tjera jofinanciare	Sektorë të tjerë rezidentë	
	1	2	3	4	5	6
2006 dhjetor	685.1	9,024.0	630.9	17,647.8	51,138.6	79,126.4
2007 dhjetor	478.7	11,459.8	557.2	31,871.7	43,351.8	87,719.3
2008 janar	474.9	7,604.5	812.8	27,585.9	42,294.7	78,772.8
	shkurt	465.1	7,752.7	868.5	22,422.4	42,592.0
mars	481.5	8,552.8	739.5	15,705.6	42,913.5	68,392.9
prill	462.9	8,460.3	879.4	16,303.8	43,350.9	69,457.3
maj	604.0	8,291.9	861.9	17,720.1	43,312.5	70,790.2
qershor	625.8	7,589.8	196.4	20,757.2	44,403.3	73,572.3
korrik	575.9	6,942.5	1,018.3	20,315.4	46,280.0	75,132.1
gusht	591.3	7,452.4	1,097.0	21,506.1	43,905.4	74,552.3
shtator	643.8	7,015.1	875.9	23,644.6	43,127.1	75,306.5
tetor	478.3	6,818.6	1,043.4	25,281.4	40,791.8	74,413.5
nëntor	464.6	6,947.3	897.0	26,192.1	42,332.6	76,833.6
2008 dhjetor	482.8	7,233.9	698.2	33,582.0	45,048.2	87,045.0

Burimi: Banka e Shqipërisë

*Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë

3.4 DEPOZITAT ME AFAT NË LEKË SIPAS SEKTORËVE* (në milionë Lekë)

	Totali (1+2+3+4+5)					
	Qeveria lokale	Korporatat jofinanciare publike	Korporata të tjera financiare	Korporata të tjera jofinanciare	Sektorë të tjerë rezidentë	
	1	2	3	4	5	
2006 Dhjetor	1.1	1,603.7	276.4	8,376.0	224,724.9	234,982.1
2007 Dhjetor	206.4	2,476.6	300.4	5,777.0	254,701.3	263,461.7
2008 Janar	221.2	3,241.8	673.3	5,887.8	266,108.9	276,133.0
Shkurt	174.1	2,791.8	270.3	6,718.6	269,630.2	279,584.9
Mars	113.1	2,843.6	306.0	7,533.5	272,247.8	283,044.0
Prill	1.1	3,329.8	333.7	7,512.5	273,399.6	284,576.7
Maj	1.1	2,819.5	505.0	8,160.0	275,314.2	286,799.9
Qershor	1.1	2,846.0	505.9	8,644.9	275,755.4	287,753.4
Korrik	15.1	2,763.5	1,534.9	9,678.8	276,431.9	290,424.3
Gusht	18.0	2,797.5	756.6	10,274.8	280,050.8	293,897.7
Shtator	12.2	2,863.1	468.3	6,648.4	284,719.7	294,711.7
Tetor	12.3	1,590.6	1,501.7	7,449.1	274,097.5	284,651.3
Nëntor	12.4	1,176.0	1,079.8	7,939.5	267,449.6	277,657.2
2008 Dhjetor	17.7	1,331.5	831.8	9,428.6	260,445.6	272,055.1

Burimi: Banka e Shqipërisë

*Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë

3.5 LLOGARITË RRJEDHËSE DHE DEPOZITAT PA AFAT NË VALUTË SIPAS SEKTORËVE* (në milionë Lekë)

	Totali (1+2+3+4+5)					
	Qeveria lokale	Korporatat jofinanciare publike	Korporata të tjera financiare	Korporata të tjera jofinanciare	Sektorë të tjerë rezidentë	
	1	2	3	4	5	6
2006 Dhjetor	1,438.4	4,268.9	200.2	18,289.8	38,146.7	62,344.0
2007 Dhjetor	221.8	3,440.4	299.0	23,003.6	42,497.6	69,462.3
2008 Janar	158.5	3,214.2	137.1	22,264.0	42,048.8	67,822.5
Shkurt	207.3	2,217.9	149.4	20,896.9	42,934.3	66,405.8
Mars	177.9	2,318.7	278.9	22,426.1	40,963.0	66,164.7
Prill	160.2	2,787.3	313.2	22,751.8	41,148.2	67,160.7
Maj	139.8	2,299.9	203.5	22,444.2	41,928.7	67,016.1
Qershor	142.6	2,531.3	317.6	27,708.0	42,613.1	73,312.7
Korrik	81.4	2,825.2	173.6	26,350.0	43,750.6	73,180.7
Gusht	99.4	2,212.7	195.0	28,707.5	45,471.1	76,685.6
Shtator	158.7	2,566.3	296.4	29,033.8	45,098.6	77,153.8
Tetor	150.7	3,464.6	224.2	27,219.6	40,403.0	71,462.2
Nëntor	153.5	3,215.0	445.7	24,308.1	39,675.9	67,798.1
2008 Dhjetor	108.8	2,609.4	608.7	23,225.7	38,561.2	65,113.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.

3.6 DEPOZITAT ME AFAT NË VALUTË SIPAS SEKTORËVE* (në milionë Lekë)

	Totali (1+2+3+4+5)					
	Qeveria lokale	Korporatat jofinanciare publike	Korporata të tjera financiare	Korporata të tjera jofinanciare	Sektorë të tjerë rezidentë	
	1	2	3	4	5	6
2006 Dhjetor	70.7	2,891.3	794.1	16,715.2	106,279.4	126,750.6
2007 Dhjetor	149.7	4,523.3	1,270.4	22,787.9	153,278.8	182,010.0
2008 Janar	150.7	4,485.3	872.7	23,222.4	160,474.6	189,205.7
Shkurt	170.5	4,605.1	1,048.6	23,208.5	165,578.3	194,611.0
Mars	168.3	5,287.3	624.1	21,681.0	162,339.0	190,099.7
Prill	167.0	5,281.6	574.9	21,179.7	164,877.5	192,080.7
Maj	609.3	5,418.5	1,385.0	13,465.0	167,705.6	188,583.5
Qershor	602.5	5,280.8	1,578.3	17,006.0	168,786.4	193,253.9
Korrik	748.7	5,189.3	1,398.3	17,653.1	172,535.1	197,524.5
Gusht	781.1	5,343.7	1,526.1	17,933.8	185,349.7	210,934.5
Shtator	811.8	6,069.1	1,445.5	16,528.6	195,629.3	220,484.3
Tetor	882.3	5,337.1	1,752.0	20,290.0	182,560.4	210,821.8
Nëntor	262.4	5,877.1	1,443.1	22,513.8	174,740.7	204,837.1
2008 Dhjetor	170.7	5,480.3	1,731.1	22,697.2	165,497.2	195,576.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.

3.7 KREDIA PËR EKONOMINË SIPAS SEKTORËVE (në milionë Lekë)

	Kredia në lekë						Kredia në valutë					
	Korporatat jo-financiare publike		Korporata të tjera financiare		Korporata të tjera jo-financiare		Korporatat jo-financiare publike		Korporata të tjera financiare		Korporata të tjera jo-financiare	
	Qeveria lokale	2	3	4	5	6 (1+2+3+4+5)	Qeveria lokale	8	9	10	11	12 (7+8+9+10+11)
2006 Dhjetor	-	2.1	-	26,285.5	32,868.9	59,156.5	-	173.5	58.1	100,799.3	35,559.4	136,590.3
2007 Dhjetor	-	0.0	70.2	35,708.3	49,057.9	84,836.4	-	3,923.0	27.2	146,340.7	58,736.4	209,027.3
2008 Janar	-	0.1	120.8	35,585.7	49,583.6	85,290.2	-	4,152.2	16.9	145,953.1	60,535.3	210,657.5
Shkurt	-	1.5	185.2	36,107.2	50,207.5	86,501.5	-	4,323.7	21.2	153,767.4	64,370.7	222,483.1
Mars	-	1.7	185.6	37,694.3	51,132.7	89,014.3	-	4,448.4	3.2	157,710.6	65,114.6	227,276.8
Prill	-	1.6	230.1	38,999.7	52,275.6	91,507.0	-	5,973.1	122.8	161,084.4	67,567.9	234,748.1
Maj	-	1.6	186.5	40,406.9	53,809.1	94,404.1	-	6,024.6	-	164,664.5	69,233.6	239,922.7
Qershor	-	1.6	185.8	42,934.4	55,293.9	98,415.7	-	4,555.3	-	173,466.5	71,816.8	249,838.6
Korrik	-	3.1	185.1	42,361.2	56,415.6	98,965.0	-	6,014.9	-	178,984.0	73,067.9	258,066.8
Gusht	-	898.8	186.6	43,148.1	57,276.8	101,510.3	-	6,038.1	60.9	182,759.2	74,701.2	263,559.4
Shtator	-	1,092.3	185.7	45,047.6	58,141.2	104,466.8	-	6,112.9	56.9	189,454.1	77,585.9	273,209.8
Tetor	-	1,615.1	232.3	46,148.7	59,914.2	107,910.3	-	6,091.4	51.6	192,968.9	79,286.4	278,398.2
Nëntor	-	2,828.7	334.0	47,566.9	60,530.6	111,260.3	-	6,043.4	46.5	198,262.2	79,677.9	284,030.0
2008 Dhjetor	-	3,636.7	334.7	49,111.0	60,936.2	114,018.6	-	9,262.4	41.5	192,939.7	79,968.9	282,212.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.8 BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITITUESE (në milionë Lekë)

	Totali i mjeteve (1+2+6+9+18+21+22+23)																									
	Arka në lekë	Arka në valutë	Depozita (3+4+5)				Leta me vlerë të ndryshme nga aksionet (7+8)				Huatë (10+11+12+13+14+15+16+17)								Aksione dhe kapital tjetër (19+20)				Llogari të Arkëtueshme	Mjete jofinanciare		
			Jorezidentët	Banka e Shqipërisë	Bankat paradepozituese	Jorezidentët	Jorezidentët	Qeveria qendrore	Jorezidentët	Jorezidentët	Qeveria qendrore	Bankat paradepozituese	Korporata të tjera financiare	Korporata jofinanciare publike	Korporata të tjera jofinanciare	Sektorë të tjerë rezidentë	Jorezidentët	19	20	21						
2006	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24		
Dhjetor	4,983.3	8,777.2	82,927.2	55,312.5	3,073.0	141,312.7	10,628.8	241,756.0	252,384.8	5,439.6	4,200.9	430.2	58.1	0.0	175.6	127,084.8	64,965.4	202,354.6	2,144.3	97.5	2,241.8	2,712.7	8,851.0	623,618.0		
Dhjetor	6,214.6	9,698.0	83,653.3	66,426.5	2,388.0	152,467.7	7,451.5	254,729.9	262,181.5	2,923.6	-	200.1	97.4	-	3,923.0	182,049.1	103,376.0	292,569.1	1,499.2	96.9	1,596.1	2,978.9	11,230.7	738,936.7		
Janar	6,486.0	7,993.1	87,921.9	63,750.1	2,344.9	154,016.9	7,285.9	254,061.7	261,347.6	2,930.8	8,530.6	331.2	137.7	-	4,152.3	181,538.8	105,663.1	303,284.4	1,502.0	96.9	1,598.9	3,026.6	11,288.8	749,042.5		
Shkurt	5,704.5	8,034.9	93,848.2	64,855.8	3,505.8	162,209.9	7,313.3	257,243.0	264,556.3	2,535.1	4,515.2	454.7	206.5	-	4,325.2	189,874.7	110,124.2	312,035.5	1,508.5	96.9	1,605.4	3,132.4	11,517.8	768,796.6		
Mars	7,239.6	7,164.0	90,601.5	60,863.8	4,430.7	155,895.9	5,646.4	260,095.9	265,742.3	1,612.9	3,099.3	550	188.7	-	4,450.2	195,404.9	111,579.3	316,390.3	1,448.6	96.7	1,545.3	3,756.8	11,747.5	769,481.7		
Prill	6,410.6	8,213.6	86,823.2	63,677.2	3,255.1	153,755.5	5,788.2	260,785.3	266,573.5	1,805.0	2,207.5	678.8	352.8	-	5,974.6	200,084.1	115,148.7	326,251.6	1,189.2	106.9	1,296.1	4,020.4	12,112.2	778,633.6		
Maj	6,118.4	6,985.3	81,626.5	63,743.3	4,897.5	150,267.3	5,669.6	261,542.5	267,212.1	1,722.8	795.0	225.0	186.5	-	6,026.2	205,071.4	118,341.0	332,368.0	1,366.5	106.8	1,473.4	3,571.7	12,965.9	780,962.0		
Qershor	7,356.3	8,022.5	82,759.7	67,437.6	4,329.1	154,526.3	5,518.5	266,388.8	271,907.3	1,715.6	-	510.1	185.8	1,831.1	4,556.9	216,401.0	122,207.2	347,407.6	1,336.9	96.6	1,433.5	3,659.4	13,160.5	807,473.4		
Korrik	6,263.8	8,625.9	86,456.5	69,367.6	5,731.3	161,555.4	5,556.4	263,048.5	268,604.9	1,660.1	-	540.0	185.1	1,836.7	6,018.0	221,345.2	124,585.0	356,170.0	1,295.6	96.6	1,392.2	3,583.7	13,740.2	819,936.1		
Gusht	7,660.0	9,531.8	97,496.5	66,362.5	6,799.8	170,658.8	5,802.7	267,179.8	272,982.5	1,907.6	-	585.1	247.5	1,844.5	6,936.9	225,907.4	127,074.4	364,503.3	1,259.5	96.9	1,356.4	3,716.9	13,955.0	844,364.7		
Shtator	7,397.5	8,256.0	95,554.3	67,049.1	6,698.4	169,301.8	7,299.7	267,569.1	274,868.8	3,207.1	-	160.0	242.6	1,866.8	7,205.2	234,501.7	130,735.7	377,919.1	2,012.2	97.1	2,109.3	3,919.3	14,133.8	857,905.5		
Tetor	7,034.9	11,253.3	76,432.0	69,840.4	5,490.3	151,762.6	9,484.4	263,995.0	273,479.4	3,399.9	-	250	283.9	1,867.6	7,706.5	239,117.6	134,198.4	386,598.8	2,030.0	97.7	2,127.7	4,047.4	14,620.5	850,924.6		
Nëntor	7,661.5	9,381.7	64,185.4	66,175.9	4,077.7	134,439.1	13,482.1	254,913.0	268,395.1	3,792.5	-	550	380.5	1,877.6	8,872.2	245,829.0	135,196.7	396,003.6	1,997.7	97.6	2,095.3	4,310.7	14,892.2	837,179.2		
Dhjetor	7,901.2	11,621.6	55,812.2	68,645.1	2,097.5	126,554.8	13,533.1	259,034.3	272,567.3	3,642.5	-	280.2	376.2	1,868.9	12,899.1	242,050.6	135,873.0	396,990.4	1,977.1	97.2	2,074.3	4,040.0	15,248.6	836,998.2		
	Detyrimet totale dhe kapitali (6+15+16+23+24+25)																									
	Depozita të përfshira në parantë e gjerë (1+2+3+4+5)				Depozita të papërfshira në parantë e gjerë (7+8+9+10+11+12+13+14)				Huatë (17+18+19+20+21+22)				Llogari të pagueshme				Llogaritë kapitale									
	Korporata të tjera financiare	Qeveria lokale	Korporata jofinanciare publike	Korporata të tjera jofinanciare	Sektorë të tjerë rezidentë	Jorezidentët	Banka e Shqipërisë	Korporata të tjera depozituese	Qeveria qendrore	Korporata të tjera financiare	Korporata jofinanciare publike	Korporata të tjera jofinanciare	Korporata të tjera depozituese	Qeveria qendrore	Korporata të tjera financiare	Korporata të tjera jofinanciare	Korporata të tjera depozituese	Jorezidentët	Banka e Shqipërisë	Korporata të tjera depozituese	Korporata të tjera financiare	Korporata të tjera jofinanciare	Korporata të tjera depozituese	Jorezidentët		
2006	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
dhjetor	1,899.7	2,195.2	17,787.9	61,028.8	419,685.0	502,596.7	23,601.7	1,135.3	2,253.7	1,162.5	-	122.7	8,277.7	7,539.9	44,093.7	-	14,395.4	9,046.1	1,119.0	206.6	-	530.1	25,297.1	6,732.3	44,898.3	623,618.0
dhjetor	2,411.3	1,056.6	21,900.1	83,440.2	492,833.4	601,641.6	14,780.9	66.4	2,847.8	1,669.9	0.4	262.8	8,544.5	9,784.2	37,956.9	-	29,371.0	1,605.2	608.9	131.1	243.6	492.2	32,452.0	7,191.8	59,694.4	738,936.7
janar	2,101.0	1,005.3	18,545.8	78,960.0	509,931.6	610,543.8	8,346.6	339.4	3,595.4	2,551.6	0.4	268.1	7,525.9	10,480.3	33,107.8	-	29,341.4	97.2	782.6	129.7	246.5	496.5	31,093.9	10,962.6	63,334.4	749,042.5
shkurt	2,334.6	1,016.9	17,367.6	73,246.4	519,738.0	613,703.5	9,094.0	133.1	3,399.3	2,563.5	4.0	290.9	7,677.9	10,377.2	33,539.9	-	42,013.0	99.8	1,814.7	131.4	-	504.4	44,563.1	12,241.4	64,748.7	768,796.6
mars	1,946.1	940.8	19,002.4	67,346.1	517,351.0	606,586.4	10,511.1	1,583.1	3,982.6	2,465.8	0.3	291.7	6,645.0	10,180.2	35,659.8	-	46,757.1	1,833.2	1,919.8	131.3	371.6	119.9	51,132.8	13,477.9	62,624.8	769,481.7
prill	2,049.7	791.2	19,859.0	67,747.7	521,663.4	612,110.9	11,186.0	463.0	4,749.2	2,277.0	0.3	80.9	7,316.4	9,745.6	35,818.4	-	48,324.6	4,424.8	1,214.3	131.5	370.7	121.7	54,587.6	12,788.2	63,328.5	778,633.6
maj	2,955.0	1,354.2	18,829.8	61,789.2	527,148.9	612,077.1	9,243.7	774.9	2,890.1	1,924.0	0.3	72.3	7,214.1	9,882.3	32,001.8	-	53,299.7	955.1	3,191.4	131.4	370.3	122.2	58,070.1	12,813.4	65,999.7	780,962.1
qershor	2,597.6	1,372.1	18,247.9	74,116.1	530,409.0	626,742.7	7,932.8	1,327.5	3,970.6	1,659.0	0.4	74.6	6,984.2	9,876.1	31,825.1	-	58,551.7	7,796.3	2,345.4	82.1	372.3	115.8	69,263.6	12,607.7	67,034.3	807,473.4
korrik	3,878.2	1,421.1	17,720.6	73,997.3	537,847.4	634,864.5	11,565.6	939.4	3,383.8	2,043.0	0.4	72.3	6,786.5	9,941.3	34,732.4	-	61,633.8	3,811.3	1,168.8	56.3	367.4	101.4	70,139.1	11,660.0	68,540.1	819,936.1
gusht	3,558.1	1,489.9	17,806.3	78,422.2	553,627.0	654,903.5	11,388.3	371.4	3,969.0	3,090.2	0.4	68.8	7,163.2	11,046.6	37,097.9	-	58,715.0	3,638.9	4,659.7	56.8	368.1	-	67,438.5	14,544.3	70,380.6	844,364.7
shator	3,074.9	1,626.5	18,513.6	75,855.5	567,345.1	666,415.6	11,706.8	364.3	3,462.2	2,601.9	0.4	70.9	7,238.9	11,382.5	36,828.0	-	56,676.7	4,020.5	4,618.3	57.7	379.0	-	65,752.1	17,133.4	71,776.5	857,905.5
tetor	3,788.4	1,523.7	17,210.9	80,240.1	536,623.5	639,386.6	14,505.0	1,289.6	1,955.2	2,290.5	0.4	77.1	7,056.9	11,460.5	38,635.3	-	62,501.5	15,395.1	4,989.8	58.0	378.0	-	83,322.3	16,640.2	72,940.3	850,924.6
nëntor	3,367.3	892.9	17,215.4	80,953.5	522,968.7	625,397.8	14,197.7	719.1	903.6	1,965.6	0.4	79.8	6,744.7	11,386.4	35,997.3	-	65,662.9	14,412.6	3,980.8	58.5	380.2	-	84,495.0	16,798.9	74,490.1	837,179.2
dhjetor	3,664.2	780.0	16,655.0	88,933.6	508,323.9	618,356.6	13,422.0	505.3	1,405.8	2,271.7	0.4	77.3	6,395.6	11,637.3	35,715.5	-	68,092.5	20,145.3	1,741.3	58.6	383.5	-	90,421.2	17,996.1	74,508.9	836,998.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.9 BILANCI SEKTORIAL I BANKËS SË SHQIPËRISË (në milionë Lekë)

Totali i mjeteve (1 + 2 + 3 + 6 + 10 + 11 + 12)														
Mbatjet e SDR	Arka në valutë	Depozita	Leirat me vlerë (4+5)				Huatë (7+8+9)				Llogari të Arkëtueshme		Mjete jo-financiare	
			Jorezidentët	Qeveria qendrore	Korporata të tjerë depozituese	Sektorë të tjerë rezidentët	Qeveria qendrore	Korporata të tjerë depozituese	Sektorë të tjerë rezidentët	10	11			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13		
2006 Dhjetor	855.3	16.9	42,297.2	127,039.7	67,940.8	194,980.5	-	9,042.5	871.4	9,913.9	12,547.6	3,450.7	264,062.2	
2007 Dhjetor	163.3	5.1	45,773.8	132,843.0	72,892.2	205,735.1	-	1,603.5	1,047.9	2,651.4	12,547.6	4,573.4	272,308.1	
2008 Janar	1,065.3	5.7	51,084.1	126,427.9	72,686.7	199,114.6	-	95.4	1,085.4	1,180.8	12,547.6	4,767.4	265,158.8	
Shkurt	927.1	6.1	47,762.8	132,787.1	64,859.9	197,647.0	-	97.5	1,083.6	1,181.1	12,547.6	4,930.0	261,159.8	
Mars	903.9	5.1	52,176.2	120,965.1	64,418.0	185,383.1	-	1,832.6	1,081.3	2,914.0	12,547.6	4,668.5	254,194.6	
Prill	1,215.2	15.7	52,746.4	118,255.8	64,342.0	182,597.7	-	4,423.4	1,108.1	5,531.6	12,547.6	4,507.8	255,536.5	
Maj	1,130.7	11.0	45,686.6	122,273.3	64,415.1	186,688.4	-	953.9	1,114.9	2,068.8	12,547.6	4,542.5	249,886.0	
Qershor	900.6	7.2	45,097.1	126,506.4	64,484.3	190,990.7	-	7,793.8	1,128.6	8,922.4	12,547.6	4,754.2	260,654.1	
Korrik	851.0	7.4	55,312.0	120,783.2	64,125.4	184,908.5	-	3,809.1	1,123.8	4,932.9	12,547.6	4,715.7	260,877.6	
Gusht	890.0	7.1	63,286.7	123,718.2	64,303.4	188,021.6	-	3,635.2	1,128.8	4,764.0	12,547.6	4,598.9	271,676.9	
Shator	877.6	16.0	62,304.3	133,124.7	64,437.5	197,562.3	-	4,018.7	1,136.8	5,155.4	12,547.6	4,804.6	280,762.0	
Tetor	943.1	1,113.8	53,835.9	147,705.6	64,392.3	212,097.9	-	15,391.8	1,147.6	16,539.4	12,547.6	4,569.0	299,445.7	
Nëntor	914.7	1,103.3	62,935.9	155,103.3	67,351.7	222,455.0	-	14,404.6	1,157.2	15,561.8	12,547.6	4,815.4	321,278.3	
2008 Dhjetor	641.8	1,068.6	64,087.6	142,952.5	75,167.2	218,119.8	3,000.0	20,141.0	1,177.6	24,318.6	12,547.6	4,782.1	325,909.8	

Detyrimet totale dhe kapitali (1 + 2 + 8 + 12 + 13 + 14)															
Paraja në qarkullim	Depozita të përfshira në parantë e gjërë (2+3)	Depozita të papërfshira në parantë e gjërë (3+4+5+6+7)				Huatë (9+10+11)				Llogari të pagueshme	Llogaritë kapitale				
		Qeveria qendrore	Korporata të tjerë depozituese	Korporata të tjerë jo-financiare	Sektorë të tjerë rezidentët	Qeveria qendrore	Korporata të tjerë depozituese	Jorezidentët							
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	
2006 Dhjetor	168,254.9	2.8	6,922.6	21,106.8	49,367.0	6.2	636.4	78,038.9	1,241.3	4,200.3	-	5,441.6	8,894.7	3,429.4	264,062.2
2007 Dhjetor	161,181.9	13.4	7,150.5	20,775.7	67,035.6	8.2	586.7	95,556.8	1,186.4	-	-	1,186.4	7,590.1	6,779.5	272,308.1
2008 Janar	153,444.8	391.8	7,152.1	18,691.9	63,383.7	8.3	523.5	89,759.6	1,194.2	8,529.2	-	9,723.4	7,235.6	4,603.6	265,158.8
Shkurt	152,844.2	0.5	7,152.1	14,041.2	64,849.7	7.4	476.5	86,526.8	1,211.4	4,514.5	-	5,725.8	7,455.8	8,606.5	261,159.8
Mars	154,070.3	0.1	7,151.1	17,914.1	59,507.3	7.9	456.9	85,037.4	1,182.9	3,098.9	-	4,281.8	6,676.3	4,128.6	254,194.6
Prill	152,587.3	49.7	7,323.8	18,504.7	63,329.5	8.1	366.0	89,532.2	1,177.0	2,207.3	-	3,384.3	7,147.6	2,835.3	255,536.5
Maj	151,096.5	(2.2)	6,625.5	17,165.1	63,276.1	7.8	438.0	87,512.4	1,168.6	794.9	-	1,963.4	7,346.5	1,969.2	249,886.0
Qershor	153,177.6	(2.0)	6,625.1	24,160.7	66,563.0	12.5	473.1	97,834.4	1,172.4	-	-	1,172.4	7,056.6	1,415.1	260,654.1
Korrik	157,107.9	245.6	6,781.4	16,917.0	68,561.7	12.8	342.4	92,615.2	1,173.7	-	-	1,173.7	6,998.8	2,736.3	260,877.6
Gusht	159,936.5	15.1	6,782.5	23,223.2	66,470.6	12.9	417.4	96,906.5	1,165.8	-	-	1,165.8	7,297.5	6,355.6	271,676.9
Shator	160,127.7	10.0	6,783.3	25,100.9	66,732.5	12.3	541.1	99,170.1	1,176.7	-	-	1,176.7	7,406.6	12,870.9	280,762.0
Tetor	172,355.3	731.4	6,785.7	18,804.1	68,867.8	12.2	764.2	95,233.9	1,171.7	-	-	1,171.7	7,882.1	22,071.3	299,445.7
Nëntor	180,937.4	497.4	6,785.4	34,057.3	65,808.1	12.2	716.7	107,379.6	1,168.4	-	-	1,168.4	7,867.9	23,427.6	321,278.3
2008 Dhjetor	203,732.8	203.1	6,783.7	19,334.8	67,793.3	12.2	890.7	94,814.7	1,173.4	-	-	1,173.4	6,708.8	19,277.0	325,909.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGJET FINANCIARE*

4.1 NORMAT E INTERESIT PËR KREDINË E RE SIPAS MONEDHAVE** (në përqindje)

	Interesat për kredinë në Lekë				
	Deri në 6 muaj	6 muaj - 1 vit	1-3 vjet	3 - 5 vjet	Mbi 5 vjet
2006 Dhjetor	12.18	11.16	17.61	14.60	10.86
2007 Dhjetor	13.85	13.55	14.55	14.64	13.72
2008 Janar	15.53	13.36	16.26	15.04	14.01
Shkurt	14.29	11.78	14.30	15.04	13.44
Mars	13.50	11.48	15.02	14.78	13.18
Prill	12.40	12.92	16.00	14.58	13.13
Maj	12.40	11.50	16.10	14.90	12.30
Qershor	13.66	11.04	15.72	13.88	11.55
Korrik	12.49	11.45	15.13	14.07	11.63
Gusht	12.04	12.32	15.78	14.44	11.60
Shtator	12.30	10.80	15.70	14.10	13.30
Tetor	12.99	12.46	15.60	14.17	12.21
Nëntor	13.44	12.05	14.39	13.90	12.13
2008 Dhjetor	11.18	10.76	12.69	12.78	13.20
	Interesat për kredinë në USD				
	Deri në 6 muaj	6 muaj - 1 vit	1-3 vjet	3 - 5 vjet	Mbi 5 vjet
2006 Dhjetor	9.76	9.11	10.00	9.74	8.86
2007 Dhjetor	8.78	8.46	7.79	8.81	8.91
2008 Janar	8.35	9.42	7.39	-	16.23
Shkurt	7.96	6.79	5.15	-	8.69
Mars	6.51	7.01	7.47	6.21	6.51
Prill	7.63	7.00	6.94	6.81	6.74
Maj	7.40	6.70	6.80	6.20	7.10
Qershor	7.17	6.87	7.16	8.94	7.00
Korrik	6.89	6.48	6.88	7.27	7.01
Gusht	6.94	7.36	7.01	9.03	6.78
Shtator	8.96	7.38	9.11	8.74	5.71
Tetor	7.88	7.51	6.90	7.49	5.58
Nëntor	7.53	8.11	8.49	9.35	6.81
2008 Dhjetor	6.84	6.98	6.96	7.29	6.02
	Interesat për kredinë në EURO				
	Deri në 6 muaj	6 muaj - 1 vit	1-3 vjet	3 - 5 vjet	Mbi 5 vjet
2006 Dhjetor	29.67	18.29	11.30	16.22	36.52
2007 Dhjetor	8.73	8.88	9.30	9.23	8.26
2008 Janar	9.40	8.12	7.86	9.14	8.10
Shkurt	8.20	7.07	6.19	9.14	7.73
Mars	8.39	7.50	8.36	7.94	7.55
Prill	8.96	8.39	9.17	8.61	8.16
Maj	8.50	8.70	9.70	8.70	8.00
Qershor	9.06	8.62	9.69	9.51	7.97
Korrik	8.53	7.98	9.52	7.61	8.39
Gusht	8.24	8.59	8.77	9.59	7.75
Shtator	8.80	9.35	9.42	9.12	7.76
Tetor	8.74	8.50	9.30	9.42	8.00
Nëntor	8.89	8.41	8.06	7.86	7.24
2008 Dhjetor	8.18	6.72	7.89	6.83	7.42

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Të dhënat e muqit dhjetor 2008 janë të dhëna paraprake.

**Përfaqësojnë normat mesatare të ponderuara të periudhës.

4.2 NORMAT E INTERESIT PËR DEPOZITAT E REJA SIPAS MONEDHAVE* (në përqindje)

	Interesat në Lekë								
	60 mujore	48 mujore	36 mujore	24 mujore	12 mujore	6 mujore	3 mujore	1 mujore	Llogari rrjedhëse
2006 Dhjetor	-	-	6.42	5.88	5.46	4.64	3.94	3.35	0.20
2007 Dhjetor	8.00	-	7.30	6.59	6.33	5.50	4.85	3.21	0.11
2008 Janar	7.75	-	7.76	6.87	6.49	5.65	5.08	3.59	0.11
Shkurt	7.75	-	7.48	6.69	6.10	5.44	4.80	3.48	0.46
Mars	6.06	-	7.44	6.56	6.11	5.42	4.84	3.58	0.45
Prill	6.94	-	7.03	6.69	6.41	5.64	5.06	3.62	0.46
Maj	7.50	7.30	7.05	6.62	6.72	5.61	4.96	4.36	0.43
Qershor	6.90	-	7.34	6.74	6.55	5.76	5.00	4.61	0.34
Korrik	8.06	-	7.49	7.37	7.72	5.99	5.21	4.63	0.36
Gusht	8.49	-	7.57	7.18	7.71	6.09	6.27	5.09	0.29
Shtator	8.61	-	7.41	6.83	7.25	5.81	5.08	4.89	0.27
Tetor	9.41	-	7.27	6.88	6.90	5.76	5.02	4.84	0.25
Nëntor	7.80	-	7.18	6.92	6.82	5.95	5.09	4.73	0.27
2008 Dhjetor	7.51	-	7.49	6.83	6.86	5.76	5.231	3.95	0.26
	Interesat në USD								
	60 mujore	48 mujore	36 mujore	24 mujore	12 mujore	6 mujore	3 mujore	1 mujore	Llogari rrjedhëse
2006 Dhjetor	5.30	-	5.03	4.86	4.29	3.87	3.44	3.03	0.21
2007 Dhjetor	5.20	-	5.04	4.43	4.10	3.63	3.37	3.59	0.11
2008 Janar	5.20	-	5.07	4.47	4.03	3.45	3.25	2.74	0.13
Shkurt	3.80	3.30	4.08	4.11	3.47	3.95	2.90	2.94	0.18
Mars	3.80	-	2.86	4.08	3.03	2.94	2.52	2.43	0.17
Prill	-	-	3.61	3.86	2.69	2.45	2.29	2.24	0.18
Maj	3.70	3.00	2.51	2.98	2.61	2.40	2.42	2.13	0.18
Qershor	3.80	-	2.23	2.98	2.78	2.40	2.30	2.21	0.15
Korrik	3.13	-	2.54	2.61	3.04	2.24	2.24	2.48	0.15
Gusht	3.94	-	2.45	2.74	3.68	2.31	2.28	2.16	0.13
Shtator	3.77	-	2.57	3.04	2.93	2.36	2.21	2.13	0.13
Tetor	4.00	-	2.41	2.73	2.48	2.17	1.97	2.05	0.14
Nëntor	3.70	-	2.28	2.84	2.70	2.10	2.10	2.14	0.14
2008 Dhjetor	-	-	1.80	2.44	2.55	2.20	2.07	1.76	0.14
	Interesat në EURO								
	60 mujore	48 mujore	36 mujore	24 mujore	12 mujore	6 mujore	3 mujore	1 mujore	Llogari rrjedhëse
2006 Dhjetor	4.73	-	4.31	4.16	3.45	3.29	2.91	2.54	0.10
2007 Dhjetor	5.61	-	4.51	4.44	4.23	3.92	3.59	2.69	0.11
2008 Janar	5.90	-	4.46	4.36	4.19	3.81	3.68	2.65	0.10
Shkurt	5.99	5.21	4.99	4.41	4.22	3.84	3.71	2.90	0.21
Mars	5.65	-	4.50	4.57	4.12	3.77	3.83	3.55	0.83
Prill	5.74	-	4.39	4.76	4.53	4.22	3.80	4.18	0.22
Maj	5.73	4.85	4.34	4.41	4.78	3.90	3.76	3.94	0.20
Qershor	4.92	-	5.31	4.82	4.74	3.98	3.82	3.99	0.17
Korrik	6.00	-	4.74	4.91	5.36	4.33	3.95	4.08	0.20
Gusht	5.83	5.00	5.08	4.91	5.51	4.40	4.23	3.88	0.16
Shtator	6.35	5.00	5.93	4.94	4.85	4.52	4.14	3.88	0.16
Tetor	5.56	5.00	4.53	4.50	4.94	4.37	4.00	3.89	0.16
Nëntor	4.71	-	4.70	5.16	4.83	4.45	3.97	3.93	0.15
2008 Dhjetor	4.71	-	4.80	4.71	4.70	4.24	4.13	2.94	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Përfaqësojnë normat mesatare të ponderuara të periudhës.

4.3 NORMAT E INTERESIT PËR BONOT E THESARIT* (në përqindje)

	Interesat sipas afatit		
	3 mujor	6 mujor	12 mujor
2007 Janar	6.32	7.18	7.87
Shkurt	6.17	7.07	7.72
Mars	5.76	6.70	7.16
Prill	5.76	6.98	7.67
Maj	5.75	7.20	7.99
Qershor	5.68	7.21	7.96
Korrik	5.81	7.26	7.99
Gusht	5.78	7.25	7.97
Shtator	5.74	7.27	7.99
Tetor	6.06	7.38	8.10
Nëntor	6.04	7.35	8.07
2007 Dhjetor	6.32	7.41	8.26
2008 Janar	6.27	7.36	8.23
Shkurt	6.26	7.29	8.00
Mars	6.25	7.36	8.02
Prill	6.29	7.41	8.12
Maj	6.28	7.48	8.16
Qershor	6.27	7.46	8.20
Korrik	6.28	7.46	8.21
Gusht	6.26	7.39	8.15
Shtator	6.25	7.33	8.02
Tetor	6.23	7.20	7.94
Nëntor	6.05	7.42	8.10
2008 Dhjetor	6.19	7.45	8.56

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Përfaqësojnë normat mesatare të ponderuara të periudhës.

KURSET E KËMBIMIT

5.1 KURSET E KËMBIMIT TË LEK-UT KUNDREJT MONEDHAVE KRYESORE (Lekë për njësi të monedhës së huaj)

Monedhat kryesore	Mesatarja e periudhës				Fundi i periudhës			
	Dollari amerikan (USD)	Monedha evropiane (EUR)	Pound-i britanik (GBP)	Franga zvicerane (CHF)	Dollari amerikan (USD)	Monedha evropiane (EUR)	Pound-i britanik (GBP)	Franga zvicerane (CHF)
	1	2	3	4	5	6	7	8
2004	102.78	127.67	188.22	82.70	92.64	126.35	178.69	81.87
2005	99.87	124.19	181.58	80.23	103.58	122.58	178.65	78.86
2006	98.10	123.08	180.56	78.29	94.14	123.85	184.65	77.17
2007	90.43	123.62	180.83	75.31	82.89	121.78	166.02	73.65
2008 Janar	83.39	122.61	164.14	75.77	82.61	122.61	164.37	76.35
Shkurt	83.89	123.69	164.75	76.92	82.58	125.34	163.67	78.74
Mars	80.32	124.59	160.75	79.41	78.29	123.70	155.39	78.87
Prill	77.79	122.68	154.05	76.93	78.94	122.75	155.41	76.08
Maj	78.45	122.08	154.15	75.18	78.65	122.01	155.19	74.90
Qershor	78.46	122.03	154.04	75.59	77.17	122.05	153.93	76.02
Korrik	77.24	121.87	153.58	75.29	78.01	121.80	154.66	74.54
Gusht	81.12	121.44	153.21	74.92	82.66	121.70	151.25	75.32
Shtator	85.65	123.05	153.95	77.16	86.38	123.89	155.56	78.04
Tetor	92.62	123.13	156.14	81.14	96.78	123.30	156.22	84.08
Nëntor	96.84	123.29	148.68	81.48	95.33	123.37	147.46	79.65
Dhjetor	90.96	123.18	135.05	80.17	87.91	123.80	127.66	82.97

Burimi: Banka e Shqipërisë

NORMAT E INTERESIT TË INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE

6.1 NORMAT BAZË TË INTERESIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË (në përqindje)

		Depozita njëditore		Marrëveshje riblerjeje njëjavore		Kredia njëditore		Kredia Lombard	
		Vlera	Ndryshimi	Vlera	Ndryshimi	Vlera	Ndryshimi	Vlera	Ndryshimi
		1	2	3	4	5	6	7	8
2004	29 prill	3.25	-	6.25	-	8.75	-	12.25	-
	12 maj	3.00	-0.25	6.00	-0.25	8.50	-0.25	12.00	-0.25
	24 qershor	2.75	-0.25	5.75	-0.25	8.25	-0.25	11.75	-0.25
	28 korrik	2.50	-0.25	5.50	-0.25	8.00	-0.25	11.50	-0.25
	04 nëntor	2.25	-0.25	5.25	-0.25	7.75	-0.25	11.25	-0.25
2005	31 mars	2.00	-0.25	5.00	-0.25	7.50	-0.25	11.00	-0.25
	27 korrik	3.25	1.25	5.00	-	6.75	-0.75	11.00	-
2006	12 korrik	3.50	0.25	5.25	0.25	7.00	0.25	11.25	0.25
	30 nëntor	3.75	0.25	5.50	0.25	7.25	0.25	11.50	0.25
2007	28 qershor	4.00	0.25	5.75	0.25	7.50	0.25	11.75	0.25
	27 shtator	4.25	0.25	6.00	0.25	7.75	0.25	12.00	0.25
	30 nëntor	4.50	0.25	6.25	0.25	8.00	0.25	12.25	0.25
2008	24 dhjetor	4.50	-	6.25	-	7.00	-1.00	12.25	-
2009	28 janar	4.50	-	6.25	-	7.00	-	12.25	-
	29 janar	4.00	-0.50	5.75	-0.50	6.50	-0.50	11.75	-0.50

Burimi: Banka e Shqipërisë.

STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

7.1 BILANCI I PAGESAVE (në milionë Euro)

Llogaria korente		Bilanci tregtar								Shërbimet		Të ardhurat		Transferta private	Transferta shtetërore
		Eksporti mallrave (fob)		Importi i mallrave (fob)		Kredi		Debi		Gabime dhe harrresa neto	Bilanci i përgjithshëm				
	1 = 4 + 5 + 6 + 7 + 8 + 9 + 10	2	3	4 = 2 + 3	5	6	7	8	9	10					
2005	-589.1	530.2	-2,006.9	-1,476.7	967.3	-1,107.7	168.2	-37.0	835.5	61.4					
2006	-471.0	630.7	-2,289.6	-1,659.0	1,156.6	-1,188.1	263.2	-54.4	968.1	42.5					
2007	-831.0	786.3	-2,890.4	-2,104.0	1,415.2	-1,402.3	278.6	-61.4	982.8	60.1					
2008	-1,290.6	915.9	-3,331.4	-2,415.5	1,524.0	-1,538.6	468.4	-159.0	802.9	27.2					
Llogaria kapitale		Llogaria financiare												Ndryshimi total në rezerva	Nga të cilat: rritjesim
		Investimet e huaja direkte		Investime portofoli		Kapitale të tjera*		Përdorim kreditsh & huash nga FMN							
	11	12 = 13 + 14 + 15 + 16		13	14	15	16	17	18 = 1 + 11 + 12 + 17		19	20	21		
2005	99.2	351.8		209.3	-2.0	135.1	9.4	262.9	124.8		-124.8	-47.4	-77.4		
2006	143.4	415.0		250.3	27.2	131.8	5.8	119.2	206.6		-206.6	-159.2	-47.9		
2007	90.1	758.3		470.1	18.5	264.2	5.5	131.2	148.6		-148.6	99.1	-49.6		
2008	78.2	1,477.6		619.2	-69.2	932.7	-5.2	-73.2	191.9		-191.9	218.4	26.5		

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Nuk përfshihen përdorime huash dhe kreditsh nga FMN.

7.2 EKSPORTI I MALLRAVE SIPAS PARTNERËVE* (në milionë euro)

	Bashkimi Evropian															
	Totali	Austri	Belgjikë	Mbretëri e Bashkuar	Danimarkë	Finlandë	Francë	Gjermani	Greqi	Irlandë	Itali	Luksemburg	Hollandë	Portugali	Spanjë	Suedi
	1=2+3+...+16	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2004	436.57	1.64	0.29	0.16	0.14	0.02	2.49	15.03	58.39	0.01	354.63	-	0.86	-	0.53	2.38
2005	466.67	1.22	0.26	0.72	0.20	-	3.67	17.61	55.42	-	383.92	-	0.72	-	0.48	2.45
2006	553.53	1.78	0.46	0.49	0.35	0.01	4.41	19.91	60.65	0.10	457.91	0.02	1.36	0.01	0.78	5.29
2007	642.90	1.91	0.33	1.79	0.17	0.14	4.91	19.20	65.02	-	534.99	0.22	0.45	0.01	1.30	12.46
2008	714.61	6.21	0.37	0.58	0.35	3.41	7.70	24.54	80.30	6.87	565.77	0.00	13.26	0.01	1.42	3.81
	Vendet e Rajonit															
	Totali	Bullgari	Bosnje Hercegovinë		Kroaci	Serbi & Mali i Zi	Serbi	Mali i Zi	RUM	Rumani	Turqi	Të tjera				
	1=2+3+...+10	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11					
2004	19.16	1.28	0.31	0.32	1.84	-	-	6.04	0.18	9.19	29.85					
2005	27.15	2.92	0.89	0.15	4.47	-	-	8.33	1.28	9.11	36.37					
2006	34.98	2.64	3.44	1.77	8.54	-	-	10.07	0.52	8.00	42.23					
2007	65.08	5.43	3.15	0.73	-	14.10	3.49	18.51	2.37	17.30	81.85					
2008	74.70	6.59	1.53	1.54	-	0.52	19.00	26.99	1.48	17.05	126.56					

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

*Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të bilancit të pagesave. Vlerat e llogaritura të eksportit të mallrave i referohen vlerës f.o.b.

7.3 EKSPORTI SIPAS GRUPMALLRAVE (në milionë euro)

	Totali									
	Ushqime dhe kafshë të gjalla	Pije dhe duhan	Materiale të përpunuara	Lëndë djegëse	Yndyrna bimore dhe shtazore	Produkte kimike	Mallra të përpunuar	Makinëri dhe pajisje	Mallra të tjerë të përpunuar	Mallra të paklasifikuar diku tjetër
	1 = 2 + 3 + ... + 11	2	3	4	5	6	7	8	10	11
2004	485.58	19.84	7.61	18.48	13.17	0.28	2.82	97.31	19.09	-
2005	530.19	20.42	9.63	25.61	15.36	0.23	4.78	114.31	22.16	-
2006	630.74	26.77	8.34	34.84	27.27	0.44	6.22	141.51	24.50	-
2007	786.34	28.43	11.04	75.60	62.47	0.73	8.20	167.40	33.06	-
2008	915.87	32.27	2.63	107.76	81.47	0.21	10.33	231.91	37.95	-

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

*Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të bilancit të pagesave. Vlerat e llogaritura të eksportit të mallrave i referohen vlerës f.o.b.

7.4 IMPORTI I MALLRAVE SIPAS PARTNERËVE* (në milionë euro)

	Bashkimi Evropian															
	Vendet e Rajonit															
	Totali	Austri	Belgjikë	Mbretëri e Bashkuar	Danimarkë	Finlandë	Francë	Gjermani	Greqi	Irlandë	Itali	Luksemburg	Hollandë	Portugali	Spanjë	Suedi
	1=2+3+...+16	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2004	1,190.25	20.47	14.33	10.45	4.15	3.93	25.66	113.81	340.91	5.89	596.61	0.60	13.65	1.26	27.65	10.90
2005	1,258.03	35.86	15.87	18.21	4.03	11.44	25.34	112.79	346.16	8.90	610.76	0.87	17.72	2.09	35.74	12.25
2006	1,385.32	28.97	20.40	33.63	3.63	6.22	23.08	136.18	380.66	7.41	677.25	0.75	12.09	1.78	41.25	12.04
2007	1,647.24	39.65	10.21	37.61	3.75	10.19	30.16	166.87	444.40	8.43	826.24	2.22	16.14	2.61	40.38	8.37
2008	1,925.61	45.33	10.10	36.94	4.90	12.86	42.57	215.63	522.93	7.06	944.38	0.42	19.07	2.27	49.75	11.39
	Të tjera															
	Turqi															
	1=2+3+...+10	2	3	Bosnje Hercegovinë	Kroaci	Serbi & Mali i Zi	Serbi	Mali i Zi	RIJM	Rumani	Turqi					
2004	229.51	36.94	0.91		23.80	10.67	-	-	19.14	7.96	130.09					
2005	296.49	59.18	2.70		24.99	13.16	-	-	25.83	15.31	155.32					
2006	392.10	66.30	6.55		34.59	21.58	-	-	38.85	41.87	182.36					
2007	452.84	54.29	9.19		29.67	-	63.70	2.59	59.08	13.06	221.26					
2008	432.15	68.44	10.31		35.54	-	0.35	6.03	78.80	19.36	213.32					

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

*Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të bilancit të pagesave. Vlerat e llogaritura të importit të mallrave i referohen vlerës c.i.f.

7.5 IMPORTI SIPAS GRUPMALLRAVE (në milionë euro)

	Totali									
	Ushqime dhe kafshë të gjalla	Pije dhe duhan	Materiale të papërpunuara	Lëndë djegëse	Yndyrna bimore dhe shtazore	Produkte kimike	Mallra të përpunuar	Makinëri dhe pajisje	Mallra të tjerë të përpunuar	Mallra të paklasifikuar diku tjetër
	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2004	1,830.51	266.09	58.81	141.10	26.53	166.62	427.48	431.48	250.89	-
2005	2,083.85	272.31	75.92	181.75	28.49	201.77	509.84	488.98	260.09	-
2006	2,410.91	320.88	86.12	254.92	31.52	252.49	618.22	484.68	284.71	-
2007	3044.71	379.30	89.38	446.38	33.96	302.23	754.90	630.91	339.50	-
2008	3555.72	422.61	112.99	564.34	51.89	346.40	848.29	781.07	353.75	-

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

*Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të bilancit të pagesave. Vlerat e llogaritura të importit të mallrave i referohen vlerës c.i.f.